

Profili i  
Barazisë  
Gjinore

# SHQIPËRIA



Funded by  
the European Union



UNITED NATIONS  
ALBANIA



UN  
WOMEN



FOR ALL  
WOMEN  
AND GIRLS

© 2025 UN Women dhe Kombet e Bashkuara.

Ky punim është i disponueshëm për përdorim të hapur, në përputhje me licencën Creative Commons të krijuar për organizatat ndërqeveritare, e cila gjendet në: <https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/3.0/igo/>.

Botuesit duhet të fshijnë logot e Kombeve të Bashkuara Shqipëri, të UN Women dhe të Bashkimit Evropian nga botimet e tyre dhe të krijojnë një dizajn të ri për ballinën e tyre.

Botuesit duhet ta dërgojnë dokumentin e botimit të tyre me email në adresën: [permissions@unwomen.org](mailto:permissions@unwomen.org).

Fotokopje dhe riprodhime të pjesëve të materialit lejohen me kusht citimin e duhur të burimit.

Krijuar nga UN Women Shqipëri, Tiranë, shtator 2025.

Lutemi që këtë botim ta citoni si: UN Women dhe Kombet e Bashkuara Shqipëri, 2025.

*"Profili i barazisë gjinore për Shqipërinë 2025", Tiranë.*

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autoreve dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë pikëpamjet e UN Women, të Kombeve të Bashkuara, të Bashkimit Evropian ose të ndonjë prej organizatave të lidhura me to.

# PROFILI I BARAZISË GJINORE SHQIPËRI

Tirana, Shtator 2025

# FALËNDERIME

**Autore:** Agustela Nini-Pavli, konsulente; Majlinda Nesturi, specialiste e statistikave dhe kërkimit shkencor; Monika Kocaqi, konsulente; Rachele Megna, specialiste e menaxhimit të projekteve, UN Women Shqipëri.

“Profili i barazisë gjinore për Shqipërinë 2025” ka përfituar shumë nga kontributet e konsiderueshme të dhëna nga një numër i madh partnerësh dhe palësh të interesit. Në përputhje me Planin e Përshejtimin të Barazisë Gjinore të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, Profili u hartua bashkërisht nga UN Women dhe ekipi i UN Shqipëri, në kuadër të Grupit të Tematikës dhe Rezultateve Gjinore.

Kontribute të rëndësishme janë dhënë edhe nga anëtarët dhe anëtarët e Grupit Këshillimor Tematik të krijuar në kuadër të hartimit të Profilit. Këtu përfshihen Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Instituti i Statistikave (INSTAT), Institucioni i Avokatit të Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, Rrjeti i Monitorimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore, Universiteti i Tiranës, dhe Zyra Rajonale e UN Women për Evropën dhe Azinë Qendrore.

Po kështu, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri kontribuoi si në aspektin e përmbajtjes, përmes pjesëmarrjes në Grupin Teknik Këshillimor, ashtu edhe financiarisht, përmes projektit “BE-ja për barazinë gjinore” që zbatohet nga UN Women.

Falënderojmë gjithashtu për mendimet e tyre të vyera anëtarët dhe anëtarët e Grupit Koordinues të Partnerëve të Zhvillimit për Çështjet Gjinore, si dhe organizata të shumta të shoqërisë civile që punojnë në fushat e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore në Shqipëri.

Dëshirojmë t’u shprehim mirënjohjen tonë të veçantë këtyre anëtarëve të zyrës së UN Women në Shqipëri: Alba Agolli, Alessia Frialdi, Anja Harasani, Arbenita Mjekiqi, Besmira Kukaj, Dolly Wittberger, Erisa Çela, Fjona Dollani, Irena Shtraza, Michele Ribotta, Sofia Trotti.



Funded by  
the European Union



UNITED NATIONS  
ALBANIA



UN  
WOMEN



FOR ALL  
WOMEN  
AND GIRLS

# TABELA E PËRMBAJTJES

Shkurtesa dhe Akronime	8
Përmbledhje Ekzekutive	11
Hyrje	12
<b>KAPITULLI 1. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI KONTEKSTIN E VENDIT</b>	<b>14</b>
1.1. Konteksti politik	15
1.2. Sistemi i drejtësisë	15
1.3. Konteksti ekonomik	16
1.4. Procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në BE	17
1.5. Varfëria dhe përfshirja sociale dhe reformat e mbrojtjes sociale	19
1.6. Aspekte demografike	20
1.7. Punësimi	21
1.8. Strehimi	22
<b>KAPITULLI 2. KONTEKSTI I BARAZISË GJINORE</b>	<b>24</b>
2.1. Kuadri legjislativ dhe i politikave për barazinë gjinore dhe zbatimin e legjislacionit	25
2.2. Zbatimin e legjislacionit, çështje kyçe të të drejtave të njeriut, përfshirë ankimmimin	29
2.3. Financimi për zbatimin e politikave të barazisë gjinore	31
2.4. Mekanizmi kombëtar i barazisë gjinore	33
2.5. Të dhënat e ndara sipas seksi dhe korniza kombëtare e statistikave gjinore	35
2.6. Roli i OSHC-ve në promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave	39
2.7. Rekomandime	41
<b>KAPITULLI 3. ÇËSHTJE KYÇE TË BARAZISË GJINORE: PROGRESI, SFIDAT DHE REKOMANDIME</b>	<b>44</b>
3.1. Sigurimi i të drejtës për të jetuar pa asnjë formë dhune me bazë gjinore	45
3.1.1. Legjislacioni dhe reagimi përmes politikave për parandalimin dhe trajtimin e DHBGJ-së	45
3.1.2. Përhapja e dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri	50
3.1.3. Qëndrimet dhe njohuritë e publikut për DHBGJ-në	55

3.1.4. Praktikrat e dëmshme (martesat e hershme, përzgjedhja e seksit së foshnjës para lindjes)	56
3.1.5. Politika dhe akte ligjore kyçe të BE-së	58
3.1.6. Rekomandime	59
<b>3.2 Gratë, varfëria dhe mbrojtja sociale</b>	<b>60</b>
3.2.1. Varfëria dhe pabarazia	60
3.2.2. Gratë nga grupet e cenueshme dhe varfëria	63
3.2.3. Mbrojtja sociale	63
3.2.4. Migracioni dhe azili	66
3.2.5. Akte ligjore dhe politika kyçe të BE-së	68
3.2.6. Rekomandime	69
<b>3.3 Fuqizimi ekonomik i grave</b>	<b>70</b>
3.3.1. Veprimtaria ekonomike dhe punësimi	70
3.3.2. Punësimi informal	73
3.3.3. Të ardhurat nga punësimi dhe hendeku gjinor në paga	74
3.3.4. Puna e papaguar dhe balanca punë-jetë	76
3.3.5. Diskriminimi në punë	78
3.3.6. Gratë në ekonominë rurale	80
3.3.7. Sipërmarrja e grave dhe aksesit në mundësi financimi	82
3.3.8. Aksesit në arsim	85
3.3.9. Të drejtat pronësore	86
3.3.10. Turizmi	87
3.3.11. Politika dhe akte ligjore kyçe të BE-së	87
3.3.12. Rekomandime	88
<b>3.4 Pjesëmarrje e barabartë, lidërshtip dhe vendimmarrje</b>	<b>90</b>
3.4.1. Gratë në parlament dhe qeverisjen vendore	91
3.4.2. Dhuna ndaj grave në zgjedhje	95

3.4.3. Gratë në qeveri	97
3.4.4. Gratë në funksione publike	97
3.4.5. Gratë në sistemin gjyqësor	97
3.4.6. Gratë në sektorin e mbrojtjes dhe të sigurisë	99
3.4.7. Trajtimi i hendekut gjinor në sektorët e infrastrukturës dhe TIK-ut	101
3.4.8. Akte ligjore kyçe të BE-së	101
3.4.9. Rekomandime	101

### **3.5. Gjinia, mjedisi, dhe ndryshimet klimatike** **104**

3.5.1. Përmasat gjinore të ndryshimeve klimatike dhe degradimit të mjedisit	104
3.5.2. Aftësia për përballimin e fatkeqësive natyrore	105
3.5.3. Konsiderata gjinore në kushtet e ndryshimeve klimatike, zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe kornizat zhvillimore	106
3.5.4. Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje për klimën dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë	109
3.5.5. Të dhëna të ndara sipas seksit në lidhje me ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre	109
3.5.6. Harmonizimi me politikat dhe legjislacionin e BE-së	110
3.5.7. Rekomandime	110

## **KAPITULLI 4. PIKA HYRËSE DHE MUNDËSI NË KONTEKSTIN E ZBATIMIT TË PVGJ III TË BE-SË** **112**

### **SHTOJCA** **115**

Shtojca 1. Kornizat kombëtare dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore në Shqipëri	116
Shtojca 2. Listë e detajuar e direktivave të BE-së sipas fushave tematike	128
Shtojca 3. Analizë e legjislacionit dhe politikave që trajtojnë dhunën me bazë gjinore	131
Shtojca 4. Treguesit gjinorë	135

### **Referenca** **141**

# SHKURTESA DHE AKRONIME

<b>AFMIS</b>	Sistemi Informativ Shqiptar i Menaxhimit të Financave
<b>AIBZH</b>	Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim
<b>RRFG</b>	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas
<b>DPPV</b>	Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim
<b>KQZ</b>	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
<b>KEGJFDG</b>	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave
<b>PBGJSH</b>	Profili i barazisë gjinore për Shqipërinë
<b>GJDBE</b>	Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian
<b>OSHC</b>	Organizatë e shoqërisë civile
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave
<b>MRF</b>	Menaxhimi i riskut të fatkeqësive
<b>ZRF</b>	Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë
<b>DHF</b>	Dhuna në familje
<b>NE</b>	Ndihma ekonomike
<b>QEAQPF</b>	Qendra Euro-Atlantike e Koordinimit të Përgjigjes ndaj Fatkeqësive
<b>EEA</b>	Agjencia Evropiane e Mjedisit
<b>IEBGJ</b>	Instituti Evropian për Barazi Gjinore
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>PVGJ III i BE-së</b>	Plani i Veprimit Gjinator III i BE-së (2021-2025/2027)
<b>EU-SILC</b>	Statistikat e BE-së për të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës
<b>BEpBGJ</b>	BE për barazinë gjinore
<b>NJF</b>	Ndihma juridike falas
<b>DHBGJ</b>	Dhuna me bazë gjinore
<b>BDGJ</b>	Gender Data Compass (Busulla e të Dhënave Gjinore)
<b>IZHGJ</b>	Indeksi i Zhvillimit Gjinator
<b>HGJP</b>	Hendeku gjinator në paga
<b>BPGJ</b>	Buxhetingu i përgjigjshëm gjinator
<b>GREVIO</b>	Grupi i Ekspertëve për Veprim kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje
<b>RZHNJ</b>	Raport i Zhvillimit Njerëzor
<b>KS</b>	Konventa e Stambollit (Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje)
<b>TIK</b>	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
<b>ONP</b>	Organizata Ndërkombëtare e Punës
<b>K.190 e ONP-së</b>	Konventa Nr.190 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi Dhunën dhe Ngacmimin në Botën e Punës
<b>INSTAT</b>	Instituti i Statistikave të Shqipërisë
<b>IPA III</b>	Instrumenti për asistencë para anëtarësimit III
<b>IPARD III</b>	Instrumenti për asistencë për zhvillimin rural para anëtarësimit III
<b>IPSIS</b>	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit për Planifikimin e Integruar
<b>LGBTIQ+</b>	Personat lesbike, gej, biseksualë, transgjitorë, interseks, kuiër, dhe me identitete gjinore të tjera

<b>PVVGJ</b>	Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore
<b>KVR</b>	Këshill Vendor Rinor
<b>MSHMS</b>	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale <sup>1</sup>
<b>MeIE</b>	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>PBA</b>	Programi i Buxhetit Afatmesëm
<b>AKDF</b>	Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve
<b>SKZRF</b>	Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë
<b>OJQ</b>	Organizatë joqeveritare
<b>SKZHIE</b>	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian
<b>SKBGJ</b>	Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore
<b>SKMS</b>	Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale
<b>SSK</b>	Sistemi Statistikor Kombëtar
<b>OP-KDPAK</b>	Protokolli Opsional i Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara
<b>OSBE</b>	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
<b>AP</b>	Institucioni i Avokatit të Popullit
<b>Marrëveshja e Parisit</b>	Konventa Kuadër e OKB-së për Marrëveshjen për Ndryshimet Klimatike
<b>SBZHRD</b>	Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit
<b>OZHQ</b>	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
<b>KSZRRF</b>	Korniza Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë
<b>ISHPSHSH</b>	Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
<b>STEM</b>	Shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë
<b>TBE</b>	Traktati i Bashkimit Evropian
<b>TFBE</b>	Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian
<b>DUDNJ</b>	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
<b>EKBSH</b>	Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri
<b>UNDP</b>	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
<b>UNDRR</b>	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë
<b>UNEP</b>	Programi i Kombeve të Bashkuara për Mjedisin
<b>UN ESCAP</b>	Komisioni Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara për Azinë dhe Paqësorin
<b>UNFCCC</b>	Konventa Kuadër e Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike
<b>UNFPA</b>	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë
<b>UNHCR</b>	Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët
<b>UNICEF</b>	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
<b>UNOPS</b>	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Projekteve
<b>UN Women</b>	Njësia e Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore dhe Fuqizimin e Grave
<b>UNSCR 1325</b>	Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 'Gratë, paqja dhe siguria'
<b>RPU</b>	Rishikimi Periodik Universal
<b>DHNGV</b>	Dhuna ndaj grave dhe vajzave
<b>PZGR</b>	Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore

1. Sipas Dekretit të Presidentit numër 333, datë 15.09.2025, emërtimi i Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është riemëruar si Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Shih: <https://president.al/presidenti-begaj-dekretoi-perberjen-e-keshillit-te-ministrave/>



# PËRMbledhje Ekzekutive

“Profili i barazisë gjinore – Shqipëri” (PBGJSH) 2025 synon të paraqesë një tablo të përditësuar të çështjeve kryesore të barazisë gjinore në Shqipëri. Ai identifikon sfidat kryesore me të cilat vazhdojnë të përballen gratë dhe vajzat në vend, thekson përparimin e bërë që nga raporti i fundit dhe ofron rekomandime për përmirësime. Raporti mbështetet në botime të mëparshme (2016<sup>2</sup> dhe 2020<sup>3</sup>) dhe, kur ekzistonin të dhëna të disponueshme, paraqet të dhënat më të fundit të ndara sipas seksit dhe përkatësive të shumëfishta si: aftësia e kufizuar, mosha, vendndodhja gjeografike, etj. Në PBGJSH analizohen në hollësi përparimi i bërë dhe sfidat me të cilat vazhdojnë të përballen gratë dhe vajzat në Shqipëri, si dhe ofrohen një numër rekomandimesh tematike për t’u marrë parasysh nga politikëbërësit dhe komuniteti ndërkombëtar. Një risi e rëndësishme e PBGJSH-së së vitit 2025 është integrimi i kornizave të politikave të Bashkimit Evropian (BE) në të gjitha fushat tematike, duke theksuar relevancën dhe rëndësinë e direktivave të BE-së për agjendën e reformave të Shqipërisë. Në secilin kapitull pasqyrohen gjithashtu edhe rekomandime kyçe të kohëve të fundit nga mekanizma të të drejtave të njeriut, ndër të cilët Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit të Grave (KEDG)<sup>4</sup> dhe Rishikimi Periodik Universal (2024).<sup>5</sup>

Procesi i anëtarësimit në BE ka marrë hov të mëtejshëm dhe është bërë katalizator më i fuqishëm për reformat në Shqipëri me hapjen e tre grup-kapitujve deri në maj 2025. Harmonizimi i legjislacionit me *acquis*-in e BE-së për barazinë gjinore është parakusht për një proces anëtarësimi të suksesshëm. Ndër arritjet e deritanishme përfshihen miratimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030<sup>6</sup> dhe i Planit të saj të Veprimit, që shërbejnë si udhërrëfyes për progresin e grave dhe vajzave në Shqipëri në përputhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Shqipëria vazhdimisht i ka shtuar ambiciet e saj në lidhje me buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, që në vitin 2024 përbënte 10 për qind të buxhetit të përgjithshëm. Vendi ka filluar gjithashtu t’u përgjigjet rekomandimeve kyçe të KEDG-së (2024), nga më të rëndësishmit prej të cilëve është rishikimi i ligjit të barazisë gjinore. Ligji i ri (i cili aktualisht po miratohet nga qeveria<sup>7</sup> dhe në shtator 2025, ishte në pritje të miratimit nga Kuvendi)<sup>8</sup> përfshin dispozita për forcimin e makinerisë kombëtare të barazisë gjinore dhe përmban më shumë aspekte të agjendës së barazisë gjinore, si trajtimi i problemit të punës së përkujdesit, si dhe krijon mundësi më ambicioze lidhur

me kuotat e pjesëmarrjes së grave në politikë. Miratimi i Planit të Dytë Kombëtar të Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë<sup>9</sup> është një tregues tjetër i përkushtimit të fuqishëm të Shqipërisë ndaj promovimit dhe zbatimit të Agjendës “Për gratë, paqen dhe sigurinë” në vend. Në vitin 2024, Zyra e Avokatit të Popullit ngriti Observatorin për Femicidet pranë atij institucioni për monitorimin e rasteve të femicideve në vend, në përputhje me metodologjitë më të përparuara ndërkombëtare të hartuara nga Zyra e Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimet dhe UN Women. Me gjithë përparimin solid të Shqipërisë dhe përkushtimin e dukshëm të saj ndaj promovimit të barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave, PBGJSH tregon se ende ka sfida të konsiderueshme në rrugën drejt arritjes së barazisë gjinore reale dhe të plotë për gratë dhe vajzat në të gjitha fushat e jetës. Politikat dhe ligjet ekzistuese shpesh nuk zbatohen, dhuna ndaj grave vazhdon të ekzistojë në të gjitha format e saj, dhe të dhënat kombëtare për përhapjen e dhunës datojnë nga viti 2018,10 gjë që pengon zhvillimin e politikave dhe programeve të përditësuar dhe të bazuara në shifra dhe fakte; gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në organet politike vendore, përballen vazhdimisht me dhunë dhe kanosje në jetën politike, që bart rrezikun e kthimit prapa sa i përket përfaqësimit të tyre në nivelin qendror, dhe gratë vazhdojnë të jenë të mbipërfaqësuar në sektorët me paga të ulëta dhe punësim me kohë të pjesshme, që është pasqyrim i barrierave strukturore ndaj pjesëmarrjes së tyre të plotë në ekonomi. Një faktor i rëndësishëm që kontribuon në këtë pabarazi është ngarkesa shproporcionale me punë të papaguara shtëpiake dhe punë të përkujdesit, që në pjesën më të madhe bie mbi shpatullat e grave. Kjo thekson nevojën për politika për njohjen, zvogëlimin dhe rishpërndarjen e ngarkesës me punë të papaguara të përkujdesit, për të mundësuar fuqizimin ekonomik të grave. Në të gjitha aspektet, gratë që përjetojnë forma të shumëfishta dhe të ndërthurura të diskriminimit vazhdojnë edhe më tej të mbeten pas dhe të jenë më të rrezikuara të nga pabarazia.

Në përgjithësi, PBGJSH paraqet një tablo të përzier të barazisë gjinore në Shqipëri: ndonëse që nga viti 2020 është bërë përparim i fuqishëm sa i përket hartimit të legjislacionit dhe politikave, sfidat ende të pranishme në zbatimin e këtyre kornizave përsëri rezultojnë në pabarazi vijuese me ndikim negativ mbi gratë shqiptare.

2. UN Women (2016). [Dosja Gjinore - Shqipëri](#).

3. UN Women (2020). [Dosja e Barazisë Gjinore, Shqipëri 2020](#).

4. UN Women. [Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave](#).

5. Këshilli i të Drejtave të Njeriut i Kombeve të Bashkuara (2024). [Universal Periodic Review – Albania](#). (Rishikimi Periodik Universal – Shqipëria)

6. UN Women (2021). [Strategjia Kombëtare për barazinë gjinore në shoqëri 2021-2030](#)

7. Vendimi nr. 432, datë 31.7.2025.

8. Projektligji që iu dorëzua Kuvendit gjendet në <https://www.parlament.al/dokumentacioni/aktet/c94610c7-8f7f-4274-a3a7-bdf6ff2459f6>

9. UN Women (2023). [Planit Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për gruan, paqen dhe sigurinë”](#)

10. Ju lutem vini re se këto të dhëna statistikore i referohen përhapjes së dhunës në të gjithë popullsinë, matur me anë të metodologjisë ndërkombëtare, që gjendet në: <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2019/05/violence-against-women-and-girls-in-albania-0#:~:text=Following%20the%20first%20and%20second,a%20primary%20education%20or%20less.>

“Profili i barazisë gjinore - Shqipëri” (PBGJSH) i vitit 2025 ofron një vlerësim gjithëpërfshirës dhe të bazuar në të dhëna të situatës së barazisë gjinore dhe të fuqizimit të grave në Shqipëri. Ai vlerëson kornizat ligjore dhe të politikave, identifikon dallimet gjinore në të gjithë sektorët kyç dhe ofron rekomandime përkatëse për forcimin e reformave reaguese gjinore në fushat institucionale dhe të politikëbërjes. Raporti analizon përparimin e bërë, sfidat që vazhdojnë të ekzistojnë, si dhe mundësitë kyçe për përparimin e barazisë gjinore në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE dhe angazhimeve ndërkombëtare të Shqipërisë. Përmes trajtimit të pabarazive gjinore në fushat politike, ekonomike dhe shoqërore, PBGJSH shërben si instrument strategjik për hartuesit e politikave, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile, duke përforcuar rolin e barazisë gjinore si gur themeli i zhvillimit të qëndrueshëm të Shqipërisë dhe i agjendës për integrimin evropian të saj. Barazia gjinore mbetet përparësi themelore në zhvillimin ekonomik, politik dhe shoqëror të Shqipërisë. Megjithëse vendi ka bërë përparime të rëndësishme në fushën legjislative, ende vazhdojnë të ekzistojnë pengesa ndaj progresit të grave, sidomos – ndër të tjera – në fusha si pjesëmarrja ekonomike, përfaqësimi politik, aksesit në drejtësi, mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore (DHBGJ), pjesëmarrja në vendimmarrje në lidhje me klimën, dhe njohuritë digjitale. Forcimi i koordinimit mes institucioneve, mekanizmave ligjzbatuese, dhe alokimi të burimeve janë me rëndësi kritike për të siguruar që politikat dhe kornizat ligjore të Shqipërisë të çojnë në përmirësime të prekshme për gratë dhe vajzat.

## Qëllimi dhe objektivat

PBGJSH është një instrument strategjik në shërbim të qeverisë së vendit, institucioneve të BE-së, organizatave ndërkombëtare dhe aktorëve të shoqërisë civile për monitorimin e tendencave të barazisë gjinore dhe krijimin e politikave të së ardhmes. Raporti synon:

- të vlerësojë përparimin e bërë nga Shqipëria për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave gjatë periudhës 2020-2025.
- të vlerësojë efektivitetin e politikave, legjislacionit dhe mekanizmave institucionale të vendit në funksion të avancimit të barazisë gjinore.
- të identifikojë barrierat kryesore gjinore ndaj pjesëmarrjes së grave në ekonomi, udhëheqje politike dhe përfshirje shoqërore.

- të analizojë zbatimin nga Shqipëria të kornizave kryesore ndërkombëtare, ndër të cilat Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave (KEGJFDG), Rishikimi Periodik Universal (RPU), Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), dhe Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit).
- të paraqesë një tablo të përgjithshme të dokumenteve legjislative kryesore të BE-së në lidhje me barazinë gjinore në fusha të ndryshme.
- të ofrojë rekomandime për politikën, si dhe rekomandime operative, për të siguruar harmonizimin me objektivat ndërkombëtare të barazisë gjinore dhe prioritetet tematike të Analizës së Përbashkët të Vendit 2025, të sistemit të Kombeve të Bashkuara, si dhe me prioritetet e Kuadrit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm (UNSDCF) për qeverinë e re shqiptare.
- të shërbejë si bazë për rishikimin afatmesëm të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore (2021-2030) dhe Planit të saj të Veprimit, përfshirë nëpërmjet vlerësimit të mangësive në të dhëna.
- të mbështesë qeverinë dhe institucionet e pavarura të Shqipërisë, si dhe të plotësojë monitorimin dhe raportimin mbi kornizat normative globale dhe rajonale, përmes ofrimit të një analize gjithëpërfshirëse të ndikimit të kornizave normative dhe legjislative mbi fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore.
- të sigurojë – përmes përdorimit të një qasjeje të bazuar në të drejtat dhe përkatësitë e shumëfishta – që rekomandimet për politikën të jenë gjithëpërfshirëse, të bazuara në të dhëna statistikore dhe të realizueshme, duke mbështetur kështu procesin e integritit të Shqipërisë dhe duke kontribuar në arritjen e objektivave të OZHQ-ve.

## Konteksti dhe harmonizimi me angazhimet ndërkombëtare

Shqipëria ka demonstruar angazhim të fuqishëm ndaj barazisë gjinore në kuadër të detyrimeve të saj sipas Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave (KEGJFDG), Rishikimit Periodik Universal (RPU), dhe Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ). Këto angazhime reflektohen më tej edhe në prioritetet kombëtare të Kuadrit të Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara

(UNSDCF) 2022-2026, që integron barazinë gjinore në politikat qeveritare, ekonomike dhe të zhvillimit shoqëror. Krahas kësaj, procesi i anëtarësimit të Shqipërisë në BE ofron një mundësi për avancimin e barazisë gjinore përmes harmonizimit të politikave kombëtare me Planin e Veprimit Gjinor të BE-së III (PVGJ III i BE-së) 2021-2025/2027,<sup>11</sup> *acquis*-in e BE-së mbi barazinë gjinore, dhe Udhërrëfyesin e ri të BE-së për të Drejtat e Grave (2025). Megjithatë, harmonizimi i plotë kërkon angazhim politik të vazhdueshëm, ndërtim të kapaciteteve institucionale dhe investime financiare për përfshirjen e këndvështrimit gjinor në të gjitha ligjet, politikat dhe reformat.

## Objekti dhe metodologjia

PBGJSH përdor një metodologji shumëdimensionale, me kombinim të analizave sasiore dhe cilësore. Vlerësimi bazohet në një shqyrtim të hollësishëm të kornizave ligjore dhe politikave të vendit, të kriterëve të anëtarësimit në BE, dhe angazhimeve globale. Ai mbështetet në të dhëna statistikore nga burime kombëtare dhe ndërkombëtare, ndër të cilët Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT), Banka Botërore, dhe Instituti Evropian për Barazi Gjinore (IEBGJ). Përveç kësaj, ai përfshin edhe informacione dhe mendime nga institucione qeveritare, përfaqësues të BE-së, agjenci të Kombeve të Bashkuara dhe organizata të shoqërisë civile (OSHC). Gjatë përgatitjes së tij u organizuan mbledhje konsultuese me Grupin e Rezultateve Tematike Gjinore të OKB-së, Delegacionin e BE-së dhe OSHC-të aktive, si pjesë e procesit të brendshëm të garantimit cilësisë, ndërsa procesi i jashtëm i garantimit të cilësisë u realizua përmes një grupi këshillimor teknik, i krijuar për të dhënë udhëzime në lidhje me zhvillimin, miratimin dhe publikimin e PBGJSH-së. Ky grup këshillimor drejtohet nga UN Women Shqipëri dhe në të bëjnë pjesë të gjitha palët e interesit në krijimin dhe përdorimin e PBGJSH-së.<sup>12</sup> Një element i rëndësishëm i kësaj metodologjie është qasja e bazuar në përkatësitë e shumëfishta, që garanton që dallimet gjinore të analizohen duke marrë parasysh faktorë të shumëfishtë dhe të ndërthurur, si moshë, përkatësia etnike, aftësia e kufizuar, statusi rural dhe kushtet social-ekonomike. Vëmendje e veçantë u kushtohet grupeve të marginalizuara, si gratë rome dhe egjiptiane, gratë me aftësi të kufizuara, personat lesbike, gejt, biseksualë, transgjinorë, interseks, kuir dhe personat me identitete gjinore të tjera (LGBTIQ+), dhe gratë

në zonat rurale, të cilat shpesh përjetojnë diskriminim të shumëfishtë.

## Struktura e raportit

PBGJSH është strukturuar në katër kapituj, ku secili analizon një përmasë specifike të barazisë gjinore në Shqipëri:

**Kapitulli 1: Vështrim i përgjithshëm mbi kontekstin e vendit** analizon faktorët politikë, ekonomikë dhe demografikë që ndikojnë në situatën e barazisë gjinore në Shqipëri. Ai ofron kontekstin më të përgjithshëm për reformat dhe zbatimin e politikave, përmes vlerësimit të strukturave qeverisëse, tendencave social-ekonomike, dhe dinamikave rajonale. Gjithashtu kapitulli vlerëson përparimin e bërë nga Shqipëria drejt integritimit në BE, duke konsideruar urbanizimin, migracionin, dhe moshimin e popullsisë si ndikime kryesore në dinamikat gjinore.

**Kapitulli 2: Konteksti specifik i barazisë gjinore** analizon kornizat ligjore dhe institucionale të barazisë gjinore në Shqipëri, përmes vlerësimit të efektivitetit të ligjeve, politikave dhe sistemeve të të dhënave gjinore në avancimin e të drejtave të grave. Ai thekson rolin e shoqërisë civile në kryerjen e punës bindëse dhe avokuese, ofrimin e shërbimeve dhe ndikimin e saj në politika, dhe thekson nevojën e bashkëpunimit shumëpalësh.

**Kapitulli 3: Çështje të barazisë gjinore, barriera dhe sfida kryesore** përbëhet nga pesë nënkaptuj tematikë të rëndësishëm:

*Nënkaptulli 3.1. Sigurimi i të drejtës për të jetuar pa asnjë formë dhune me bazë gjinore*

*Nënkaptulli 3.2. Gratë, varfëria dhe mbrojtja sociale*

*Nënkaptulli 3.3. Fuqizimi ekonomik i grave*

*Nënkaptulli 3.4. Barazi e grave në pjesëmarrje, rol drejtues dhe vendimmarrje*

*Nënkaptulli 3.5. Gjinia, ndryshimet klimatike dhe reduktimi i riskut nga fatkeqësitë*

**Kapitulli 4: Pika të përgjithshme dhe specifike sektoriale të hyrjes për mbështetjen politike dhe operacionale të BE-së dhe dialog me BE-në** ofron informacion për lidhjet midis PVGJ III të BE-së dhe Udhërrëfyesit për të Drejtat e Grave të BE-së me objektivat e barazisë gjinore të Shqipërisë.

11. Komisioni Evropian (2023). EU extends the duration of the Gender Action Plan from 2025 until 2027 in external action to build on its achievements towards a gender-equal world. (Bashkimi Evropian zgjat afatin e Planit të Veprimit Gjinor nga 2025 në 2027 në kuadër të veprimit të jashtëm, për të çuar më tej arritjet drejt një bote me barazi gjinore)

12. Si Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, INSTAT-i, Delegacioni i BE-së në Shqipëri, Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, Rrjeti i Monitorimit të Dhunës me Bazë Gjinore, dhe përfaqësues nga bota akademike.



7

**VËSHTRIM I  
PËRGJITHSHËM  
MBI KONTEKSTIN  
E VENDIT**

## Ky kapitull ofron informacion bazë që shërben për të kuptuar sfondin më të gjerë social dhe politik, ekonomik dhe demografik në të cilin zhvillohen përpjekjet për arritjen e barazisë gjinore dhe të fuqizimit të grave në Shqipëri.

### 1.1 KONTEKSTI POLITIK

Shqipëria është republikë parlamentare me një sistem pluralist të përbërë nga tri degë: pushteti legjislativ, ekzekutiv, dhe gjyqësor. Kryetar i shtetit është presidenti, i zgjedhur nga Kuvendi për një maksimum prej dy mandate pesëvjeçare; presidenti nuk ka pushtet ekzekutiv, por ushtron disa kompetenca mbi forcat e armatosura dhe gjyqësorin. Kryeministri, si kreu i qeverisë, ka kompetenca të konsiderueshme ekzekutive dhe është përgjegjës për përcaktimin e politikave, menaxhimin e ekzekutivit dhe mbikëqyrjen e administrimit të përditshëm të punëve të shtetit.

Shqipëria ka një parlament me një dhomë (Kuvendi), me 140 anëtarë që zgjidhen për mandate katërvjeçare. Skena politike e vendit vazhdon të karakterizohet nga polarizimi dhe tensione të shpeshta politike midis partive rivale, që ndikojnë efektshmërinë e punës parlamentare, përfshirë në lidhje me mbikëqyrjen nga parlamenti të veprimtarisë së ekzekutivit, që vazhdon të jetë e dobët.<sup>13</sup>

Që nga organizimi i zgjedhjeve demokratike në vitin 1991, Shqipëria ka përdorur disa sisteme elektorale (mazhoritar, proporcional, dhe kombinim të të dyve). Sistemi i tanishëm, që ka hyrë në fuqi në vitin 2008, është një sistem proporcional rajonal, i bazuar në zona zgjedhore shumë-emërore. Me ndryshimet më të fundit në Kodin Zgjedhor në korrik 2024, u prezantuan dy modele të strukturës së fletës së votimit: a) lista shumë-emërore me rend të fiksuar të kandidatëve; dhe b) lista shumë-emërore e kandidatëve që i nënshtrohen votimit parapëlqyes.<sup>14</sup> Krahas kësaj, u sanksionua me ligj edhe votimi i shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë shtetit, që konsiderohet një arritje e madhe për sistemin demokratik të vendit. Këto ndryshime përfshinë edhe dispozita të

reja për ruajtjen dhe garantimin e kuotës gjinore prej 30 për qind në të dy format e strukturës së fletës së votimit (listat e hapura dhe të mbyllura e kandidatëve).<sup>15</sup>

Shqipëria ka bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e legjisllacionit zgjedhor në kontekstin e barazisë gjinore, përmes vendosjes së kuotave gjinore dhe garancive të tjera. Megjithatë, këto zbatohen vetëm në zgjedhjet e deputetëve në Kuvend dhe në zgjedhjet për këshillat bashkiakë, por jo për kandidatët dhe kandidatet në zgjedhjet për kryetar/kryetare bashkie.

### 1.2 SISTEMI I DREJTËSISË

Shqipëria vazhdon të zbatojë reformën në drejtësi, të filluar në vitin 2016, me fokus forcimin e shtetit të së drejtës, pavarësisë së gjyqësorit, aksesit në drejtësi për të gjithë qytetarët, dhe për adresimin e problemit të korrupsionit – që ka rezultuar në përmirësime të rëndësishme në funksionimin e gjyqësorit.<sup>16</sup> Në vitin 2021 filloi zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë (2021-2025) së bashku me Strategjinë për Edukimin Ligjor (2019-2023). Megjithëse sipas Komisionit të BE-së cilësia e strategjisë dhe e monitorimit të saj ishin në përgjithësi të kënaqshme, shkalla e zbatimit dhe kapacitetet e raportimit të institucioneve gjyqësore kompetente mbeten të ulëta dhe cilësia e të dhënave statistikore mbetet e dobët.<sup>17</sup> Ndër dokumente të tjera të rëndësishme të miratuara në kontekstin e reformës në drejtësi janë Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur (2022-2026) dhe Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit (2024-2030).

Krahas tyre, është miratuar një Strategji e re Ndërsektoriale e Drejtësisë për periudhën 2024-2030,

13. Komisioni Evropian (2024). Albania Report, 2024 (Raporti për Shqipërinë, 2024).

14. Kjo ndryshon nga sistemi i mëparshëm i votimit parapëlqyes, në të cilin votuesit zgjidhnin jo vetëm partinë ose koalicionin, por edhe kandidatin ose kandidaten që parapëlqenin, çka mundësonte që votuesit të kishin potencialisht ndikim edhe në renditjen e kandidatëve.

15. UN Women (2024). Gratë në politikë në Shqipëri: Informacion për trajnimin e trajnerëve për ndërtimin e kapaciteteve të grave kandidate në politikë dhe këshilltare në këshillat bashkiakë, Programi "Gratë në udhëheqje" i UN Women Shqipëri, shtator 2024.

16. Komisioni Evropian (2024).

17. Po aty.

e cila trajton aspekte që lidhen me edukimin ligjor të publikut. Megjithatë, kjo strategji përgjithësisht nuk i trajton çështjet përmes këndvështrimit gjinor dhe nuk njuh apo trajton sfidat e panumërta me të cilat përballen gratë për të pasur akses në drejtësi.<sup>18</sup> Këto probleme janë dokumentuar në shumë raporte në vite, përfshirë në raporte të organizatave ndërkombëtare, OJQ-ve dhe të Avokatit të Popullit, dhe janë ndër rekomandimet kryesore të mekanizmave ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut në Shqipëri.<sup>19</sup>

Shqipëria vazhdon të bëjë përparim sa i përket forcimit të sistemit të ndihmës juridike falas (NJF) bazuar në Ligjin "Për ndihmën juridike falas", që mundëson shërbime juridike parësore dhe dytësore për personat me të ardhura të ulëta dhe për persona të tjerë të cënueshëm.<sup>20</sup> Numri i përfituesve nga ndihma juridike parësore po rritet, falë zgjerimit të qendrave të ndihmës juridike falas.<sup>21</sup> Megjithatë, duhet bërë punë e mëtejshme në lidhje me nevojat specifike të grave me cënueshmëri të shumëfishta, përfshirë gratë viktime të dhunës dhe fëmijët, të cilat ende nuk plotësohen.

### 1.3 KONTEKSTI EKONOMIK

Shqipëria është një vend me të ardhura të mesme të larta. Pas recesionit ekonomik të shkaktuar nga pandemia COVID-19, vendi pati një rimëkëmbje të fuqishme në vitin 2021, me një rritje reale të PPB-së prej 8,5 për qind, në sajë të stimuljeve politikë dhe rritjes së konsiderueshme të aktiviteteve ekonomike në sektorët e udhëtimit, ndërtimit dhe industrisë nxjerrëse.<sup>22</sup> Rritja ekonomike u kthye në

nivelet para pandemisë, me një rritje të PPB-së me 4,9 për qind në vitin 2022 dhe 3,5 për qind në vitin 2023, që, ndonëse shënonte ulje, ishte më e lartë se projeksioni prej 3 për qind.<sup>23</sup> Ekonomia pritet të ketë rritje me përshpejtim të moderuar, deri në 3,4 për qind, në vitin 2025. Kjo rritje i atribuohet konsumit shumë të qëndrueshëm privat, si dhe aktiviteteve në fushat e turizmit dhe të ndërtimit.<sup>24</sup> Sidoqoftë, rritja e çmimeve ushqimore dhe të energjisë mund të ndikojë në rritjen ekonomike në të ardhmen, sepse mund të ndikojë të në ardhurat reale të disponueshme, të ngadalësojë reduktimin e varfërisë dhe të ngushtojë hapësirën fiskale.<sup>25</sup> Vlerësimi i BE-së i viteve të fundit mbi kriteret ekonomike vëren stabilitet në sektorin financiar, por vë në dukje edhe ekzistencën në vijimësi të përmasave të mëdha të ekonomisë informale që pengon mjedisin e biznesit dhe konkurrencën.<sup>26</sup> Gratë janë veçanërisht të prekura, sepse ato janë më së tepërmi të angazhuara në punët e papaguara në familje, bujqësi dhe si punëtore shtëpiake, që vazhdojnë të jenë, në pjesën më të madhe, sektorë informalë.

Bashkimi Evropian është mbështetësi kryesor i zhvillimit social-ekonomik dhe i reformave në Shqipëri, përmes asistencës financiare dhe teknike të ofruar në kuadër të instrumentit të asistencës para anëtarësimit (IPA). Fondet e IPA III për programet kombëtare ishin rreth 250 milion euro për periudhën 2021-2023.<sup>27</sup> Në këtë kontekst është dhënë mbështetje edhe për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, përmes një numri projektesh të financuara nga BE-ja, ku përfshihen fonde të drejtpërdrejta për OSHC-të, si edhe fondet në kuadër të programit të përbashkët të OKB-së "BE për barazinë gjinore në Shqipëri – zbatimi i *acquis*-it të BE-së për barazinë gjinore", që zbatohet

18. UN Women e shqyrtoi projekt-strategjinë e re që u vu në dispozicion për konsultim publik në shtator-tetor 2024 dhe shprehu shqetësimin se rekomandimet gjithëpërfshirëse që i ishin bërë Ministrisë së Drejtësisë për përfshirjen e perspektivës gjinore në strategjinë e re – të harmonizuara me legjisllacionin shqiptar për integrimin gjinor në politikat sektoriale – nuk ishin marrë parasysh.

19. Vërejtjet përmbyllëse të Komitetit të KEGJFDHG-së, 2023; Raporti i vlerësimit i GREVIO-s, 2024; Projekt-rekomandimet e RPU-së për Shqipërinë, 2024, dhe dokumente të tjera.

20. Fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, viktimat e dhunës në familje, dhunës seksuale dhe trafikimit të qenieve njerëzore, personat që përjetojnë diskriminim, etj.

21. Që nga dhjetori 2023, në Shqipëri funksionojnë 20 qendra të ndihmës juridike falas, të menaxhuara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas, 12 nga të cilat mbështeten nga buxheti i shtetit dhe tetë nga UNDP dhe Agjencia Austriake për Zhvillim. Shih: <https://ndihmajuridike.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/12.-Analiza-Statistikore-Dhjetor-2023.pdf>

22. Banka Botërore (2022). <https://openknowledge.worldbank.org/entities/publication/daee74fc-66e7-5e3f-84de-3cfd30259e3>.

23. Fondi Monetar Ndërkombëtar, Albania: 2024 Staff Visit Press Release (Shqipëria: Njoftim për shtyp nga vizita e misionit në vitin 2024), 15 korrik 2024.

24. Banka Botërore, Shqipëri (2024). Economic Outlook (Parashikimi ekonomik), përditësimi i fundit në tetor 2024.

25. Banka Botërore (2024). *Western Balkans Regular Economic Report* (Raporti i rregullt ekonomik për Ballkanin).

26. Komisioni Evropian (2024).

27. EU Data (2023). Albania on its European path (Shqipëria në rrugën evropiane).

nga UN Women dhe Fondi i Kombeve të Bashkuara për Popullsinë (UNFPA) dhe financohet nga BE-ja përmes Fondit të Përsheptimit të OZHQ-ve (faza I, 2021-2023) dhe përmes BE për Barazinë Gjinore, faza II—Instrumenti i Barazisë Gjinore në Shqipëri (2024-2027).

## 1.4 PROCESI I ANËTARËSIMIT TË SHQIPËRISË NË BE

Integrimi në BE dhe përparimi i negociatave të anëtarësimit mbeten ndër prioritetet më kryesore të vendit dhe janë shtysë për zbatimin e një numri reformash, shumë prej të cilave kanë lidhje të drejtpërdrejtë me barazinë gjinore (në ekonomi, drejtësi, mbrojtje sociale dhe përfshirje sociale). Në vijim paraqitet një përmbledhje e arritjeve më kryesore në negociatat e Shqipërisë me BE-në, që po ndihmojnë vendin të përgatitet të përmbushë detyrimet që burojnë nga anëtarësimi në BE.

- Negociatat për anëtarësim u hapën në korrik të vitit **2022**. Ato u bazuan në kuadrin negociues në vijim të një shqyrtimi analitik, ose “procesit të shqyrtimit të përputhshmërisë”, i organizuar në bazë të gjashtë grup-kapitujve.<sup>28</sup> Këta grup-kapituj pasqyrojnë *acquis*-in e BE-së, dhe përbëhen nga kapituj individualë që mbulojnë secili një fushë të caktuar të politikave, si dhe nga parime dhe standarde më të përgjithshme.
- Procesi i shqyrtimit të përputhshmërisë së Shqipërisë përfundoi në nëntor **2023** për të gjashtë grup-kapitujt. Pas kësaj u bënë përgatitjet për hapjen zyrtare të negociatave për grup-kapitullin 1: “Themeloret”, ose parimet dhe vlerat e përbashkëta të BE-së që lidhen me: (i) funksionimin e institucioneve demokratike dhe reformën e administratës publike; (ii) shtetin e së drejtës;<sup>29</sup> dhe (iii) kriteret ekonomike.<sup>30</sup>

- Në nëntor të vitit **2024** u hapën zyrtarisht negociatat për “Themeloret”, pas dorëzimit nga Shqipëria të tre udhërrëfyesve të kërkuar, në bazë të të cilëve do të kryhen negociatat dhe reformat e saj.<sup>31</sup> Negociatat për këtë grup-kapitull hapen të parat dhe mbyllen të fundit, dhe përparimi i tyre do të përcaktojë edhe ritmin e përgjithshëm të negociatave. Në qoftë se do të ketë përparim të mjaftueshëm në kryerjen e reformave, kjo do ta sjellë Shqipërinë më afër integritimit në BE përmes integritit të përsheptuar dhe shtimit të investimeve dhe financimeve.<sup>32</sup>

Paralelisht me përparimin në procesin e anëtarësimit në BE, Shqipëria duhet t'i japë përparësi barazisë gjinore, mbrojtjes së grave dhe promovimit të duhur të të drejtave të tyre në përputhje me kornizat përkatëse gjithëpërfshirëse ligjore dhe të politikave të BE-së.

Arritja e barazisë gjinore në BE dhe më gjerë është përparësi e BE-së, bazuar në **Strategjinë e Barazisë Gjinore të BE-së (2020-2025)**.<sup>33</sup>

Strategjia zbaton një qasje të dyfishtë për përfshirjen e perspektivës gjinore, të kombinuar me veprime të synuara, dhe përkatësia e shumëfishtë është një parim horizontal në zbatimin e saj. Në mars të vitit 2025 u miratua **Udhërrëfyti i BE-së për të Drejtat e Grave**, me të cilin Komisioni Evropian përforcoi më tej përkushtimin ndaj barazisë gjinore, me një vizion afatgjatë për progres në këtë fushë. Udhërrëfyti ndërton mbi arritjet dhe përparimin e konsiderueshëm që u arrit në kuadër të Strategjisë së Barazisë Gjinore 2020-2025 dhe synon të krijojë kushte të mëtejshme për arritjen e tetë objektivave të rëndësishme: e drejta për të jetuar pa dhunë me bazë gjinore; standarde më të larta shëndetësore; paga të barabarta dhe fuqizim ekonomik; balanca punë-jetë personale dhe përkujdesi; mundësi punësimi të barabarta

28. Këta janë: Themeloret; tregu i brendshëm; konkurrenshmëria dhe rritja gjithëpërfshirëse; agjenda e gjelbër dhe konektiviteti i qëndrueshëm; burimet, bujqësia dhe kohezioni; dhe marrëdhëniet e jashtme. Negociatat hapen për secilin grup si i tërë, pasi të jenë plotësuar standardet bazë për hapjen e negociatave. Çdo kapitull trajtohet si njësi më vete, për sa i përket mbylljes provizore të tij.

29. Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore; dhe Kapitulli 24: Drejtësia, liria dhe siguria.

30. Ekzistenca e një ekonomie tregu funksionuese; kapaciteti për të përballuar trysnitë e konkurrencës dhe të forcave të tregut në BE; Kapitulli 5: Prokurimi publik; Kapitulli 18: Statistikat, dhe Kapitulli 32: Kontrolli financiar.

31. Udhërrëfyti për reformën për administratën publike; udhërrëfyti për kapitujt e shtetit të së drejtës, dhe udhërrëfyti për funksionimin e institucioneve demokratike.

32. Komisioni Evropian (2024). EU Accession Process Step by Step (Procesi i anëtarësimit hap pas hapi).

33. Objektivat kryesore janë: e drejta për të mos përjetuar dhunë; kundërvënia ndaj stereotipeve gjinore; ngushtimi i dallimeve gjinore në tregun e punës; arritja e pjesëmarrjes së barabartë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë; trajtimi i dallimeve gjinore në paga dhe pensione; ngushtimi. Dallimeve gjinore në punët e përkujdesit dhe arritja e balancës gjinore në vendimmarrje dhe politikë.

dhe kushte pune të përshtatshme; arsim përfshirës dhe cilësor; pjesëmarrje në politikë dhe përfaqësim i barabartë; dhe mekanizma institucionalë që mundësojnë realizimin e të drejtave të grave.<sup>34</sup> Në tetor të vitit 2023, Komisioni i BE-së miratoi **Planin e ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor**. Plani bazohet në metodologjinë ekzistuese të BE-së për zgjerimin dhe synon t'i sjellë partnerët e Ballkanit Perëndimor më afër BE-së duke u ofruar atyre, përpara anëtarësisht të rajonit në BE, disa përfitime që gëzojnë shtetet anëtare të BE-së, me qëllim forcimin e rritjes ekonomike dhe përsheptimin e konvergencës social-ekonomike.<sup>35</sup> Krahas kësaj, u krijua edhe **Instrumenti** për Reforma dhe Rritje,<sup>36</sup> që përbën boshtin e Planit të Rritjes, i cili shton ndihmën financiare mbi bazën e një agjende reformash me fokus reformat social-ekonomike, krahas reformave të tjera themelore. Ai bazohet në parimin e kushtëzimit, përmes krijimit të një mekanizmi pagesash që do të varet nga arritjet e këtyre reformave. Ai plotëson instrumentin ekzistues IPA III, me fokus mbi tregues specifikë të rritjes sociale dhe ekonomike.<sup>37</sup>

Si një nga përfitueset e këtij programi të ri, Shqipërisë i kërkohet të përgatisë një agjendë reformash me të gjitha masat kryesore që duhet të zbatohen deri në vitin 2027 për përsheptimin e konvergencës social-ekonomike me BE-në. Në këtë kontekst, një kriter kryesor është që zbatimi i Instrumentit të Rritjes dhe i Planit të Rritjes duhet të promovojë dhe avancojë aktivisht barazinë gjinore dhe integrimin gjinor, të sigurojë pjesëmarrjen reale të grave në proceset vendimmarrëse, dhe të mbështesë fuqizimin e grave dhe vajzave. Përveç këtyre, ai duhet të synojë të mbrojë dhe nxisë të drejtat e grave dhe vajzave dhe të parandalojë dhe të luftojë të gjitha format e dhunës ndaj

grave dhe të dhunës në familje, në përputhje me Planin e Barazisë Gjinore të BE-së, përfundimet përkatëse të Këshillit, dhe konventave ndërkombëtare në këtë fushë.<sup>38</sup> Në vijim të kërkesave, Komisioni Evropian ka miratuar *Instrumentin për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor – Agjenda e Rritjes e Shqipërisë*,<sup>39</sup> së bashku me instrumentet përkatëse të vendeve të tjera të Ballkanit Perëndimor.<sup>40</sup> Në pjesën narrative të Planit, integrimi gjinor është përfshirë gjerësisht në të gjitha fushat e politikave, sidomos në Kapitullin 5, ku theksohet përfshirja e tij në shtyllat e kapitalit njerëzor, klimës së biznesit, tranzicionit digjital dhe të gjelbër, themeloreve dhe sundimit të ligjit, si edhe në kuadër të zbatimit të Agjendës së Reformave. Megjithatë, pjesa e buxhetit nuk përfshin përcaktime të detajuara në lidhje me integrimin gjinor, as si nënfushë më vete, dhe as si linjë specifike aktivitetesh. Kjo mungesë thekson nevojën për ta trajtuar integrimin gjinor më qartë dhe shprehimisht, përmes bashkërendimit dhe bashkëpunimit me vendimmarrësit dhe institucionet publike të Shqipërisë gjatë zbatimit të Planit.

Nga Shqipëria kërkohet gjithashtu që të harmonizojë plotësisht legjislacionin dhe praktikën zbatuese me legjislacionin e BE-së mbi trajtimin e barabartë dhe eliminimin e diskriminimit mes grave dhe burrave, bazë për të cilat janë, ndër të tjera:

- Traktati i Bashkimit Evropian (TBE): nenet 2-3 dhe 6;<sup>41</sup>
- Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian (TFBE): nenet 8-10, 18-19 dhe 157;<sup>42</sup>
- Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian: kapitujt III dhe IV (nenet 20-38);<sup>43</sup>
- Direktivat e Parlamentit Evropian dhe të Këshillit lidhur me trajtimin e barabartë të burrave dhe grave në

34. Komisioni Evropian (2025). Udhërrëfyeni i BE-së për të Drejtat e Grave: a renewed push for gender equality (Udhërrëfyeni i BE-së për të drejtat e grave: një shtysë e mëtejshme për barazi gjinore).

35. Komisioni Evropian (2023). Communication new Growth Plan for the Western Balkans. (Komunikimi i Planit të ri të Rritjes për Ballkanin Perëndimor).

36. Instrumenti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor – Agjenda e Reformave e Shqipërisë.

37. Rregullorja (BE) 2024/1449, e miratuar nga bashkëlegjislatorët më 14 maj 2024. Establishing the Reform and Growth Facility for the Western Balkans (Krijimi i Instrumentit për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor).

38. Po aty.

39. Komisioni Evropian. Instrumenti për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor – Agjenda e Reformave e Shqipërisë.

40. Komisioni Evropian (2024). Vendim zbatues i Komisionit për miratimin e Agjendave të Reformave dhe programit shumëvjeçar të punës në kuadër të Instrumentit për Reforma dhe Rritje për Ballkanin Perëndimor. Shih: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/commission-implementing-decision-approving-reform-agendas-and-multiannual-work-programme-under\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/commission-implementing-decision-approving-reform-agendas-and-multiannual-work-programme-under_en)

41. Bashkimi Evropian (2012). Consolidated version of the Treaty of the European Union (Versioni i konsoliduar i Traktatit të Bashkimit Evropian).

42. Bashkimi Evropian (2012). Consolidated version of the Treaty of the Functioning of the European Union (Versioni i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian)

43. Karta e të Drejtave Themelore e Bashkimit Evropian: Kapitujt III and IV (nenet 20-38). Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=celex%3A12012M%2FTXT>

fushat e ndryshme të kompetencave të tri shtyllave të BE-së.<sup>44</sup> Këtu përfshihen direktivat në lidhje me çështje të punësimit dhe profesionit,<sup>45</sup> pagat (paga të barabarta),<sup>46</sup> sigurimet shoqërore, vetëpunësimin,<sup>47</sup> dhe aksesin dhe furnizimin me mallra dhe shërbime.<sup>48</sup> Janë miratuar gjithashtu edhe direktiva për balancën punë-jetë<sup>49</sup> dhe për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtoreve shtatzëna,<sup>50</sup> standardet për organet e barazisë në fushën e trajtimit të barabartë dhe mundësive të barabarta mes grave dhe burrave për çështje të punësimit dhe profesionit,<sup>51</sup> dhe kohët e fundit, në maj 2024, direktiva e parë për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës në familje (DHF).<sup>52</sup> Krahas tyre, janë edhe një numër i madh aktesh ligjore në kuadër të *acquis*-it të BE-së që i kushtojnë vëmendje kritereve të barazisë gjinore.

- Jurisprudenca përkatëse e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian (GJDBE), e cila siguron që ligjet e BE-së të interpretohen dhe zbatohen në të njëjtën mënyrë në çdo shtet të BE-së dhe garanton që shtetet dhe institucionet e BE-së t'u përmbahen ligjeve të BE-së. Ndër vite, GJDBE-ja ka dhënë shumë vendime për çështje që lidhen me diskriminimin me grave dhe burrave në shtetet anëtare të BE-së bazuar në traktatet dhe direktivat e sipërpërmendura të BE-së (*acquis*-i i BE-së).<sup>53</sup>

Së fundi, BE-ja ka miratuar gjithashtu Planin e Veprimit Gjiner III të BE-së (2021-2025/2027) për promovimin e barazisë gjinore dhe të fuqizimit të grave në të gjithë veprimtaritë e jashtme të BE-së (politikat e jashtme dhe të sigurisë).<sup>54</sup>

## 1.5 VARFËRIA DHE PËRFSHIRJA SOCIALE DHE REFORMAT E MBROJTJES SOCIALE

Gjatë viteve, Shqipëria ka bërë përparim në trajtimin e problemit të varfërisë, ndër të tjera përmes zhvillimit ekonomik dhe reformave në fushat e mbrojtjes dhe përfshirjes sociale. Shkalla e riskut për të qenë i/e varfër është ulur gradualisht, nga 23 për qind në vitin 2019 në 19,7 për qind në vitin 2023.

Megjithatë, shumë njerëz ende janë të rrezikuar nga përjashtimi social dhe nuk mund të marrin pjesë plotësisht në shoqëri për shkak të aksesit të kufizuar në burimet, të drejtat dhe shërbimet që janë të disponueshme për shumicën e popullsisë. Gratë dhe vajzat janë veçanërisht ndikuar: shkalla e riskut të varfërisë është më e lartë tek gratë (20,2 për qind) se tek burrat (19,3 për qind).

44. Bashkimi Evropian, 2018, Shtyllat e Evropës. Trashëgimia e Traktatit të Mastroihtit 25 vjet më vonë. Shih [https://www.consilium.europa.eu/media/38778/expo\\_maastricht-brochure\\_en.pdf](https://www.consilium.europa.eu/media/38778/expo_maastricht-brochure_en.pdf)

45. Direktiva (BE) 2024/1500 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 maj 2024 "Për standardet për organet e barazisë në fushat e trajtimit të barabartë dhe mundësive të barabarta të grave dhe burrave për çështje të punësimit dhe profesionit, që ndryshon Direktivat 2006/54/EC dhe 2010/41/EU". Marrë nga: <http://data.europa.eu/eli/dir/2024/1500/oj>

46. Direktiva (BE) 2023/970 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 10 maj 2023 "Për forcimin e zbatimit e parimit të pagës së barabartë për punë të barabartë ose punë me vlerë të barabartë midis burrave dhe grave nëpërmjet transparencës së pagave dhe mekanizmave të zbatimit".

47. Direktiva 2010/41/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 7 korrik 2010 "Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave të vetëpunësuar, që shfuqizon Direktivën e Këshillit 86/613/EEC". Marrë nga <http://data.europa.eu/eli/dir/2010/41/oj>

48. Direktiva e Këshillit Nr. 2004/113/EC e datës 13 dhjetor 2004 "Për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në lidhje me aksesin dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve".

49. Direktiva (BE) 2019/1158 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 qershor 2019 "Për balancën punë-jetë për prindërit dhe kujdestarët dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 2010/18/EU". Marrë nga <http://data.europa.eu/eli/dir/2019/1158/oj>

50. Direktiva e Këshillit 92/85/EEC e datës 19 tetor 1992 "Për përfshirjen e masave për nxitjen e përmirësimeve në sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtoreve shtatzëna dhe punëtoreve që kanë pak kohë që kanë lindur, apo që kanë fëmijë në gji" (Direktiva e dhjetë e individuale sipas përcaktimit të nenit 16 (1) të Direktivës 89/391/EEC). Marrë nga <http://data.europa.eu/eli/dir/1992/85/oj>

51. Po aty, Direktiva (BE) 2024/1500.

52. Direktiva (BE) 2024/1385 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 maj 2024 "Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje". Marrë nga <http://data.europa.eu/eli/dir/2024/1385/oj>

53. [https://curia.europa.eu/jcms/jcms/j\\_6/en/](https://curia.europa.eu/jcms/jcms/j_6/en/)

54. Komunikatë e Përbashkët e Parlamentit Evropian dhe Këshillit: "Plani i Veprimit Gjiner (PVGJ) III i BE-së – Një agjendë ambicioze për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në politikën e jashtme të BE-së". Shih: [https://ec.europa.eu/international-partnerships/system/files/join-2020-17-final\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/international-partnerships/system/files/join-2020-17-final_en.pdf); PVGJ III i BE-së është plotësisht i harmonizuar me instrumente ndërkombëtare si: Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave (KEGJFDG); Platforma për Veprim e Pekinit (PpVP); dhe Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 'Gratë, paqja dhe siguria' (UNSCR 1325). Ky plan u shty deri në vitin 2027. Shih: [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/%20en/ip\\_23\\_5858](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/%20en/ip_23_5858)

Përqindja është veçanërisht e lartë ndër fëmijët 0-17 vjeç (26,5 për qind, krahasuar me 19,2 për qind në popullatën e rritur, 18-64 vjeç).<sup>55</sup>

Shqipëria ka ndërmarrë një varg reformash të mbrojtjes sociale, bazuar në një kuadër solid ligjor dhe të politikave, ku përfshihen: Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” i vitit 2016, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020 (afati për zbatimin e së cilës u shty deri më 2023) dhe Strategjia Kombëtare aktuale për Mbrojtjen Sociale (SKMS) 2024-2030, që u miratua në janar 2024. Strategjia fokusohet në mbrojtjen sociale të popullatave të pafavorizuara me të ardhura të ulëta përmes ndihmës në të holla<sup>56</sup> dhe shërbimeve të kujdesit shoqëror.<sup>57</sup> Këto janë pjesë e skemës së përgjithshme të mbrojtjes sociale, që përfshin gjithashtu edhe sigurimet shoqërore,<sup>58</sup> si dhe programet e punësimit dhe të tregut të punës.<sup>59</sup> Janë hartuar një numër dokumentesh të politikave të mbrojtjes sociale dhe përfshirjen e grupeve të caktuara të pafavorizuara.<sup>60</sup> Me gjithë këto përmirësime, vazhdimisht janë ngritur shqetësime në lidhje me mjaftueshmërinë e ndihmave sociale, disponueshmërinë e shërbimeve sociale dhe rolin e programeve për nxjerrjen e njerëzve nga varfëria, sikurse pranohet edhe në SKMS 2024-2030.<sup>61</sup>

## 1.6 ASPEKTE DEMOGRAFIKE

Në qershor 2024, Shqipëria botoi rezultatet e “Censit të popullsisë dhe banesave në Shqipëri”<sup>62</sup> që është veprimtaria kryesore statistikore e Institutit të Statistikave (INSTAT) që kryhet çdo dhjetë vjet. Shqipëria ka një popullsi prej 2.402.113 banorësh, që shënon një rënie me

420.000 banorë që nga Censi i vitit 2011, kur popullsia e Shqipërisë ishte 2.821.977. Kjo e dhënë konfirmon shqetësimet e shprehura gjatë dhjetë viteve të fundit nga publiku për rënien e shpejtë të numrit të popullsisë së Shqipërisë, që i atribuohet kryesisht migracionit dhe shkallës më të ulët të fertilitetit.

Struktura e popullsisë aktuale përbëhet nga 49,6 për qind meshkuj dhe 50,4 për qind femra. Në moshat e vogla deri në 10 vjeç, numri i meshkujve tejkalon atë të femrave me një raport gjinor më të lartë se 108. Ky raport përmbysset rreth moshës 40 vjeç dhe pëson rënie të ndjeshme pas moshës 80 vjeç, për shkak të jetëgjatësisë më të madhe të femrave krahasuar me meshkujt. Raporti gjinor në popullsinë mbi 80 vjeç është 82,1; gjithashtu pesë nga gjashtë individët me moshë mbi 100 vjeç janë gra.

Sa i përket *statusit martesor*, 54,9 për qind e popullsisë janë të martuar, 36,6 për qind nuk janë martuar ndonjëherë, shtatë për qind e popullsisë janë të ve/të veja, dhe 1,4 për qind janë të divorcuar ose të ndarë. Në popullatën e ve, 82,3 për qind janë gra. Ndër personat e divorcuar ose të ndarë, gratë përbëjnë shumicën, 58,9 për qind. Ndërsa ndër personat që nuk janë martuar ndonjëherë (beqarë/e) meshkujt përbëjnë 55,7 për qind, për shkak të moshës mesatare më të vonshme të martesës. Analiza e shpërndarjes gjinore dhe moshore të popullatës së martuar tregon një përqindje shumë më të lartë të grave dhe vajzave të grupmoshave më të reja, për shkak të martesës së tyre në moshë më të re. Për shembull, në grupmoshën 15 deri 19 vjeç, ka 1.713 vajza/të reja të martuara kundrejt 215 djemve/të rinjve të martuar, ndërsa në grupmoshën 20-24 vjeç, ka 14.398 të reja të martuara kundrejt 2.239 të rinjve të martuar.<sup>63</sup>

55. INSTAT. “Anketa mbi të ardhurat dhe nivelin e jetesës në Shqipëri (EU-SILC) 2023”, botuar në dhjetor 2024. Shih: [https://www.instat.gov.al/media/14638/income-and-living-conditions-survey-2023\\_1312.pdf](https://www.instat.gov.al/media/14638/income-and-living-conditions-survey-2023_1312.pdf)

56. Ndihma Ekonomike (NE) dhe subvencione të ndryshme për përfituesit e NE-së, pensioni për aftësi të kufizuar, pensioni social.

57. Shërbimet sociale dhe të familjes.

58. Pensionet me kontribute dhe pa kontribute.

59. Formimi profesional, subvencionet e pagave, trajnimet në punë dhe praktikatat profesionale, mbështetja e sipërmarrjeve, ndihmat për të papunët, ndihma për nënat me fëmijë të vegjël, etj.

60. Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025, Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025, Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2025, Plani Kombëtar i Veprimit për De-institucionalizimin 2020-2022, Strategjia e Strehimit Social 2016-2025, i përditësuar në vitin 2021, Plani Kombëtar i Veprimit 2021-2027 për personat LGBTI, dhe Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2021-2023.

61. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 152, datë 13.3.2024, “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj”. Shih: <https://faolex.fao.org/docs/pdf/alb230041.pdf>

62. INSTAT (2024). “Censi i popullsisë dhe banesave në Shqipëri”. Shih: <https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2024/albanian-population-and-housing-census-2023/>

63. Tabela 3, Popullsia sipas seksit, grupmoshës dhe statusit martesor. Shih: <https://www.instat.gov.al/media/13626/cens-2023-census-botim.pdf>

Sa i përket *arsimit*, shkalla e aftësisë për shkrim e lexim në popullsinë e moshës 15 vjeç e lart është 97,7 për qind. Në popullsinë mbi 15 vjeç, 96,8 për qind kanë përfunduar shkollën ose po ndjekin shkollën aktualisht. Shkalla e aftësisë për shkrim e lexim ndër të rriturit është më e lartë tek meshkujt (98,1 për qind) krahasuar me femrat (97,2 për qind). Shkalla e aftësisë për shkrim e lexim ndër të rinjtë dhe të rejtat e grupmoshës 15-24 vjeç është 99,1 për qind (98,9 për qind për femrat dhe 99,2 për qind për meshkujt).

Në popullsinë e moshës 15 e lart, mbi 38,8 për qind kanë përfunduar arsimin e mesëm të ulët dhe 34,8 për qind kanë përfunduar arsimin e mesëm të lartë, që konsiderohet niveli arsimor minimal që i ndihmon njerëzit të jenë të aftë për të pasur pjesëmarrje të plotë në shoqëri dhe për të qenë të realizuar në jetë. Rreth 0,6 për qind e popullsisë nuk kanë përfunduar asnjë nivel arsimor. Nga popullsia e përgjithshme e personave që kanë përfunduar arsimin universitar, 55,7 për qind janë femra dhe 44,3 për qind janë meshkuj. Përqindja e femrave me arsim universitar është rritur vazhdimisht, nga 41,1 për qind në Censin e vitit 2001 në 51 për qind në Censin e vitit 2011 dhe 55,7 për qind në Censin e vitit 2023.

Prevalenca e aftësisë së kufizuar në popullsinë me moshë 5 vjeç e lart është 6,5 për qind. Ndër individët me të paktën një aftësi të kufizuar, pjesa më e madhe janë femra (56 për qind) krahasuar me meshkujt (44 për qind), që vë në pah nevojën për politika të posaçme që trajtojnë vështirësitë me të cilat përballen gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara. Nga popullsia me aftësi të kufizuara, 59,5 për qind janë të moshës 65 vjeç e lart. Analiza sipas grupmoshave tregon se prevalenca e aftësisë së kufizuar ndër burrat dhe djemtë të moshës 5 deri 49 vjeç është pak më e lartë se sa ndër gratë dhe vajzat (përkatësisht dy për qind për burrat dhe djemtë dhe 1,6 për qind për gratë dhe vajzat). Megjithatë, në popullsinë e moshës 50 e lart, ky raport përmbysset. Kjo tendencë me gjasë pasqyron jetëgjatësinë më të madhe të grave në popullatën e moshuar, që është më e cenueshme nga aftësitë e kufizuara. Numri total i

*njësive ekonomike familjare* ishte 755.950, që përbën një rritje me 4,7 për qind në krahasim me Censin e vitit 2011. Madhësia mesatare e njësive ekonomike familjare është 3,2 anëtarë, krahasuar me 3,9 anëtarë në Censin e vitit 2011. Rreth një e katërta e njësive ekonomike familjare (24,3 për qind) kanë kryefamiljare gra, që është personi që përgjithësisht merr vendimet kryesore në familje dhe njihet si kryefamiljar(e) nga të gjithë anëtarët e tjerë të familjes. Kjo përfaqëson një rritje të ndjeshme krahasuar me 14 për qind të njësive ekonomike familjare që kishin kryefamiljare gra, që u raportuan në Censin e vitit 2011. Pjesa më e madhe e njësive ekonomike familjare (82,5 për qind) janë pronare të banesës ku jetojnë.

## 1.7 PUNËSIMI

Kohët e fundit, shkalla e papunësisë në Shqipëri është ulur – në vitin 2023 ajo ishte 10,7 për qind, 0,2 pikë përqindjeje më e ulët se në vitin 2022.<sup>64</sup> Është bërë njëfarë përparimi edhe në fushën e të drejtave në punës, si rritja e pagës minimale në 40.000 lekë në muaj (e barabartë me 466 USD ose 406 euro<sup>65</sup>); ratifikimi i Konventës 190 të ONP-së mbi Eliminimin e Dhunës dhe Ngacmimit në Botën e Punës, etj.

Megjithatë, përfshirja e grave dhe e të rinjve dhe të rejave nga komunitetet e pafavorizuara në tregun e punës mbetet problematike. Në vitin 2023, pjesëmarrja e grave në tregun e punës ishte 12,4 për qind më e ulët se e burrave.<sup>66</sup> Hendeku gjinor në paga në vitin 2023 ishte 6,2 për qind, i njëjtë me vitin 2022, por përbën një rritje prej 1,7 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2021.<sup>67</sup> Duhet përmendur se në këto shifra nuk përfshihen gratë që kryejnë punë informale ose punë të papaguar. Gratë vazhdojnë të kenë nivel më të lartë inaktiviteti krahasuar me burrat: përkatësisht 30,4 për qind dhe 18 për qind në vitin 2023. Informaliteti vazhdon të jetë shqetësim: një pjesë e konsiderueshme e popullatës në marrëdhënie pune mbetet e padukshme – e pa pasqyruar në statistika – dhe gratë janë veçanërisht të prekura në këtë drejtim.

64. INSTAT (2024). "Tregu i punës në Shqipëri, 2023". Shih: <https://www.instat.gov.al/media/13552/tregu-i-punes-2023.pdf>

65. Kursi i këmbimit më 05.06.2025 ishte USD: 85,87 dhe EUR: 98,05. Të gjitha konvertimet në këtë raport bazohen në këtë kurs këmbimi. Shih: [https://www.bankofalbania.org/Markets/Official\\_Exchange\\_rate/](https://www.bankofalbania.org/Markets/Official_Exchange_rate/)

66. INSTAT, "Anketa e forcave të punës", shkalla e papunësisë, T1 2019 - T1 2023. Shih: <https://www.instat.gov.al/en/themes/labour-market-and-education/employment-and-unemployment-from-lfs/#tab2>

67. Po aty.

Në vitin 2023, përqindja e punësimit informal në sektorin jobujqësor ishte 26,2 për qind, që shënon një rënie me dy pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2022.<sup>68</sup> Në zonat rurale, gratë nuk marrin pagë mujore për punën e kryer në fermat familjare, por identifikohen si të vetëpunësuar.<sup>69</sup>

## 1.8 STREHIMI

Shqipëria është një nga vendet me ritmet më të shpejta të urbanizimit në Evropë, por përballlet me shumë sfida, si mungesa e banesave të përballueshme financiarisht në zonat me zhvillim të hovshëm dhe deprivimi i përhapur në zonat me popullsi në rënie. Ndonëse Shqipëria ka ndër përqindjet më të larta të banesave të pabanuara në Evropë, shkalla e mbipopullimit është mbi 58 për qind— më e larta në Evropë pas Malit të Zi.<sup>70</sup> Tërmeti i nëntorit 2019 ndikoi ndjeshëm në burimet financiare të vendit, sepse nga ai u prekën, drejtpërdrejt ose tërthorazi, më shumë se 200.000 banorë, gjë që bëri të nevojshme rindërtimin e 11.490 njësive banesash.<sup>71</sup>

Të dhënat e Censit 2023 tregojnë se në Shqipëri ka 726.325 banesa konvencionale, të ndërtuara kryesisht mes viteve 1981 dhe 2010. Prej tyre, 18 për qind kanë sipërfaqe banimi të përdorshme prej më pak se 40 m<sup>2</sup>, pothuaj gjysma janë me sipërfaqe midis 40 m<sup>2</sup> dhe 69 m<sup>2</sup>, një e katërta kanë sipërfaqe 70-99 m<sup>2</sup>, ndërsa vetëm 3 për qind janë mbi 130 m<sup>2</sup>. Në një të tretën e banesave konvencionale me sipërfaqe banimi deri në 40 m<sup>2</sup> banojnë katër ose më shumë banorë.

Të dhënat e Censit tregojnë se njësitë ekonomike familjare po zvogëlohen – NJEF-të me një anëtar tani përbëjnë 13,7 për qind të numrit të përgjithshëm të tyre. Shumica e NJEF-ve – më saktësisht, dy të tretat e NJEF-ve përbëhet nga familjet me dy deri në katër anëtarë, ndër të cilat më të zakonshmet janë ato me dy anëtarë. NJEF-të më të mëdha, me pesë ose më shumë anëtarë, janë më

të rralla (19,5 për qind) por përsëri përbëjnë një përqindje të konsiderueshme të popullsisë (35,8 për qind). Rreth një e katërta e NJEF-ve përbëhen nga një çift i martuar ose që bashkëjeton, me ose pa fëmijë apo anëtarë të tjerë të familjes.

Shqipëria ka miratuar dhe po zbaton një paketë gjithëpërfshirëse reformash në sektorët e strehimit, planifikimit urban, zhvillimit rajonal dhe menaxhimit të tokës, me qëllim përputhjen e tyre me standardet ndërkombëtare përkatëse.<sup>72</sup> Këtu përfshihen programe të strehimit social për trajtimin e problemeve që lidhen me përballueshmërinë e strehimit, përmes ofrimit të banesave sociale me qira, banesave me kosto të ulët, dhe përdorimin e tokës për ndërtimin e njësive të banimit. Ligji "Për strehimin social" (2018) ka zgjeruar fushëveprimin e tij me qëllim trajtimin e nevojave për banesë t grupeve më të pafavorizuara në shoqëri, ku përfshihen gratë kryefamiljare, gratë viktime të dhunës, dhe familjet nga pakicat rome dhe egjiptiane.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për vitin 2021, nga 2.700 përfitues të programit të strehimit, 302 ose 11,2 për qind ishin gra kryefamiljare dhe viktime të dhunës në familje. Në fund të gushtit 2022, nga rreth 2.400 përfitues, 174 ose 7,2 për qind ishin gra kryefamiljare dhe viktime të dhunës në familje. Megjithatë, buxheti i caktuar për zbatimin e programeve të strehimit ndahet sipas kategorive të programit dhe nuk ka një fond të dedikuar nga i cili të përfitojnë vetëm gratë.<sup>73</sup>

68. INSTAT, "Tregu i punës 2023". Shih: <https://www.instat.gov.al/media/14273/tregu-i-punes-2023.pdf>

69. INSTAT, "Tregu i punës 2021". Shih: <http://www.instat.gov.al/media/10066/tregu-i-punes-2021.pdf>

70. UNECE, "Profile të vendeve në lidhje me zhvillimin urban, strehimin dhe menaxhimin e tokës: Shqipëria". Shih: [https://unece.org/sites/default/files/2024-05/ECE%20HBP%20226\\_CPAIbania\\_E.pdf](https://unece.org/sites/default/files/2024-05/ECE%20HBP%20226_CPAIbania_E.pdf)

71. Po aty.

72. Strategjia e Strehimit Social (2016-2025), Ligji "Për strehimin social" i vitit 2018, Ligji "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i vitit 2014, Ligji "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", Plani i Përgjithshëm Hapësinor Kombëtar i Shqipërisë 2015-2030, Ligji "Për zhvillimin rajonal dhe kohezionin" i vitit 2020.

73. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 152, datë 13.3.2024, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj". Shih: <https://faolex.fao.org/docs/pdf/alb230041.pdf>



A large, stylized white number '2' is positioned in the upper left quadrant. The background is a solid purple color with various abstract, semi-transparent shapes in lighter shades of purple, including circles, rectangles, and overlapping geometric forms. The overall aesthetic is modern and graphic.

2

**KONTEKSTI  
I BARAZISË  
GJINORE**

## Arritja e barazisë gjinore është një nga shtyllat qendrore të qeverisjes demokratike dhe zhvillimit të qëndrueshëm. Shqipëria po ndërmerr hapa të rëndësishëm drejt harmonizimit me standardet evropiane dhe ndërkombëtare dhe me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Kombeve të Bashkuara.

Si vend kandidat për integrim në Bashkimin Evropian, Shqipëria është e përkushtuar që të harmonizojë kuadrin e saj ligjor dhe të politikave mbi barazinë gjinore me kornizat përkatëse të BE-së, si edhe të forcojë dhe garantojë të drejta të barabarta në të gjithë sektorët. Sikurse u paraqit në Dosjen e Barazisë Gjinore të Shqipërisë 2020,<sup>74</sup> Shqipëria ka nënshkruar konventa ndërkombëtare të rëndësishme dhe ka miratuar politika proaktive për ngushtimin e hendeqeve gjinore, konsolidimin e institucionalizimit, dhe krijimin e mundësive të barabarta.

Përkushtimi i fuqishëm i Shqipërisë ndaj barazisë gjinore shihet qartë edhe në një numër indeksesh globale dhe rajonale, ku përfshihen **raportet globale mbi hendeqet gjinore (Global Gender Gap – GGG)** të Forumit Ekonomik Botëror, **baza e të dhënave globale e OZHQ-ve, Indeksi 'Gratë, paqja dhe siguria 2023/2024', 'Raporti i zhvillimit njerëzor 2023/2024' (Human Development Report – HDR), dhe 'Treguesi i të dhënave gjinore 2023' (Gender Equality Index – GEI).** Në vitin 2020, Shqipëria publikoi për herë të parë **"Indeksin e barazisë gjinore për Republikën e Shqipërisë"**,<sup>75</sup> që u hartua nga INSTAT-i në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, me mbështetjen e Institutit Evropian për Barazi Gjinore (IEBGJ) dhe Bankës Botërore. Mbështetur në të dhëna të vitit 2017, Shqipëria shënoi 60,4 nga 100 në vlerësimin e strukturuar të barazisë gjinore në gjashtë fusha thelbësore: puna, paraja, dijet, koha, pushteti dhe shëndeti. Performanca e Shqipërisë ishte më e mirë në fushën e shëndetit, por rezultate të mira u shënuan edhe në fushën e pushtetit, ku ajo e tejkaloi mesataren e BE-së si rezultat i pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje politike dhe ekonomike. Indeksi i vitit 2020 nuk përfshiu dy fushat shtesë – atë të dhunës ndaj grave dhe të pabarazive të ndërthurura – që, ndonëse të rëndësishme, nuk ndikojnë në rezultatin e përgjithshëm dhe shërbejnë vetëm për qëllimin e kryerjes së analizave. Me gjithë këto kufizime, botimi i parë i indeksit të barazisë gjinore të Shqipërisë shënoi një hap të rëndësishëm përpara. Indeksi ofroi një instrument kombëtar dhe të

përputhshëm me BE-në për monitorimin e barazisë gjinore dhe informimin e politikave publike. Botimi i ardhshëm i indeksit pritet të përfshijë edhe dy fushat shtesë, që do të ofrojnë një tablo më gjithëpërfshirëse të pabarazive gjinore në Shqipëri. Ky zgjerim do të shtojë kapacitetet e vendit për të trajtuar jo vetëm hendeqet gjinore, por edhe pabarazitë strukturore dhe ato për shkak të përkatësive të shumëfishta që ndikojnë grupe të ndryshme grash dhe burrash në të gjithë shoqërinë. Gjatë viteve, dhe sidomos në periudhën e fundit pesëvjeçare, 2020-2024, Shqipëria ka bërë përparim të konsiderueshëm në krijimin e një kuadri legjislativ dhe të politikave që synon eliminimin e diskriminimit gjinor dhe promovimin e fuqizimit të grave. Organizatat e shoqërisë civile (OSHC) dhe organizatat ndërkombëtare kanë luajtur një rol kyç në nxitjen e këtij zhvillimi, sidomos përmes fokusimit të tyre në grupet e pafavorizuara, sigurimit të shërbimeve kritike për të mbijetuarat e dhunës, dhe mobilizimit në terren. Ato kanë ndihmuar gjithashtu në nxitjen e reformave përmes monitorimit të veprimtarive të qeverisë dhe shtimit të llogaridhënies. Megjithatë, këto veprime ende nuk kanë arritur të trajtojnë probleme si patriarkalizmi i rrënjosur thellë, fondet e pamjaftueshme për programet, dhe zbatimin e pabarabartë të mbrojtjeve ligjore dhe, rrjedhimisht, koordinimi në vijimësi midis institucioneve qeveritare, OSHC-ve dhe organizatave ndërkombëtare ka rëndësi kritike për nxitjen e një zhvillimi konkret, të barabartë dhe gjithëpërfshirës.

### 2.1 KUADRI LEGJISLATIV DHE I POLITIKAVE PËR BARAZINË GJINORE DHE ZBATIMI I LEGJISLACIONIT

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka përsheptuar përpjekjet për harmonizim me standardet ndërkombëtare të barazisë gjinore. Në qendër të këtyre përpjekjeve ka qenë zbatimi i konventave ndërkombëtare, zhvillimi i legjislationit progresiv, dhe krijimi i strategjive dhe planeve të fokusuara të veprimit. Megjithatë, kapërcimi

74. <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/12/country-gender-equality-brief-albania-2020-0>

75. [https://www.instat.gov.al/media/6657/gender\\_equality\\_index\\_for\\_the\\_republic\\_of\\_albania\\_2020\\_alb.pdf](https://www.instat.gov.al/media/6657/gender_equality_index_for_the_republic_of_albania_2020_alb.pdf)

i dallimeve gjinore sistemike kërkon ndërhyrje sistemike, ndër të cilat përmes veprimeve lidhur me aspekte legislative, politike, ndërgjegjësuese dhe institucionale. Mangësitë në përmbushjen e standardeve, dhe në financim e koordinim mes palëve të ndryshme të interesit mund të pengojnë përpjekjet për përshejtimin përmbushjes së standardeve të barazisë gjinore.

Kuadri ligjor i Shqipërisë për barazinë gjinore mbështetet fort në standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, me Kushtetutën dhe legjislacionin e vendit që pasqyrojnë angazhimet kryesore globale, disa prej të cilave janë: Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa për të Drejtat Politike të Grave, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Krahas tyre, Shqipëria ka ratifikuar instrumente kryesore të të drejtave të njeriut në lidhje me barazinë gjinore, si Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave (KEGJFDG) dhe Protokollin Opsional të saj, së bashku me traktate të tjera të rëndësishme si Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim (DPPV), Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), dhe Konventa mbi të Drejtat e Fëmijëve (KDF), Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), Konventa 190 e ONP-së mbi Eliminimin e Dhunës dhe Ngacmimit në Botën e Punës, etj. Në Shtojcën I jepet një pasqyrë e plotë e kornizave ligjore ndërkombëtare që orientojnë politikën kombëtare në Shqipëri.

Kuadri ligjor i Shqipërisë promovon barazinë gjinore dhe të drejtat e grave dhe pasqyron angazhimet ndërkombëtare dhe normat e BE-së për një shoqëri gjithëpërfshirëse. Në të përfshihet Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji "Për barazinë gjinore në shoqëri", Ligji "Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare", Ligji "Për mbrojtjen nga diskriminimi" etj., që e vendosin barazinë gjinore si parim themelor të jetës politike dhe sociale në Shqipëri

dhe ndalojnë diskriminimin në bazë të seksit. Gjatë pesë viteve të fundit, Shqipëria ka forcuar më tej kuadrin ligjor për përmirësimin e mbrojtjes nga diskriminimi gjinor dhe dhuna me bazë gjinore, dhe për promovimin e të drejtave të grave, përfshirë përmes ndryshimeve në kodin penal dhe ndryshimeve në Kushtetutë dhe në Kodin Zgjedhor.

**Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030**<sup>76</sup> (SKBGJ 2021-2030), miratuar në qershor 2021, është një instrument kyç për promovimin e të drejtave të grave dhe luftimin e DHBGJ-së. Ajo ka një lidhje të fortë me **Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm** (në veçanti OZHQ-të 1, 3, 4, 5, 8, 10, 11, 13, 16 dhe 17) dhe është e harmonizuar me kornizat më të rëndësishme ndërkombëtare dhe rajonale, ndër të cilat KEGJFDG, DPPV, Konventa e Stambollit, dhe Plani i Veprimit Gjinor III i BE-së (2021-2025/2027). **Vizioni i Strategjisë është** barazia dhe drejtësia gjinore si parakusht për zhvillimin e qëndrueshëm të Shqipërisë, me tolerancë zero për dhunën dhe praktikën e dëmshme. Strategjia i vë theksin fort **fuqizimit të të gjitha grave, të rejave dhe vajzave**, sidomos ato nga grupet e cënueshme dhe të pafavorizuara, si gratë, të rejtat dhe vajzat nga zonat rurale, pakicat etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTIQ+, nënat e vetme, viktimat e përdhunimit, viktimat e trafikimit, gratë e moshuara, azilkërkuese, etj., në gjithë diversitetet e tyre. Ndonëse SKBGJ 2021-2030 u hartua me një kornizë gjithëpërfshirëse monitorimi dhe vlerësimi afatmesëm dhe deri më sot janë hartuar tre raporte monitorimi,<sup>77</sup> përparimi i zbatimit të saj në periudhën 2021-2023 nuk ka qenë i njëtrajtshëm sikurse pasqyrohet në përmbledhjen e shkallës së zbatimit të aktiviteteve për periudhën 2021-2023 në Tabelën 1.<sup>78</sup>

SKBGJ 2021-2030 do t'i nënshtrohet një procesi rishikimi afatmesëm në vitin 2025, që ka si objektivi vlerësimin e përparimit të bërë, identifikimin e prioriteteve që dalin, si dhe që të shërbejë si bazë për planifikimin buxhetor institucional për periudhën 2026-2028.<sup>79</sup> Ndonëse mekanizmat e koordinimit, kapacitetet institucionale dhe përpjekjet për mbledhjen e të dhënave janë forcuar gradualisht, raportet e monitorimit vënë në pah nevojën

76. Vendim i Këshillit të Ministrave nr.400, datë 30.06.2021. Shih: <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2022/02/national-strategy-for-gender-equality-2021-2030>

77. Raportet përgatiten nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale me mbështetjen teknike të UN Women Shqipëri.

78. "Raport monitorimi: Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planit të saj të Veprimit 2021-2030" për vitin 2021, f. 6. Shih: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2022/10/Raport-Monitorimi-per-vitin-2021-SKBGJ.pdf>; "Raport monitorimi: Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planit të saj të Veprimit 2021-2030" për vitin 2022, f 5-6. Shih: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2023/06/Raport-i-Monitorimit-SKBGJ-2022-.pdf>; Raport monitorimi: Zbatimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planit të saj të Veprimit 2021-2030" për vitin 2023, f 5-6, (i pabotuar).

79. SKBGJ 2021-2030, f. 45.

**Tabela 1**

**Përmbledhje e zbatimit të aktiviteteve bazuar në raportet e monitorimit të SKBGJ-së për vitet 2021, 2022 dhe 2023**

Objektiva strategjike	% e aktiviteteve të zbatuara plotësisht			% e aktiviteteve të zbatuara pjesërisht			% e aktiviteteve në proces zbatimi			% e aktiviteteve të pazbatuara ende			% e aktiviteteve për të cilat nuk ka informacion për statusin e zbatimit		
	2021	2022	2023	2021	2022	2023	2021	2022	2023	2021	2022	2023	2021	2022	2023
1. Përbushja e të drejtave ekonomike dhe sociale	22	31	31	-	12	12	22	13	13	12	21	21	44	23	23
2. Sigurimi i të drejtave të barabarta në pjesëmarrje, përfaqësim dhe role udhëheqëse	-	25	11	67	62	45	-	-	11	-	-	-	33	13	33
3. Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore	61	57	67	33	15	12	-	12	12	6	3	3	-	13	6
4. Zbatimi i integritimit gjinor	-	37	54	25	16	7	50	47	31	25	-	-	-	-	8

Burimi: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Raportet e monitorimit mbi zbatimin e SKBGJ 2021-2030 për vitet 2021, 2022, dhe 2023.

për përpjekje në vijimësi për përforcimin e kanaleve të koordinimit ndërinstitucional, alokimin e burimeve të mjaftueshme financiare, dhe forcimin e konsistencës dhe të standardizimit të të dhënave dhe raportimit. Trajtimi i këtyre aspekteve është me rëndësi thelbësore për përshpejtimin e zbatimit. Bazuar në përpjekjet që po bëhen në vijimësi, është e rëndësishme që të forcohet llogaridhënia institucionale, të sqarohen detyrimet për raportim, dhe të vendoset një mekanizëm i vetëm monitorimi, i lehtë për t'u përdorur, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel vendor. Alokimet e qëndrueshme financiare, përpjekjet në vijimësi për ndërtimin e kapaciteteve dhe angazhimi aktiv i shoqërisë civile në proceset e monitorimit – e kombinuar me ndjekjen në vijimësi të shpenzimeve për çdo masë – do të jetë gjithashtu me rëndësi kritike për vlerësimin me efektivitet të progresit dhe të impaktit.

Krahas SKBGJ 2021-2030, në pesë vitet e fundit Shqipëria ka miratuar edhe një varg strategjish dhe planesh veprimi të tjera kombëtare, të cilat trajtojnë barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave. Një listë gjithëpërfshirëse e tyre gjendet në **Shtojcën I**.

Integrimi i barazisë gjinore në të gjitha politikat e reja të hartuara dhe miratuara rishtas, që është edhe një nga masat kyçe në kuadër të SKBGJ 2021-2030, po përparon në mënyrë graduale. Aktualisht, një numër kornizash ligjore dhe strategjish i referohen barazisë gjinore dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale vazhdon të japë mendime dhe vlerësime dhe të avokojë për integrimin e objektivave të SKBGJ-së në të gjitha strategjitë sektoriale dhe ndërsektoriale; megjithatë, integrimi sistematik i perspektivës gjinore është ende në evolucion dhe kërkon konsolidim të mëtejshëm në të gjitha këto fusha

tematike. Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” parashikon integrimin gjinor në hartimin e të gjitha ligjeve dhe politikave, si dhe në proceset e planifikimit, buxhetimit dhe zbatimit. Ky ligj krijoi edhe Këshillin Kombëtar për Barazinë Gjinore për të monitoruar zbatimin efektiv të tij në këto fusha. Ai kërkon gjithashtu që çdo projektligj të shoqërohet me një analizë të ndikimit të tij tek gratë dhe burrat (kryerja e vlerësimit paraprak të ndikimit gjinor). Megjithatë, pas miratimit të Ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri” është e nevojshme të trajtohen mangësitë ekzistuese ligjore përmes akteve nënligjore mbi integrimin gjinor, sipas kërkesave të *acquis*-it të BE-së, si dhe të sigurohen mekanizmat përkatës të zbatimit. Aktualisht, këto dispozita jo gjithmonë zbatohen në praktikë, duke rezultuar në strategji të cilave u mungon perspektiva gjinore.<sup>80</sup> Trajtimi i këtyre mangësive është prioritet në rishikimin e Ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

Për korrigjimin e tyre, është e nevojshme që të gjitha dokumentet e politikave të hartohen në një gjuhë me ndjeshmëri gjinore dhe të përmbajnë veprime konkrete për gratë, burrat, vajzat dhe djemtë, në gjithë diversitetet e tyre. Në këtë kontekst, është veçanërisht e rëndësishme që të ekzistojnë burimet njerëzore dhe aftësitë teknike të nevojshme për realizimin e integritit gjinor. Kjo kërkon që të sigurohet që nëpunëset dhe nëpunësit e barazisë gjinore dhe personat e kontaktit për barazinë gjinore në nivel qendror dhe vendor të jenë pjesë e të gjitha grupeve të punës për përgatitjen e dokumenteve strategjike dhe të planifikimit, si dhe që ata të kenë kapacitete të mjaftueshme për të kontribuar realisht në këto procese. OSHC-të dhe partnerët ndërkombëtarë janë burime të rëndësishme dhe duhet të angazhohen në mënyrë efektive në proceset e hartimit dhe konsultimit, jo vetëm përmes dorëzimit të komenteve gjatë periudhës së rregullt 21-ditore të konsultimit, kur projekt dokumentet vihen në dispozicion në internet, por edhe përtej asaj periudhe.

## Barazia gjinore dhe planifikimi social në nivel vendor

Në kuadër të zbatimit të SKBGJ 2021-2030, një numër njësisish të vetëqeverisjes vendore kanë nënshkruar “Kartën evropiane për barazi të grave dhe burrave në jetën vendore”,<sup>81</sup> me angazhimin për të hartuar dhe zbatuar **plane vendore të veprimit për barazinë gjinore (PVVGJ)**. Si nënshkrimi i Kartës, ashtu edhe hartimi i PVVGJ-ve identifikohen në SKBGJ 2021-2030 si masa që duhet të ndërmerren nga organet e pushtetit vendor. Deri në korrik 2025, Karta ishte nënshkruar nga 25 bashki (më shumë se 41 për qind e numrit të përgjithshëm të bashkive në vend).<sup>82</sup> Ndër to, 18 bashki kanë përfunduar procesin e përgatitjes së PVVGJ-ve të paktën një herë, dhe në 12 bashki PVVGJ-të janë miratuar nga këshillat bashkiakë përkatës. Këto PVVGJ janë të harmonizuara me kornizat kombëtare dhe ndërkombëtare si: SKBGJ 2021-2030, PVGJ III i BE-së, KEGJFDG, OZHQ-të dhe Konventën e Stambollit.<sup>83</sup> Që nga korriku 2025, 15 bashki nënshkruese të Kartës<sup>84</sup> janë në proces hartimi të PVVGJ-ve të reja (2025-2027/2030), ndërsa katër janë angazhuar në monitorimin e zbatimit të PVVGJ-ve (2022-2024) të tyre – nga të cilat një e ka përfunduar procesin ndërsa tri të tjerat po e kryejnë atë aktivisht.<sup>85</sup>

Po kështu, **planet sociale vendore (PSV)** janë detyrim ligjor i bashkive në kuadër të planifikimit të shërbimeve sociale për grupet e cenushme. Në tetor 2021, 60 bashki kishin përfunduar PSV-të e tyre, 50 nga të cilat vijuan të zbatoheshin përtej vitit 2022.<sup>86</sup> Kjo u mundësoi bashkive të kishin akses në Fondin Social kombëtar.<sup>87</sup> Megjithëse PSV-të mbështesin decentralizimin e shërbimit të kujdesit shoqëror dhe synojnë harmonizimin

80. Kombet e Bashkuara, Shqipëri (2023). “Përshpejtimi i progresit për barazinë gjinore në shoqëri në Shqipëri – pikëpamjet e OKB-së mbi rishikimin e Ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”. Shih: <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2023/03/accelerating-progress-on-gender-equality-in-albania-a-un-perspective-on-the-revision-of-the-law-on-gender-equality-in-society>

81. Dokumenti i përgatitur nga Këshilli i Bashkive dhe Rajoneve Evropiane ((KBRE) në vitin 2006 dhe i rishikuar në vijim në vitin 2022. Shih: [https://ccre-cemr.org/wp-content/uploads/2024/03/Charter\\_2022\\_EN.pdf](https://ccre-cemr.org/wp-content/uploads/2024/03/Charter_2022_EN.pdf)

82. Bashkitë: Gjirokastrë, Korçë, Elbasan, Shkodër, Tiranë, Durrës, Përmet, Bulqizë, Librazhd, Cërrik, Dibër, Pogradec, Kamzë, Gramsh, Lushnjë, Kavajë, Lezhë, Vau i Dejës, Roskovec, Vlorë, Maliq, Dropull, Divjakë, Mat dhe Klos.

83. Procesi i nënshkrimit të Kartës Evropiane të Barazisë dhe përgatitjes së Planeve Vendore të Veprimit Për barazinë gjinore në shoqëri udhëhiqet nga UN Women me mbështetjen e Bashkimit Evropian (vetëm gjashtë bashku u mbështetën përmes projektit USAID/PLGP në vitin 2020).

84. Përkatesisht bashkitë e Bulqizës, Dibrës dhe Shkodrës, me mbështetjen teknike të UN Women dhe AICS Tirana, dhe bashkitë e Pogradecit, Korçës, Roskovecit, Lezhës, Lushnjës, Elbasanit, Maliqit, Divjakës, Kamzës, me mbështetjen teknike të UN Women dhe Bashkimit Evropian; Bashkitë e Klosit, Matit dhe Dropullit, me nismën e tyre (Dropulli po udhëzohet në proces nga UN Women).

85. Bashkitë Elbasan (që e ka përfunduar procesin) Tiranë, Gramsh and Gjirokastrë, me mbështetjen teknike të UN Women dhe Bashkimit Evropian.

86. HDPC dhe UNICEF, 2022. Raporti “Fondi Social—një realitet mes sfidash lokale”, f. 18-20. Shih: <https://www.unicef.org/albania/media/5716/file/Fondi%20Social%20E2%80%93nj%C3%AB%20realitet%20mes%20sfidash%20lokale.pdf>

87. Fondi Social është një instrument përmes të cilit bashkive që kanë plane të miratuara të kujdesit shoqëror u alokohen fonde nga buxheti i qeverisë.

e ofrimit të shërbimeve me standardet e BE-së, një pjesë e madhe e tyre ende përballen me vështirësi sa i përket sigurimit të fondeve të mjaftueshme buxhetore dhe diversifikimit të burimeve të financimit. Koncepti dhe kriteret e Fondit Social në Shqipëri po evoluojnë drejt një modeli më të bazuar në nevojat, më transparent dhe më të qëndrueshëm të financimit të shërbimeve sociale vendore. Reformat e së ardhmes synojnë t'u japin prioritet bashkive me nevoja më të mëdha sociale, të shtojnë përgjegjësitë për bashkëfinancim, dhe të promovojnë shërbime novatore të bazuara në komunitet, përmes partneriteteve midis sektorit publik dhe atij jofitimprurës. Zvogëlimi gradual i subvencioneve shtetërore gjatë një harku kohor trevjeçar synon të nxisë 'ndjenjën e pronësisë' vendore, ndërsa llogaridhënia do të sigurohet përmes treguesve të performancës dhe kërkesave të raportimit. Këto ndryshime do të mbështesin më tej decentralizimin e shërbimit të kujdesit shoqëror dhe harmonizimin me standardet e politikave sociale të BE-së.<sup>88</sup>

## 2.2 ZBATIMI I LEGJISLACIONIT, ÇËSHTJE KYÇE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT, PËRFSHIRË ANKIMIMIN

Shqipëria ka një legjislacion solid për barazinë gjinore dhe nivele të larta të përmbushjes së standardeve ndër-kombëtare. Megjithatë, ende ekzistojnë mangësi për sa i përket përputhshmërisë me angazhimet në evolucionin të BE-së dhe probleme në zbatimin e tyre. Nevojiten reforma të rëndësishme legjislative për Ligjin "Për barazinë gjinore në shoqëri", Kodin Penal (femicidi, dhuna seksuale dhe dhuna kibernetike), Kodin e Familjes, Kodin e Procedurës Civile (martesat e të miturve) dhe Ligjin "Për shëndetin riprodhues", sikurse është theksuar nga KEDG (2023), GREVIO (2024) dhe the RPU (2025). Problemet në zbatim vijnë nga:

**(i) Kapacitete dhe koordinim i kufizuar midis palëve të interesit.** Ndonëse kanë vazhduar përpjekjet për forcimin në vijimësi të koordinimit ndër-institucional

për barazinë gjinore, ky koordinim do të përfitonte nga forcimi i mandateve dhe shtimi i burimeve.<sup>89</sup>

**(ii) Sfida në funksionimin e makinerisë së barazisë gjinore kombëtare.** Kohët e fundit janë bërë përmirësime të rëndësishme institucionale dhe për forcimin e sektorit të barazisë gjinore në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale. Megjithatë, korniza e përgjithshme institucionale për barazinë gjinore do të përfitonte nga një koherencë më e madhe strategjike, qartësi operative dhe burime të mjaftueshme. Bashkërendimi mes aktorëve të organeve të pushtetit qendror dhe vendor mbetet fragmentar dhe pengon zbatimin me efektivitet të politikave. Për këtë nevojitet monitorim i vazhdueshëm sistematik dhe mekanizma vlerësimi për zbatimin e ligjeve dhe politikave që lidhen me gjininë.

**(iii) Nivel i ulët i ndërgjegjësimit të publikut dhe akses i kufizuar në mjete juridike.** Shumë gra, sidomos ato nga zonat rurale, pakicat etnike, gratë me aftësi të kufizuara dhe/ose LGBTIQ+, kanë njohuri të kufizuara për të drejtat e tyre dhe mekanizmat e disponueshëm të ankimit në rast se u shkelen të drejtat e njeriut.<sup>90</sup> Përveç qeverisë, rol të rëndësishëm ka edhe shoqëria civile, sidomos organizatat për të drejtat e grave. Në Shqipëri, këto organizata kanë qenë shumë aktive në veprimtari avokuese, monitorimin e detyrimeve të të drejtave të njeriut, dhe ofrimin e shërbimeve për gratë në nevojë, përfshirë ndihmën juridike për gratë viktime të dhunës. Megjithatë, ato nuk janë përfshirë aq shumë në rritjen e ndërgjegjësimit të grave për mjetet juridike (në nivel kombëtar dhe ndër-kombëtar) të disponueshme në rast diskriminimi dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut, si dhe në përfaqësimin ligjor të rasteve në emër të viktimeve, përfshirë përmes padive strategjike.<sup>91</sup>

Përfshirja e kufizuar e OSHC-ve në rritjen e ndërgjegjësimit dhe mbështetjen e rasteve të tilla është rezultat i dallimeve të konsiderueshme në kapacitetet e partnerëve zbatues. Vlerësimet e Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Projekteve (UNOPS) në kuadër të granteve

88. Po aty, f. 21-23.

89. OKB Shqipëri (2021), "Avancimi i barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave në Shqipëri. Parashtrim i pozicionit të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri". Shih: <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2021/06/advancing-gender-equality-and-the-empowerment-of-all-women-and-girls-in-albania#view>

90. KEDG, 2023.

91. Paditë strategjike synojnë të sjellin ndryshime në shoqëri përtej kuadrit të çështjes konkrete, përmes përdorimit të mjeteve juridike për t'iu kundërvënë padrejtësive që nuk janë trajtuar si duhet në ligj dhe politikë.

EU4Culture (BE për kulturën)<sup>92</sup> tregojnë se ndërsa disa partnerë kanë krijuar struktura dhe kanë personel, të tjerëve u mungojnë politikat dhe njohuritë bazë që lidhen me gjininë. Kjo mungesë konsistence minon efektivitetin e përpjekjeve për barazi gjinore. Kufizimet në personel dhe fonde – sidomos ndër OSHC-të e vogla – kufizojnë më tek aftësitë e tyre për t'u angazhuar në trajnime, mbrojtje, dhe zbatim të programeve. Shumë prej tyre nuk kanë person të dedikuar kontakti për mbrojtjen nga shfrytëzimi seksual dhe në lidhje me abuzimin dhe gjininë, gjë që pengon mbikëqyrjen dhe ndjekjen në vijimësi të këtyre rasteve.

**(iv) Sfida** në vijimësi që kufizojnë aksesin e grave në drejtësi. Pavarësisht nga reformat gjyqësore që kanë filluar që në vitin 2016, gratë në Shqipëri vazhdojnë të përballen me vështirësi për të pasur akses në drejtësi. Komiteti i KEGJFDG-së ka shprehur shqetësim për burimet e pamjaftueshme të alokuara për zbatimin e Ligjit nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti", sidomos për viktimat e dhunës me bazë gjinore. Ndër këto probleme përfshihen procedurat e dobëta hetimore, kapacitetet e pamjaftueshme forenzike, dhe tendencioziteti gjinor në radhët e organeve të rendit dhe gjyqësore, që çon në riviktimizim dhe ngurrim për të raportuar abuzimin.<sup>93</sup>

Gjithashtu, me gjithë faktin që Shqipëria ka bërë përpjekje për garantimin e aksesit në drejtësi, vlerësime të kohëve të fundit në lidhje me të drejtat e njeriut – të KEDG-së (2022-2023), GREVIO-s (2023-2024), dhe RPU-së (2024-2025) – kanë identifikuar disa mangësi në lidhje me: (i) mbrojtjen nga DHBGJ dhe femicidi; (ii) aksesin një sistemin e drejtësisë dhe shërbime, sidomos nga gratë në zonat rurale dhe nga grupet e pafavorizuara; (iii) fuqizimin ekonomik dhe trajtimin e diskriminimit në tregun e punës; (iv) angazhimin politik në nivel vendor (vetëm 17 për qind e kryetarëve të bashkive janë gra) dhe trajtimin e dhunës elektorale; dhe (v) trajtimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe të drejtat e emigrantëve, me mbrojtje të dobët për viktimat dhe refuzime të padrejta të azilit.

92. <https://eu4culture.al>

93. KEDG (2023). "Vërejtjet përmblyëse për Shqipërinë". Shih: <https://docs.un.org/en/CEDAW/C/ALB/CO/5>

94. Krijuar me Ligjin nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi".

95. Ndër arsye të tjera diskriminimi janë raca, ngjyra, përkatësia etnike, gjuha, identiteti gjinor, orientimi seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, statusi ekonomik, arsimor ose social, shtatzania, përkatësia prindërore, përgjegjësia prindërore, mosha, familja ose statusi martesor, statusi civil, vendi i banimit, statusi shëndetësor, predispozitat gjenetike, aftësia e kufizuar, përkatësia në një grup të veçantë, ose për çfarëdo arsye tjetër.

96. Komisioni Evropian, "Raporti për Shqipërinë 2024", f. 39. Shih: [https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68\\_en?filename=Shqipëria%20Report%202024.pdf](https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Shqipëria%20Report%202024.pdf)

## Mekanizmat institucionalë të ankimit

**Komisioneri për Mbrojtje nga Diskriminimi (KMD)**<sup>94</sup> është institucion publik i pavarur që siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë tjetër që nxit diskriminimin për arsye të ndryshme, përfshirë gjininë.<sup>95</sup> Ndryshimet e vitit 2020 në Ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi" kishin për qëllim të forconin rolin e KMD-së, ndër të tjera përmes zgjerimit të mandatit të tij për të monitoruar edhe zbatimin e Ligjit "Për barazinë gjinore në shoqëri". Megjithatë, ligji nuk jep hollësi se si do të kryhet monitorimi ose burimet për mbështetjen e tij. Rishikimi i Ligjit "Për barazinë gjinore në shoqëri" paraqet një mundësi për të qartësuar dhe për të siguruar që kjo përgjegjësi e KMD-së të zbatohet në praktikë. Sipas raportit të fundit të BE-së për Shqipërinë, KMD ka vazhduar ta ushtrojë mandatin e tij në mënyrë të kënaqshme, por numri i personelit të institucionit është ende i pamjaftueshëm dhe duhet të përmirësohet.<sup>96</sup> Kjo është sidomos e rëndësishme në lidhje me rastet e diskriminimit gjinor, raportimi i të cilave, sikurse u përmend më herët, ende mbetet shumë i ulët, gjë që duhet ta nxisë Komisionerin të ushtrojë më aktivisht mandatin e vet për të filluar hetime *ex officio* të këtyre rasteve.

**Institucioni i Avokatit të Popullit (AP)** është institucioni kombëtar i nivelit më i lartë për të drejtat e njeriut në Shqipëri dhe është akredituar me statusin "A" nga Aleanca Globale e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (*Global Alliance of National Human Rights Institutions - GANHRI*). AP ka qenë mjaft aktiv në promovimin e të drejtave të grave gjatë viteve të fundit dhe me mbështetjen e agjencive të OKB-së ka përgatitur një numër raportesh monitorimi mbi masat e qeverisë për zbatimin e legjislacionit dhe të detyrimeve ndërkombëtare përkatëse. Ndër to janë raporti alternativ dorëzuar Komitetit të KEGJFDG-së në kuadër të rishikimit të katërt për Shqipërinë (2020), një raport për buxhetimin gjinor në lidhje me shërbimet për gratë viktime të dhunës (2020), një raport mbi masat e pushtetit qendror dhe

vendor për trajtimin e DHF-së (2021), dhe një raport për dhunën ndaj grave në politikë (2021).<sup>97</sup> Kohët e fundit, AP ka ngritur Observatorin për Femicidet, që shërben si një mekanizëm monitorimi shumë i rëndësishëm për mbledhjen e të dhënave mbi vrasjet e grave dhe të vajzave të klasifikuara si femicid dhe dhënieve të rekomandimeve për parandalimin e tyre.<sup>98</sup>

Gjithashtu, institucioni i Avokatit të Popullit ka dhënë rekomandime të rëndësishme për përmirësimin dhe zbatimin e legjislationit për barazinë gjinore dhe DHBGJ-në, përfshirë rekomandime për masa që lidhen me të drejtat pronësore, parandalimin e seksizmit në media, të cilat u pasqyruan si në Ligjin "Për mediat audiovizive"<sup>99</sup> ashtu edhe në Kodin e Transmetimit për Mediat Audiovizive<sup>100</sup> (2023); përfaqësimin e barabartë gjinor në administratën e pushtetit vendor (2023, në bashkëpunim me KMD); ndryshimet në Kodin Penal në lidhje me përkufizimin e femicidit (2024); përmirësimin e kuadrit normativ mjeko-ligjor në lidhje me dhunën seksuale (2024); dhe përmirësimin e standardeve për funksionimin e strehëzave të emergjencës për viktimat e dhunës seksuale.

## 2.3 FINANCIMI PËR ZBATIMIN E POLITIKAVE TË BARAZISË GJINORE

Zbatimi i politikave të barazisë gjinore në Shqipëri mbështetet jo vetëm nga buxheti i shtetit, por edhe përmes fondeve nga donatorët, të cilët i japin mbështetje të drejtpërdrejtë qeverisë së Shqipërisë dhe OSHC-ve, si dhe kanë edhe programet e tyre të veta të ndërhyrjes.

**Fondet nga buxheti i shtetit.** Gjatë pesë viteve të fundit Shqipëria ka bërë përparim të konsiderueshëm në procesin e planifikimit të buxhetit. Sipas Raportit Pekin +30 të qeverisë shqiptare,<sup>101</sup> prioritetet gjinore janë integruar gjithnjë e më shumë në financat publike.

Prioritetet kombëtare të politikave gjinore tani ndërlidhen me Programin e Buxhetit Afatmesëm (PBA) përmes Sistemit Informativ Shqiptar Menaxhimit të Financave (AFMIS) dhe Sistemit të Menaxhimit të Informacionit për Planifikimin e Integruar (IPSIS). Objektivat gjinorë të synuar, treguesit kyç të performancës dhe qëllimet e planeve kombëtare, si Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore, po ndërlidhen përmes IPSIS në modulet buxhetore të AFMIS-it.

Çdo program buxhetor duhet të përfshijë të paktën një objektivi dhe tregues gjinor, që të lidhet me specifikime të detyrueshme gjinore në nivelin e treguesve.<sup>102</sup> Krahas kësaj, është e detyrueshme edhe mbledhja dhe përdorimi i të dhënave të ndara sipas seksit në analizën e politikave. Kjo kornizë e integruar mbështet vlerësimin e ecurisë në realizimin e objektivave, produkteve dhe shpenzimeve që lidhen me gjininë në të gjitha fazat e PBA-së dhe të ciklit buxhetor vjetor. Ministritë duhet të përfshijnë tregues të performancës lidhur me integrimin gjinor (përmes IPSIS), sasinë e produkteve (përmes AFMIS), dhe kostot që lidhen me to (përmes sistemit të Thesarit) qoftë në lidhje me planifikimin e buxhetit, ashtu edhe për ndjekjen në vijimësi të shpenzimeve. Ky sistem shërben si bazë për llogaritjen e shpenzimeve të parashikuara dhe atyre faktike për arritjen e objektivave gjinore, dhe mundëson krijimin e dokumenteve të rëndësishme me ndjeshmëri gjinore, si bilanci i buxhetimit gjinor, shtojcat e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, dhe buxheti i qytetarit.<sup>103</sup>

Tabela 2 në vijim tregon një rritje të qëndrueshme në numrin e programeve buxhetore të përgjigjshme gjinore (PPGJ) në Shqipëri, nga 38 në vitin 2019 në 76 në vitin 2024, si dhe një rritje të konsiderueshme të fondeve përkatëse të alokuara. Alokimet për PPGJ-në u rritën nga 38 milion lekë (e barabartë me 442.000 USD ose 385.000 euro) në vitin 2019 në më shumë se 73.9 miliard lekë (e barabartë me 885 milion USD ose 765 milion euro) në vitin 2024, që është 10 për qind e buxhetit kombëtar

97. Avokati i Popullit (2025), Botime, <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-speciale-1/>

98. Avokati i Popullit (2024), "Vrasja e grave dhe vajzave dhe femicidi në Shqipëri", (2021-2023). Shih: <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20Vrasjet%20e%20Grave%20dhe%20Vajzave%20dhe%20Femicidi%20ne%20Shqipëri,%202021-2023.pdf>

99. Ligji nr. 30/2023 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

100. Miratuar me vendimin e AMA-s nr. 60, datë 10.07.2023.

101. Shih: <https://unece.org/sites/default/files/2024-08/Shqipëria-Report.pdf>

102. Bazuar në Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe udhëzimin nr. 7 të Ministrit të Financave, datë 28.02.2018 "Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm".

103. Për më shumë shih: <https://financa.gov.al/buxheti-i-qytetarit>

**Tabela 2****Tendenca në buxhetimin e përgjigjshëm gjinor në Shqipëri (2019-2024)**

Viti	Nr. i programeve të BPGJ	Shumat në lekë	% e PBGJ në buxhetin total	% e PBGJ në Prodhimin e Përgjithshëm Bruto (PPB)
2019	38	38,264,748	7.2	2.3
2020	43	52,630,418,850	9	3
2021	45	50,012,668,836	9	3
2022	48	60,380,387,485	9	3
2023	51	61,592,927,707	9	3
2024	76	73,960,749,397	10	3

Burimi: Të dhëna nga Ministria e Financave në kuadër të përgatitjes së vlerësimit kombëtar Pekin+30, maj 2024

dhe 3 për qind e PPB-së. Kjo dëshmon angazhimin e fuqishëm të Shqipërisë për integrimin e prioritetëve gjinorë në financat publike. Ndonëse përqindja e PPGJ-së në kuadër të buxhetit dhe të PPB-së ka mbetur e pandryshuar që prej vitit 2020, rritja e madhe në terma absolute në vitin 2024 pasqyron zbatimin më të gjerë të tij në të gjithë sektorët. Këto të dhëna flasin për progres në ndërtimin e kapaciteteve institucionale për buxhetim gjinor dhe pranimin në rritje të nevojës për të kryer me efektivitet zbatimin, ndjekjen në vijimësi të ecurisë dhe monitorimin e tij bazuar në rezultate, për të pasur ndikim të prekshëm në rrugën drejt arritjes së barazisë gjinore.

Sipas Ministrisë së Financave,<sup>104</sup> buxheti i vitit 2025 do të vazhdojë të trajtojë çështje që lidhen me barazinë gjinore, kryesisht në fushat e arsimit, shëndetësisë, mbrojtjes sociale, drejtësisë dhe rendit publik.

**Agjencitë dhe programet ndërkombëtare.** Krahas fondeve nga shteti, mbështetja nga agjencitë dhe programet ndërkombëtare është me rëndësi kritike për avancimin e fuqizimit të grave dhe barazisë gjinore.

Në kuadër të **instrumentit të asistencës para anëtarësimit** 2021-2027 (IPA III), një vendim i katërt për të financuar me një fond prej 67,35 milion eurosh Planin Vjetor të Veprimit 2024, mbështet vetëqeverisjen dhe

zhvillimin ekonomik vendor, sigurinë ushqimore, pyjet, punësimin dhe përfshirjen sociale, dhe luftën kundër korrupsionit. Krahas tij, vendimi i parë për financimin me një fond prej 130 milion eurosh të tre programeve operative 2024-2027, mbështet aktivitete në fushat e digjitalizimit, të avancimit të agjendës së gjelbër të Shqipërisë, dhe punësimin të rinjve dhe të rejave. Këto programe plotësohen me një paketë të konsiderueshme prej 112 milion eurosh, në kuadër të programeve shumëvendëshe si dhe të programit të instrumentit për asistencë për zhvillimin rural para anëtarësimit (IPARD III). Shqipëria është gjithashtu pjesëmarrëse në katër programe të bashkëpunimit ndërkufitar, programe të bashkëpunimit ndërshtetëror, dhe programe të BE-së.<sup>105</sup>

Kjo mbështetje financiare për Shqipërinë, ndonëse jo e etiketuar shprehimisht si mbështetje për barazinë gjinore, ka potencial të konsiderueshëm për avancimin e objektivave të barazisë gjinore. Përfshirja me efektivitet e perspektivës gjinore në të gjitha programet IPA III është me rëndësi kyçe për sigurimin e një zhvillimi gjithëpërfshirës dhe për harmonizimin e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të procesit të anëtarësimit në BE, sidomos me Strategjinë e BE-së për Barazinë Gjinore 2020-2025 dhe Planin e Veprimit Gjinor III (2021-2025/2027). Institucionet e Shqipërisë duhet të zbatojnë buxhetimin përgjigjës gjinor, mbledhjen e të dhënave të

104. Ministria e Financave, tetor 2024, "Buxheti për qytetarët, 2025". Shih: <https://financa.gov.al/wp-content/uploads/2024/11/Buxheti-per-Qytetarët-Ministria-e-Financave-2025.pdf>

105. Komisioni Evropian. "Raporti për Shqipërinë 2024", f. 96. Shih: [https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68\\_en?filename=Shqipëria%20Report%202024.pdf](https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Shqipëria%20Report%202024.pdf)

ndara sipas seksit, dhe analizën në bazë të përkatësive të shumëfishta, për të siguruar që gratë dhe burrat të përfitojnë në mënyrë të drejtë nga reformat e financuara nga BE-ja.

**Kombet e Bashkuara dhe partnerë të tjerë kontribues ndërkombëtarë** shpenzuan 3,5 milion USD ose 6,2 për qind të buxhetit të tyre të përgjithshëm në vitin 2022 dhe 3,4 milion USD ose 5,7 për qind të buxhetit të tyre të përgjithshëm në vitin 2023 në mbështetje të OZHQ 5 (barazia gjinore) në Shqipëri. Në vitin 2024, ato alokuan 4,1 milion USD të disponueshme ose 6,2 për qind të buxhetit të tyre të përgjithshëm.<sup>106</sup> Megjithatë, efektiviteti i kësaj mbështetjeje varet nga kapaciteti i institucioneve të vendit për të zbatuar parimet e BPGJ-së dhe për të kryer analiza bazuar në përkatësitë e shumëfishta në të gjithë ciklin e programit.

Për të pasur ndikime konkrete, reformat legjislativë duhet të mbështeten me fonde të dedikuara për të mundësuar buxhetim përgjigjës gjinor (PPGJ) në të gjithë sektorët, si edhe në nivel vendor. Për këtë qëllim, Programi i BE-së për Mbështetje Buxhetore dhe, në veçanti, Marrëveshja e re e Partneritetit Ekonomik (MPE), janë mundësi të rëndësishme. Integrimi i politikave të punësimit dhe atyre sociale në kuadrin e MPE-së mund të lehtësojë mobilizimin e fondeve shtesë për institucionet qendrore dhe vendore për avancimin e barazisë gjinore.

Grantet për performancën e bashkive duhet të përfshijnë edhe kërkesa për trajtimin e përkatësive të shumëfishta, për të mundësuar ofrimin e barabartë të shërbimeve për gratë dhe vajzat që përjetojnë forma të ndërthurura ose të shumëfishta të marginalizimit.

Sistemet aktuale të matjes zakonisht i japin më shumë përparësi efikasitetit administrativ se sa parimit të përfshirjes dhe disponueshmërisë së shërbimeve. Duke përfshirë në këto sisteme matje me ndjeshmëri gjinore dhe me orientim trajtimin e barabartë, shpenzimet publike mund të bëhen efektive, përgjigjëse, dhe llogaridhënëse në kuadër të strategjisë së barazisë gjinore dhe ambicieve të Shqipërisë për integrim në BE.

106. Shih: <https://albania.un.org/en/sdgs>

107. Sigma dhe OECD, "Raport i monitorimit të administratës publike në Shqipëri 2024", f.29. Shih: [https://www.sigmaweb.org/en/publications/public-administration-in-albania-2024\\_5577d117-en.html](https://www.sigmaweb.org/en/publications/public-administration-in-albania-2024_5577d117-en.html)

108. Ligji nr. 9770, datë 18.12.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri" dhe Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006, "Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare", i ndryshuar.

## KUTIA 1. SFIDA TË VAZHDUESHME PËR NDJEKJEN NË VIJIMËSI TË INVESTIMEVE PËR BARAZINË GJINORE

Me gjithë fondet shtesë të përmendura më sipër që janë investuar në Shqipëri gjatë pesë viteve të fundit, marrja e informacionit për shumtë reale të shpenzuara për barazinë gjinore vazhdon të jetë problem, pavarësisht nga përmirësimet në sistemin fiskal të Shqipërisë.

Sipas raporteve të kohëve të fundit: "sistemi i digjital i krijuar për mbështetjen e procesit të zhvillimit të strategjive (IPSI) ende nuk është funksional dhe nuk jepen udhëzime se si duhet faktikisht të përgatiten përmbajtjet e strategjive sektoriale, apo analizat e situatës, qëllimet dhe objektivat." Gjithashtu, "dokumentet zakonisht përmbajnë analizën e situatës dhe objektiva, por jo gjithmonë përfshijnë tregues në nivelin e rezultateve dhe objektivave, të cilët shërbejnë për monitorimin e zbatimit të qëllimeve.

Efektiviteti i monitorimeve të mëvonshme pengohet më tej nga mungesa e afateve të qarta [...]".<sup>107</sup> Këto të meta janë veçanërisht të dukshme në ndjekjen e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030. Nuk janë të disponueshme të dhëna të konsoliduara për shpenzimet faktike në kuadër të objektivave dhe aktiviteteve të planifikuara.

## 2.4 MEKANIZMI KOMBËTAR I BARAZISË GJINORE

Sipas legjislacioneve aktual në fuqi,<sup>108</sup> autoriteti shtetëror përgjegjës për barazinë gjinore dhe luftën kundër DHF-së në Shqipëri është ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore. Për periudhën 2020-2025 këto

përgjegjësi vazhdojnë të mbulohen nga **Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale (MSHMS)**. Ky rol ushtrohet përmes rolit drejtues të Ministrit në Këshillin Kombëtar për Barazinë Gjinore dhe, deri në fund të vitit 2024, përmes Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave të Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, specifikisht, përmes sektorit të politikave të barazisë gjinore. Në tetor 2024, me urdhër të Kryeministrit u krijua një strukturë e re,<sup>109</sup> Drejtoria e Barazisë Gjinore, e përbërë nga një sektor i barazisë gjinore dhe një sektor për luftën kundër dhunës në familje, secili me nga një përgjegjës dhe dy specialistë. Këto përmirësime strukturore janë një hap tejte i mirëpritur për forcimin e kornizës së përgjithshme institucionale të mekanizmit të barazisë gjinore.

Megjithatë, burimet dedikuar barazisë gjinore nga MSHMS-ja këto pesë vitet e fundit mbeten të kufizuara. Kjo është e vërtetë si për burimet njerëzore, ashtu edhe për zbatimin e aktiviteteve përkatëse të renditura në SKBGJ 2021-2030 për të cilat është përgjegjëse kjo ministri. Kjo është theksuar edhe nga institucione ndërkombëtare në rekomandimet që i kanë dhënë Shqipërisë. RPU e vitit 2024<sup>110</sup> e nxiste Shqipërinë që të zbatojë plotësisht SKBGJ 2021-2030, të rishikojë Ligjin "Për barazinë gjinore në shoqëri", si dhe të sigurojë fonde dhe mbështetjen e duhur institucionale. Të njëjtat shqetësime u theksuan edhe në vërejtjet përmbyllëse të KEDG-së të vitit 2023 dhe në rekomandimet e GREVIO-s në raportin e parë tematik të vitit 2024. GREVIO ka rekomanduar që Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore duhet të fuqizohet me më shumë autoritet dhe burime, që politikat duhet të trajtojnë edhe diskriminimin për shkak të përkatësive të shumëfishta të grave të marginalizuara, dhe se ato duhet të vlerësohen në vijimësi në bazë të treguesve të parapërcaktuar për të përmirësuar llogaridhënien.<sup>111</sup>

**Rrjeti i nëpunësve të barazisë gjinore.** Institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor kanë detyrimin në bazë të ligjit që të bashkëpunojnë me ministrin përkatës që mbulon çështjet e barazisë gjinore për shkëmbimin e informacionit dhe mundësimin e përmeshjes së funksioneve ministrore. Ky bashkëpunim dhe koordinim

kryhet përmes sektorit të barazisë gjinore. Për të trajtuar çështjet e barazisë gjinore, në çdo ministri është caktuar një **nëpunës i barazisë gjinore** (NBGJ), së bashku me një ose më shumë NBJG vendorë në çdo bashki. Deri më tani janë emëruar NBJG në 11 ministri, një person kontakti në Policinë e Shtetit dhe 61 NBJG në nivel vendor. Në shumicën e rasteve, NBJG-të vendorë kryejnë edhe funksionin e koordinatorit/koordinatores për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje. Ndonëse këto masa synojnë të mbështesin në mënyrë efektive barazinë gjinore dhe integrimin gjinor në nivel qendror dhe vendor, NBJG-të shpesh nuk janë punonjës me kohë të plotë; ato ose ata shpesh kanë role të shumëfishta dhe kapacitete të kufizuara për t'u angazhuar me efektivitet në çështjet gjinore.

**Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore (KKBGJ)**<sup>112</sup> është organi më i lartë këshillues për çështjet e barazisë gjinore dhe për sigurimin e integritetit gjinor në të gjitha fushat, sidomos në çështjet politike, sociale, ekonomike dhe kulturore. Këshilli është krijuar me urdhër të Kryeministrit dhe rizgjidhet një herë në katër vjet. KKBGJ drejtohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe përbëhet nga nëntë përfaqësues të ministrive të linjës – në rang zëvendësministri dhe drejtor drejtorie – dhe tre përfaqësues të shoqërisë civile që zgjidhen me konkurrim të hapur.<sup>113</sup> Megjithatë, ka vend për përmirësim të mëtejshëm të efektivitetit të KKBGJ-së. Sikurse u theksua nga Komiteti i KEGJFDG-së (2023), "[...] Këshilli Kombëtar për Barazinë Gjinore nuk ka financim të qëndrueshëm dhe burime njerëzore të mjaftueshme për të përmbushur mandatin e vet me efektivitet" (para. 15), çka vë në pah nevojën për sigurimin e fondeve të qëndrueshme dhe forcimin e burimeve njerëzore, teknike dhe financiare në dispozicion të Këshillit. Ndonëse Drejtoria e Barazisë Gjinore, që shërben si sekretariat i Këshillit, është forcuar dhe numri i personelit tashmë është plotësuar dhe ofron mbështetje të vazhdueshme, sigurimi i ekspertizës dhe burimeve të mëtejshme të specializuara do ta ndihmonin KKBGJ-në në përmbushjen më me efektivitet të mandatit të tij dhe në koordinimin e përpjekjeve në nivel kombëtar për forcimin e barazisë gjinore. Krahas kësaj, duhet të

109. Urdhri nr. 205, datë 23.10.2024, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale».

110. "Raport i grupit të punës mbi Raportin Periodik Universal" A/HRC/58/5, 20 dhjetor 2024, f. 10-24. Shih: <https://docs.un.org/en/A/HRC/58/5>

111. Shih: <https://rm.coe.int/grevio-s-first-thematic-evaluation-report-on-albania/1680b1a0ca>

112. Në bazë të Ligjit nr. 9770, datë 18.12.2008, "Për barazinë gjinore në shoqëri", nenet 11 dhe 12.

113. Ju lutem vini re se përbërja dhe struktura e KKBGJ-së po rishikohet në kuadër të procesit të hartimit të ligjit të ri për barazinë gjinore që është në proces.

sigurohet edhe koordinimi me entitetet e ndryshme që janë pjesë e makinerisë kombëtare për avancimin e grave, dhe duhet të ketë qartësi në ndarjen e përgjegjësie, përcaktimin e prioriteteve dhe të fushave të bashkëpunimit.<sup>114</sup> Në vlerësimin e parë tematik për Shqipërinë, GREVIO rekomandoi forcimin e rolit të KKBGJ-së si organi koordinues kombëtar, përmes forcimit të kompetencave dhe funksioneve të tij dhe alokimit të burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare si për KKBGJ-në, ashtu edhe për MSHMS-në, për sigurimin e vijueshmërisë së punës së tyre.<sup>115</sup>

Procesi i hartimit të ligjit të ri të barazisë gjinore që po kryhet aktualisht, synon të sigurojë forcimin e përbërjes dhe funksioneve të KKBGJ-së, që përbën një progres të mirëpritur dhe është tregues i gatishmërisë së Shqipërisë për të reflektuar dhe zbatuar Vërejtjet Përmblyëse të KEDG-së.

Në nivelin e Kuvendit, krahas **Aleancës së Grave Deputete** (grup parlamentar informal) çështjet e barazisë gjinore, të DHBGJ-së, dhe DHF-së diskutohen dhe trajtohen në **Komitetin** për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, Nënkomiteti për Zhvillimin e Qëndrueshëm, në **grupe vullnetare**, etj. Komiteti për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë është përgjegjës për marrëdhëniet e punës, çështjet sociale, sigurimet shoqërore, familjen, gratë dhe shëndetësinë, si edhe për aspektet e agjendës së zhvillimit të qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe për zbatimin e angazhimeve që rrjedhin prej tyre.

Nënkomiteti për Zhvillimin e Qëndrueshëm<sup>116</sup> është përgjegjës për çështjet e zhvillimit ekonomik dhe social, rritjen ekonomike të qëndrueshme, realizimin e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe Agjendën 2030 të OKB-së. Grupi vullnetar për popullsinë dhe zhvillimin<sup>117</sup> synon të avokojë për çështje që lidhen me popullsinë dhe zhvillimin dhe, më specifikisht, me shëndetin riprodhues, aspekte demografike, moshimin, etj.

## 2.5 TË DHËNAT E NDARA SIPAS SEKSIT DHE KORNIZA KOMBËTARE E STATISTIKAVE GJINORE

### Kuadri ligjor dhe institucional dhe koordinimi i statistikave gjinore zyrtare

Kuadri kombëtar për prodhimin dhe koordinimin e statistikave gjinore dhe të dhënave të ndara sipas seksit në Shqipëri është krijuar me Ligjin nr. 17/2018 "Për statistikat zyrtare",<sup>118</sup> që përcakton Institutin e Statistikave (INSTAT) si institucionin qendror përgjegjës për drejtimin dhe koordinimin e sistemit statistikor kombëtar (SSK). SSK përfshin INSTAT-in, Bankën e Shqipërisë dhe institucione të tjera qeveritare që kanë mandat ligjor të prodhojnë statistika zyrtare në kuadër të Programit të Statistikave Zyrtare 2022-2026,<sup>119</sup> të miratuar nga Kuvendi.

INSTAT-i mbikëqyr aktivitetet statistikore në të gjithë SSK-në për të siguruar përputhshmërinë me metodologjitë e Eurostatit, Kodin e Praktikës për Statistikat Evropiane,<sup>120</sup> dhe standardet ndërkombëtare të përcaktuara nga Komisioni i Statistikave i Kombeve të Bashkuara.<sup>121</sup> Si organi qendror përgjegjës për të dhënat kombëtare, INSTAT-i është ngarkuar me detyrën e garantimit të cilësisë, krahasueshmërisë, transparencës dhe aksesueshmërisë së statistikave zyrtare, përfshirë edhe ato që lidhen me barazinë gjinore.

Për të forcuar koordinimin e statistikave gjinore mes institucioneve, në nëntor të vitit 2024, INSTAT-i dhe MSHMS-ja krijuan grupin e punës për statistikat gjinore në përputhje me angazhimet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030. Grupi i punës shërben si platformë shumëpalëshe për harmonizimin e treguesve gjinorë me kërkesat e BE-së, përmes identifikimit të të dhënave gjinore, dhe koordinimit të përpjekjeve për monitorimin e progresit në lidhje me angazhimet e barazisë gjinore në nivel

114. Po aty.

115. GREVIO, shtator 2024. "Raporti i parë vlerësues tematik për Shqipërinë: Ndërtimi i besimit përmes sigurimit të mbështetjes, mbrojtjes dhe drejtësisë", f. 12.

116. Krijuar nga Kuvendi i Shqipërisë me Vendimin nr. 34/2022, datë 14.4.2022.

117. Krijuar me Urdhrin nr. 43 të Kryetares së Kuvendit të Shqipërisë, datë 18.07.2023.

118. <https://www.instat.gov.al/media/3972/law-no17-2018-on-official-statistics.pdf>

119. <https://www.instat.gov.al/media/14365/osp-2022-2026-en.pdf>

120. <https://ec.europa.eu/eurostat/web/quality/european-quality-standards/european-statistics-code-of-practice>

121. <https://unstats.un.org/unsd/dnss/gp/fundprinciples.aspx>

kombëtar dhe ndërkombëtar. MSHMS ka funksionin e mekanizmit kombëtar të barazisë gjinore të Shqipërisë. Si institucioni drejtues në kuadër të Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore, ajo është përgjegjëse për mbikëqyrjen e politikave gjinore dhe koordinimin e mbledhjes së treguesve të lidhur me gjininë nga institucionet publike në nivel qendror dhe vendor. Këta tregues harmonizohen me Programin Statistikor Shumëvjeçar, që kryhet në bashkëpunim të ngushtë me INSTAT-in për të siguruar zbatimin e një metodologjie konsistente dhe gatishmërinë në raportimin e statistikave në nivel kombëtar.

Forcimi i kornizës kombëtare të statistikave gjinore është me rëndësi thelbësore jo vetëm për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, por edhe për mbështetjen e monitorimit të strategjive të tjera sektoriale dhe të detyrimeve të tjera të Shqipërisë në kuadër të kornizave ndërkombëtare si Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, KEGJFDG, Konventa e Stambollit dhe Platforma për Veprim e Pekinit.

Për më tepër, forcimi i prodhimit, harmonizimit dhe përdorimit të statistikave gjinore në përputhje me kërkesat e Eurostatit dhe të Institutit Evropian për Barazi Gjinore<sup>122</sup> kontribuon në përputhshmërinë e vendit me standardet e statistikave të BE-së dhe me procesin e integritetit të BE-së në përgjithësi. Në këtë drejtim, ligji i ri për barazinë gjinore (që aktualisht është në proces miratimi) përfshin një nen të posaçëm për statistikave gjinore, i cili përcakton modalitetet për mbledhjen dhe analizimin e tyre, që pritet të forcojë më tej kornizën kombëtare të statistikave gjinore.

### Burimet dhe prodhimi i statistikave gjinore

Statistikave gjinore në Shqipëri prodhohen nëpërmjet kombinimit të të dhënave administrative, censeve të popullsisë dhe anketimeve të NJEF-ve, të koordinuara nga INSTAT-i si pjesë e sistemit të statistikave kombëtare. Këto burime përbëjnë bazën për gjenerimin e të dhënave të ndara sipas seksit dhe të treguesve specifikë gjinorë dhe relevantë në një numër fushash të politikave, në mbështetje të kornizave monitoruese kombëtare dhe ndërkombëtare.

### Të dhënat administrative

Të dhënat administrative prodhohen nga ministritë e linjës dhe institucionet publike si pjesë e funksioneve të tyre të zakonshme. INSTAT-i luan rol qendror në bashkërendimin dhe integrimin e këtyre të dhënave për qëllime statistikore, në bazë të memorandumëve të mirëkuptimit me institucionet përkatëse, ku përcaktohen rolet, të dhënat që përcillen dhe kriteret e cilësisë së të dhënave. Prodhimi i statistikave gjinore nga burimet administrative varet nga shkëmbimi i rregullt dhe i strukturuar i të dhënave midis INSTAT-it dhe institucioneve që mbajnë të dhënat e sektorit përkatës. INSTAT-i siguron që këto të dhëna plotësojnë standardet e duhura metodologjike dhe cilësore për t'u përfshirë në produktet statistikore. Me mbështetjen e grupit ndërinstitucional të punës për statistikave gjinore do të hartohen tregues shtesë specifikë gjinorë ose të lidhur me gjininë, sidomos në fushat e arsimit, mbrojtjes sociale, shëndetit, punësimit dhe vendimmarrjes.

### Censi i popullsisë dhe banesave

Censi i popullsisë dhe banesave, që kryhet një herë në dhjetë vjet, është një burim gjithëpërfshirës të dhënash demografike dhe social-ekonomike. Censi i vitit 2023,<sup>123</sup> që u krye në përputhje të pjesshme me Rregulloren e BE-së 763/2008,<sup>124</sup> përbën një bazë të rëndësishme për prodhimin e treguesve gjinorë në fusha të ndryshme. Çka është më e rëndësishme, Censi mundëson gjenerimin e treguesve të ndarë sipas seksit në nivelet më të vogla gjeografike, që nuk mund të sigurohen përmes anketave të NJEF-ve. Në fund të vitit 2026, INSTAT-i, me mbështetjen e UN Women, do të kryejë një analizë të thelluar për identifikimin e pabarazive gjinore në nivel rajonal dhe vendor në fusha si migracioni, arsimit, pjesëmarrja në forcat e punës, struktura familjare, strehimi dhe aksesit në shërbime bazë.

### Anketat e njësive ekonomike familjare

INSTAT kryen një numër anketash të njësive ekonomike familjare që shërbejnë si burime të rëndësishme statistikash gjinore.

*"Anketa e dhunës ndaj grave dhe vajzave (DHNGV) në*

122. <https://eige.europa.eu/gender-equality-index> dhe <https://ec.europa.eu/eurostat/web/equality-non-discrimination/overview>

123. <https://www.instat.gov.al/en/census-2023/>

124. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32008R0763>

*Shqipëri*: Shqipëria ka kryer tre të tilla (2007, 2013 dhe 2018). Ndonëse anketa e vitit 2018 nuk përdori metodologjinë që përdor Eurostat në anketën për DHBGJ-në në BE125 ajo megjithatë prodhoi një numër treguesish sipas kërkesave të Eurostatit. Një anketë plotësisht e harmonizuar me anketat e DHBGJ-së në BE është planifikuar për vitin 2026, në përputhje me metodologjinë dhe standardet teknike të Eurostatit.

*"Anketa e përdorimit të kohës" (APK)*: APK-ja, që për herë të fundit u krye në vitin 2010,<sup>126</sup> është me rëndësi thelbësore për matjen e punës së papaguar të përkujdesit dhe të modeleve gjinore në përdorimin e kohës. Duke qenë se Shqipëria nuk ka të dhëna të përditësuara në këtë fushë, është planifikuar një anketë e re për vitin 2026, në përputhje me udhëzimet e përditësuara të Eurostatit.<sup>127</sup> *Anketa të tjera*: INSTAT-i prodhon edhe të dhëna të ndara sipas seksit përmes anketave kryesore si "Anketa e forcave të punës" (AFP), "Anketa e të ardhurave dhe nivelit të jetesës" (EU-SILC), "Anketa e buxhetit të njëjive ekonomike familjare" (ABNJEJF), "Anketa e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) në familje dhe nga individët", "Anketa evropiane e intervistimit shëndetësor (EHIS), dhe "Anketa e arsimit për të rritur" (AES). Këto anketa zhvillohen nga INSTAT-i dhe zbatohen në kuadër të Rregullores së BE-së 2019/1700 (IESS).<sup>128</sup> Ato ofrojnë të dhëna thelbësore për ndjekjen në vijimësi të pabarazive gjinore në punësim, konsum, akses në mjete digjitale, arsim dhe kujdes shëndetësor. Krahas tyre, dy anketa të tjera të rëndësishme të INSTAT-it, "Anketa e strukturës së të ardhurave nga puna" (ASAP) dhe "Anketa e kostos së punës" (AKP), kryhen në përputhje me metodologjinë e Eurostat-it. AKP-ja ofron informacion të detajuar për nivelin, strukturën dhe tendencat afatshkurtra të kostove të punës, ndërsa ASAP ofron të dhëna të krahasueshme në nivel të BE-së mbi marrëdhëniet midis të ardhurave, punonjësve dhe punëdhënësve të tyre. Çka është më e rëndësishme, të dhënat e ASAP përdoren edhe për të llogaritur hendekun gjinor në pagë (HGJP), të paponduar, që mundëson krahasueshmërinë dhe është e dhënë kyçe për monitorimin e barazisë gjinore

në tregun e punës. Megjithatë nevojiten përpjekje të mëtejshme për arritjen e përputhshmërisë së plotë me rregulloret dhe kriteret e Eurostatit. Vihet në dukje se "Indeksi i kostos së punës" ende nuk është hartuar; po kështu edhe "Anketa e vendeve të disponueshme të punës" ende nuk është zbatuar nga INSTAT-i.

## Shpërndarja dhe përdorimi i statistikave gjinore në Shqipëri

Shpërndarja efektive e statistikave gjinore dhe statistikave të ndara sipas seksit është me rëndësi thelbësore për transparencën, hartimin e politikave të bazuara në fakte, dhe llogaridhënien publike. Në Shqipëri, INSTAT-i luan rol qendror në botimin e statistikave gjinore përmes platformave dhe produkteve të dedikuara, në përputhje me Programin e Statistikave Zyrtare.

INSTAT-i integron të dhënat e ndara sipas seksit në disa produkte statistikore kombëtare, ndër të cilët më të rëndësishmit janë botimi vjetor "Gratë dhe burrat në Shqipëri",<sup>129</sup> Paneli i të Dhënave Statistikore për Gjininë,<sup>130</sup> dhe një seksion më vete në Bazën e të Dhënave Statistikore.<sup>131</sup> Këto instrumente ofrojnë të dhëna të aksesueshme, të lehta për t'u përdorur, të cilat përdoren gjerësisht nga hartuesit e politikave, studiuesit dhe shoqëria civile. "Gratë dhe burra në Shqipëri" u botua për herë të parë në vitin 2008 dhe është bërë botim i përvitshëm që prej vitit 2013, çka dëshmon angazhimin në rritje të Shqipërisë për raportim konsistent mbi barazinë gjinore në të gjithë sektorët. Ai përfshin treguesit sasiore të **Listës minimale të treguesve gjinorë të OKB-së**, të miratuar nga Komisioni i Statistikave i Kombeve të Bashkuara në vitin 2013.<sup>132</sup> Kjo listë përfshin 52 tregues sasiore në fusha kyçe si arsimi, punësimi, shëndetësia, të drejtat e njeriut, dhe pjesëmarrja e grave në jetën publike dhe vendimmarrje. INSTAT-i prodhon dhe boton pjesën më të madhe të këtyre treguesve çdo vit, duke u kushtuar atyre një kapitull të veçantë në botimin "Gratë dhe burrat në Shqipëri". Megjithatë, shtatë tregues, si

125. <https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-manuals-and-guidelines/-/ks-gq-21-009>

126. <https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2011/albania-time-use-survey-2010-2011/>

127. <https://ec.europa.eu/eurostat/web/products-manuals-and-guidelines/-/ks-gq-20-011>

128. <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32019R1700>

129. <https://www.instat.gov.al/en/publications/books/2023/men-and-women-2023/>

130. <https://www.instat.gov.al/publikimi-interaktiv-gratë-dhe-burra-në-shqipëri/>

131. <https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/en/DST/>

132. [https://unstats.un.org/unsd/demographic-social/gender/MinSet\\_ListIndicator\\_2023.pdf](https://unstats.un.org/unsd/demographic-social/gender/MinSet_ListIndicator_2023.pdf)

ata që lidhen me shkallën e punësimit të prindërve me fëmijë të moshës nën tre vjeç, arsimin parashkollor dhe pronësinë mbi tokën në bujqësi, aktualisht nuk janë të disponueshëm. Gjithashtu, më shumë se dhjetë tregues mbështeten në të dhëna nga anketime jo të shpeshta, si “Censi i popullsisë dhe i banesave”, “Studimi demografik dhe shëndetësor”, dhe “Anketa e përdorimit të kohës”, që do të thotë se ende nuk janë të disponueshme të dhëna të përditësuara për raportimet e rregullta.

Në kuadër të angazhimit të Shqipërisë ndaj OZHQ-ve, theks i veçantë i kushtohet barazisë gjinore, sidomos OZHQ 5 dhe treguesve që kanë lidhje me gjininë në të gjithë objektivat e tjerë. Barazia gjinore është jo vetëm një objektivi më vete, por edhe prioritet në të gjitha fushat: në të gjithë Agjendën 2030 janë identifikuar gjithsej 81<sup>133</sup> tregues specifikë gjinorë. Të dhëna globale janë të disponueshme për 58 tregues specifikë gjinorë, ndërsa Shqipëria aktualisht prodhon 22, të cilët paraqiten në botimin “Gratë dhe burrat në Shqipëri”. Këta tregues janë të disponueshëm edhe përmes Panelit të OZHQ-ve<sup>134</sup> që menaxhohet nga INSTAT-i, që është një platformë e aksesueshme nga përdoruesit për monitorimin e progresit në objektivat e barazisë gjinore dhe objektiva të tjerë të lidhur me të. Investimi në vijimësi për harmonizimin dhe ndarjen e të dhënave sipas seksit dhe variabëlave të tjerë është shumë i rëndësishëm për zgjerimin e disponueshmërisë dhe përmirësimin e cilësisë së treguesve të OZHQ-ve të lidhur me gjininë.

Së fundi, Indeksi i Barazisë Gjinore që u përmend më herët, që Shqipëria e botoi për herë të parë në vitin 2020, përmban edhe statistika të dobishme për kuptimin e pabarazive gjinore në Shqipëri dhe botimet e ardhshme premtajnë të krijojnë një pasqyrë edhe më të plotë të situatës. Në vitin 2020, Shqipëria nxori të parin Indeks të Barazisë Gjinore sipas BE-së, që u hartua nga INSTAT-i në bashkëpunim me MSHMS-në, i cili u validua nga Instituti Evropian për Barazi Gjinore. Shqipëria shënoi 60,4 nga 100 pikë, me performancën më të mirë në fushën e shëndetësisë, si edhe me rezultate mbresëlënëse në fushën e pushtetit, ku kishte performancë më të mirë se sa mesatarja e BE-së, për shkak të pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje politike dhe ekonomike. Botimi i ardhshëm i Indeksit pritet të përfshijë edhe dy fushat

shtesë, që do të ofrojë një tablo më gjithëpërfshirëse të pabarazive gjinore në Shqipëri.

## Kufizimet aktuale dhe veprime të rekomanduara

Shqipëria ka bërë përparim të vazhdueshëm në prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave gjinore. Megjithatë, ka një numër kufizimesh që pengojnë zhvillimin e një kornize kombëtare të statistikave gjinore gjithëpërfshirëse, bashkëkohore dhe me relevancë për hartimin e politikave. Së pari, vazhdon të ekzistojë një hendek i madh në prodhimin sistematik të statistikave lidhur me përkatësitë e shumëfishta, që shkojnë përtej ndarjes sipas seksit dhe që përfshijnë moshën, aftësinë e kufizuar, përkatësinë etnike, statusin e migracionit, llojin e familjes dhe vendndodhjen gjeografike. Mungesa e një ndarjeje të tillë kufizon aftësinë për të kuptuar se si manifestohen pabarazitë gjinore në të gjitha grupet e ndryshme të popullatës dhe pengon zhvillimin e politikave publike përfshirëse dhe të fokusuar. Krahas kësaj, **disponueshmëria e kufizuar të dhënave në nivel vendor** pengon përpjekjet për identifikimin dhe trajtimin e dallimeve rajonale, sidomos ato që ndikojnë në aksesin e grave në shërbime dhe mundësi ekonomike. Një vështirësi tjetër e rëndësishme është **përdorimi i kufizuar i të dhënave administrative** për qëllime statistikore. INSTAT-i aktualisht përdor dokumentacion administrativ për të prodhuar statistika gjinore, por ka shumë vend për përmirësim për shfrytëzimin e plotë të të dhënave të disponueshme. Mangësitë janë sidomos të dukshme në fusha si mbrojtja sociale, pensionet, formimi profesional, dhe punëkërkesit e regjistruar, ku ndarja sipas karakteristikave kryesore demografike dhe sociale vazhdon të jetë e pamjaftueshme. Po kështu, **të dhënat e anketave nuk përdoren sa duhet** për gjenerimin e treguesve gjinorë në fusha tematike kyçe si puna e papaguar e përkujdesit, gjendja shëndetësore, të ardhurat, arsimit për të rritur dhe punësimi, përfshirë aftësinë për përdorimin e këndvështrimit të përkatësive të shumëfishta. Sigurimi i harmonizimit me standardet e Eurostatit është shumë i rëndësishëm për korrigjimin e këtyre mangësive dhe për të mbështetur përmbushjen e kërkesave statistikore të BE-së nga Shqipëria. Kufizimet në kapacitete ndikojnë gjithashtu edhe

133. [https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/CSW/64/National-reviews/Annex1\\_English.pdf](https://www.unwomen.org/sites/default/files/Headquarters/Attachments/Sections/CSW/64/National-reviews/Annex1_English.pdf)

134. <https://www.instat.gov.al/en/sdgs/>

prodhimin, analizën dhe përdorimin e statistikave gjinore. Investimet në vijimësi në zhvillimin e kapaciteteve dhe koordinimi ndërmjet institucioneve janë thelbësore për përmirësimin e cilësisë së të dhënave dhe për të siguruar që gjinia të integrohet në të gjithë sistemin statistikor.

## 2.6 ROLI I OSHC-VE NË PROMOVIMIN E BARAZISË GJINORE DHE FUQIZIMIN E GRAVE

Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC) në Shqipëri kanë luajtur **rol kritik** në promovimin e **barazisë gjinore dhe të fuqizimit të grave**. Ato kanë kontribuar në veprimtaritë avokuese, **reforma ligjore, ofrim shërbimesh dhe fushata ndërgjegjësuere**. Megjithatë, këto organizata ende përballen me **sfida të lidhura me financimin, bashkëpunimin me qeverinë dhe zbatimin e politikave gjinore**.

Lëvizja e OSHC-ve në Shqipëri ka një histori të gjatë që filloi në vitet 1990 me krijimin e organizatave të para joqeveritare (OJQ) të grave. OJQ-ja e parë e krijuar pas rënies së regjimit komunist u fokusua në trajtimin e çështjeve kyçe të të drejtave të grave. Të frymëzuara nga Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim (DPPV) e vitit 1995, OJQ-të e grave e zgjeruan fokusin e tyre në fusha të ndryshme me rëndësi kritike të përfshira në DPPV. Që nga ajo kohë, shoqatat e grave kanë kryer një varg aktivitetesh që lidhen me të drejtat e grave dhe fëmijëve, kujdesin social dhe shëndetësor, zhvillimin ekonomik (kryesisht bizneset e vogla) dhe luftën kundër dhunës ndaj grave. Në vitin 2020 filloi një lëvizje kombëtare për fuqizimin politik të grave e cila mori hov me kalimin e viteve, duke u kurorëzuar me një fushatë në media për përfaqësimin politik të grave në vitin 2005, me mbulim të gjerë në televizion dhe radio dhe debate publike. Lëvizja që e suksesshme në përmirësimin e klimës politike dhe sociale të vendit, për sa i përket balancës gjinore. Pas viteve 2000, OJQ-të e grave u bënë më proaktive në veprimtari lobimi dhe avokimi për përmirësimin e të drejtave të grave (për shembull, Ligji “Për dhunën në marrëdhëniet familjare” i vitit 2006, ishte nga ligjet e para që u krijua përmes nismave qytetare dhe me mbështetjen e OJQ-ve të grave). Krahas kësaj, këto organizata kontribuan me ekspertizën e tyre në konsultimet për hartimin e Ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri” dhe të Strategjisë Kombëtare për Barazinë

Gjinore 2007-2010. Karakteristike për këtë periudhë ishte krijimi i rrjeteve dhe koalicioneve, dhe OJQ-të kishin rol qendror në ofrimin e shërbimeve gjatë asaj kohe.

Në dhjetëvjeçarin 2010-2020, roli i OJQ-ve të grave u zgjerua si në drejtim të ofrimit të shërbimeve, ashtu edhe në fushat e lobimit dhe avokimit për përmirësimin e kornizave ligjore dhe të politikave për fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore. Ato luajtën një rol shumë të rëndësishëm në përgatitjen e raporteve hije dhe raporteve alternative lidhur me zbatimin e traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në Shqipëri. Kontributet e tyre u njohën nga shteti dhe ato u ftuan të merrnin pjesë në borde këshillimore, konsultime, etj. Përveç mbështetjes që jepet nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, disa OJQ që ofrojnë shërbime filluan të merrnin mbështetje të drejtpërdrejtë nga organet e qeverisjes qendrore ose vendore (përmes ofrimit të mjediseve për aktivitetet e tyre, mbështetjes për shërbimet që lidhen me strehimin e të mbijetuarave të DHBGJ-së, dhe kontribuimit me fonde për shërbime këshillimi, etj.).

Puna e OSHC-ve për fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore ka vazhduar edhe gjatë pesë viteve të fundit, megjithëse financimi i tyre varet nga mbështetja ndërkombëtare. Një nga rekomandimet e raportit të parë tematik të GREVIO-s për Shqipërinë, 2024, theksoi nevojën për sigurimin e rolit të qëndrueshëm të organizatave të të drejtave të grave përmes financimit të duhur të tyre. Ky rol përfshin shërbime mbështetëse për të gjitha viktimat e dhunës ndaj grave, përfshirë ndihmën juridike, përmes granteve afatgjata të akorduara bazuar në procedura prokurimi transparente. GREVIO theksoi gjithashtu rëndësinë e eliminimit të barrierave të panevojshme burokratike në procesin e aplikimit për fonde.

Përveç punës avokuese në drejtim të legjisllacionit dhe ofrimit të shërbimeve, OSHC-të në Shqipëri kanë luajtur rol qendror në **ndryshimin e qëndrimeve të shoqërisë lidhur me barazinë gjinore dhe të drejtat e grave**. Përmes fushatave ndërgjegjësuere në nivel kombëtar, angazhimit të mediave dhe programeve arsimore, ato kanë ndihmuar në luftimin e stereotipeve dhe promovimin e një shoqërie më përfshirëse nga pikëpamja gjinore. OSHC-të kanë kontribuar edhe në **forcimin e pjesëmarrjes së grave në jetën politike dhe ekonomike**, përmes avokimit për kuota gjinore dhe mbështetjen e grave candidate në zgjedhje. Roli i tyre në **programet për ndërtimin e kapaciteteve** ka fuqizuar me mijëra gra përmes ofrimit të **mbështetjes** me

trajtime profesionale, njohuri financiare dhe sipërmarrje, që kontribuon në pavarësinë e tyre ekonomike. Ato kanë ofruar gjithashtu ndërtim kapacitetesh për institucionet shtetërore dhe profesionistët, për t'i ndihmuar që t'u përgjigjen më mirë problemeve të barazisë gjinore dhe DHBGJ-së. Krahas këtyre, OSHC-të shqiptare kanë krijuar partneritete të fuqishme rajonale dhe ndërkombëtare, duke harmonizuar përpjekjet e tyre me lëvizjet globale dhe praktikat më të mira dhe duke forcuar fuqinë avokuese të tyre në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Me gjithë kontributet e rëndësishme të tyre, OSHC-të vazhdojnë të **përballesh me sfida strukturore dhe operacionale** që kufizojnë aftësinë e tyre për të pasur ndikim afatgjatë. Një nga problemet më të ngutshme mbetet mbështetja e tyre **në financime nga donatorët ndërkombëtarë**, të cilat shpesh janë të destinuara për projekte specifike dhe afatshkurtra. Ndonëse ekzistojnë disa mundësi për financim nga fondet publike – si përmes Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile dhe alokimet bashkiake për OSHC-të që ofrojnë shërbime të caktuara (p.sh. në mbështetje të viktimave të trafikimit) – këto fonde nuk janë të garantuara rregullisht dhe variojnë mjaft nga viti në vit. Kjo parashikueshmëri e kufizuar, së bashku me kapacitetet e kufizuara institucionale dhe financiare, bën që OSHC-të jenë të rrezikuara nga paqëndrueshmëria financiare dhe pengon aftësinë e tyre për të ndërmarrë dhe zbatuar nisma afatgjata dhe me ndikim për barazinë gjinore. Krijimi i një mekanizmi financimi më të institucionalizuar dhe të parashikueshëm do të ndihmonte për të siguruar që shërbimet thelbësore që ofrohen nën drejtimin e OSHC-ve të mbështeten në vijimësi.

Krahas kësaj, përpjekjet e OSHC-ve në fushën e avokimit ndonjëherë pengohen nga **barriera politike dhe institucionale**, sidomos kur kërkojnë zbatim më rigoroz të ligjeve dhe politikave që lidhen me gjininë. Angazhimi dhe përfaqësimi i organizatave (të të drejtave të njeriut) të grave në proceset dhe mekanizmat e integritimit në BE, si Platforma Kombëtare për Integritimin në BE, ka mbetur i kufizuar. Nevoja në rritje për **shërbime mbështetëse të specializuara**, si këshillimi psikologjik për të mbijetuarat e DHBGJ-së dhe ndihma juridike, kërkon investime më të mëdha në kapacitete njerëzore dhe burime financiare. Për më tepër, ndryshimet e shpejta të prioritetëve kombëtarë dhe globale – si krizat ekonomike dhe mungesa e stabilitetit politik – mund të devijojë vëmendjen dhe

burimet prej nismave të barazisë gjinore. Trajtimi i këtyre sfidave do të kërkojë bashkëpunim më të fuqishëm midis OSHC-ve, organeve qeveritare dhe partnerëve ndërkombëtarë, për të siguruar progres të qëndrueshëm drejt barazisë gjinore në Shqipëri.

Vrojtimit në terren tregojnë se OSHC-të që nuk fokusohen në çështjet gjinore shpesh e kanë të vështirë të përfshijnë barazinë gjinore në programet e tyre, kryesisht për shkak të mungesës së ndërgjegjësimit, trajnimit të pamjaftueshëm ose angazhimit jo të plotë institucional. Kjo rezulton në mangësi afatgjata në shërbime, sidomos në ato për mbështetje psikosociale, shërbimet e ri-integritimit dhe të ndihmës juridike për viktimat e DHBGJ-së. Për t'i korrigjuar këto mangësi, nevojiten përpjekje të fokusuar për ndërtimin e kapaciteteve dhe rritjen e ndërgjegjësimit në sektorin e shoqërisë civile në tërësi. Mbështetja e OSHC-ve që nuk kanë në fokus gjininë që të integrojnë barazinë gjinore në punën e tyre, mund të forcojë të gjithë mjedisin e ofruesve të shërbimeve. Aktorët ndërkombëtarë duhet t'i japin prioritet financimit përfshirës dhe mbështetjes teknike përfshirëse, për të mundësuar koordinimin në të gjithë sektorin dhe për të siguruar që barazia gjinore të integrohet në të gjitha aktivitetet e kryera nga OSHC-të.

## KUTIA 2. ROLI I OSHC-VE NË SHQIPËRI

Në Raportin e vitit 2024 për Shqipërinë, Komisioni Evropian theksoi se: "Organizatave e shoqërisë civile (OSHC) në Shqipëri operojnë në një mjedis që paraqet sfida, ndër të tjera edhe për sa i përket kriterëve të regjistrimit të tyre dhe fondeve të kufizuara publike për OSHC-të. Roli i shoqërisë civile, përfshirë edhe në procesin e negociatave me BE-në, duket të forcohet më tej. Strukturat e krijuara për konsultimin me shoqërinë civile duhet të forcohen dhe të bëhen plotësisht funksionale. Përveç kësaj, duhet të vendosen pa vonesa të mëtejshme kushtet e nevojshme për lirimin e tyre nga pagesa e TVSH-së."<sup>135</sup>

135. Komisioni Evropian. "Raporti për Shqipërinë, 2024", f. 4.

## 2.7 REKOMANDIME

### Niveli i politikave

1. Integrimi i seksit në dokumentet e politikave strategjike kombëtare për realizimin e masave të planifikuara, përmirësimin e monitorimit dhe vlerësimin, dhe sigurimin e mekanizmave të mjaftueshëm të alokimit të burimeve dhe llogaridhënies, me qëllim përmbushjen e masave të planifikuara me qëllim realizimin efektiv të të drejtave të grave dhe vajzave.
2. Forcimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor (BPGJ) për të siguruar integrimin konsistent të objektivave dhe treguesve gjinorë dhe për gjurmimin e shpenzimeve në të gjithë sektorët dhe nivelet e qeverisjes, si edhe krijimi i një mekanizmi të unifikuar që ngërthen shpenzimet faktike për barazinë gjinore.
3. Përmirësimi i sistemeve të monitorimit përmes operacionalizimit të sistemit IPSIS, standardizimit të treguesve në nivelin e rezultateve, dhe vendosjes së afateve të qarta për zbatimin e objektivave të SKBGJ 2021-2030.
4. Maksimizimi i fondeve të donatorëve për integrimin e barazisë gjinore në reformat e mbështetura nga BE-ja dhe në reforma të tjera kombëtare, zbatimin e parimeve të BPGJ-së për përfitime të barabarta, harmonizimi i investimeve të partnerëve ndërkombëtarë me prioritetet kombëtare, dhe forcimi i kornizave të përbashkëta të llogaridhënies.
5. Forcimi i zbatimit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në nivelin e qeverisjes vendore duke siguruar që programet buxhetore afatmesme (PBA-të) të bashkive dhe strategjitë vendore të mbështeten me burime të mjaftueshme dhe të përfshijnë mekanizma monitorimi dhe vlerësimi me tregues të ndarë sipas seksit. Ndërtimi i kapaciteteve të punonjësve të bashkive dhe anëtarëve të këshillave bashkiakë për të zbatuar mjetet e BPGJ-së, dhe institucionalizimi i mekanizmave të pjesëmarrjes që përfshijnë gratë dhe shoqërinë civile në planifikimin dhe mbikëqyrjen e buxhetit.

### Infrastruktura ligjore

Reforma legjislativë për përafrim me *acquis*-in e BE-së dhe standardeve ndërkombëtare, për mbylljen e boshllëqeve dhe forcimin e akteve nënligjore dhe të zbatimit të legjislationit. Përditësimi i kuadrit ligjor, veçanërisht i Ligjit "Për barazinë gjinore në shoqëri", Ligjit "Për masa

kundër dhunës në marrëdhëniet familjare", Kodit Penal, Kodit të Procedurës Penale, Kodit të Familjes, Kodit Civil, Kodit të Procedurës Civile dhe Ligjit "Për shëndetin riprodhues", ndër të tjera, për të trajtuar mangësitë që janë identifikuar nga KEDG, GREVIO, dhe PRU.

### Korniza institucionale

6. Përmirësimi i koordinimit institucional për forcimin e bashkëpunimit ndërministror, fuqizimin e nëpunësve dhe personave të kontaktit të barazisë gjinore, dhe konsolidimi i sistemeve të monitorimit në nivel qendror dhe vendor.
7. Forcimi i kapaciteteve institucionale për përmirësimin e koordinimit, qartësimin e mandateve dhe sigurimin e burimeve të mjaftueshme për makinerinë kombëtare gjinore, KMD-në dhe AP-në, përfshirë standardet për strehëzat, të drejtat pronësore, luftën kundër seksizmit në media, dhe mbrojtjen në pjesëmarrjen në politikë.
8. Forcimi i kapaciteteve të makinerisë së barazisë gjinore (MBGJ) përmes sigurimit të burimeve të mjaftueshme njerëzore, profesionale dhe financiare për institucionet, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel vendor. Garantimi që mekanizmat e barazisë gjinore të krijohen siç duhet, dhe që nëpunësit gjinorë të emërohen dhe të funksionojnë në qeveri dhe bashki. Këto masa duhet të formulohen edhe në përputhje me kërkesat e BE-së, në mënyrë që të kontribuojnë drejtpërdrejt në procesin e anëtarësimit në BE dhe të demonstrojnë progres drejt përmbushjes së standardeve të BE-së për barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin.
9. Forcimi i kapaciteteve institucionale përmes ofrimit të trajnimeve në institucionet publike qendrore dhe vendore për zbatimin e BPGJ-së, kryerjen e analizave që marrin parasysh përkatësitë e shumëfishta, dhe përfshirjen e të dhënave të ndara sipas seksit në planifikim dhe raportim.

### Qeverisja vendore

10. Mbështetja e organeve të pushtetit vendor në standardizimin e hartimit, monitorimit dhe vlerësimin të planeve vendore të veprimit për barazi gjinore (PVVB-GJ) me buxhete realiste dhe masa për llogaridhënie, si edhe rritja e përpjekjeve për përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha planet vendore.

## Niveli parlamentar

11. Rritja e angazhimit të Kuvendit përmes forcimit të roleve të komisioneve, nënkomisioneve, dhe grupeve vullnetare në avancimin e barazisë gjinore dhe monitorimin e angazhimeve në kuadër të OZHQ-ve.

## Statistikat gjinore

12. **Investimi në zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve** të punonjësve që merren me të dhënat dhe statistikën në institucionet publike në nivel kombëtar dhe në nivel vendor, si edhe të anëtarëve të grupit ndërinstitucional të punës për statistikën gjinore, për forcimin e aftësive të tyre për prodhimin, interpretimin, përdorimin dhe komunikimin e statistikave gjinore.
13. **Integrimi i perspektivës gjinore** në të gjitha fazat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave, përfshirë në zgjedhjen e tematikës, hartimin e pyetësorëve, zgjedhjen e kampionëve, trajnimin për punën në terren, kodifikimin e të dhënave dhe interpretimin e tyre, për të siguruar që të dhënat të pasqyrojnë përvojat e jetuara dhe nevojat e të gjitha grupeve të popullatës.
14. **Shfrytëzimi i të dhënave administrative dhe të anketimeve** për gjenerimin e treguesve shtesë specifikë dhe relevantë gjinorë, përmes përdorimit të një qasjeje me fokus mbi përkatësitë e shumëfishta, që përfshin moshën, aftësinë e kufizuar, përkatësinë etnike, statusin e migracionit, llojin e familjes, vendndodhjen gjeografike, etj.
15. **Nxitja e bashkëpunimit institucional** midis INSTAT-it, ministrive të linjës, organizatave të shoqërisë civile (OSHC), botës akademike dhe qendrave kërkimore për të mbështetur shkëmbimin e të dhënave, për të forcuar hartimin e politikave të mbështetur në fakte, dhe për të inkurajuar përdorime inovative të statistikave.
16. **Përfshirja e moduleve mësimore për statistikën gjinore** në institucionet e arsimit të lartë dhe në Shkollën e Administratës Publike, për të përgatitur në vijimësi profesionistë të aftë në fushën e të dhënave gjinore dhe të promovohen njohuritë për të dhënat statistikore në të gjitha institucionet publike.

## Organizatave të shoqërisë civile

17. Mbështetja e angazhimit të OSHC-ve dhe ndërtimi i kapaciteteve të tyre për punë avokuese, ndërgjegjësim, ofrimin e shërbimeve dhe monitorim.
18. Forcimi i partneriteteve për rritjen e bashkëpunimit mes OSHC-ve, institucioneve qeveritare dhe partnerëve ndërkombëtarë për të ndikuar në hartimin e politikave dhe forcimin e ofrimit të shërbimeve.
19. Ndërtimi i kapaciteteve për mbështetjen e OSHC-ve që nuk janë të specializuara në fushën e barazisë gjinore për integrimin e seksit në programet e tyre, përmes trajnimeve dhe asistencës teknike.
20. Fuqizimi i OSHC-ve për monitorimin e zbatimit të kuadrit ligjor mbi barazinë gjinore dhe për promovimin e llogaridhënies.

## Të tjera (drejtësia, ndërgjegjësimi, DHBGJ)

21. Sigurimi i aksesit në drejtësi për të gjitha gratë përmes shtimit të financimit për ndihmën juridike, përmirësimin të kapaciteteve forenzike, dhe trajtimin të problemit të anshmërisë gjinore në organet ligjzbatuese dhe të gjyqësorit, dhe sigurimi i procedurave të ndjeshme ndaj viktimeve.
22. Luftimi i diskriminimit dhe DHBGJ-së përmes fuqizimit të institucioneve të KMD-së dhe Avokatit të Popullit për të kryer hetime proaktive të çështjeve me bazë gjinore dhe për të siguruar ndjekjen në vijimësi të tyre në mënyrë efektive.
23. Forcimi i monitorimit dhe llogaridhënies përmes vendosjes së mekanizmave sistematike për ndjekjen në vijimësi të zbatimit të kuadrit ligjor ekzistues, përmirësimin të mbledhjes dhe përdorimit të statistikave gjinore, dhe kryerjes së vlerësimeve të rregullta të zbatimit të akteve ligjore të lidhura me gjininë (*ex-post*).
24. Rritja e ndërgjegjësimin të publikut përmes zgjerimit të punës informuese mbi të drejtat e grave dhe për t'i informuar ato për mjetet ligjore të disponueshme, sidomos për grupet e marginalizuara.
25. Trajtimi i barrierave sistematike përmes kundërvënies ndaj normave patriarkale, zgjerimit të punës për ngritjen e ndërgjegjësimin, dhe priorizimit të grupeve të marginalizuara (pakicave, grave me aftësi të kufizuara, LGBTIQ+, nënave të vetme, të mbijetuarave, grave nga zonat rurale, etj.).



# 3

**ÇËSHITJE KYÇE  
TË BARAZISË  
GJINORE:  
PROGRESI,  
SFIDAT DHE  
REKOMANDIME**

**Shqipëria ka bërë përparim në drejtim të barazisë gjinore përmes reformave. Megjithatë, ende vazhdojnë pabarazitë në sferat politike, ekonomike dhe sociale, sidomos në zonat rurale, të cilat shtojnë rrezikun e dhunës me bazë gjinore (DHBGJ).**

**DHBGJ-ja mbetet shqetësim kritik**, me nivele të larta mosraportimi për shkak të **stigmës, varësisë ekonomike nga dhunuesi dhe mbështetjes së pamjaftueshme institucionale**. Normat shoqërore vazhdojnë të përforcojnë rolet gjinore tradicionale, duke kufizuar autonominë e grave dhe duke i ngarkuar ato së tepërmi me **punë të papaguara të përkujdesit**, që, nga ana e tyre, kufizojnë aksesin e tyre **në punësim formal dhe përparim në karrierë**. Grupet e pafavorizuara, si **gratë rome dhe egjiptiane, gratë me aftësi të kufizuara, gratë e moshuara, nënat e vetme dhe personat LGBTIQ+**, përballen me **forma të shumëfishta diskriminimi**, përfshirë diskriminimin për shkak të përkatësisë së shumëfishtë, që thellojnë më tej përjashtimin social dhe ekonomik të tyre. Me gjithë **angazhimet progresive përmes politikave, mekanizmat e dobët të zbatimit dhe burimet e pamjaftueshme financiare** pengojnë zbatimin efektiv të politikave ekzistuese dhe kornizave ligjore.

### **3.1 SIGURIMI I TË DREJTËS PËR TË JETUAR PA ASNJË FORMË DHUNE ME BAZË GJINORE**

Dhuna me bazë gjinore vazhdon të jetë një prej sfidave më të ngutshme në fushën e të drejtave të njeriut në Shqipëri, e ushqyer nga pabarazitë strukturore, cenueshmëria ekonomike, dhe normat tradicionale të rrënjësura thellë. Me gjithë shtimin e përpjekjeve ndërgjegjësuere dhe përfshirjen e masave parandaluese në ligjet dhe politikat përkatëse, nivelet e përhapjes së DHBGJ-së vazhdojnë të jenë alarmante, dhe shumë raste nuk raportohen për shkak të frikës, stigmës dhe mungesës së besimit në sistemet e mbështetjes.

Perceptimet publike të DHBGJ-së, shpesh të ndikuara nga normat gjinore tradicionale, ndikojnë që shoqëria të tolerojë disa forma të dhunës, duke kufizuar efektivitetin e masave mbrojtëse. Krahas kësaj, praktika të dëmshme si zgjedhja e seksit të foshnjës në lindje dhe martesat në moshë të hershme vazhdojnë, gjë që pasqyron faktin që diskriminimi gjinor vazhdon të ekzistojë. Femicidi, forma më e skajshme e DHBGJ-së vazhdon të marrë jetë grash në Shqipëri, të cilat shpesh vriten nga partnerët intimë ose anëtarë të familjes, që është tregues i dështimeve sistematike të mekanizmave parandalues dhe mbrojtës.<sup>136</sup> Raporti i GREVIO-s (2024) thekson se Shqipëria ka ndërmarrë hapa për harmonizimin e politikave dhe strategjive të saj për trajtimin e problemit të DHNG-së me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Megjithatë, zbatimi i këtyre kornizave mbetet i kufizuar.<sup>137</sup> Trajtimi me efektivitet i DHBGJ-së kërkon një qasje gjithëpërfshirëse dhe të koordinuar, që i jep përparësi llogaridhënies institucionale, mekanizmave të përmirësuar për mbrojtjen e viktimave dhe angazhimin më të madh të publikut për t'iu kundërvënë qëndrimeve sociale të rrënjësura thellë.

#### **3.1.1 Legjislacioni dhe reagimi përmes politikave për parandalimin dhe trajtimin e DHBGJ-së**

Shqipëria ka bërë përparim të ndjeshëm në forcimin e kornizave ligjore dhe të politikave për luftimin e DHBGJ-së, me fokus dhunën në familje, përmes harmonizimit të legjislacionit kombëtar me direktivat e BE-së dhe traktatet ndërkombëtare si Konventa e Stambollit dhe KEGJFDG.

136. UN Women Shqipëri dhe Avokati i Popullit (2025). "Vrasja e grave dhe vajzave dhe femicidi në Shqipëri", Shih: <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Draft%20Raporti%20per%20Femicidin%2004.12.2024.pdf>

137. Shih faqen 5 të raportit të GREVIO-s (2024): "Ndonëse autoritetet kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të reformuar ligjet dhe politikat ekzistuese dhe për t'i përafuar ato me kërkesat e Konventës së Stambollit, raporti aktual tregon boshllëqe të konsiderueshme për sa i përket zbatimit ... Boshllëqet e konsiderueshme midis vullnetit politik për të kryer reformë dhe zbatimit të atyre dispozitave vazhdojnë të minojnë besimin e viktimave ... mungesa e zbatimit dhe ekzekutimit të mjaftueshëm të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes ... stigma që shoqëron dhunën seksuale dhe përdhunimin ... dhe ekzistenca e vetëm një qendre për raste krizash të përdhunimit, jo plotësisht funksionuese ... Për këtë arsye, vazhdon të ekzistojë nevojë urgjente për të investuar në mara të mëtejshme dhe më të qëndrueshme për rritjen e ndërgjegjësimin dhe për zgjerimin e shërbimeve mbështetëse përkatëse ...".

Ndër reformat më të rëndësishme legislative janë ndryshimet në Ligjin "Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare", në Kodin Penal, dhe në Ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi", që parashikojnë masa mbrojtëse më të forta, zgjerojnë kategoritë e viktimave dhe sigurojnë harmonizim me përkufizimet e BE-së. Krahas këtyre, masa plotësuese si krijimi i regjistrit kombëtar të autorëve të krimeve seksuale dhe ratifikimi i Konventës 190 të ONP-së i shtuan më tej garancitë mbrojtëse ligjore si në sferën publike ashtu edhe në atë private, përfshirë në vendin e punës.

SKBGJ 2021-2030 është një strategji e integruar dhe ndërsektoriale për parandalimin e DHBGJ-së, mbrojtjen e viktimave dhe rritjen e llogaridhënies, me nivel të lartë përputhshmërie me Planin e Veprimit Gjinator III të BE-së (2021-2025/2027). Me gjithë këto përpjekje, problemet në zbatim vazhdojnë të ekzistojnë dhe nevojiten reforma të mëtejshme për të bërë harmonizimin e plotë me standardet evropiane dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

Nën drejtimin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Shqipëria ka bërë hapa të rëndësishëm përpara në rishikimin e kuadrit të saj legjislativ mbi dhunën në familje për përfshirjen e të gjitha formave të dhunës, me qëllim që legjislacioni dhe politikat e vendit të përafrohen dhe të mbulojnë të gjitha format e dhunës ndaj grave të përfshira në Konventën e Stambollit, ndër të cilat edhe femicidi. Kërkesa e detyrueshme ligjore për pajtimin midis viktimës dhe autorit të dhunës duhet të shfuqizohet për të gjitha rastet penale në lidhje me dhunën ndaj grave, sidomos në rastet e përdhunimeve, abuzimit seksual dhe martesave të detyruara, si edhe në proceset e ndarjes së prindërve, në rastet kur ka pasur incidente dhune.<sup>138</sup> Ende nuk janë miratuar akte ligjore dhe nënligjore për krimin kibernetik; po kështu edhe penalizimi i të gjitha formave të dhunës seksuale *online* ndaj fëmijëve ende nuk është kryer. Kuadri ligjor për trafikimin e qenieve njerëzore

është pjesërisht i harmonizuar me *acquis*-in e BE-së dhe duhet të rishikohet nën dritën e ndryshimeve në Direktivën 2011/36/EU për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të tij.<sup>139</sup> Gjymtimi gjenital femëror, që identifikohet si një nga llojet e dhunës ndaj grave në Konventën e Stambollit dhe Direktivën 2024/1385 të BE-së të vitit 2024 për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, ende nuk është penalizuar. Të gjitha format e dhunës kibernetike (përndjekja kibernetike, ngacmimi *online* dhe dërgimi i pamjeve ose fotografive tek të tjerët pa pëlqimin e personit) ende nuk penalizohen me ligj,<sup>140</sup> po kështu mungojnë edhe dispozitat ligjore për ndjekjen penale të krimeve të urrejtjes, qoftë fizikisht apo në internet. Përkufizimi i përdhunimit në Kodin Penal duhet të ndryshohet për të përfshirë një përkufizim që bazohet në mungesën e pëlqimit, në përputhje me nenin 36 të Konventës së Stambollit. Kuadri ligjor nuk është ende aty ku duhet të jetë dhe duhet të reformohet për të parandaluar, hetuar, dhe dënuar dhunën gjinore politike. Po kështu, Kodi i Familjes duhet të rishikohet plotësisht për të ndaluar martesat e të miturve, martesat në moshë të hershme dhe ato të detyruara, në mënyrë që të eliminohet mundësia e përjashtimeve ndaj kërkesës ligjore për moshën minimale në martesë prej 18 vjeç.<sup>141</sup>

Në vitin 2025, qeveria shqiptare filloi procesin e hartimit të një ligji të ri për dhunën me bazë gjinore. Ky ligj synon të pasqyrojë rekomandimet afatgjata të GREVIO-s dhe mekanizmave të tjerë ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut mbi detyrimet e Shqipërisë për të trajtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse të gjitha format e dhunës me bazë gjinore, përtej dhunës në familje. Po kështu synohet të garantohet përafrimi me Direktivën 2024/1385 të BE-së për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, përfshirë dispozitat që kanë të bëjnë me dhunën në hapësirën digjitale, si dhe me Konventën nr. 190 të ONP-së që lidhet me eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në vendin e punës.

138. GREVIO, 2024. "Raporti i parë vlerësues tematik për Shqipërinë: Ndërtimi i besimit përmes sigurimit të mbështetjes, mbrojtjes dhe drejtësisë", Shtojca I, f. 49-55. Shih: <https://rm.coe.int/grevio-s-first-thematic-evaluation-report-on-albania/1680b1a0ca> KEGJFDG 2023.

"Vërejtjet përmblyëse mbi raportin e pestë periodik të Shqipërisë", f. 7. Shih: <https://docs.un.org/en/CEDAW/C/ALB/CO/5>

139. Komisioni Evropian, "Raporti për Shqipërinë 2024", f. 42. Shih: [https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68\\_en?filename=Shqipëria%20Report%202024.pdf](https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Shqipëria%20Report%202024.pdf)

140. Direktiva 2024/1385 e BE-së "Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", f. 73-78. Shih: [https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/A-9-2023-0234-AM-298-298\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/A-9-2023-0234-AM-298-298_EN.pdf)

141. Këshilli i të Drejtave të Njeriut, "Raport i grupit të punës mbi Raportin Periodik Universal për Shqipërinë", 20 dhjetor 2024. Shih: <https://docs.un.org/en/A/HRC/58/5>

## Ofrimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara

Shqipëria po bën përpjekje në vijimësi për krijimin dhe forcimin e shërbimeve të specializuara mbështetëse për të mbijetuarat e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, sikurse parashikohet në Konventën e Stambollit (neni 22), me disa nga këto shërbime që janë krijuar dhe menaxhohen nga OJQ, ndonëse nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar harmonizimin e tyre të plotë me standardet e Konventës. Deri më sot janë krijuar rreth 82 shërbime mbështetëse të specializuara, të cilat ofrojnë kryesisht strehim, linja telefonike kombëtare të ndihmës, mbështetje për viktimat e dhunës seksuale, ndihmë juridike falas, dhe programe për autorët e dhunës.

**Strehëzat dhe/ose forma të tjera të strehimit të sigurt** aktualisht ofrohen përmes rreth **27 shërbimeve** (nga të cilat **21 i dedikohen posaçërisht të mbijetuarave të dhunës në familje; pesë viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit dhe një komunitetit LGBTIQ+).** Ndër to përfshihen **dy strehëza shtetërore në nivel kombëtar** (një për viktimat e dhunës në familje<sup>142</sup> dhe një për viktimat (potenciale) të trafikimit,<sup>143</sup> **katër strehëza afatgjata jopublike;**<sup>144</sup> 19 strehëza emergjente (të menaxhuara nga bashkitë, OJQ-të, ose modele të përziera); <sup>145</sup> dhe **një strehëz afatgjatë për personat LGBTIQ+.** Forma të tjera të strehimit të sigurt ofrohen përmes programit të strehimit social dhe përmes skemave të bonusit të qirasë. GREVIO ka vënë në dukje se aksesimi në qendrën kombëtare varet nga fakti nëse viktimat kanë raportuar veprën penale dhe kanë marrë urdhër mbrojtës nga gjykata. Viktimave që nuk

i kanë këto u refuzohet sistematikisht qëndrimi në to, megjithëse vendet në strehëz rrallë janë të mbushura në kapacitet. Ekzistojnë **dallime gjeografike** të konsiderueshme për sa i përket disponueshmërisë së strehëzave, me shumicën e shërbimeve të përqendruara kryesisht në zonat urbane. Strehëzat e menaxhuara nga OJQ-të, që gjenden në tre qytete të mëdha të vendit – Tiranë, Vlorë, dhe Elbasan – kontribuojnë në kapacitetin e përgjithshëm dhe plotësojnë pjesërisht këtë boshllëk. Megjithatë, financimi i tyre mbetet i fragmentuar dhe pre e luhatjeve. Një analizë e kostos së tre strehëzave të menaxhuara nga OJQ-të tregon se kontributet nga shteti mbulojnë afërsisht 68,7 për qind të buxhetit të tyre,<sup>146</sup> që plotësohet me mbështetje të donatorëve; ndërsa raporti i përgatitur nga Komisioni i Lartë i Shtetit (KLSH, 2023), i cili u fokusua në qytetet e Tiranës, Durrësit, Gjirokastrës dhe Kukësit, konstatoi se për periudhën 2020-2023, 34 për qind e alokimeve nga Fondi Social shkuan për strehëza ose qendra multifunksionale që ofrojnë shërbime të DHF-së.<sup>147</sup> GRETA (2025) ka raportuar shtim të alokimit të fondeve nga shteti – mbi 24 milion lekë për qendrën shtetërore dhe 9 – 11,8 milion lekë për strehëzat e drejtuara nga OJQ-të – megjithatë vuri në dukje se këto fonde mbulojnë kryesisht pagat dhe ushqimin, duke lënë të paplotësuara kostot operacionale dhe duke rrezikuar qëndrueshmërinë afatgjatë të tyre. Autoritetet raportuan një rritje prej 45 për qind të fondeve për strehëzat e OJQ-ve në vitin 2024; po kështu janë rritur edhe fondet për strehëzën shtetërore, ku përfshihet edhe një rritje prej 10 për qind e pagave të punonjësve.<sup>148</sup> Ngritja e strehëzave të emergjencës plotëson mangësinë e identifikuar në mbrojtjen emergjente të viktimave dhe përbën një zhvillim pozitiv për mbështetjen e vazhdueshme të grave viktime.

142. Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje, është një qendër kombëtare afatgjatë, me 32 vende, që operon me buxhet nga shteti. Komisioni i Lartë i Shtetit (KLSH). 2023. *Raport auditimi performance: "Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus gratë e dhunuara.* Shih: <https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2025/05/KLSH-2023-Dhuna-ndaj-grave.pdf>

143. Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikimit, një qendër kombëtare afatgjatë që ofron 40 vende dhe është e aksesueshme edhe për personat me aftësi të kufizuara fizike, që operon me fonde nga buxheti i shtetit. Raporti i GRETA-s për Shqipërinë 2025. Shih: <https://rm.coe.int/greta-evaluation-report-on-the-implementation-of-the-council-of-europe/1680b65f41>

144. Përkatësisht: Strehë "Edlira Haxhiymeri" dhe "Të ndryshëm dhe të barabartë" në Tiranë; "Vatra" në Vlorë, "Tjetër vizion" në Elbasan, shërbime të drejtuara nga OJQ-të, të financuara pjesërisht nga shteti.

145. Strehëza emergjente (të financuara nga buxheti i bashkisë /shtetit) në Berat, Gjirokastrë, Përmet, Pogradec, Roskovec, Sarandë, Urë Vajguore, Krujë, Kukës, Maliq, Kurbin, Korçë dhe Lezhë; Strehëza emergjente (të financuara nga buxheti i bashkisë /shtetit dhe fonde të donatorëve), në Dibër, Durrës dhe Shkodër; Strehëza emergjente të menaxhuara nga OJQ të financuara pjesërisht nga shteti: "Forum i grave" në Elbasan, "Shtëpia e ngjyrave" – ARSIS, në Tiranë; Strehëza e emergjencës në Lezhë, e krijuar dhe menaxhuar nga komuniteti katolik.

146. Të dhëna të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në kuadër të përgatitjes së këtij raporti.

147. Komisioni i Lartë i Shtetit (KLSH). 2023. *Raport auditimi performance: "Efektiviteti i sistemit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje me fokus gratë e dhunuara.* Shih: <https://www.sherbimisocial.gov.al/wp-content/uploads/2025/05/KLSH-2023-Dhuna-ndaj-grave.pdf>

148. Raporti i GRETA-s për Shqipërinë 2025. Shih: <https://rm.coe.int/greta-evaluation-report-on-the-implementation-of-the-council-of-europe/1680b65f41>

Strehëzat emergjente pranojnë viktimat dhe fëmijët e tyre, por djemtë e moshës mbi 14 vjeç ndahen nga nënat dhe vendosen në mjedise më vete. GREVIO gjithashtu vë në dukje se pas largimit të viktimave nga strehëza, ka një mungesë shërbimesh të disponueshme të specializuara të ri-integrimit, si për shembull apartamente tranzitore.<sup>149</sup>

Dy **linja telefonike këshillimi kombëtare** ofrojnë shërbime për gra dhe fëmijë: Linja Kombëtare e Këshillimit për Gra dhe Vajza (LKKGV) 116 117<sup>150</sup> dhe Linja Kombëtare e Telefonit për Fëmijë, ALO 116 111.<sup>151</sup> Që të dyja janë shërbime 24/7 të ngritura nga OJQ-të por të mbështetura nga buxheti i shtetit. GREVIO ka vënë në dukje se ndonëse bashkëpunimi i LKKGV-së 116-117 me MSHMS-në është zyrtarizuar me një marrëveshje, financimi nga shteti varet nga dorëzimi i projekt-propozimeve çdo vit. Kapaciteti i linjës telefonike është rritur me shtimin e dhjetë këshilluesve dhe shërbimet tani ofrohen edhe në gjuhët angleze dhe italiane. Viktimat e dhunës seksuale po e përdorin linjën telefonike gjithnjë e më shumë, çka thekson rolin kritik të saj në ekosistemin e strukturave dhe shërbimeve.<sup>152</sup>

**Mbështetja për viktimat e dhunës seksuale** ofrohet përmes tri qendrave të posaçme për trajtimin e rasteve të tyre.<sup>153</sup> Megjithatë, pavarësisht nga udhëzimet e dhëna nga MSHMS për të kundërtën, GREVIO vë në dukje se aksesimi në këto qendra varet nga raportimi i veprës penale në polici nga viktimat. Duke pasur parasysh shkallën e lartë të përhapjes së dhunës seksuale në Shqipëri, ku 8,6 për qind e grave kanë përjetuar dhunë seksuale, GREVIO është shumë i shqetësuar për numrin e ulët të viktimave, sidomos të grave të rritura, që përfitojnë shërbime në këto qendra. Kjo mund të jetë rezultat i

drejtpërdrejtë i detyrimit për të raportuar sulmin seksual ose përdhunimin si kusht për përfitimin e shërbimeve të ofruara në qendrën e dhunës seksuale, që është në kontrast të thellë me qëllimin dhe frymën e Konventës së Stambollit dhe ndalohet shprehimisht nga neni 18, paragrafi 4 i saj.<sup>154</sup>

**Ndihma juridike falas** është e disponueshme në tri forma: ndihmë juridike parësore (këshillim ligjor), ndihmë juridike dytësore (përfaqësim para organeve të drejtësisë) dhe përjashtimi nga pagesa e shpenzimeve dhe tarifave gjyqësore, si edhe nga shpenzimet që lidhen me ekzekutimin e vendimeve. Ndihma juridike parësore ofrohet nga 47 ofrues<sup>155</sup> dhe në periudhën 2020-2023 kishte 2.916 viktimat të DHF-së, dhunës seksuale dhe trafikimit që përfituan nga ndihma juridike parësore. Në të njëjtën periudhë u dhanë 995 vendime gjyqësore për ndihmë juridike dytësore dhe/ose për përjashtim nga tarifat e procesit gjyqësor ose për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore në favor të viktimave të DHF-së, përfituesve nga skemat e mbrojtjes sociale dhe një viktimit të trafikimit.<sup>156</sup>

GREVIO ka vënë në dukje se shërbimet e këshillimit për viktimat e dhunës janë përmirësuar që nga viti 2017, kur doli raporti i parë i vlerësimit paraprak.<sup>157</sup> Megjithatë, numri i viktimave që përfitojnë ndihmë juridike mbetet i ulët krahasuar me numrin e rasteve të raportuara të dhunës dhe me numrin e përgjithshëm të përfituesve të ndihmës juridike. Këto shifra duhet të rriten me kalimin e viteve, sidomos në qoftë se mbështetjen me fondet e dhura dhe me masa ndërgjegjësuese.<sup>158</sup> Për më tepër, megjithëse mekanizmat e të drejtave të njeriut përsëriten përpjekjet e Shqipërisë për

149. GREVIO, 2024. "Raporti i parë vlerësues tematik për Shqipërinë: Ndërtimi i besimit përmes sigurimit të mbështetjes, mbrojtjes dhe drejtësisë". Shih: <https://rm.coe.int/grevio-s-first-thematic-evaluation-report-on-albania/1680b1a0ca>

150. Shih: <https://hotlinealbania.org/>

151. Shih: <https://alo116.al/>

152. GREVIO, 2024. "Raporti i parë vlerësues tematik për Shqipërinë: Ndërtimi i besimit përmes sigurimit të mbështetjes, mbrojtjes dhe drejtësisë". Shih: <https://rm.coe.int/grevio-s-first-thematic-evaluation-report-on-albania/1680b1a0ca>

153. Qendra LILIUM në Tiranë e menaxhuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe dy shërbime të tjera të integruara të reagimit të menjëhershëm (*One stop centre*) në spitalet rajonale të Fierit dhe Shkodrës. Një qendër tjetër e ngjashme me LILIUM po ndërtohet në Vlorë (informacion i dhënë nga MSHMS).

154. GREVIO, 2024. "Raporti i parë vlerësues tematik për Shqipërinë: Ndërtimi i besimit përmes sigurimit të mbështetjes, mbrojtjes dhe drejtësisë". Shih: <https://rm.coe.int/grevio-s-first-thematic-evaluation-report-on-albania/1680b1a0ca>

155. Njëzet qendra të shërbimit të ndihmës juridike parësore, 12 klinika ligjore në institucione të arsimit të lartë dhe 15 organizata jofitimprurëse të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë për ofrimin e këtyre shërbimeve.

156. "Raport gjithëpërfshirës kombëtar mbi zbatimin e Platformës për Veprim të Pekinit në kuadër të Platformës së Pekinit +30", përgatitur nga Shqipëria dhe dorëzuar më 1 qershor 2023, f.76. Shih: [https://www.unwomen.org/sites/default/files/2024-09/b30\\_report\\_albania\\_en.pdf](https://www.unwomen.org/sites/default/files/2024-09/b30_report_albania_en.pdf)

157. "Raporti fillestar vlerësues i GREVIO-s mbi masat legjislative dhe masa të tjera për vënien në jetë të dispozitave të Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje" (Konventa e Stambollit), botuar në 24 nëntor 2017. Shih: [https://rrjetikunderdhunesgjimore-monitorime.al/en/wp-content/uploads/2018/03/GREVIO-Inf-2017-13\\_ALB\\_eng.pdf.compressed.pdf](https://rrjetikunderdhunesgjimore-monitorime.al/en/wp-content/uploads/2018/03/GREVIO-Inf-2017-13_ALB_eng.pdf.compressed.pdf)

158. GREVIO, 2024. "Raporti i parë vlerësues tematik për Shqipërinë: Ndërtimi i besimit përmes sigurimit të mbështetjes, mbrojtjes dhe drejtësisë". Shih: <https://rm.coe.int/grevio-s-first-thematic-evaluation-report-on-albania/1680b1a0ca>

garantimin e aksesit në ndihmë juridike, ato kanë shprehur shqetësime për procedurën e përfitimit të ndihmës juridike dytësore, sidomos në rastet e DHF-së; për burimet e pamjaftueshme që alokohen për zbatimin e Ligjit "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti". Krahas kësaj, me gjithë përpjekjet e vazhdueshme nga institucionet dhe OJQ-të, raportet e kohëve të fundit të OHCHR-së dhe UNDP-së theksojnë nevojën në vijimësi për rritjen e përpjekjeve ndërjegjësuere lidhur me disponueshmërinë e ndihmës juridike falas dhe procedurën e aplikimit për të.<sup>159</sup> Këto sfida u konfirmuan edhe në anketën më të fundit të UNDP-së mbi aksesin në drejtësi në Shqipëri, ku theksohet gjithashtu se viktimat e DHF-së duhet të marrin urdhër mbrojtjeje përpara se të kenë akses në ndihmë juridike – një kusht që përbën pengesë, sepse shumë viktima kanë frikë se kjo mund ta përkeqësojë situatën. Krahas kësaj, ekziston nevoja për trajnim të specializuar për ofruesit e ndihmës juridike, gjyqtarët dhe profesionistë të tjerë, sepse shumë prej tyre, përfshirë avokatët, shpesh nuk kanë ekspertizë të mjaftueshme për të trajtuar raste të ndërlikuara dhe sensitive të viktimave të DHF-së dhe të trafikimit.<sup>160</sup>

**Programet për dhunuesit** ofrohen në katër qytete: Tiranë, përmes linjës së këshillimit për burra dhe djem;<sup>161</sup> Shkodër, përmes Zyrës për Burra dhe Djem;<sup>162</sup> Elbasan, si pjesë e shërbimeve të ofruara nga organizata Tjetër Vizion;<sup>163</sup> dhe Vlorë, si pjesë e shërbimeve të ofruara nga qendra Vatra.<sup>164</sup> GREVIO ka vënë në dukje mungesën e përpjekjeve konkrete dhe fondeve të qëndrueshme për përmirësimin e programeve për dhunuesit. Ato pak programe të disponueshme për dhunuesit vazhdojnë të menaxhohen nga disa OJQ dhe fokusohen kryesisht në dhunues që janë dënuar nga gjykata, ose kundër të cilëve është lëshuar urdhër mbrojtjeje. Këto programe faktikisht funksionojnë mbi baza vullnetare, domethënë, në qoftë se dhunuesit nuk e ndjekin programin, ata nuk janë objekt i raportimit apo sanksioneve. Nuk ka një protokoll për harmonizimin e përmbajtjes së programeve, të cilat duket se funksionojnë në bazë grupi dhe bëjnë vlerësim

individual të secilit dhunues. Është e rëndësishme të theksohet në Shqipëri se nuk ka programe specifike për dhunuesit seksualë.<sup>165</sup>

## Funksionimi i mekanizmave të koordinuar të referimit

Në bazë të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) 327/2021, mekanizmi i koordinuar i referimit (MKR) për rastet e dhunës në familje krijohet në çdo bashki dhe synon parandalimin dhe trajtimin e rasteve të DHF-së. MKR përbëhet nga a) komitetet drejtuese për bashkërendimin e veprimtarisë së institucioneve të autoriteteve përgjegjëse, në nivel vendor dhe referimin e rasteve të dhunës në familje; b) ekipet teknike ndërdisiplinore; c) koordinatorët vendorë. Anëtarë të komiteteve drejtuese janë përfaqësues nga Policia e Shtetit, drejtorja arsimore, Drejtorja Qendrore e Operatorit të Shërbimit të Kujdesit shëndetësor, Shërbimi Social Shtetëror, prefektura, qarku, zyra e punësimit, OJQ-të, strehëzat për viktimat e dhunës në familje, qendrat e rehabilitimit për dhunuesit, institucionet fetare, dhoma e avokatisë e rrethit, dhe drejtorja e ndihmës juridike. Në mbledhjet e komitetit drejtues mund të ftohen të marrin pjesë përfaqësues nga gjykata e rrethit gjyqësor, prokuroria e rrethit, zyra e përmbartimit, qendra e menaxhimit të dhunës seksuale, Shërbimi i Provës, njësia për mbrojtjen e fëmijëve, Urdhri i Psikologut, Urdhri i Punonjësit Social, kryetari i fshatit, mjekësia ligjore, mediat vendore dhe autoritete, shërbime dhe specialistë të tjerë.<sup>166</sup>

Bashkërendimi dhe funksionimi i këtij mekanizmi është përshkruar me hollësi në VKM 327/2021 si dhe në procedurat standarde të veprimit (PSV) të përmendura në fillim të kësaj pjese. Me anëtarët e MKR-së zhvillohen rregullisht aktivitete për ndërtimin e kapaciteteve, për rritjen e efektivitetit të punës së tyre për menaxhimin e rasteve. Institucionet fetare u bënë zyrtarisht anëtare të dy MKR-ve në vitin 2023, përmes nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit për funksionimin e MKR-

159. Kontributi i Zyrës së të Drejtave të Njeriut të OKB-së për Raportin e Komisionit Evropian mbi Shtetin e së Drejtës të vitit 2025, Kapitulli për Shqipërinë, f. 4. Shih: [https://europe.ohchr.org/sites/default/files/2025-02/ROE\\_X\\_Shqipëria.pdf](https://europe.ohchr.org/sites/default/files/2025-02/ROE_X_Shqipëria.pdf); "Vërejtjet përmblylëse të Komitetit të KEGJFDHG-së për Shqipërinë, 2023"

160. UNDP Shqipëri. 2025. "Aksesi në drejtësi në Shqipëri, 2024", <https://www.undp.org/albania/publications/study-access-justice-albania>

161. Shih: <https://www.facebook.com/linjakeshillimitperburradhedjem/>

162. Shih: <https://gtg.al/zyra-per-djem-dhe-burra/>

163. Shih: <https://www.tjetervizion.org/services-3>

164. Shih: <https://qendravratra.org.al/sq/rreth-nesh/>

165. GREVIO, 2024. "Raporti i parë vlerësues tematik për Shqipërinë: Ndërtimi i besimit përmes sigurimit të mbështetjes, mbrojtjes dhe drejtësisë". Shih: <https://rm.coe.int/grevio-s-first-thematic-evaluation-report-on-albania/1680b1a0ca>

166. VKM nr. 327/2021, pikat 6 dhe 8. Shih: <https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/VKM-Nr-327-dat%C3%AB-2.06-00000002.pdf>

ve.<sup>167</sup> Megjithatë, niveli i funksionimit të MKR-ve ndryshon nga bashkia në bashki. Sikurse ka vënë në dukje GREVIO, MKR-të në qytetet e mëdha janë të mirorganizuara, bëjnë takime të rregullta për diskutimin e rasteve dhe nxisin bashkëpunim të ngushtë mes anëtarëve. Por situata ndryshon në bashkitë më të vogla, ku mekanizmat janë ngritur më vonë. Ende nuk ka një listë të standardizuar të shërbimeve që duhet të përfshijë çdo bashki në mekanizmin vendor. Ndonëse protokollet ekzistuese për menaxhimin e rasteve përcaktojnë me saktësi rolet për të gjitha strukturat që marrin pjesë në MKR, së bashku me afatet përkatëse, ende nuk është bërë vlerësim nëse ato zbatohen siç duhet. Protokollet për funksionimin e MKR-ve duhet të përditësohen dhe rishikohen për të pasqyruar dispozitat e VKM 327/2021, që u miratuan, ndër të tjera, për të përmirësuar funksionimin e MKR-ve.

Përveç kësaj, nuk ka protokolle ose procedura standarde veprimi në lidhje me martesat e detyruara, sterilizimin e detyruar, ose trajtimin e grave viktime të dhunës në familje me aftësi të kufizuara mendore. Ka pasur raste të koordinimit të pamjaftueshëm mes anëtarëve të MKR-së, si OJQ-të, sidomos në bashkitë ku këta mekanizma janë krijuar më vonë. Gjithashtu, ndryshimet e shpeshta të personelit janë theksuar si një nga arsyt kryesore për mangësitë në punën e tyre. Financimi i MKR-ve është ende pjesërisht i varur nga donatorët e huaj.<sup>168</sup>

### **Mjekësia ligjore dhe aksesimi në drejtësi për të mbijetuarat e DHBGJ-së**

Një mangësi kritike në përgjigjen e Shqipërisë ndaj DHBGJ-së është mungesa e profesionistëve mjeko-ligjorë, që ndikon ndjeshëm në ndjekjen penale të rasteve të dhunës seksuale dhe dhunës në familje. Mjekësia ligjore luan rol kyç në mbledhjen e provave mjekësore dhe mjeko-ligjore, por vendi ende ka një mungesë të theksuar specialistësh të trajnuar, sidomos gra mjeko në këtë fushë. Protokolli për trajtimin e viktimeve të dhunës seksuale<sup>169</sup> u jep të mbijetuarave të drejtën që ekzaminimi për marrjen e provave mjeko-ligjore të bëhet nga një mjeko, por kjo

e drejtë jo gjithmonë zbatohet për shkak të numrit të kufizuar të grave specialiste mjeko-ligjore.

Aktualisht, ekzaminimet mjeko-ligjore pa pagesë bëhen vetëm me kërkesën e autoriteteve të ligjit dhe rendit. Në qoftë se dikush dëshiron të kërkojë ekzaminim me nismën e vet, duhet të paguajë tarifën e specifikuar nga Instituti i Mjekësisë Ligjore. Kjo politikë mund të pengojë raportimin dhe marrjen e provave të rëndësishme, sidomos në rastet e personave që nuk janë të sigurt nëse duan të bëjnë padi ose jo. Në këtë mënyrë, shërbimet për mbështetjen e viktimeve varen nga raportimet zyrtare, që krijon barriera për të mbijetuarat dhe kufizon aftësinë e tyre për të marrë vendime të bazuara në informacion nëse, dhe si, ta ndjekin çështjen ligjorë.

Mungesa e ekspertizës së specializuar mjeko-ligjore dobëson paditë dhe proceset gjyqësore kundër dhunuesve, duke shkaktuar vonesa në gjykime, vështirësi në sigurimin e dënimeve, dhe barriera për qasjen në drejtësi të të mbijetuarave. Po kështu, shërbimet mjeko-ligjore nuk janë të shpërndara në mënyrë të barabartë në të gjithë Shqipërinë, duke i detyruar shumë të mbijetuarat – sidomos ato në zonat rurale – që të bëjnë rrugë të gjata për ekzaminime mjekësore, gjë që shkurajon më tej raportimin e rasteve të DHBGJ-së. Korrigjimi i kësaj mangësie kërkon investime në programe trajnimi të mjekësisë ligjore, më shumë rekrutime të grave specialiste në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe përhapjen e njësive mjeko-ligjore në të gjithë vendin. Forcimi i shërbimeve mjeko-ligjore është me rëndësi thelbësore për qasje pa vonesë në drejtësi për të mbijetuarat dhe për përmirësimin e përgjigjes së përgjithshme të Shqipërisë ndaj DHBGJ-së.

### **3.1.2 Përhapja e dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri**

Dhuna ndaj grave dhe vajzave (DHNGV) në Shqipëri nuk është dukuri e re, por një problem me rrënjë të thella në traditat patriarkale dhe normat shoqërore që historikisht


167. Përkatësisht në bashkitë e Pogradecit dhe Vlorës. Kjo u mbështet nga UNFPA në kuadër të Projektit të Përbashkët për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave, faza e dytë, e zbatuar nga UN Women, UNDP dhe UNFPA në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe qeverinë e Suedisë.

168. GREVIO, 2024. "Raporti i parë vlerësues tematik për Shqipërinë: Ndërtimi i besimit përmes sigurimit të mbështetjes, mbrojtjes dhe drejtësisë". Shih: <https://rm.coe.int/grevio-s-first-thematic-evaluation-report-on-albania/1680b1a0ca>

169. Shih: <https://www.undp.org/albania/publications/protocol-managing-domestic-sexual-violence-cases-local-level-through-coordinated-referral-mechanism-crm>

**Figura 1**

**Përvoja të dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri**



Burimi: INSTAT. Dhuna ndaj grave dhe vajzave, 2018.

kanë përcaktuar rolet gjinore dhe dinamikat e pushtetit. Faktorët tradicionalë, si identitetet gjinore të përcaktuara ngurtësisht, autoriteti patriarkal, kodi tradicional i nderit dhe turpit, kontrolli i brezave të vjetër mbi të rinjtë në familje, dhe pabarazitë ekonomike vazhdojnë të ushqejnë DHBGJ-në. Pabarazitë strukturore në arsim, punësim dhe modelet e migracionit përkeqësojnë më tej cenueshmërinë e grave prej dhunës. Studimet e kryera në Shqipëri konfirmojnë se DHNGV është problem mjaft i përhapur dhe kompleks, që haset në të gjitha zonat dhe grupet shoqërore. Studime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare theksojnë se DHF, në masë të madhe, vazhdon të mos raportohet sa duhet për shkak të frikës së të mbijetuarave nga stigma dhe hakmarrja, si edhe për shkak të mungesës së besimit në reagimet institucionale. Vrojtimi i fundit kombëtar mbi dhunën ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri u krye nga INSTAT-i<sup>170</sup> në vitin 2018. Konstatimet kryesore të këtij vajtimi u paraqitën në botimin "Dosja e barazisë gjinore – Shqipëri". Ndonëse vajtimi i vitit 2018 mbi DHNGV-në në Shqipëri nuk iu përmbajt plotësisht kornizës metodologjike BE-DHBGJ të Eurostatit,


ai prodhoi një numër treguesish të rëndësishëm sipas kërkesave të Eurostatit, përmes përdorimit të të dhënave të disponueshme. Duke pranuar nevojën për të pasur të dhëna të harmonizuara dhe të krahasueshme për përmbushjen e standardeve të BE-së, Shqipëria është angazhuar që të harmonizojë plotësisht vajtimin e ardhshëm, i për vitin 2026, me metodologjinë e Eurostatit. Ky hap është një pjesë e rëndësishme e përpjekjeve për integrimin e vendit në BE dhe do të përmirësojë ndjeshëm cilësinë dhe krahasueshmërinë e të dhënave. Gjithashtu, ai do të mbështesë zhvillimin dhe zbatimin më efektiv të politikave për parandalimin dhe reagimin ndaj DHBGJ-së.

Sipas të dhënave zyrtare, 61,8 për qind e grave dhe vajzave të moshës 18 deri 74 vjeç në Shqipëri kanë përjetuar dhunë në marrëdhënie dashurore, 33,7 për qind kanë përjetuar dhunë në familje nga partneri intim, 8,5 për qind kanë përjetuar ngacmim seksual, 6,9 për qind kanë përjetuar përndjekje dhe 2,4 për qind kanë përjetuar dhunë nga jopartneri që nga moshën 15 vjeç. (Shih Figurën 1.)

170. Mbështetur nga UNDP dhe UN Women me kontributin financiar të qeverisë së Australisë në kuadër të projektit për statistikat gjinore rajonale dhe OZHQ-të "Gratë janë të rëndësishme" dhe Qeverisë së Suedisë në kuadër të Programit të Përbashkët të OKB-së për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave në Shqipëri. Shih: <https://www.instat.gov.al/media/6123/publication-violence-against-women.pdf>

**Figura 2**

**Përjetimi i dhunës në familje nga partneri intim (OZHQ 5.2.1) aktualisht**



Burimi: INSTAT. Dhuna ndaj grave dhe vajzave, 2018

Të dhënat për dhunë në familje nga partneri intim (OZHQ 5.2.1) tregojnë se 47 për qind e grave dhe vajzave kanë përjetuar ndonjëherë në jetën e tyre këtë lloj dhune dhe 33,7 për qind e përjetojnë atë aktualisht. Për sa i përket llojit të dhunës, 41,2 për qind kanë përjetuar ndonjëherë në jetën e tyre kontroll shtrëngues, 31,4 për qind dhunë psikologjike, 18 për qind dhunë fizike, 8,6 për qind dhunë seksuale, dhe 7 për qind dhunë ekonomike. Shpërndarja aktuale për secilin lloj dhune aktualisht është përkatësisht 25,2 për qind, 19,7 për qind, 7,2 për qind, 3,6 për qind, dhe 7 për qind. (Shih Figurën 2.)

Opinionet publike lidhur me dhunën në Shqipëri flasin për norma gjinore të rrënjosura thellë, sidomos sa i përket pranimit të ndëshkimit fizik. Sipas botimit të UNICEF-it "Raportimi i dhunës ndaj fëmijëve në Shqipëri",<sup>171</sup> meshkujt kanë 25 për qind më shumë tendencë se gratë që të konsiderojnë se ndëshkimi trupor në familje është i pranueshëm. Ky dallim i përgjithshëm mes gjinive tregon se ende vazhdojnë të ekzistojnë norma sociale që mbështesin dhunën si mjet disiplinimi, sidomos ndër meshkujt. Këto qëndrime bëjnë që dhuna në mjediset familjare të normalizohet dhe dobësojnë përpjekjet për prindërim jo të dhunshëm, dhe me ndjeshmëri

gjinore. Ato janë gjithashtu tregues për probleme më të gjera strukturore, si niveli i ulët i ndërgjegjësimit për të drejtat e fëmijëve dhe zbatimimi në nivele të ndryshme të garancive ligjore mbrojtëse. Megjithëse Shqipëria është angazhuar ligjërisht për ndalimin e ndëshkimit fizik – ndër aktet më kryesore në këtë drejtim është Ligji "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës" – qëndrimet mbizotëruese tregojnë për një hendek midis ligjit dhe jetës së përditshme. Për eliminimin e këtij hendeku duhen përpjekje të bashkërenduara, si ndërgjegjësim i publikut, programe për prindërimin në shkollë dhe komunitet dhe promovim i metodave disiplinore pozitive. Çka është e rëndësishme, këto ndërhyrje duhet të jenë të ndjeshme ndaj roleve dhe ndikimeve të ndryshme të burrave dhe grave në transformimin e normave të prindërimit dhe të pranimit të dhunës në familje.

**Raportimi i dhunës në familje në polici**

Krahas të dhënave të mësipërme për DHNGV-në, Policia e Shtetit Shqiptar mbledh rregullisht të dhëna për rastet e DHF-së, numrin e kërkesave për urdhra mbrojtjeje, numrin e grave dhe vajzave të vrara si rezultat i DHF, dhe numrin e dhunuesve të arrestuar (në bazë të nenit 130/a të Kodit

171. Shih: <https://www.unicef.org/albania/media/6601/file/The%20Reporting%20of%20Violence%20Against%20Children%20in%20Shqipëria.pdf>

**Table 3****Rastet e dhunës në familje të raportuara në polici për periudhën 2020-2024**

Viti	Raste të regjistruara nga policia (130/a + Ligji 9669 <sup>173</sup> )	Autorë (130/a + Ligji 9669)	Kërkesa për urdhër mbrojtës (Ligji 9669)	Numri i viktimave të vdekura (130/a+79/c) <sup>174</sup>	Autorë të arrestuar (neni 130/a)
2020	4321	4443	2816	11	615
2021	4897	5025	3266	17	638
2022	4827	4946	2940	12	682
2023	4641	4790	2730	13	697
2024	5073	5271	2934	10	844

Burimi: Të dhëna nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, INSTAT, maj 2025

Penal). Këto të dhëna tregojnë për një rritje në numrin e rasteve të DHF-së të regjistruara, me 4.321 raste në vitin 2020 dhe 5.073 raste në vitin 2024. Megjithatë, numri i kërkesave për urdhër të menjëhershëm mbrojtjeje/ urdhër mbrojtjeje është krahasimisht shumë i ulët, me 2.816 kërkesa në vitin 2020 dhe 2.934 kërkesa në vitin 2024 (shih Tabelën 3). GREVIO ka vënë në dukje se policia ngurron të lëshojë urdhra për masa paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (UMPMM). Gjithashtu, kur kryhen vlerësime të riskut, policia shpesh nuk merr parasysh të gjithë treguesit relevantë të riskut, që çon në konkluzionin se UMPMM-ja nuk është e nevojshme në raste të caktuara. GREVIO vuri në dukje gjithashtu probleme në implementimin dhe zbatimin e urdrave të menjëhershëm të mbrojtjes të lëshuar nga gjykata. Gjykatat jo gjithmonë urdhërojnë largimin e dhunuesit nga shtëpia e familjes; ato ndonjëherë urdhërojnë dhunuesin të banojë në një dhomë, ndërkohë që viktimja vazhdon të banojë në një dhomë tjetër, ose kërkojnë vetëm që dhunuesi të mos i afrohet viktimës më shumë se disa metra. Po kështu, GREVIO-s iu paraqit informacion për urdhra të ndërsjellë, që lëshohen pa kryer analizën e duhur për të identifikuar se kush është agresori kryesor. Ndonëse numri i tyre është i vogël, këto lloj vendimesh të gjykatave minojnë besimin e viktimave në sistem. GREVIO-s nuk iu dorëzua informacion për sanksione kundër përfaqësuesve të ndonjë autoriteti shtetëror për moszbatimin e një urdhri të menjëhershëm mbrojtjeje.<sup>172</sup>

172. GREVIO, 2024. "Raporti i parë vlerësues tematik për Shqipërinë: Ndërtimi i besimit përmes sigurimit të mbështetjes, mbrojtjes dhe drejtësisë". Shih: <https://rm.coe.int/grevio-s-first-thematic-evaluation-report-on-albania/1680b1a0ca>

173. Ligji "Për masat kundër dhunës në marrëdhëniet familjare."

174. Vrasjet në familje dhe në kontekstin e lidhjeve familjare.

### Sistemi REVALB për menaxhimin e rasteve të dhunës në familje

Sistemi REVALB, i krijuar si platformë elektronike, është një instrument i rëndësishëm për dokumentimin e rasteve të DHF-së të evidentuara dhe të zgjidhura në nivelin e komunitetit përmes përpjekjeve të MKR-ve. Sistemi promovon mbledhjen dhe mbikëqyrjen e të dhënave përmes kornizës shumësektoriale që përbëhet nga koordinatorët vendorë kundër dhunës në familje, ekipet teknike ndërdisiplinore, dhe MSHMS-ja, sikurse parashikohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327/2021. Ndonëse REVALB është burim i rëndësishëm i të dhënave administrative, vazhdojnë të ekzistojnë probleme si mungesa e konsistencës në hedhjen e të dhënave, probleme konektiviteti në zonat rurale, dhe dallime në kapacitetet e palëve vendore të interesit për zbatimin efektiv të sistemit. Këto kufizime pengojnë monitorimin dhe përdorimin e plotë të të dhënave për të ndikuar në formulimin e politikave si dhe për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve.

### Femicidi

Midis viteve 2021 dhe 2023, në Shqipëri u vranë 32 gra dhe vajzave dhe në 27 prej këtyre rasteve autorët ishin persona me të cilët viktimat ishin në marrëdhënie familjare. Nga 28 autorët e vrasjeve, 26 ishin burra, ndërsa dy ishin gra e vajza. Në 28 raste, autori u gjet dhe u arrestua, ndërsa në

dy raste autori ka mbetur i paidentifikuar nga autoritetet. Përveç kësaj, gjashtë autorë humbën jetën menjëherë pas krimit, nga të cilët pesë bënë vetëvrasje ndërsa njëri humbi jetën gjatë përpjekjes për t'i shpëtuar arrestimit nga policia. Gjithashtu, dy autorë femicidi humbën jetën kur ishin në paraburgim, gjatë procesit hetimor. Nga 32 rastet e grave dhe vajzave të vrara, 24 i përmbushnin kriteret për t'u klasifikuar si femicide, ose vrasje për shkak të seksit, të kryera nga 22 autorë. Në rreth 90 për qind të rasteve, viktimat e femicidit ishin abuzuar nga autorët përpara krimit, por vetëm gjashtë prej tyre (25 për qind) e kishin raportuar më parë dhunën në polici. Dy nga këto gra ishin pajisur me urdhra mbrojtjeje ose urdhra të menjëhershëm mbrojtjeje në kohën kur u vranë, ndërsa asnjëra nuk kishte UMPMM të lëshuar nga policia. Katër prej grave dhe vajzave u vranë pak ditë pas lirimit të autorëve nga burgu, pasi kishin vuajtur dënime për veprat penale të dhunës në familje në bazë të nenit 130/a të Kodit Penal. Pesëdhjetë e pesë fëmijë u ndikuan nga vrasja e nënave të tyre, 20 nga të cilët ishin në moshë të mitur dhe disa prej tyre ishin të pranishëm në kohën e incidentit. Shkalla e femicideve në Shqipëri për vitin 2021 ishte 0,85 për 100.000 gra dhe vajza; në vitin 2022, ky tregues ra në 0,50, dhe në vitin 2023 u rrit në 0,84.<sup>175</sup>

Konstatimet e mësipërme u nxorën nga raporti i parë kombëtar "Vrasjet e grave dhe vajzave – Femicidi në Shqipëri",<sup>176</sup> bazuar në kuadrin statistikor të UN Women dhe të Zyrës së Kombeve të Bashkuara mbi Drogën dhe Krimin.<sup>177</sup> Ai përbën një hap të rëndësishëm drejt matjes sistematike dhe me ndjeshmëri gjinore të femicidit, i harmonizuar me standardet ndërkombëtare. Megjithatë, zbatimimi i këtij kuadri mbetet problematik në shumë vende për shkak të dallimeve në përkufizimet gjinore, kodet penale dhe praktikat e mbledhjes së të dhënave. Eurostat, për shembull, raporton vetëm për vrasje me dashje të kryera nga partnerët intimë ose anëtarët e familjes, dhe përjashton rastet me motive të tjera të lidhura me gjininë, që janë të

renditura në kuadrin statistikor të OKB-së. Duke pasur parasysh se të gjitha femicidet e evidentuara në Shqipëri në vitin 2023 u kryen nga një partner intim ose anëtar i familjes, krahasimi me të dhënat e BE-së është i mundshëm. Në vitin 2023, niveli mesatar i vrasjeve me dashje të kryera në BE nga një partner intim ose anëtar i familjes ishte 0,41 për 100.000 gra,<sup>178</sup> ndërsa në Shqipëri ky tregues ishte 0,84, më shumë se dyfishi i mesatares së BE-së.

Të dhënat për femicidin mblidhen në kuadër të **Observatorit të Femicidit në Shqipëri**, që u krijua në mars 2024 pranë Zyrës së Avokatit të Popullit në përputhje me kërkesat e KEGJFDG-së, Konventës së Stambollit, etj.<sup>179</sup> Observatori është një mekanizëm vrojtues i krijuar për të trajtuar rastet e vrasjeve të grave dhe vajzave, me qëllim parandalimin e kësaj dukurie dhe zbatimin me efektivitet të legjislacionit kundër DHBGJ-së. Përmes këtij mekanizmi mblidhen të dhëna në shkallë kombëtare, të cilat analizohen në thellësi për të identifikuar problemet dhe mangësitë në zinxhirin e mekanizmave mbrojtës për viktimat e dhunës.<sup>180,181</sup>

## Dhuna përmes përdorimit të teknologjisë

Dhuna përmes teknologjisë është një formë gjithnjë e më e dukshme dhe e dëmshme e DHBGJ-së në Shqipëri, objekt i së cilës janë gratë dhe vajzat në mjediset digjitale, si publike ashtu edhe private. Ndër format më të zakonshme janë përndjekja kibernetike, ngacmimi *online*, shpërndarja e pamjeve intime pa pëlqimin e personit, vjedhja e identitetit dhe gjuha e urrejtjes – të cilat që të gjitha ndikojnë më shumë tek gratë. Këto shkelje rezultojnë në pasoja të rënda psikologjike, sociale dhe ekonomike, shpesh duke i detyruar ato që të heshtin dhe të kufizojnë pjesëmarrjen e tyre në jetën publike dhe në internet. Me gjithë përhapjen e madhe të këtij lloji të dhunës, Shqipëria nuk ka dispozita ligjore specifike që përkufizojnë dhe trajtojnë dhunën digjitale, duke lënë boshllëqe të mëdha në parandalim, mbrojtje dhe ndjekje penale. Gjithashtu, kapacitetet institucionale

175. UN Women Shqipëri and Avokati i Popullit (2025). "Vrasja e grave dhe vajzave dhe femicidi në Shqipëri", <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Draft%20Raporti%20per%20Femicidin%2004.12.2024.pdf>

176. [https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/20250226-Femicide-EN-EDIT-FINAL%20\(003\)%20\(002\).pdf](https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/20250226-Femicide-EN-EDIT-FINAL%20(003)%20(002).pdf)

177. [https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/Statistical\\_framework\\_femicide\\_2022.pdf](https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/statistics/Statistical_framework_femicide_2022.pdf)

178. Shih: [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/crim\\_hom\\_vreL\\_custom\\_16741113/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/crim_hom_vreL_custom_16741113/default/table?lang=en)

179. Ngritja e Observatorit u mbështet nga Programi i Përbashkët i Kombeve të Bashkuara dhe Qeverisë Shqiptare "Ti japim fund dhunës ndaj Grave", i financuar nga Qeveria e Suedisë.

180. UN Women Shqipëri dhe Avokati i Popullit (2025). "Vrasja e grave dhe vajzave dhe femicidi në Shqipëri", shih <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Draft%20Raporti%20per%20Femicidin%2004.12.2024.pdf>

181. UN Women Shqipëri dhe Avokati i Popullit (2025). "Vrasja e grave dhe vajzave dhe femicidi në Shqipëri", shih <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Draft%20Raporti%20per%20Femicidin%2004.12.2024.pdf>

për reagim ndaj këtyre dukurive mbeten të dobëta dhe OSHC-të nuk kanë burime të qëndrueshme për të ofruar mbështetje të specializuar. Nevojiten ndërhyrje urgjente për harmonizimin e kornizave ligjore, ngritjen e ndërgjegjësimit dhe pajisjen e aktorëve përkatës me mjetet dhe trajnimin e duhur për parandalimin dhe reagimin efektiv ndaj dhunës me përdorim të teknologjisë.<sup>182</sup>

### 3.1.3 Qëndrimet dhe njohuritë e publikut për DHBGJ-në

Qëndrimet dhe ndërgjegjësimi i publikut për DHBGJ-në në Shqipëri kanë evoluar ndër vite, megjithatë normat sociale të rrënjosura thellë, traditat patriarkale dhe perceptimet tradicionale vazhdojnë të ndikojnë në mënyrën se si perceptohet dhe trajtohet DHBGJ-ja. Studimet tregojnë se, ndonëse ndërgjegjësimi për DHBGJ-në si shkelje e rëndë e të drejtave të njeriut është rritur, shumë shqiptarë ende e shohin DHF-në si çështje private brenda familjes, dhe jo si vepër penale. Sipas "Vrojtimin kombëtar me bazë popullatën 2018: Dhuna ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri", 52,2 për qind e grave të moshës 18-74 vjeç raportuan se shumica, ose të gjithë njerëzit në komunitetin e tyre besonin se dhuna midis bashkëshortit dhe bashkëshortes është çështje private dhe se të tjerët nuk duhet të ndërhyjnë. Po kështu, 46,5 për qind e grave thanë se shumica, ose të gjithë njerëzit në komunitetin e tyre duhet të tolerojnë njëfarë dhune, për të ruajtur familjen. Sa u përket normave sociale të lidhura me dhunën seksuale, 26,1 për qind e grave u shprehën se shumica ose të gjithë njerëzit në komunitetin e tyre besojnë se një grua duhet të ketë turp apo t'i vijë zor të flasë për përdhunimin. Gjithashtu, 21,2 për qind e grave raportuan se shumica ose të gjithë njerëzit në komunitetin e tyre besojnë se, se nëse një grua përdhuhet, ka të ngjarë që ajo të jetë treguar e pakujdesshme dhe e ka vënë veten në atë situatë. Kur u pyetën se sa problem ishte dhuna ndaj grave dhe vajzave (DHNGV) në Shqipëri, tri nga katër gra, ose 75,4 për qind e grave u përgjigjën se dhuna në familje/bashkëshortore është problem madh në Shqipëri; po kështu, 70,8 për qind e grave mendonin se dhuna seksuale ndaj grave dhe vajzave është problem i madh. Më tej, dy të tretat e grave, ose 69,9 për qind e

grave raportuan se ngacmimi seksual i grave dhe vajzave është problem i madh dhe dy të tretat, ose 68,4 për qind raportuan se përndjekja e grave është problem i madh. Këto të dhëna tregojnë se gratë në Shqipëri pranojnë se DHNGV-ja është problem i konsiderueshëm dhe serioz, por vënë në pah edhe ndikimin e fuqishëm të stigmës, heshtjes dhe normalizimit të kësaj dhune përmes fajësimit të viktimave për dhe ngarkimit të tyre me përgjegjësi.<sup>183</sup> Pavarësisht nga këto vështirësi, ndërgjegjësimi i publikut për DHBGJ-në është përmirësuar përmes fushatave ndërgjegjësuese, programeve edukative dhe mbulimit më të gjerë në media. Përfshirja e OSHC-ve dhe partnerëve ndërkombëtarë ka ndihmuar në ndryshimin e perceptimeve sociale dhe i ka nxitur të mbijetuarat e dhunës të kërkojnë ndihmë. Megjithatë, stigmatizimi dhe fajësimi i viktimës vazhdojnë të jenë mjaft të përhapur, sidomos në zonat rurale, ku rolet gjinore tradicionale gjinore janë më të rrënjosura. Po kështu, shumë viktime nuk e raportojnë dhunën për shkak të frikës, varësisë ekonomike dhe mungesës së besimit tek institucionet.

### Fushatat ndërgjegjësuese në shkallë kombëtare

Shqipëria ka vite që kryen fushata të shumta ndërgjegjësuese në shkallë kombëtare për t'iu kundërvënë stereotipeve të dëmshme gjinore dhe për të nxitur tolerancën zero ndaj dhunës ndaj grave. Këto fushata janë zhvilluar nën drejtimin e MSHMS-së së bashku me ministritë e tjera, autoritetet vendore, OSHC-të, partnerët ndërkombëtarë, përfshirë agjencitë të Kombeve të Bashkuara, dhe kanë pasur rezultate pozitive. Vlen të përmendet se Shqipëria çdo vit merr pjesë aktivisht në festimin ndërkombëtar të 16 Ditëve të Aktivizimit dhe Ditës Ndërkombëtare të Grave. Nga viti 2019 deri në 2021, këto fushata patën një audiencë prej miliona njerëzish përmes mediave sociale, aktiviteteve publike, dhe mesazheve në hapësira publike, me një angazhim të konsiderueshëm të bizneseve, institucioneve dhe mediave.<sup>184</sup>

### Mashkulloriteti toksik dhe ndikimi i tij në dhunën me bazë gjinore

Në Shqipëri, normat e rrënjosura gjinore që e lidhin mash-

182. UN Women 2024. "Studim për dhunën kibernetike/digjitale dhe dimensionin psikologjik i kësaj forme të dhunës. Rasti i Shqipërisë" (i pabotuar).

183. INSTAT 2018. "Vrojtim kombëtar me bazë popullatën 2018: Dhuna ndaj grave dhe Vajzave në Shqipëri (DHNGV)". Shih: <https://www.instat.gov.al/media/6123/publication-violence-against-women.pdf>

184. "Raport gjithëpërfshirës kombëtar mbi zbatimin e Platformës për Veprim të Pekinit në kuadër të Platformës së Pekinit +30", përgatitur nga Shqipëria dhe dorëzuar më 1 qershor 2023, f.49. Shih: [https://www.unwomen.org/sites/default/files/2024-09/b30\\_report\\_albania\\_en.pdf](https://www.unwomen.org/sites/default/files/2024-09/b30_report_albania_en.pdf)

kulloritetin me kontrollin dhe ndrydhjen emocionale, që shpesh quhen "mashkulloritët toksik", vazhdojnë të ushqejnë DHBGJ-në dhe femicidin. Anketa të zhvilluara nga UN Women (2023)<sup>185</sup> dhe UNFPA (2024)<sup>186</sup> tregojnë se ende vazhdojnë pritshmëritë e shoqërisë që përforcojnë dominimin e meshkujve, martesat e hershme për vajzat dhe rolet e pabarabarta në familje. Shumë burra ndihen të detyruar që të mos i shprehin ndjenjat e tyre dhe të mos pranojnë barazinë gjinore, dhe të paktë janë ata që u kundërvihen normave të dëmshme. Fakti që pjesa më e madhe e 32 grave të vrara në periudhën 2021-2023 kishin pësuar dhunë edhe më parë, por vetëm një e katërta e tyre e kishte raportuar dhunën,<sup>187</sup> ilustron heshtjen dhe mosndëshkimin në lidhje me DHBGJ-në. Trajtimi i këtij problemi kërkon përpjekje në shkallë sistemi në arsim, angazhim të komunitetit dhe reforma ligjore për çrrënjosjen e roleve gjinore toksike dhe promovimin e marrëdhënieve jo të dhunshme.

### 3.1.4 Praktikë e dëmshme (martesat e hershme, përzgjedhja e seksit së foshnjës para lindjes)

**Martesat e hershme dhe të detyruara** janë një aspekt që nuk është trajtuar sa duhet që prek vajzat nga grupe të ndryshme shoqërore. Kjo praktikë e dëmshme, që i ka rrënjët tek normat sociale, varfëria, dhe përjashtimi social, ka ndikim shumë më të madh tek vajzat dhe kufizon të drejtat, arsimimin, dhe autonominë e tyre. Ato janë një formë e DHBGJ-së me pasoja afatgjata fizike, psikologjike dhe sociale.

Në Kodin e Familjes të Shqipërisë, mosha minimale për lidhjen e martesës është 18 vjeç dhe, megjithëse ligji parashikon përjashtime për martesë përpara kësaj moshe, ato mund të lidhen vetëm me lejen e gjykatës (neni 7).

Megjithatë, në ligj nuk ka ndonjë dispozitë që përcakton moshën minimale nën të cilën gjykata ndalohet të miratojë përjashtime të tilla, një aspekt që GREVIO dhe KEDG-ja e kanë theksuar si problematik për Shqipërinë.

Sipas INSTAT-it, në vitin 2022, 15 vajza ishin regjistruar si të martuara përpara moshës 18 vjeç – që përbën rënie nga 19 raste në vitin 2021. Ndër vajzat e moshës 18 dhe 19 vjeç, ato të martuara përbëjnë përkatësisht 6,1% dhe 4,7% të numrit të përgjithshëm. Në dallim nga to, nuk ka raste të regjistruara të djemve të martuar përpara moshës 18 vjeç, dhe ndër djemtë e moshës 18 dhe 19 vjeç, numri i atyre të martuar është më pak se 1%.<sup>188</sup>

KEDG-ja ka rekomanduar që Shqipëria të heqë të gjitha përjashtimet ndaj moshës minimale të përcaktuar me ligj për lidhjen e martesës – 18 vjeç – si për vajzat, ashtu edhe për djemtë. Komiteti gjithashtu nxit vazhdimin e përpjekjeve për luftimin e martesave të fëmijëve dhe martesave të detyruara përmes: (i) trajtimit të shkaqeve që qëndrojnë në themel të kësaj praktike të dëmshme; (ii) nxitjes së raportimit të këtyre rasteve; (iii) sigurimit të llogaridhënies përmes ndëshkimit të anëtarëve të familjes, udhëheqësve fetarë ose të komunitetit, dhe përfaqësuesve të ligjit dhe rendit që i pranojnë dhe i ndihmojnë këto praktika; dhe (iv) vendosjes së mekanizmave për zbulimin e këtyre rasteve dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse të specializuara për vajzat e prekura nga martesat e detyruara. Këto rekomandime janë në përputhje me Rekomandimin e Përgjithshëm të Përbashkët Nr. 31 të Komitetit të KEGJFDG-së dhe me Komentin e Përgjithshëm Nr. 18 të Komitetit për të Drejtat e Fëmijës (2019) në lidhje me praktikën e dëmshme.<sup>189</sup>

Masat për mbështetjen e vajzave të rrezikuara dhe për të parandaluar martesat e hershme të fëmijëve parashikohen edhe në SKBGJ 2021-2030 (sidomos nën Objektivin Specifik III.1, masat III.1.2, dhe II.5.2.f). Edhe OSHC-të janë bërë rekomandime për ndryshime në legjislacionin<sup>190</sup>

185. UN Women Shqipëri (2023) "Zërat e të rejave dhe të rinjve: Barazia gjinore dhe kohezioni social në Ballkanin Perëndimor", që u zhvillua në kuadër të nismës rajonale të Kombeve të Bashkuara 'Të rejtat e të rinjtë për përfshirje, barazi dhe besim', që zbatohet nga UN Women, UNDP, UNFPA dhe UNESCO. Shih: <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2023/09/voices-of-youth-gender-equality-and-social-cohesion-in-the-western-balkans>

186. Rrjeti i organizatave "Zëri i të rinjve", në bashkëpunim me UNFPA Shqipëri (2024) "Kuptimi i barrierave dhe barrierave me të cilat përballen djemtë në nxitjen dhe promovimin e barazisë", përgatitur në kuadër të Projektit "T'i jepet fund dhunës ndaj grave dhe vajzave në Shqipëri" (EVAWIA), një program i përbashkët i OKB-së i financuar nga Qeveria e Suedisë dhe i zbatuar nga tri agjenci të OKB-së: UNFPA, UNDP dhe UN Women në partneritet me qeverinë shqiptare. Shih: <https://www.facebook.com/watch/?v=556448803846564>

Sikurse shpjegohet në pjesën 3.1.2 të këtij raporti.

187. Të dhëna nga Observatori i Femicideve në Shqipëri.


188. INSTAT, "Burra dhe Gra 2023", f. 16.

189. KEDG, 2023. "Vërejtjet përmblyëse mbi raportin e pestë periodik të Shqipërisë". Shih: <https://docs.un.org/en/CEDAW/C/ALB/CO/5>

190. Shih: [https://www.qag-al.org/publikime/legal\\_review\\_report.pdf](https://www.qag-al.org/publikime/legal_review_report.pdf)

**Figura 3**

**Martesa të hershme (deri në moshën 19 vjeç) të regjistruara, sipas seksit**



Burimi: INSTAT, "Gra dhe burra në Shqipëri, 2023".

për sa i përket moshës minimale për martesë, nën të cilën martesat nuk mund të lejohet as me vendim gjykatë; dhe sqarimin e legjitimitetit aktiv në proceset që lidhen me martesat nën moshë (d.m.th. kush ka të drejtë të paraqesë kërkesë për "lejimin e martesës nën moshë"). Për ta kuptuar saktë dhe për ta trajtuar siç duhet këtë praktikë të dëmshme, është thelbësore të bëhet dallimi i qartë midis martesave të fëmijëve – domethënë martesave nën moshën 18 vjeçare të përcaktuara në ligj – dhe martesave të hershme të personave që mund të jenë mbi moshën e përcaktuar me ligj, por martesat nuk është bërë me pëlqimin e tyre të plotë, të lirë dhe të bazuar në informacion. Krahas kësaj, rritja e ndërgjegjësimit për martesat e hershme dhe të fëmijëve është shumë e rëndësishme për ndryshimin e qëndrimeve publike, forcimin e përpjekjeve për parandalimin e tyre, dhe promovimin e plotë të të drejtave të vajzave në të gjitha komunitetet.


**Përzgjedhja e seksit së foshnjës para lindjes.** Në Shqipëri, praktika e përzgjedhjes së seksit së foshnjës para lindjes ndikohet prej vlerave të rrënjësura patriarkale, preferencës së fuqishme tradicionale për djem, disponueshmërisë së teknologjisë për përcaktimin e seksit, dhe uljes së shkallës së lindshmërisë. Raporti mes gjinive në lindje është 107 djem për 100 vajza, që është mbi

raportin biologjik natyror prej 105 djem për 100 vajza, dhe rrjedhimisht është tregues i përdorimit të procedurave për përzgjedhjen e seksit. Përzgjedhja e seksit para lindjes ka pasoja afatgjata në të drejtat, shëndetin dhe barazinë sociale të grave. Ato përballen me presion të konsiderueshëm nga familja dhe me pritshmëritë e shoqërisë për të lindur djem dhe, në shumë raste, përballen me dhunë psikologjike kur mbeten shtatzëna dhe foshnja është vajzë. Këto situata çojnë në aborte të detyruara, që ndikojnë në shëndetin e tyre psikologjik dhe fizik. Në nivelin e shoqërisë, praktika e përzgjedhjes së seksit së foshnjës para lindjes përforcon pabarazinë gjinore, ul vlerën që u jepet vajzave, dhe shton imbalancat demografike.

Trajtimi i këtij problemi kërkon kryerjen e fushatave ndërgjegjësuese në shkallë të gjerë për ndryshimin e qëndrimeve dhe të sjelljeve, që u drejtohen kryesisht të rinjve dhe të rejave, çiftëve të reja të sapomartuara, udhëheqësve të komunitetit dhe profesionistëve të mjekësisë. Cilësia e shërbimeve të shëndetit riprodhues duhet të përmirësohet, ndër të tjera përmes trajnimit të punonjësve të shëndetësisë dhe rishikimit të të gjitha programeve të edukimit mjekësor. Kjo nismë duhet të kombinohet me reforma ligjore dhe ndryshime në politika që mbështesin angazhimin e qeverisë për eliminimin e përzgjedhjes së seksit para lindjes dhe promovimin e barazisë gjinore në të gjitha fushat.

**Figura 4**

### Raporti gjinor në lindje



Burimi: INSTAT, "Gra dhe burra në Shqipëri, 2023".

### 3.1.5 Politika dhe akte ligjore kyçe të BE-së

BE-ja i kushton përparësi mbrojtjes kundër DHF-së dhe DHBGJ-së përmes kornizave politike dhe të legjislacionit. Ndër instrumentet kryesore janë Strategjia e BE-së për Barazinë Gjinore 2020-2025, Udhërrëfyese i BE-së për të Drejtat e Grave, që parashikohet të dalë në vitin 2025, dhe sidomos hyrja e BE-së në Konventën e Stambollit në vitin 2023, që konfirmon dhe përforcon angazhimin e të gjitha shteteve anëtare të tij. Në vitin 2024, BE-ja miratoi Direktivën 2024/1385<sup>191</sup> "Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje". Kjo direktivë penalizon format e DHBGJ-së jashtë sferës së internetit (p.sh. gjymtimin gjenital femëror, martesat e detyruara) dhe në internet (p.sh. shpërndarja pa dhënie pëlqimi e pamjeve intime, ngacmimi kibernetik); përmban detyrimin për mbrojtjen, mbështetjen dhe aksesin në drejtësi për viktimat; dhe kërkon marrjen e masave parandaluese, duke vënë theksin mbi pëlqimin në marrëdhëniet seksuale.<sup>192</sup> Megjithëse korniza legjislativë e Shqipërisë është e harmonizuar në shkallë të konsiderueshme me

Konventën e Stambollit, ajo duhet të harmonizohet më tej me Direktivën 2024/1385, sidomos për sa i përket dhunës në internet. Propozime për arritjen e këtij harmonizimi i janë bërë Ministrisë së Drejtësisë në kuadër të procesit të reformimit të Kodit Penal.<sup>193</sup>

Akte të tjera ligjore të BE-së në këtë fushë përfshijnë Direktivën për të Drejtat e Viktimave (Direktiva 2012/29/EU), që përcakton standardet minimale për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimit, përfshirë të mbijetuarat e DHBGJ-së; Direktivën Anti-Trafikim (Direktiva 2011/36/EU), që, ndër çështje të tjera, trajton edhe trafikimin e grave dhe vajzave për qëllimin e shfrytëzimit seksual; dhe Direktivën për Plotësimin e Kriteve për Azil (Direktiva 2011/95/EU), që ofron mbrojtje ndërkombëtare për personat që kanë pësuar përdhunim ose forma të tjera të rënda të dhunës psikologjike, fizike ose seksuale. Ndonëse korniza ligjore në përgjithësi është e formuar, zbatimi mbetet i dobët, sidomos për sa i përket mekanizmave të parandalimit, mbrojtjes, dhe zbatimit.

191. Direktiva (BE) 2024/1385 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 maj 2024 "Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", [https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=OJ:L\\_202401385&qid=1716884102079](https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=OJ:L_202401385&qid=1716884102079)

192. Komisioni Evropian (2025), "T'i jepet fund dhunës me bazë gjinore", [https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-based-violence/ending-gender-based-violence\\_en](https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/gender-equality/gender-based-violence/ending-gender-based-violence_en)

193. Informacioni i dhënë nga UN Women (2024)

### 3.1.6 Rekomandime

**1. Forcimi i kornizave ligjore dhe të politikave** — Legjislacioni i vendit ende nuk penalizon të gjitha format e DHBGJ-së, si femicidi, dhuna kibernetike, sterilizimi i detyruar dhe ngacmimi përmes internetit; duhet të ndryshohet përkufizimi i përdhunimit në Kodin Penal dhe vendoset një përkufizim i bazuar në mungesën e pëlqimit; të shfuqizohen dispozitat për pajtimin e detyrueshëm në çështjet penale që kanë të bëjnë me përdhunimin, abuzimin seksual dhe martesat e detyruara; të ndalohen të gjitha përjashtimet ndaj moshës minimale për martesë prej 18 vjeç për të eliminuar miratimin nga gjykata të martesave të fëmijëve; të garantohen mbrojtje të gjera kundër diskriminimit të grupeve të cënueshme si gratë rome dhe egjiptiane, personat LGBTQI+, dhe gratë me aftësi të kufizuara. Ky rekomandim lidhet me: vërejtjet përmbyllëse të KEDG-së (2023, para. 25(a)(b), 27, 29(b)(d)), rekomandimet e përgjithshme nr. 19, 28, 33, dhe 35; rekomandimet e RPU-së të vitit 2024 120.57, 120.61, dhe 120.62; treguesit e OZHQ-ve 5.1, 5.2, dhe 5.3; dhe Konventën e Stambollit, veçanërisht nenet 33–37 dhe 43.

**2. Forcimi i zbatimit të ligjit dhe i reagimit** të gjyqësorit — të krijohen njësi të specializuara të policisë për DHBGJ-në dhe të merren masa për trajnimin e detyrueshëm të organeve të rendit, prokurorëve dhe gjyqtarëve; të sigurohet lëshimi i menjëhershëm dhe konsistent i urdhrave për masa paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (UMPMM) nga policia dhe gjykatat; të krijohen gjykata të specializuara me procedim të përshpejtuar për rastet e DHBGJ-së, me gjyqtarë të trajnuar, me qëllim që të mbijetuarave t'u sigurohet zhvillim pa vonesë i procedurave ligjore; të forcohet llogaridhënia e autorëve të krimeve përmes vendosjes së detyrimit për ndjekjen e programeve të rehabilitimit si kusht për dënim më të ulët, si dhe të përdoret monitorimi elektronik (gjurmimi përmes sistemit GPS) për autorët me rrezikshmëri të lartë. Ky rekomandim lidhet me vërejtjet përmbyllëse të KEDG-së (2023, para. 27(c)(d)), rekomandimet e përgjithshme nr. 33 dhe 35; rekomandimet e RPU-së të vitit 2024 120.60 dhe 120.63, treguesit e OZHQ-ve 5.2 dhe 16.1, dhe Konventën e Stambollit, veçanërisht nenet 45 dhe 49-56.

**3. Zgjerimi dhe përmirësimi i shërbimeve**

**mbështetëse për të mbijetuarat** — të rritet numri i strehëzave të financuara nga shteti me akses të garantuar, pa kushtin për pasjen e urdhrin të mbrojtjes nga gjykata; të zgjerohen shërbimet e ndihmës juridike, duke siguruar përfaqësimin ligjor pa pagesë për të mbijetuarat e dhunës, sidomos për ato nga komunitetet rurale dhe të marginalizuara; të forcohet mbështetja psikosociale dhe përkujdesi lidhur me trajtimin e traumave, përfshirë përmes ngritjes së qendrave rajonale për trajtimin e rasteve të krizave të dhunës seksuale dhe ofrimit të trajnimit të specializuar për ofruesit e shërbimeve shëndetësore për përmirësimin e identifikimit të viktimave dhe të kujdesit për to; të forcohet pavarësia ekonomike e të mbijetuarave përmes ngritjes së programeve për gjetjen e vendeve të punës dhe formimin profesional, si dhe përmes ofrimit të programeve për mikrofinancimin dhe njohuri financiare për të mbijetuarat e DHF-së. Ky rekomandim lidhet me vërejtjet përmbyllëse të KEDG-së (2023, para. 25(c), 27(e), 29(e)), rekomandimet e përgjithshme nr. 28, 33, dhe 35, rekomandimet e RPU-së të vitit 2024 120.58 dhe 120.60, treguesit e OZHQ-ve 5.2 dhe 10.2, dhe Konventën e Stambollit, veçanërisht nenet 20-25 mbi shërbimet mbështetëse.

**4. Adresimi i praktikave të dëmshme: përzgjedhja e seksit të foshnjës para lindjes dhe martesat e hershme** — të rregullohen me ligj praktikatat e përcaktimit të seksit të foshnjave para lindjes për të parandaluar abortet me qëllim përzgjedhjen e seksit të fëmijës; të zhvillohen fushata ndërgjegjësuese që fokusohen në profesionistët e shëndetësisë, familjet dhe udhëheqësit e komunitetit, me qëllim ndryshimin e qëndrimeve lidhur me preferencën për djem; të kryhen kontrole në sistemin e regjistrimit të lindjeve me qëllim që të ndiqen në vijimësi imbalancat në raportin mes gjinive dhe për të zbuluar rastet e përzgjedhjes së seksit para lindjes. Ky rekomandim është në përputhje me vërejtjet përmbyllëse të KEDG-së (2023) dhe rekomandimet e përgjithshme nr. 24 dhe 31 për eliminimin e praktikave të dëmshme, rekomandimet e RPU-së të vitit 2024 për ndalimin e miratimit nga gjykatat të përjashtimeve nga moshë minimale për martesë dhe me OZHQ-në 5.3 për eliminimin e martesave të hershme dhe të detyruara.

**5. Përmirësimi i mbledhjes dhe monitorimit të të**

**dhënave** – të zhvillohen anketime të rregullta kombëtare mbi DHBGJ-në, përfshirë DHF-në, ngacmimin seksual dhe abuzimin në internet, me të dhëna të ndara sipas seksit, përkatësisë etnike dhe aftësisë së kufizuar; të zgjerohet Observatori mbi Femicidin për monitorimin sistematik të vrasjeve me bazë gjinore dhe botimin e raporteve vjetore; të krijohet një bazë e centralizuar kombëtare e të dhënave për të ndjekur rastet e DHBGJ-së në organet e rendit, institucionet shëndetësore dhe shërbimet sociale; të forcohet bashkëpunimi ndër-institucional midis qeverisë, OJQ-ve dhe organizatave ndërkombëtare për përmirësimin e mbështetjes së viktimave dhe koordinimin e zbatimit të ligjit. Ky rekomandim është në përputhje me rekomandimet e përgjithshme nr. 28 dhe 35 të KEDG-së (2023), rekomandimet e RPU-së të vitit 2024, Konventën e Stambollit, neni 11, dhe OZHQ-të 5.1, 5.2, dhe 17.18 për forcimin e të dhënave dhe sistemeve të llogaridhënies në lidhje me DHBGJ.

## 6. Rritja e ndërgjegjësimit dhe edukimi i publikut

– Të ndërmerren trajnime të detyrueshme mbi komunikimin jo të dhunshëm dhe barazinë gjinore në shkolla, me një program që fokusohet në stereotipat gjinorë, pëlqimin dhe parandalimin e DHBGJ-së; të zgjerohen fushatat kombëtare në media që u kundërvihen normave patriarkale dhe promovojnë të drejtat e të mbijetuarave; të përfshihen burrat dhe djemtë në nismat për parandalimin e dhunës përmes programeve shkollore, aktivizmit rinor dhe dialogut në komunitet; të sigurohet respektimi i Konventës 190 të ONP-së përmes vendosjes së politikave të detyrueshme kundër ngacmimit në vendin e punës, si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, dhe përmes vendosjes së mekanizmave për raportimin anonim të ngacmimit seksual në punë. Ky rekomandim lidhet me rekomandimet e përgjithshme nr. 28 dhe 35 të KEDG-së (2023), rekomandimet e RPU-së të vitit 2024, Konventën e Stambollit, neni 11, dhe OZHQ-të 4.7 dhe 5.1, dhe Konventën 190 të ONP-së mbi stereotipat gjinorë, edukimin dhe ngacmimin në vendin e punës.

## 3.2 GRATË, VARFËRIA DHE MBROJTJA SOCIALE

### 3.2.1 Varfëria dhe pabarazia


Shqipëria ka bërë përparim në adresimin e varfërisë gjatë viteve, përfshirë përmes zhvillimit ekonomik dhe përmes mbrojtjes sociale dhe reformave për përfshirje sociale. Shkalla e rrezikut për të qenë i/e varfër ka pësuar ulje graduale, nga 23 për qind në vitin 2019 në 21,8 për qind në vitin 2020; 22 për qind në vitin 2021; 20,6 për qind në vitin 2022; dhe 19,7 për qind në vitin 2023. Numri i personave që jetonin nën pragun e rrezikut për të qenë i/e varfër në vitin 2023 llogaritej të ishte 545.400, që shënon një rënie nga 576.316 në vitin 2022.<sup>194</sup> Në vitin 2023, treguesi i rrezikut për të qenë i/e varfër ishte 3,5 pikë përqindjeje më i lartë se mesatarja e BE-së.

Pavarësisht nga përparimi i bërë, shumë njerëz mbeten të cenueshëm ndaj përjashtimit social dhe nuk kanë mundësi të marrin pjesë plotësisht në jetën e shoqërisë, sepse kanë akses të kufizuar në burimet, të drejtat dhe shërbimet që ofrohen për shumicën e popullsisë. Në Shqipëri, pjesa e popullsisë së rrezikuar për të qenë e varfër, ose përjashtimi social - që përkufizohet si individët që, ose janë në rrezik për të qenë të varfër, ose janë thëllësisht të privuar nga ana materiale dhe sociale, ose jetojnë me intensitet shumë të ulët punësimi – u vlerësua të ishte në nivelin 42,1% në vitin 2023, që përbën rënie nga 44,5% në vitin 2022.<sup>195</sup> Ky nivel është shumë më i lartë se mesatarja e BE-së prej 21,3 për qind – një dallim prej 20,9 pikë përqindjeje. Po kështu, numri i personave në rrezik për të qenë të varfër para marrjes së ndihmave sociale ishte 36,5%, ku popullatat rurale dhe të pakicave janë veçanërisht të cenueshme nga varfëria dhe vështirësitë sociale.

Gratë dhe vajzat janë veçanërisht të prekura nga varfëria. Shkalla e rrezikut për të qenë i/e varfër është më e lartë ndër gratë se sa ndër burrat (përkatësisht 20,2 për qind dhe 19,3 për qind) dhe sidomos e lartë për fëmijët 0-17 vjeç (26,5 për qind krahasuar me 19,2 për qind të popullatës së rritur 18–64 vjeç). Kjo përqindje është më e lartë ndër familjet me fëmijë në varësi (23,9 për qind) krahasu-

194. INSTAT, "Anketa e të ardhurave dhe nivelit të jetesës në Shqipëri (EU-SILC) 2023", botuar në dhjetor 2024, shih: [https://www.instat.gov.al/media/14638/income-and-living-conditions-survey-2023\\_1312.pdf](https://www.instat.gov.al/media/14638/income-and-living-conditions-survey-2023_1312.pdf)

195. INSTAT(2023), "Anketa e të ardhurave dhe nivelit të jetesës në Shqipëri (EU-SILC) 2023", shih: [https://www.instat.gov.al/media/14638/income-and-living-conditions-survey-2023\\_1312.pdf](https://www.instat.gov.al/media/14638/income-and-living-conditions-survey-2023_1312.pdf)

**Figura 5****Treguesi i rrezikut për të qenë i/e varfër, 2023**

Burimi: INSTAT dhe Eurostat, "Anketa e të ardhurave dhe nivelit të jetesës në Shqipëri, 2023".

ar me ato pa fëmijë në varësi (11,3 për qind).<sup>196</sup> Gjithashtu, fuqia blerëse e përfitimeve të ndihmës ekonomike ka rënë me kalimin e viteve. Edhe pas rritjes së kohëve të fundit, shuma maksimale e përfitimeve rrallë i kalon 12.000 lekë (e barabartë me 139 USD ose 122 euro) për një familje me tre ose më shumë fëmijë në varësi, ndërsa në vitin 2023 pragu i varfërisë për një familje me dy fëmijë në varësi ishte shuma mujore prej 47.345 lekë (e barabartë me 551 USD ose 453 euro).<sup>197</sup>

Për sa i përket varfërisë së grave, në SKBGJ 2021-2030 janë parashikuar disa masa strategjike nën qëllimin e parë strategjik që synon reduktimin/eliminimin e varfërisë përmes plotësimit të të drejtave ekonomike dhe sociale të grave dhe vajzave; fuqizimin e tyre, sidomos përmes rritjes dhe qëndrueshmërisë së ekonomisë mjedisore (të gjelbër); dhe pjesëmarrjen e tyre të barabartë në digjitalizim.

Ndonëse hendeuku gjinor i lidhur me varfërinë në Shqipëri nuk është i konsiderueshëm në pamje të parë, janë një numër aspektesh që duhen konsideruar gjatë analizimit të


marrëdhënies midis seksit dhe varfërisë. Tradicionalisht, varfëria monetare llogaritet në nivelin e familjes, që e bën të vështirë dallimin e statusit të varfërisë të anëtarëve të ndryshëm të familjes.<sup>198</sup> Përveç kësaj, matjet e varfërisë të bazuara në të ardhurat nuk ngërthejnë përvojat komplekse të grave dhe vajzave që përballesh me forma të shumfishta dhe të ndërthurura të diskriminimit, deficite në të ardhura, shërbime shëndetësore, strehim dhe arsim, që kanë tendencën të ndërthuren dhe të përkeqësojnë njëra-tjetrën. Për ta korrigjuar këtë, janë krijuar matje shumëdimensionale të varfërisë, që përfshijnë variabla në nivelin e individit, si arsimi dhe shëndetësia, por ato ende vazhdojnë të mbështeten së tepërmi në variabla në nivelin e familjes, si për shembull aksesin në strehim apo infrastrukturë. Matjet e varfërisë gjithashtu përjashtojnë edhe aspekte kritike që lidhen me përvojat e grave dhe të vajzave me varfërinë, si prania e DHBGJ-së në jetën e tyre, mungesa e mundësisë për të thënë fjalën e tyre dhe për të ndërmarrë veprime, dhe mungesa e theksuar e kohës.<sup>199</sup> Gjithashtu, të dhënat e ndara sipas seksit dhe statistikave gjinore vazhdimisht

196. Po aty. [https://www.instat.gov.al/media/14638/income-and-living-conditions-survey-2023\\_1312.pdf](https://www.instat.gov.al/media/14638/income-and-living-conditions-survey-2023_1312.pdf)

197. Informacioni i bazuar në dokumentin "Rishikimi i shpenzimeve buxhetore vendore për shërbimet sociale, 2022", hartuar në kontekstin e programit "Askush të mos mbetet pas - 2" (draft ende i pabotuar).

198. Instituti Gjerman për Zhvillim dhe Qëndrueshmëri (IDOS), (2023), "Dosje politikash: Natyra gjinore e varfërisë: të dhëna, prova, dhe rekomandime për politika". Shih: [https://www.idos-research.de/uploads/media/PB\\_24.2023.pdf](https://www.idos-research.de/uploads/media/PB_24.2023.pdf)

199. UN Women (2024). "Anketim botëror për rolin e grave në zhvillim 2024: Përdorimi mbrojtës social për barazi gjinore, qëndrueshmëri dhe transformim". Shih: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2024/10/world-survey-on-the-role-of-women-in-development-2024>

**Figura 6****Shkalla e rrezikut për të qenë i/e varfër, sipas moshës dhe seksit, 2023**

Burimi: INSTAT dhe Eurostat, "Anketa e të ardhurave dhe nivelit të jetesës në Shqipëri, 2023"

mblidhen përmes anketimeve të njëjësive ekonomike familjare dhe nuk marrin parasysh dinamikat e pushtetit brenda familjes. Një numër shumë i madh grash në të gjithë botën, që jetojnë në familje jo të varfra, nuk kanë akses, ose kanë akses të kufizuar në të ardhurat e tyre, dhe nuk kanë, ose kanë shumë pak pushtet për të marrë vendime për mënyrën e përdorimit të burimeve të familjes. Ato janë *de facto* të varfra në të ardhura dhe kanë gjasa të përjetojnë edhe shumë privime të tjera, megjithatë mbeten të padukshme dhe të papasqyruara në statistika.<sup>200</sup>

Matja statistikore e BE-së, "Anketa e të ardhurave dhe nivelit të jetesës" (EU-SILC) mat varfërinë në Shqipëri mbi bazën e shpërndarjes së të ardhurave, varfërisë dhe përjashtimit social. Matja e varfërisë në kuadër të anketimit EU-SILC mbështetet në një koncept relativ që e

konsideron varfërinë si të qenit në disavantazh ekonomik krahasuar me të tjerë brenda së njëjtës popullatë. Kufiri i varfërisë përkufizohet si 60 për qind e të ardhurave mediane të disponueshme të ekuivalentuara për secilin individ në familje.<sup>201</sup> E ardhura e disponueshme e ekuivalentuar supozon se të gjithë anëtarët e familjes, qofshin gra ose burra, i ndajnë të ardhurat në mënyrë të barabartë, që do të thotë se çdo anëtar i familjes gëzon të njëjtin standard jetese.<sup>202</sup>

Kjo do të thotë se të ardhurat që i atribuohen secilit individ përfaqësojnë matjen e standardit të tyre të jetesës dhe jo të ardhurat faktike të tyre. Duke pasur parasysh këtë supozim, të dhënat e EU-SILC-së nuk reflektojnë dallimet e konsiderueshme gjinore në rrezikimin nga varfëria ose përjashtimi social.

200. Po aty.

201. Kjo llogaritje është e ponderuar, me përdorim të shkallës së modifikuar të ekuivalentimit të OECD-së, për të siguruar krahasueshmërinë midis familjeve me madhësi dhe përbërje të ndryshme. Koncepti i të ardhurave të disponueshme të ekuivalentuara është qendror në këtë metodologji. Ai fillon me përcaktimin e të ardhurave totale të disponueshme të një familjeje, që përfshin të ardhurat neto pas zbritjeve tatimore dhe atyre për kontributet shëndetësore dhe sigurimet shoqërore. Kjo shumë pastaj pjesëtohet me madhësinë e ekuivalentuar të familjes, që llogaritet bazuar në shkallën e modifikuar të ekuivalentimit të OECD-së.

202. EUROSTAT (2023). Udhëzime metodologjike dhe përshkrim i variabëlave të treguesve të EU-SILC, [https://ec.europa.eu/eurostat/documents/203647/20298610/Methodological+guidelines+2023+operation\\_v6-accessibility.pdf/2d6aa68c-aa51-d386-1f1c-0206fda5be49?t=1730709878443](https://ec.europa.eu/eurostat/documents/203647/20298610/Methodological+guidelines+2023+operation_v6-accessibility.pdf/2d6aa68c-aa51-d386-1f1c-0206fda5be49?t=1730709878443)

### 3.2.2 Gratë nga grupet e cenueshme dhe varfëria

Varfëria dhe pabarazitë janë më të dukshme në zonat rurale dhe ndër grupet e cenueshme të shoqërisë shqiptare, si për shembull anëtarët e komuniteteve rome dhe egjiptiane, të moshuarit, të rinjtë dhe të rejtat, personat me aftësi të kufizuara, dhe grupe të tjera. Megjithatë të dhënat për nivelet e varfërisë në këto grupe nuk janë të disponueshme, një numër raportesh përmendin sfidat e vazhdueshme në lidhje me përfshirjen sociale, punësimin dhe mundësitë e tjera. Për shembull, mekanizmat e të drejtave të njeriut kanë shprehur shqetësim lidhur me: situatën e banorëve në komunitetet e zonave të thella dhe rurale, që janë lënë pas sa i përket aksesit në shërbime, duke shkaktuar varfëri, papunësi dhe marginalizim në shkallë të gjerë;<sup>203</sup> diskriminimin e vazhdueshëm dhe të përhapur strukturor të komuniteteve rome dhe egjiptiane, që vazhdojnë të përballen me përjashtim social dhe marginalizim;<sup>204</sup> dhe për përjashtimin dhe varfërinë e personave me aftësi të kufizuara, që shkaktohet si nga mungesa e ndërgjegjësimit në popullatën e gjerë, ashtu edhe nga problemet e përhapura me aksesueshmërinë.<sup>205</sup> Gratë nga këto grupe janë veçanërisht të prekura nga këto probleme, për shkak të ndërthurjes së seksit me arsye të tjera potenciale të diskriminimit dhe përjashtimit, si përkatësia etnike, aftësitë e kufizuara, mosha, orientimi seksual, vendi i banimit (zonat rurale) dhe faktorë të tjerë. Qeveria e Shqipërisë ka njohur dhe pranuar parimin e përkatësive të shumëfishta në SKBGJ 2021-2030, duke i vënë gratë dhe vajzat, përfshirë ato të mitura, në gjithë diversitetin e tyre,<sup>206</sup> në qendër të masave dhe veprimeve

të Strategjisë. Megjithatë, katër vjet pas miratimit të Strategjisë, informacioni për masat konkrete të marra për trajtimin e varfërisë dhe përjashtimit social ndër gratë dhe vajzat është ende i kufizuar (me pak përjashtime të shtimit të ndihmës ekonomike për disa grupe grash – shih më poshtë). Në Vërejtjet Përmblyëse për Shqipërinë, të vitit 2023, Komiteti i KEGJFDG-së ngriti shqetësimet për “nivelet tejet të larta të varfërisë dhe aksesin e kufizuar në përfitime ekonomike dhe sociale të grupeve të pafavorizuara të grave, sidomos të grave rurale, grave me aftësi të kufizuara, grave nga pakicat etnike dhe grave lesbike, biseksuale, transjinore dhe interseks.”<sup>207</sup>

### 3.2.3 Mbrojtja sociale

Ka një numër vitesh që Shqipëria po zbaton një reformë të gjerë të mbrojtjes sociale dhe përfshirjes sociale, bazuar në një kornizë solide ligjore dhe të politikave. Këtu përfshihen: Ligji “Për shërbimet e kujdesit shoqëror” i vitit 2016, Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2015-2020 (afati i së cilës u zgjat deri në vitin 2023) dhe Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale (SKMS) 2024-2030, që synon të çojë përpara rezultatet e arritura në vitet e mëparshme për reformimin e mbrojtjes sociale të popullatave me të ardhura të ulëta dhe të pafavorizuara. Po kështu, janë hartuar edhe një numër dokumentesh për mbrojtjen sociale dhe përfshirjen e grupeve të pafavorizuara.<sup>208</sup>

Skema e përgjithshme e mbrojtjes sociale përfshin sigurimet shoqërore<sup>209</sup> dhe programet e punësimit dhe të

203. Raportuesi i posaçëm i OKB-së për të drejtën për zhvillim (2023). Raport mbi vizitën në Shqipëri, korrik 2023, <https://undocs.org/Home/Mobile?FinalSymbol=A%2FHRC%2F54%2F27%2FAdd.1&Language=E&DeviceType=Desktop&LangRequested=False>

204. Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor (KEDR) 2024. “Vërejtjet përmblyëse të përbashkëta për raportin e trembëdhjetë dhe të katërbëdhjetë periodik për Shqipërinë”, <https://undocs.org/Home/Mobile?FinalSymbol=CERD%2FC%2FALB%2FCO%2F13-14&Language=E&DeviceType=Desktop&LangRequested=False>

205. Raportuesi special i OKB-së për të drejtën për zhvillim (2023), Raport për vizitën në Shqipëri, korrik 2023 (<https://undocs.org/Home/Mobile?FinalSymbol=A%2FHRC%2F54%2F27%2FAdd.1&Language=E&DeviceType=Desktop&LangRequested=False>)

206. Këtu përfshihen gratë, vajzat e reja dhe vajzat e vogla rome dhe egjiptiane; gratë, vajzat e reja dhe vajzat e vogla me aftësi të kufizuara; gratë, vajzat e reja dhe vajzat e vogla që jetojnë në kushte privimi ekonomik dhe social; gratë, vajzat e reja dhe vajzat e vogla viktime të përdhunimit ose trafikimit të qenieve njerëzore; nënat e vetme; gratë, vajzat e reja dhe vajzat e vogla migrante dhe azilkërkuese; gratë, vajzat e reja dhe vajzat e vogla LGBTI+; dhe gratë e moshuara, sepse ato përballen me forma të shumëfishta diskriminimi.

207. Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit të Grave (KEDG), 2023. “Vërejtjet përmblyëse mbi raportin e pestë periodik për Shqipërinë”. [https://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=KEGJFDG%2FC%2FALB%2FCO%2F5&Lang=en](https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=KEGJFDG%2FC%2FALB%2FCO%2F5&Lang=en)

208. Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025, Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025, Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2025, Plani Kombëtar i Veprimit për Deinstitutionalizimin 2020-2022, Strategjia e Strehimit Social 2016-2025, e përditësuar në vitin 2021, Plani Kombëtar i Veprimit 2021-2027 për personat LGBTI, dhe Plani Kombëtar i Veprimit për luftën kundër trafikimit të personave 2021-2023.

209. Pensione me ose pa pagesa kontributesh.

tregut të punës.<sup>210</sup> Mbrojtja sociale e grupeve të pafavorizuara të popullatës është një komponent shumë i rëndësishëm i skemës, që realizohet si përmes ndihmave në para<sup>211</sup> ashtu edhe përmes shërbimeve të kujdesit shoqëror.<sup>212</sup> Në vitin 2022, shpenzimet e mbrojtjes sociale ishin 1,66 miliard euro, që përfaqëson 9,2 për qind të PPB-së dhe 30,4 për qind të të gjitha shpenzimeve. Kjo është shifër modeste krahasuar me 19,5 për qind të PPB-së që u shpenzua në BE për mbrojtjen sociale në vitin 2022. Në vitin 2023, shpenzimet për mbrojtjen sociale në Shqipëri ranë në 8,7 për qind të PPB-së, por ishin më të larta si vlerë totale (1,9 miliard euro ose 30,7 për qind e shpenzimeve të përgjithshme).

Projeksioni për vitin 2024 ishte 9,5 për qind e PPB-së ose 2,2 miliard euro, që përbën 30,9 për qind të shpenzimeve totale. Të njëjtat projeksione parashikohen edhe për vitin 2025, me 9,5 për qind të PPB-së ose 30,1 për qind të shpenzimeve totale. Rritja në vitet 2024 dhe 2025 ishte për shkak të skemës së re të pensioneve, që përbën rreth 0,3 për qind të PPB-së.<sup>213</sup> Skema e pensioneve është pjesë e fondit të sigurimeve shoqërore dhe përbën pjesën më të madhe të shpenzimeve për mbrojtjen sociale. Ky fond përbënte 7,6 për qind të PPB-së në vitin 2022, 7,2 për qind të PPB-së në vitin 2023, 7,1 për qind të PPB-së në vitin 2024 dhe planifikohet të përbëjë 7,3 për qind të PPB-së në vitin 2025. Pagesat e papunësisë,<sup>214</sup> ndihmat në para, pagesat për personat me aftësi të kufizuara, dhe politika të reja, si bonusi për bebet, përbënin 1,4 për qind të PPB-së në vitin 2022, 1,3 për qind të PPB-së në vitin 2023, 1,2 për qind të PPB-së në vitin 2024 dhe 1,1 për qind të PPB-së në vitin 2025.

## Përfitimet financiare

Në vitin 2021, për të zbutur ndikimin e pandemisë KOVID-19 shumat e ndihmës ekonomike (NE) u rritën për disa kategori të caktuara, nga të cilat përfituan sidomos gratë. Këto përfshinë dyfishimin e NE-së për familje me

tre ose më shumë fëmijë dhe rritjen me 10 për qind për familjet e tjera, ndërsa për jetimët, viktimat e trafikimit dhe viktimat e DHF-së pagesa u trefishua. Në vitin 2022, përfitimet në para u rritën përsëri për të zbutur ndikimin e mundshëm ekonomik të luftës në Ukrainë, ku mund të përmendet dyfishimi i pagesave për gratë kryefamiljare me deri në dy fëmijë dhe dyfishimi i ndihmës për personat mbi 65 vjeç që nuk përfitojnë pension pleqërie ose pension social. Po kështu, pagesat për familjet e tjera që plotësonin kushtet për të marrë ndihma por që nuk përfshiheshin në kategoritë e mësipërme, u rritën me 10 për qind krahasuar me vitin 2022.<sup>215</sup>

Si rezultat i këtyre masave, numri i grave që përfitojnë nga kjo ndihmë është rritur ndër vite, me 29.140 gra viktimat të dhunës dhe rreth 8.090 gra kryefamiljare përfituese të skemës së ndihmës ekonomike (qershor 2024). Janë bërë disa përpjekje për të njohur punën e papaguar të kujdestarëve të personave me aftësi të kufizuara, të cilat janë kryesisht gra. Aktualisht, 164.000 personat me aftësi të kufizuara dhe kujdestaret e tyre përfitojnë ndihmë ekonomike. Krahas kësaj, për herë të parë jepet ndihmë e posaçme për gratë e papuna me tre ose më shumë fëmijë nën moshën 18 vjeç dhe me të ardhura familjare deri në 100.000 lekë (e barabartë me 1.165 USD ose 1.120 euro) në muaj. Kjo ndihmë mbulon shpenzimet sociale dhe shëndetësore për periudhën e kujdesit për një fëmijë deri në pesë vjeç.

Ka pasur një rritje të ndjeshme edhe të numrit të grave rome dhe egjiptiane që kanë marrë ndihmë/përfitime ekonomike ose që kanë marrë pjesë në programe ri-integrimit – nga 112 gra rome dhe 89 gra egjiptiane në vitin 2016 në 1.785 gra rome dhe 846 gra egjiptiane në vitin 2019.<sup>216</sup> Me gjithë këto përmirësime, janë shprehur shqetësime në rritje për përshtatshmërinë dhe mjaftueshmërinë e pagesave të asistencës sociale dhe të rolit të programit për nxjerrjen e njerëzve nga varfëria – probleme që janë njohur edhe në SKMS 2024-2030.<sup>217</sup>

210. Aftësim profesional, subvencionim i pagave, trajnim në vendin e punës dhe praktika profesionale, mbështetje për sipërmarrjet, pagesa të papunësisë, pagesa të barrë lindjes, etj.

211. Ndihma ekonomike dhe subvencione të tjera për përfituesit e NE-së, asistencë për aftësinë e kufizuar, pensioni social.

212. Shërbimet sociale dhe familjare.

213. Ministria e Financave e Shqipërisë, Ligji i buxhetit për vitin 2024.

214. Ulja e numrit të njerëzve që përfitojnë pagesa të papunësisë – 3750 të papunë gjatë periudhës 2025-2027 – synon integrimin e grave dhe burrave nga këto familje në tregun e punës.

215. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2024), "Vlerësim gjithëpërfshirës kombëtar i zbatimit të Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim, Pekin +30", qershor 2024.

216. Po aty.

217. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 152, datë 13.3.2024 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030 dhe planit të veprimit në zbatim të saj".

Përveç kësaj, mungesa e një standardi minimal zyrtar dhe të përkufizuar mirë e bën të vështirë të vlerësohet masa në të cilën ndihma ekonomike ndihmon në lehtësimin e varfërisë. E vetmja referencë zyrtare nga një institucion shtetëror për llogaritjen e standardit minimal të jetesës vjen nga Avokati i Popullit, që në vitin 2019 përcaktoi se minimumi jetik për një individ ishte përafërsisht 17.875 lekë në muaj (e barabartë me 208 USD ose 182 euro). Në vitin 2024, pas marrjes parasysh të inflacionit,

Avokati i Popullit përlogariti se minimumi jetik në atë vit ishte 21.000 lekë (e barabartë me 245 USD ose 214 euro).<sup>218</sup> Megjithatë, shumat aktuale të ndihmave mbeten nën këtë prag: ndërkohë që paga minimale është 40.000 lekë (466 USD ose 408 euro), më shumë se dyfishi i minimumit jetik të përlogaritur,<sup>219</sup> pensioni i pleqërisë në zonat urbane është 18.341 lekë (214 USD ose 187 euro), pagesa e papunësisë është 20.000 lekë (233 USD ose 204 euro), dhe NE-ja mesatare mujore për familje është 7.237 lekë (84 USD ose 73 euro) – rreth 60% më e ulët se minimumi jetik. Këto shifra vënë në pah hendeqet që vazhdojnë të ekzistojnë dhe përforcojnë shqetësimet që përfitimet faktike në para nuk janë të mjaftueshme për të nxjerrë gratë, burrat, dhe fëmijët nga varfëria.

Përveç kësaj, pavarësisht nga disa përpjekje për përfshirjen e punës së papaguar, sistemi i mbrojtjes sociale në Shqipëri nuk merr parasysh sistematikisht punën e papaguar të kujdesit në hartimin dhe zbatimin e masave të mbrojtjes sociale.

Këtu përfshihet edhe marrja e masave për të siguruar që skemat kontribuuese të pensionit të njohin dhe kompensojnë në masën e duhur për kohën e shpenzuar me shërbime të kujdesjes, në përputhje me udhëzimet e ONP-së për sisteme të mbrojtjes sociale me ndjeshmëri gjinore, si dhe me detyrimet e Shqipërisë sipas Konventave nr. 100 (Për shpërblimin e barabartë) dhe nr. 111 (Për diskriminimin në punë dhe profesion) të ONP-së.

## Shërbimet sociale (shpenzimet jomonetare)

Shërbimet sociale janë një komponent me rëndësi jetësore në sistemin e mbrojtjes sociale, që mbështetin mirëqenien e përgjithshme të individëve. Këto shërbime u përgjigjen një game nevojash të shkaktuara nga varfëria, probleme shëndetësore, strehimi i papërshtatshëm ose cenueshmëri të tjera (aftësi të kufizuara, banimi në strehëza, etj.), ndërsa disa të tjera trajtojnë aspekte të përfshirjes sociale, si shërbimet e këshillimit, udhëzimit, mentorimit, mbështetjes psikologjike, rehabilitimit ose shërbimet e specializuara. Shërbimet sociale të integruara, të kombinuara me mbështetje financiare, janë thelbësore, sidomos për gratë viktime të dhunës, ato kujdestare, dhe gratë e cenueshme për shkak të ngarkesës me punë informale dhe të përkujdesit.

Gjatë viteve, në Shqipëri janë bërë përpjekje për përmirësimin e shërbimeve sociale. UNDP ka mbështetur Shërbimin Social Shtetëror për kryerjen e hartëzimeve të rregullta të shërbimeve sociale në vitet 2019, 2021, 2023 dhe 2025. Sipas këtyre hartëzimeve, në vitin 2023 kishte rreth 391 institucione publike dhe jopublike të shërbimeve të kujdesit shoqëror (që përbënte një rritje prej 16 për qind krahasuar me vitin 2021)<sup>220</sup> dhe në vitin 2025 numri i ofruesve të shërbimeve u rrit në 439, ose 13 për qind më i lartë se në vitin 2023.<sup>221</sup> Këto shërbime ofrohen nga ofrues publikë<sup>222</sup> dhe jopublikë<sup>223</sup> të shërbimeve, numri total i të cilëve gjatë periudhës 2021-2025 është rritur me 29 për qind – një rritje që i atribuohet kryesisht ofruesve publikë.<sup>224</sup> Këto 439 institucione ofrojnë 1.669 shërbime të kujdesit shoqëror për 39.091 individë në nevojë. Institucionet publike që ofrojnë shërbime të kujdesit shoqëror përbëjnë 59 për qind të numrit total dhe u shërbejnë 44 për qind të individëve në nevojë, ndërsa institucionet jopublike përbëjnë 41 për qind të numrit total dhe u ofrojnë shërbime 56 për qind të përfituesve.<sup>225</sup> (Në hartëzimet e mëparshme të viteve 2021 dhe 2023 u përfshi edhe një kategori e tretë institucionesh hibride të kombinuara publike-jopublike, që nuk është përfshirë në hartëzimin e fundit). Gratë dhe vajzat përbënin rreth

218. Avokati i Popullit (2024), Raporti "Vrasjet e grave dhe vajzave (femicidi) në Shqipëri, 2021-2023".

219. INSTAT (2023), Mbrojtja Sociale. Shih: <https://www.instat.gov.al/en/themes/social-condition/social-protection/#tab2>

220. UNDP (2023), "Hartëzimi i shërbimeve sociale në Shqipëri". Shih: <https://www.undp.org/albania/publications/mapping-social-services-albania-0>

221. UNDP (2025). "Hartëzimi i shërbimeve sociale në Shqipëri" (raporti përfundimtar ende nuk ishte botuar deri në korrik 2025).

222. Ofrues publikë janë të gjithë ata që financohen dhe administrohen me fonde publike (qendrore, rajonale, organet e vetëqeverisjes vendore, ndihma të huaja, burime publike të përziera).

223. Ofruesit jopublikë janë të gjithë ata që mbështeten nga burime jopublike (fondacione, shoqata, donatorë privatë, OJQ, organizata ndërkombëtare që veprojnë jashtë kontekstit të ndihmës zyrtare për zhvillim, burime të përziera jopublike, etj).

224. Po aty.

225. Po aty.

52 për qind të përfituesve të shërbimeve si në vitin 2023 ashtu edhe në vitin 2025.<sup>226</sup>

Hartëzimi i vitit 2025 tregon se megjithëse ofrimi i shërbimeve po orientohet gjithnjë e më shumë drejt adresimit të nevojave, shërbimet e kujdesit social në nivelin vendor vazhdojnë të jenë të kufizuara si për sa i përket gamës, ashtu edhe mbulimit, dhe me një shpërndarje që mbetet e pabalancuar në vend.<sup>227</sup> Gjithashtu vihen re mangësi edhe në shërbimet që mbështesin gratë që kanë nevoja të veçanta, si gratë viktimat të dhunës ose gratë që janë në rolin e ofruesve të përkujdesit. Për shembull, hartëzimi i vitit 2025 tregon se numri i ofruesve të shërbimeve për gratë është pakësuar në pothuaj të gjitha zonat e vendit, përveç Dibrës, Korçës, Tiranës, Fierit, dhe Gjirokastrës. Gratë viktimat të dhunës kryesisht kanë akses në shërbimet e strehëzave (51 për qind), shërbimet e urgjencës (20 për qind), dhe këshillimit (19 për qind), por kanë akses të kufizuar në qendrat ditore, qendrat komunitare apo në shërbimet në familje. Në 16 bashki nuk ka person të posaçëm përgjegjës për shërbimet për viktimat e dhunës në familje. Në tërësi, këto shërbime përbëjnë vetëm 11 për qind të të gjitha shërbimeve shoqërore, ndërsa viktimat e dhunës përbëjnë vetëm 6 për qind të të gjithë përfituesve. Vihet re një përmirësim i lehtë krahasuar me hartëzimin e mëparshëm, sipas të cilit strehëzat përbënin vetëm 3 për qind të të gjitha shërbimeve shoqërore dhe shërbimet për viktimat e dhunës në përgjithësi përbënin vetëm 8 për qind të të gjitha shërbimeve.<sup>228</sup> Megjithatë, përqindja e viktimave të dhunës që përfitojnë nga këto shërbime nuk ka ndryshuar (në vitin 2023 ishte përsëri 6 për qind). Në kontekstin e reformës së decentralizimit, organet e vetëqeverisjes vendore janë përgjegjëse për realizimin e shërbimeve shoqërore, por kapacitetet financiare dhe teknike të tyre janë të kufizuara. Për të adresuar vështirësitë e bashkive në financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, në vitin 2019 u krijua Fondi Social, si instrument për alokimin e fondeve nga buxheti qendror për plane të miratuara të shërbimit të kujdesit shoqëror. Gjatë pesë viteve të fundit, qeveria qendrore ka financuar rreth 84 shërbime (19 në nivel rajonal dhe 65 në nivel bashkie), nga të cilat 74 shërbime vazhdojnë të

funksionojnë. Bashkitë kanë bërë përparim në miratimin e planeve të kujdesit shoqëror me mbështetjen e donatorëve dhe të OSHC-ve. Të gjitha bashkitë tani kanë plane të kujdesit shoqëror; kur planit i mbaron afati, hartohet plan i ri. Deri në vitin 2025 janë punësuar rreth 680 gra dhe burra si rezultat i projekteve të financuara nga Fondi Social në bashki të ndryshme.<sup>229</sup> Roli gjithnjë e më i madh i organeve të vetëqeverisjes vendore dhe ndikimi pozitiv i Fondit Social në ofrimin e shërbimeve u evidentua qartë edhe në hartëzimin e shërbimeve sociale të vitit 2025. Rreth 34 për qind e përfituesve të shërbimeve publike lidhen me institucione të financuara nga bashkitë, ndërsa 24 për qind përfitojnë shërbime të financuara krejtësisht vetëm nga Fondi Social. Gjatë dy viteve të fundit, Fondi Social ka luajtur rol të rëndësishëm, duke mbuluar 18 për qind të ofruesve të shërbimeve dhe 15 për qind të përfituesve në të gjithë vendin. Në disa rrethe – si Gjirokastra, Vlora, Elbasani, Fieri, Kukësi, Berati, dhe Dibra – ndikimi i tij ka qenë edhe më i madh, me një kontribut që varion 27 për qind deri në 38 për qind të shërbimeve dhe me një rritje të numrit të përfituesve nga 20 për qind deri në dyfish.<sup>230</sup>

### 3.2.4 Migracioni dhe azili

Shqipëria ka bërë përpjekje për të përmirësuar kornizat e saj ligjore dhe të politikave të migracionit dhe azilit në përgjigje të dinamikës në evoluim të migracionit – si dalës ashtu edhe hyrës – që është intensifikuar gjatë viteve të fundit. Kuadri ligjor kryesor përfshin miratimin e ligjeve të reja për azilin<sup>231</sup> dhe për të huajt<sup>232</sup> në vitin 2021 si dhe aktet nënligjore përkatëse, që e kanë sjellë sistemin shqiptar të migracionit dhe azilit më afër standardeve ndërkombëtare dhe legjislationit të BE-së. Në vitin 2024, Shqipëria miratoi Strategjinë Kombëtare për Migracionin (2024-2030), që pritet të adresojë mangësitë e mëparshme në politikat e drejtimit dhe menaxhimit të migracionit.

Për sa i përket emigrimit nga Shqipëria, rezultatet e Censit të vitit 2023 konfirmuan shqetësimin për ndikimin që ka migracioni në popullatën shqiptare, e cila është ulur

226. Bazuar në hartëzimin e vitit 2025. Sipas hartëzimit të vitit 2023, gratë përbënin 53% të përfituesve.

227. Po aty.

228. Po aty.

229. Informacion i marrë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

230. UNDP (2025), "Hartëzimi i shërbimeve sociale në Shqipëri" (raporti përfundimtar ende nuk ishte botuar në korrik 2025).

231. Ligji nr. 10/2021 "Për azilin në Republikën e Shqipërisë".

232. Ligji nr. 79/2021 "Për të huajt".

me 420.000 banorë që nga Censi i vitit 2011. Pjesa më e madhe e personave që emigrojnë jashtë shtetit janë të moshës nga 20 deri në 39 vjeç, ku meshkujt kanë më shumë gjasa të emigrojnë se femrat. Gjithashtu, ka një tendencë më të madhe migrimi në radhët e punëtorëve më pak të kualifikuar dhe meshkujve që punojnë në bujqësi, zeytari dhe në manifakturë. Sa u përket grave – gratë që punojnë në sektorin e shërbimeve dhe ato të angazhuara në profesione bazike<sup>233</sup> kanë më tepër gjasa të emigrojnë se burrat. Në përgjithësi, gratë që kanë mbaruar arsimin universitar e kanë më të vështirë të integrohen në forcat e punës të vendeve pritëse.<sup>234</sup>

Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore ka vënë në dukje se faktorë ekonomikë, si shkalla e lartë e papunësisë, perspektivat e kufizuara për punë dhe pagat e ulëta mbeten arsye kryesore për emigrim.<sup>235</sup> Krahas këtyre, faktorë të tjerë strukturorë që lidhen me qeverisjen kanë të bëjnë me pakënaqësinë për shkak të korrupsionit dhe klientelizmit dhe performancën në sektorët e shëndetësisë, arsimit dhe drejtësisë.<sup>236</sup>

Ndonëse numri i personave nga Shqipëria që kërkojnë azil në shtetet anëtare të BE-së ka rënë dhe shqiptarët nuk janë më ndër vendet kryesore të origjinës për aplikimet për azil, migracioni i parregullt vazhdon të jetë në nivel të lartë. Sipas Eurostatit, në vitin 2023, shqiptarët përbënin grupin e dytë më të madh të personave të cilëve iu refuzua hyrja në BE, pas ukrainasve, me 14.000 refuzime. Eurostatit vëren gjithashtu se shqiptarët ishin ndër grupet më të mëdha të kthyer në një vend jashtë BE-së, me 7.800 persona të kthyer të regjistruar në vitin 2023.<sup>237</sup> Në të njëjtën kohë, shtetasit shqiptarë vazhdojnë të jenë ndër grupet që marrin më shumë shtetësi në vendet e

BE-së. Në vitin 2022, 50.300 persona fituan shtetësinë e një vendi anëtar të BE-së, që shënoi një rritje me 55 për qind krahasuar me vitin 2021. Shtetet kryesore që u dhanë shtetësi shqiptarëve ishin Italia (75,8 për qind) dhe Greqia (19,2 për qind), që pasqyrojnë lidhjet e forta të migracionit midis Shqipërisë dhe këtyre vendeve.<sup>238</sup>

Për sa i përket migracionit neto, Shqipëria ka balancë negative, që do të thotë se emigrantët që largohen nga vendi janë më të shumtë se migrantët që hyjnë në vend. Përbërja e personave që migrojnë në Shqipëri është 64 për qind burra dhe 36 për qind gra, si për sa u përket migrantëve ndërkombëtarë, ashtu edhe personave të kthyer.<sup>239</sup>

Strategjia e re e migracionit njih lidhjen e rëndësishme midis migracionit dhe mundësive të punësimit në vend dhe adreson sfida kyçe në menaxhimin e migracionit, përfshirë mbrojtjen e të drejtave të migrantëve dhe integrimin e tyre në shoqërinë shqiptare. Strategjia synon të përfshijë perspektivën gjinore në objektivat dhe veprimet e saj përmes: përmirësimit të mbledhjes së të dhënave për migracionin të ndara sipas seksit; zbatimin e masave për të siguruar që politikat shqiptare të migrimit të jenë reaguese gjinore; dhe zbatimin e masave që promovojnë punë të denjë për gratë dhe burrat dhe eliminojnë pabarazitë gjinore në të gjitha fushat përkatëse dhe në vendin e punës.

Nga ana tjetër, agjencitë e OKB-së që punojnë me refugjatët dhe azilkërkuessit kanë ngritur shqetësime se masat kundër varfërisë dhe sistemi i mbrojtjes sociale në përgjithësi – përfshirë legjislacionin për mbrojtjen sociale, SKMS-në e re (2024-2030), dhe legjislacionin

233. Punë rutinë kryerja e të cilave mund të kërkojë përdorimin e veglave të dorës dhe përpjekje fizike, si pastrimi, bartja e furnizimeve dhe kryerja e punëve bazë të mirëmbajtjes në mjedise banimi ose profesionale (për shembull, hotele dhe zyra).

234. IOM (2023), Studimi "Modelimi parashikues: ndikimi i migracionit në forcat shqiptare të punës dhe nevojat për zhvillimin e aftësive nga perspektiva gjinore në Shqipëri". Shih: <https://albania.iom.int/resources/study-predictive-modelling-migration-impact-albanian-workforce-and-skills-development-needs-gender-perspective-albania>

235. Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (2024), "Vërejtjet përmbyllëse mbi raportin e katërt periodik për Shqipërinë", <https://uhri.ohchr.org/en/document/0002235d-aea9-4ebc-9a06-a7a5db730413>

236. IOM (2023), "Vlerësimi i kornizave të lëvizjes së fuqisë punëtore dhe ndikimit të tyre në lëvizjen e emigrantëve shqiptarë të punës", <https://albania.iom.int/resources/assessment-labour-mobility-frameworks-and-their-impact-mobility-albanian-labour-migrants>.

237. Eurostat (2024), "Migracioni dhe azili në Evropë", botim i vitit 2024, marrë nga Eurostat: <https://ec.europa.eu/eurostat/web/interactive-publications/migration-2024#irregular-migration-and-return>

238. Eurostat (2024), Statistika për marrjen e shtetësisë. Shih: [https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Acquisition\\_of\\_citizenship\\_statistics](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Acquisition_of_citizenship_statistics)

239. IOM (2023), Studimi "Modelimi parashikues: ndikimi i migracionit në forcat shqiptare të punës dhe nevojat për zhvillimin e aftësive nga perspektiva gjinore në Shqipëri", <https://albania.iom.int/resources/study-predictive-modelling-migration-impact-albanian-workforce-and-skills-development-needs-gender-perspective-albania>

për strehimin social – nuk janë të harmonizuara me Ligjin nr. 10/2021 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë.” Këto korniza jo gjithmonë janë konsistente në trajtimin e kategorive të vajzave dhe grave azilkërkuese dhe refugjate dhe atyre të cilave u është miratuar mbrojtje ndërkombëtare ose e përkohshme. Përfshirja e të gjitha këtyre kategorive në skemën e mbrojtjes sociale, si në lidhje me ndihmat financiare ashtu edhe shërbimet, do të ishte në përputhje me legjislacionin për azilin dhe do t’u ofronte familjeve të cenueshme azilkërkuese dhe refugjate mjete të parashikueshme për plotësimin e nevojave të tyre bazë, për akses në përfitime sociale, akses në punësim, si dhe garanci më të forta për punë të denjë dhe përfitim të sigurimeve shoqërore.<sup>240</sup>

Gjithashtu, Komiteti i KEGJFDG-së ka ngritur shqetësimin se gratë dhe vajzat refugjate, azilkërkuese dhe migrante përballen me forma të shumëfishta diskriminimi dhe nivele shproporcionale të DHBGJ-së në Shqipëri, sidomos në zonat kufitare, dhe se gratë migrante që nuk kanë dokumente përballen me rrezik më të madh të shfrytëzimit seksual, punës së detyruar dhe rekrutimit nga rrjetet e trafikimit të qenieve njerëzore. Komiteti ka vënë në dukje edhe probleme si procedurat e ndërlikuara dhe tarifatat e larta me të cilat përballen personat të cilëve u është njohur statusi i refugjatit, për marrjen e dokumentacionit, si edhe centralizimin e procesit të dokumentimit të refugjatëve, që shton më tej kostot e tyre dhe rrezikun që ata të ndalohen, ose të bëhen pre e zhvatjeve dhe e DHBGJ-së gjatë udhëtimit.<sup>241</sup>

### 3.2.5 Akte ligjore dhe politika kyçe të BE-së

Banorët e BE-së nuk janë imunë ndaj varfërisë dhe përjashtimit social – mesatarisht më se një e pesta e banorëve të BE-së jetojnë me rrezikun për të qenë të varfër ose të përjashtuar nga ana sociale. Në vitin 2023, rreziku ishte më i lartë për gratë se sa për burrat (22,3 për

qind krahasuar me 20,3 për qind).<sup>242</sup> Baza kryesore e politikave në këtë fushë është Shtylla Evropiane e të Drejtave Sociale, që përfaqëson angazhimin e përbashkët të qeverive të shteteve, institucioneve të BE-së dhe palëve kyçe të interesit për luftimin e varfërisë dhe përjashtimit social. Ajo përcakton parimet kryesore të përfshirjes sociale, ndër të cilat: sigurimi i minimumit të të ardhurave, përfshirja e personave me aftësi të kufizuara, strehimi dhe ndihma për të pastrehët, dhe akses në shërbimet bazë.

Plani i Veprimit i Shtyllës Evropiane të të Drejtave Sociale përmban një objektivi në lidhje me varfërinë, për reduktimin e numrit të personave të rrezikuar për të qenë të varfër ose të përjashtuar nga ana sociale me të paktën 15 milion njerëz deri në vitin 2030, ndër të cilët të paktën pesë milion fëmijë. Ky objektivi u miratua në takimin e nivelit të lartë të vitit 2021 në Porto dhe u përshëndet nga Këshilli Evropian. Plani i Veprimit ka shpallur edhe një numër nismash për mbështetjen e zbatimit të parimeve të Shtyllës së të Drejtave Sociale. Disa nga këto nisma në fushat e varfërisë dhe të përjashtimit social janë rekomandimi i Këshillit për akses në mbrojtje sociale për punëtorët dhe personat e vetëpunësuar (2019), rekomandimi i Këshillit Evropian për të ardhurat minimale (2023), Platforma Evropiane për Luftimin e Varfërisë (2022), dhe Udhëzuesi për Përdorimin Vlerësimit të Ex Ante të Shpërndarjes së Impaktit.<sup>243</sup>

Në raportin më të fundit për Shqipërinë (2024), Komisioni Evropian nënvizoi përpjekjet e qeverisë për të konsoliduar skemën e ndihmës ekonomike, zbatimin e sistemit të vlerësimit biopsikosocial për personat me aftësi të kufizuara, si dhe përpjekjet për reformimin e sistemit të shërbimeve të kujdesit shoqëror. Megjithatë, u rekomandua që efektiviteti i mbulimit me skemën e ndihmës ekonomike të vlerësohet në bazë të studimeve në terren dhe analizës së mikro të dhënave të Eurostatit për Anketën e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës, si me anë të anketave të buxhetit të njësive ekonomike

240. Komente të UNHCR-së në lidhje me “Profilin e barazisë gjinore – Shqipëri” (2025)

241. Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit të Grave, (2023) “Vërejtjet përmblylëse mbi raportin e pestë periodik të Shqipërisë” (CEDAW/C/ALB/CO/5). CEDAW/C/ALB/CO/5

242. Eurostat (2023), “Kushtet e jetesës në Evropë”. Shih: [https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Living\\_conditions\\_in\\_Europe\\_-\\_poverty\\_and\\_social\\_exclusion](https://ec.europa.eu/eurostat/statistics-explained/index.php?title=Living_conditions_in_Europe_-_poverty_and_social_exclusion)

243. Komisioni Evropian (2023), “Njëzet parimet e shtyllës evropiane të të drejtave sociale”, [https://employment-social-affairs.ec.europa.eu/european-pillar-social-rights-20-principles\\_en](https://employment-social-affairs.ec.europa.eu/european-pillar-social-rights-20-principles_en). Komisioni Evropian (2024), Raporti për Shqipërinë 2024. Gjetet në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en)

familjare. Kjo do të ndihmonte në identifikimin e grupeve të cenueshme që ende nuk përfitojnë nga kjo skemë. Autoritetet nxiten gjithashtu të finalizojnë vlerësimin e ndikimit lidhur me përshtatshmërinë e strategjisë së daljes nga skema, për të mundësuar daljen nga skemat e ndihmës ekonomike, rritjen e shumave të ndihmës, krijimin e një mekanizmi indeksimi vjetor dhe zbatimin e udhërrëfyesit për rivlerësimin e përfitimeve bazuar në konstatimet e vlerësimit.<sup>244</sup>

Që nga maji 2025, BE-ja ka hapur negociatat me Shqipërinë për kapitullin 19 mbi politikën sociale dhe punësimin (pjesë e grup-kapitullit të tretë) dhe vendi po harmonizon veprimet kyçe që po ndërmerren në kuadër të reformave të mbrojtjes sociale me afatet e përgjithshme në kuadër të negociatave. Po bëhen përpjekje për të finalizuar udhërrëfyesin për zbatimin e politikave të BE-së në lidhje me këtë kapitull dhe me Shtyllën Evropiane për të Drejtat Sociale.<sup>245</sup> Në këtë kontekst, është thelbësore të zbatohet integrimi gjinor për të siguruar që masat përkatëse të trajtojnë siç duhet vështirësitë kryesore me të cilat përballen gratë – sidomos ato nga grupet e pafavorizuara – në lidhje me përfshirjen dhe mbrojtjen sociale, sikurse u trajtua në analizën e mëparshme, si dhe në përputhje me rekomandimet relevante të Komisionit të BE-së dhe të mekanizmave të të drejtave të njeriut për Shqipërinë.

### 3.2.6 Rekomandime

Më poshtë jepen disa rekomandime që synojnë avancimin e barazisë gjinore në kuadër të politikave të mbrojtjes sociale, migracionit dhe lehtësimit të varfërisë, duke u bazuar drejtpërdrejt në parimet e paraqitura në vërejtjet përmblyëse të Raportit e Pestë Periodik për Shqipërinë të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit të Grave dhe rekomandimet relevante të Rishikimit Periodik Universal (RPU).

#### 1. Të sigurohet zbatimi tërësor i reformës së mbrojtjes sociale dhe i Strategjisë për Përfshirjen Sociale

që trajtojnë faktorët që shkaktojnë varfërinë dhe përjashtimin social, duke siguruar një standard të përshtatshëm jetese për gratë dhe burrat, pa diskriminim (në përputhje me rekomandimin 124.112 të RPU-së).<sup>246</sup>

- 2. Të shtohen si vlera, ashtu edhe gama e përfitimeve të mbrojtjes sociale, duke siguruar që ato të jenë jo vetëm të mjaftueshme, por edhe të orientuara strategjikisht për trajtimin e nevojave të grupeve të cenueshme, sidomos të grave** (në përputhje me rekomandimin 124.110 të RPU-së). Në këtë kontekst, duhet të merret parasysh rekomandimi i Avokatit të Popullit për njohjen zyrtare dhe përditësimin përkatës të standardit minimal të jetesës.
- 3. Të sigurohet alokim i balancuar midis përfitimeve financiare dhe shërbimeve mbështetëse bazë**, në veçanti në shërbimet për gratë, si gratë viktime të DHBGJ-së, shërbimet për mbështetjen e familjeve dhe të fëmijëve, dhe shërbime të tjera. Kjo qasje e integruar do të ndihmojë të sigurohet që individët jo vetëm të marrin ndihmë financiare, por edhe të kenë qasje në shërbimet e nevojshme për mirëqenie afatgjatë, përfshirje sociale, dhe rehabilitim (në përputhje me rekomandimin 124.111 të RPU-së).
- 4. Të shtrihet mbrojtja sociale edhe për gratë që punojnë në ekonominë informale** për të mbrojtur sigurinë financiare dhe mirëqenien e tyre. Ky zgjerim duhet të përfshijë kujdesin shëndetësor, pensionet, dhe përfitime të tjera të sigurimeve shoqërore, duke u ofruar grave të njëjtat mbrojtje si ato të personave të punësuar në tregun formal (në përputhje me rekomandimet e KEDG-së).<sup>247</sup>
- 5. Të sigurohet që gratë e angazhuara në bizneset familjare dhe punë të përkujdesit** të kompensohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë për punën e tyre dhe të përfitojnë nga skemat e sigurimeve shoqërore (në përputhje me rekomandimet e KEDG-së).<sup>248</sup>

244. Komisioni Evropian (2024). "Raporti për Shqipërinë 2024". Gjetet në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en)

245. OKB (2025), "Raporti i progresit i programit të përbashkët 'Askush të mos mbetet pas'", (korrik-dhjetor 2024), i pabotuar.

246. Këshilli i të Drejtave të Njeriut (2024). "Raporti i grupit të punës për Raportin Periodik Universal: Shqipëria" (Seanca e 58-të, Pika e rendit të ditës 6); A/HRC/58/5.)

247. Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit të Grave, (2023) "Vërejtjet përmblyëse mbi raportin e pestë periodik të Shqipërisë"(CEDAW/C/ALB/5). CEDAW/C/ALB/CO/5, Rekomandimi 34 (b).

248. CEDAW/C/ALB/CO/5, Rekomandimi 34 (c).

6. **Të miratohen strategji të fokusuara dhe të shumanshme për reduktimin e varfërisë tek gratë, sidomos tek gratë nga grupet e pafavorizuara, si gratë nga zonat rurale, gratë me aftësi të kufizuara, gratë nga pakicat etnike, dhe gratë lesbike, biseksuale, transgjimore dhe interseks.** Kjo mund të arrihet përmes rritjes së aksesit në burime financiare, veçanërisht përmes huave me normë të ulët interesi që nuk kërkojnë kolateral. Këto masa do t'ua bëjnë më të lehtë këtyre grave ndjekjen e mundësive sipërmarrëse dhe fitimin e të ardhurave të qëndrueshme, duke forcuar kështu pavarësinë e tyre ekonomike dhe duke mundësuar përfshirjen social-ekonomike afatgjatë të tyre (në përputhje me rekomandimet e KEDG-së).<sup>249</sup>

7. **Të rishikohet korniza për matjen e varfërisë** për miratimin e një qasjeje shumëpërmasore, duke siguruar që përvojat e grave, sidomos të atyre nga grupet e marginalizuara, të pasqyrohen siç duhet. Kjojo vetëm që do të nxjerrë në pah barrierat specifike me të cilat përballen gratë, por edhe do të promovojë përfshirjen sociale përmes ndërhyrjeve më efektive dhe të posaçme të bazuara në informacion.

8. **Të trajtohen nevojat e grave refugjate, azilkërkuese dhe migrante përmes veprimeve gjithëpërfshirëse që luftojnë format e diskriminimit dhe të dhunës me bazë gjinore për shkak të përkatësisë së shumëfishtë.** Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet zonave ku niveli i rrezikut është më i lartë, si zonat kufitare, zonat turistike dhe zonave me industri nxjerrëse. Duhet të bëhen përpjekje që dhunuesit të ndiqen penalisht dhe të dënohen (në përputhje me rekomandimet e KEDG-së).<sup>250</sup>

9. **Të zbatohen procedura të përballueshme financiarisht dhe të mundësohet dokumentacion i aksesueshëm** për gratë të cilave u është miratuar statusi si refugjate, me **tarifa të reduktuara** dhe

**procedura administrative të thjeshtuara** për të siguruar aksesin e tyre në shërbime thelbësore si **arsimi, punësimi, shërbimi shëndetësor, strehimi dhe përfitimet sociale.**<sup>251</sup>

10. **Të përdoret qasje me ndjeshmëri gjinore** në shërbimet e pritjes për gratë azilkërkuese dhe refugjate, si edhe të ofrohen trajnime për punonjësit e imigracionit mbi teknika intervistimi me ndjeshmëri gjinore dhe të trajtohen me përparësi nevojat për mbrojtje të këtyre grave dhe vajzave në procedurat e azilit.<sup>252</sup>

### 3.3 FUQIZIMI EKONOMIK I GRAVE

#### 3.3.1 Veprimtaria ekonomike dhe punësimi

Aktiviteti ekonomik në Shqipëri është rritur ndjeshëm ndër vite. Megjithatë, bujqësia mbetet sektori dominues, ku është e punësuar 32,3 për qind e forcave të punës. Bujqësia ndiqet nga shërbimet e tregut (29 për qind);<sup>253</sup> administrata publike, shërbimet dhe aktivitetet në komunitet dhe të tjera (17,6 për qind); industria e lehtë (11,2 për qind); ndërtimi (7,6 për qind) dhe në fund, minierat, furnizimi me energji elektrike, gaz dhe ujë (2,2 për qind).<sup>254</sup> Përparimi i punësimit në vitet e fundit tregon se sektorët me rritje relative më të madhe në vend janë shërbimet e informacionit, industri të tjera përpunuese, shërbimi shëndetësor, turizmi dhe hoteleria, programimi kompjuterik dhe tregtimi dhe riparimi i automjeteve.<sup>255</sup>

Për sa i përket shpërndarjes gjinore në sektorë specifikë, shihet se përqindja e grave pjesëmarrëse në forcat e punës është më e lartë se sa e burrave në disa sektorë, si në bujqësi (53,3 për qind gra kundrejt 46,7 për qind burra), administratë publike dhe shërbime sociale (56 për qind gra kundrejt 44 për qind burra) dhe industri të lehtë (57,2 për qind gra kundrejt 42,8 për qind burra), dhe më e ulët në shërbimet e tregut, ndërtim dhe miniera.<sup>256</sup>

249. CEDAW/C/ALB/CO/5, Rekomandimi 34 (a).

250. CEDAW/C/ALB/CO/5, Rekomandimi 46 (a).

251. CEDAW/C/ALB/CO/5, Rekomandimi 46 (b).


252. CEDAW/C/ALB/CO/5, Rekomandimi 46 (c).

253. Tregti, transport, bizneset e hotelarisë dhe ushqimit, dhe shërbimet administrative.

254. INSTAT (2024), "Tregu i punës në Shqipëri", 2023, <https://www.instat.gov.al/media/13552/tregu-i-punes-2023.pdf>

255. Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030, [https://arkiva.financa.gov.al/wp-content/uploads/2023/10/National-Employment-and-Skills-Strategy-2030\\_EN.pdf](https://arkiva.financa.gov.al/wp-content/uploads/2023/10/National-Employment-and-Skills-Strategy-2030_EN.pdf)

256. INSTAT (2023), "Anketa e forcave të punës".

**Figura 7****Personat e punësuar sipas llojit të punësimit dhe seksit, 2023**

Burimi: INSTAT, "Tregu i punës në Shqipëri, 2023"

Sa i përket llojit të punësimit, shumica e grave të punësuar kategorizohen si punëmarrëse, ndjekur nga ato që kontribuojnë si punëtore në biznesin e familjes. Ekziston një hendek i konsiderueshëm prej 10,7 pikë përqindjeje në pjesëmarrjen si kontribues në biznesin familjar, ku gratë janë tejet të mbipërfaqësuar. Hendeku gjinor në radhët e personave të vetëpunësuar është edhe më i theksuar – 13,4 pikë përqindjeje – që tregon për një pjesëmarrje shumë më të ulët të grave në vetëpunësim krahasuar me burrat.

Në vitin 2023, numri i forcave të punës në Shqipëri vlerësohej të ishte 1.485.843 (53,8 për qind burra dhe 46,2 për qind gra), nga të cilët 1.327.042 ishin të punësuar (53,9 për qind burra dhe 46,1 për qind gra). Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës e grave të moshës 15-64 vjeç ishte 69,6 për qind, me një hendek gjinor prej 12,4 pikë përqindjeje krahasuar me burrat.<sup>257</sup> Në lidhje me nivelet arsimore, gratë me arsim të lartë kanë shkallën më të lartë të pjesëmarrjes, me 87,5 për qind, ndjekur nga ato me arsim të mesëm, me 66 për qind, dhe ato


me arsim të ulët, me 62,3 për qind. Hendeku gjinor në pjesëmarrje në forcat e punës është më i theksuar ndër gratë me arsim të mesëm, me 21,4 pikë përqindjeje, ndërsa është shumë më i ulët tek ato me arsim të lartë, me 5 pikë përqindjeje.<sup>258</sup>

Vitet e fundit ka pasur njëfarë progresi në reduktimin e papunësisë. Në vitin 2023, niveli i përgjithshëm i papunësisë ishte 10,7 për qind, që përbën një ulje të vogël me 0,2 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2022, pa dallime mes gjinive. Nga 1 korriku 2022 deri në 30 qershor 2023, numri i punëkërkuessve të papunë që përfituan nga programet për promovimin e punësimit u rrit në 15.204 – një rritje prej 11,2 për qind nga niveli i referencës. Gjatë së njëjtës periudhë, në programet e formimit profesional morën pjesë 10.862 persona të papunë.<sup>259</sup> Me gjithë këto përmirësime, sfidat në punësim vazhdojnë të ekzistojnë, sidomos për punëtorët dhe punëtoret më të moshuara që mund të kenë kufizime për sa i përket kryerjes së punëve fizike dhe të jenë më të rrezikuar t'i largojnë nga puna për shkak të automatizimit të proceseve të punës.

257. INSTAT (2024), "Tregu i punës në Shqipëri, 2023", <https://www.instat.gov.al/media/13552/tregu-i-punes-2023.pdf>

258. Po aty.

259. Delegacioni i BE-së në Shqipëri, AIDE MÉMOIRE, Shënim informativ mbi raportin përfundimtar të vlerësimit - ndihma teknike për vlerësimin dhe monitorimin e përmbushjes së standardeve të mbështetjes së BE-së për programin e përfshirjes sociale, Tiranë, Shqipëri, NEAR/TIA/2020/EA-RP/00-61, qershor 2024.

**Figura 8****Hendeku gjinor në pjesëmarrjen në forcat e punës sipas nivelit arsimor, 2023**

Burimi: INSTAT, "Tregu i punës në Shqipëri, 2023"


Më problematike është përfshirja në tregun e punës e të rinjve dhe të rejave nga komunitetet e pafavorizuara. Shumë prej këtyre individëve janë joaktivë, të papunë, dhe as nuk ndjekin shkollën, dhe të rinjtë e të rejtat që jetojnë në zona të thella shpesh janë tërësisht të përjashtuar. Në vitin 2023, 24,6 për qind e të rinjve dhe të rejave të grupmoshës 15-29 nuk ishin të punësuar, nuk ndiqnin shkollën apo ndonjë formim profesional, dhe 49,4 për qind e tyre ishin pa punë. Pjesa tjetër ishin jashtë tregut të punës sepse ishin të dekurajuar<sup>260</sup> (2 për qind), kishin detyra dhe përgjegjësi familjare (13,4 për qind), ose për arsye të tjera (35,3 për qind). Krahasuar me vitin paraardhës, numri i të rinjve dhe të rejave të dekurajuar pësoi një ulje me 5,7 pikë përqindjeje. Në grupmoshën 15-29 vjeç, 25,6 për qind e të rejave nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollën apo formim profesional, që është përqindje më e lartë se në radhët e të rinjve, me një hendek gjinor prej 2,1 pikë përqindjeje, që tregon se vajzat e reja kanë më tepër gjasa të jenë jashtë tregut të punës dhe sistemit arsimor se sa djemtë e rinj. Ndër të rinjtë dhe të rejtat që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollën apo ndonjë formim profesional,

djemtë e rinj janë më aktivë ekonomikisht se sa vajzat e reja. 61 për qind e meshkujve që nuk janë të punësuar, në arsim apo formim profesional, janë të papunë, krahasuar me 39 për qind të femrave në të njëjtën kategori. Vajzat e reja kanë shumë më tepër gjasa që të merren me punë shtëpie dhe përkujdesi për familjen – konkretisht, 25,3 për qind e femrave që nuk janë të punësuar, nuk ndjekin shkollën apo formim profesional kryejnë punë të papaguar përkujdesi, krahasuar me vetëm 0,2 për qind të meshkujve në këtë kategori. Kjo vë në pah ngarkesën e konsiderueshme që kanë vajzat e reja në Shqipëri me punë dhe përgjegjësi të papaguara përkujdesi.<sup>261</sup>

Nuk ka të dhëna specifike në lidhje me punësimin e grave nga grupe të pafavorizuara (ndër të cilat gratë me aftësi të kufizuara, gratë nga komunitetet romë dhe egjiptiane, gratë LGBTIQ+ dhe gratë përfituese të ndihmave sociale). Megjithatë, agjencitë e OKB-së që punojnë për mbështetjen e një tregu pune përfshirës në Shqipëri, raportojnë për barriera të shumfishta me të cilat përballen këto gra në rrugën e tyre për t'u bërë të punësueshme, dhe sidomos për të pasur aftësitë për t'u

260. Të papunë të dekurajuar janë personat që nuk kanë punë, që aktualisht janë të disponueshëm për të punuar, por që nuk kërkojnë punë sepse besojnë që nuk ka punë të përshtatshme për ta.

261. INSTAT (2024), "Tregu i punës në Shqipëri, 2023", <https://www.instat.gov.al/media/13552/tregu-i-punes-2023.pdf>

**Figura 9****Të rinjtë jo në punësim, arsim dhe as në trajnim (NEET) sipas arsyeve kryesore, 2023**

Burimi: INSTAT, "Tregu i Punës në Shqipëri, 2023"

përshtatur me tregun e punës. Bazuar në disa praktika që u pilotuan në kuadër të një nisme të financuar nga BE-ja për përfshirjen në tregun e punës, aktorët në tregun vendor të punës duhet të mundësojnë delegim të qëndrueshëm të mekanizmave financiare vendore të jashtme përmes forcimit të partneriteteve me OSHC të specializuara.<sup>262</sup> Kjo mbështet realizimin e modeleve ekzistuese dhe të reja të shërbimeve të punësimit dhe zhvillimit të aftësive në nivel vendor, me fokus mbi gratë me cenueshmëri të llojeve të ndryshme.<sup>263</sup>

Niveli arsimor nuk ka ndonjë ndikim të konsiderueshëm në hendekun gjinor në papunësi. Ashtu si burrat, edhe shumica e grave të papuna, janë me arsim të mesëm. Megjithatë, hendeku gjinor në shkallën e papunësisë është pak më i lartë në personat me arsim të lartë (3,5 pikë përqindjeje), ndonëse vazhdon të jetë relativisht i ulët krahasuar me hendekun gjinor në shkallën e punësimit.<sup>264</sup>

### 3.3.2 Punësimi informal

Sipas legjislacionit shqiptar, "punësimi informal" është ai që nuk u përmbahet kërkesave të legjislacionit të punës dhe atij tatimor dhe ku punonjësit nuk përfitojnë të drejtat që u takojnë si punëmarrës.<sup>265</sup> Për qëllimet e informacionit statistikor dhe të mbledhjes së të dhënave në kuadër të botimit të INSTAT-it për tregun e punës, punësimi informal përfshin punonjësit jo të sektorit bujqësor, për të cilët marrëdhëniet ekonomike me punëdhënësin nuk mbulojnë, ose mbulojnë pjesërisht, përmes marrëveshjeve formale.<sup>266</sup> Punësimi informal përfshin edhe personat e vetëpunësuar që punojnë në ndërmarrje të vogla me pesë ose më pak persona dhe të cilët vendin e punës e kanë në shtëpinë e tyre, shtëpinë e klientit ose të punëdhënësit, ose një strukturë ngjitur me shtëpinë, një kantier ndërtimi, një tezgë fikse në treg ose

262. Delegimi i disa shërbimeve financiare apo funksioneve mbështetëse (si menaxhimi i subvencioneve, granteve, mikrokredivë, apo fondeve për mbështetjen e punësimit) tek organizata të jashtme, në këtë rast, OSHC-ve.

263. Kontributi i UNDP-së për raportin.

264. INSTAT(2023), "Anketa e forcave të punës": <https://www.instat.gov.al/media/14273/tregu-i-punes-2023.pdf>

265. Ligji nr. 9634/2006 "Për inspektimin e punës dhe Inspektoratin Shtetëror të Punës" i ndryshuar.

266. Punonjësit që nuk përfitojnë leje vjetore të paguar, ose leje sëmundjeje të paguar kur sëmuren, ose punonjësit që përfitojnë leje vjetore ose leje sëmundjeje të paguar, por që punëdhënësit e tyre nuk paguajnë kontribute të sigurimeve shoqërore për ta.

në rrugë, ose jo një vend fiks (punësim i lëvizshëm).<sup>267</sup> Në vitin 2023, në grupmoshën 15 vjeç e lart, 49,0 % e të punësuarve ishin të punësuar me pagë, 29,7 % ishin të vetëpunësuar (punëdhënës ose të vetëpunësuar, pa të punësuar të tjerë) dhe 21,3 % ishin punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes. Gratë kishin 1,4 herë më shumë gjasa sesa burrat për të qenë punëtore pa pagesë në biznesin e familjes. Vlerësimet e marra nga AFP-ja tregojnë se 27,2 % e grave të punësuar dhe 16,3 % e burrave të punësuar janë punëtorë pa pagesë në biznesin e familjes. 25,7 për qind e grave dhe 15 për qind e burrave janë të angazhuar në punë pa pagesë në biznesin e familjes.<sup>268</sup>

Informaliteti mbetet shqetësim në Shqipëri, ku një pjesë e mirë e popullsisë në marrëdhënie pune mbeten jashtë statistikave zyrtare. Në vitin 2023, punësimi informal në sektorin jobujqësor (që përfshin edhe marrëdhëniet e punës gjysmëformale)<sup>269</sup> ishte 26,2 për qind, që shënon një ulje me 2 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2022.<sup>270</sup> Në Shqipëri, mungesa e standardeve të qarta për përkufizimin e punësimit informal vazhdon të pengojë monitorimin e saktë të tij; po kështu, nuk ka të dhëna të disponueshme të ndara sipas seksit. Një numër institucionesh kanë publikuar gjatë viteve përlogaritje të ndryshme të këtyre shifrave, përfshirë edhe lidhur me informalitetin në sektorin e bujqësisë, i cili ende nuk pasqyrohet si duhet në statistikat kombëtare.

Sipas ONP-së, sektorët në të cilët mbizotëron informaliteti janë bujqësia, tregtia me shumicë dhe pakicë, dhe ndërtimi, ku punësimi informal është mbi 84 për qind.<sup>271</sup> Krahas tyre, BE-ja ka ngritur shqetësime edhe për punësimin informal në sektorin e turizmit, që ka pësuar rritje të konsiderueshme vitet e fundit, duke krijuar sfida për përpjekjet që synojnë reduktimin e ekonomisë informale.<sup>272</sup>

Gratë mbizotërojnë në shumicën e sektorëve me shkallë të lartë informaliteti dhe ato nuk përfitojnë mbrojtjet e parashikuara në Kodin e Punës apo përfitime të tjera sociale, si pensioni, sigurimet shëndetësore, pagesat për paaftësi nga sëmundjet, dhe përfitimet në rast lëndimi në punë. Mungesa e mbrojtjes sociale ka pasoja afatgjata, shpesh duke bërë që personat të mbeten në varfëri deri në moshë të thyer për shkak të mospërfitimit të pensionit. Në fakt, në të gjithë botën, numri i grave që përfitojnë pension është më i ulët dhe si rezultat numri i grave të moshuara që jetojnë aktualisht në varfëri është më i madh edhe në vendet me ekonomi të zhvilluar.<sup>273</sup> (Në BE, pensioni mesatar i grave është 29,4 për qind më i ulët se i burrave.)<sup>274</sup> Gratë në punësim informal kanë gjithashtu paga më të ulëta dhe kushte jo të sigurta në punë, përfshirë edhe për shkak të ngacmimit seksual. Gjithashtu, personat që humbasin punën në sektorin informal kanë më tepër gjasa të dalin plotësisht nga forcat e punës sesa të kalojnë në statusin e papunësisë, gjë që ndikon konsiderueshëm në shkallën e inaktivitetit të grave.<sup>275</sup>

Shqipëria ka bërë përpjekje për trajtimin e problemit të informalitetit; megjithatë informacioni për masat specifike të zbatuara dhe efektivitetin e tyre mbetet i kufizuar.<sup>276</sup>

### 3.3.3 Të ardhurat nga punësimi dhe hendeku gjinor në paga

Një zhvillim i rëndësishëm në fushat e marrëdhënieve të punës dhe punësimit është rritja e pagës minimale në 40.000 lekë (e barabartë me 466 USD ose 408 euro) në muaj, një ndryshim i konsiderueshëm i viteve të fundit. Paga mesatare mujore bruto e një punonjësi është

267. INSTAT (2024), "Tregu i punës në Shqipëri, 2023", <https://www.instat.gov.al/media/13552/tregu-i-punes-2023.pdf>

268. Po aty.

269. Rastet kur një pjesë e pagës deklarohet në autoritetet tatimore dhe pjesa tjetër paguhet me para në dorë dhe, rrjedhimisht, nuk deklarohet.

270. Po aty.

271. ONP (2023), "Programi i punës së denjë 2023-2026: Shqipëria" [https://www.ilo.org/sites/default/files/wcmsp5/groups/public/%40europe/%40ro-geneva/%40sro-budapest/documents/genericdocument/wcms\\_865203.pdf](https://www.ilo.org/sites/default/files/wcmsp5/groups/public/%40europe/%40ro-geneva/%40sro-budapest/documents/genericdocument/wcms_865203.pdf)

272. Komisioni i BE-së (2024), "Raporti për Shqipërinë, 2024". Shih: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68\\_en?filename=Shqipëria%20Report%202024.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Shqipëria%20Report%202024.pdf)

273. UN Women (2025), "Gratë në ekonominë informale", <https://www.unwomen.org/en/news/in-focus/csw61/women-in-informal-economy>


274. Eurostat Data Browser (Baza e të dhënave të kërkueshme të Eurostatit) [në internet]. "Hendeku gjinor në pensione sipas grupmoshës". Shih: [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC\\_PNP13\\_\\_custom\\_3335865/default/table?lang=en](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/ILC_PNP13__custom_3335865/default/table?lang=en)

275. ONP (2021). Monitori i ONP-së: "Kovid-19 dhe bota e punës". Botim i tetë. Vlerësime dhe analiza të përditësuara.

276. Komisioni i BE-së (2024), "Raporti për Shqipërinë, 2024". Shih: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68\\_en?filename=Shqipëria%20Report%202024.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Shqipëria%20Report%202024.pdf)

**Figura 10**

**Hendeku gjinor në paga**



Burimi: INSTAT, "Tregu i punës në Shqipëri, 2023"

70.539 lekë (e barabartë me 821 USD ose 719 euro),<sup>277</sup> që përbën një rritje me 14 për qind nga viti 2022.

Nga llogaritja e hendekut gjinor në paga (HGJP), i paponduar – llogaritur në bazë të Anketës së Strukturës së të Ardhurave nga Puna të vitit 2022, ky hendek – i përkufizuar si dallimi midis të ardhurave mesatare bruto për orë të punëtorëve dhe punëtoreve, e shprehur si përqindje e të ardhurave të punëtorëve meshkuj – ishte 6,7 për qind.<sup>278</sup> Duke qenë se ky tregues është nxjerrë nga ASAP, që përdor metodologjinë e Eurostatit, ai është drejtpërdrejt i krahasueshëm me mesataren e BE-së. Bie në sy që HGJP në Shqipëri është shumë më i ulët se mesatarja e BE-së prej 12 për qind.<sup>279</sup> Shtetet anëtare të BE-së nxjerrin çdo vit përllogaritje të HGJP-së për krahasim me shifrat referencë të Anketave të Strukturës së të Ardhurave, ndërsa Shqipëria ende nuk ka filluar ta

zbatojë këtë praktikë. Krahas kësaj, INSTAT-i publikon çdo vit përllogaritjen e HGJP-së bazuar në të dhënat administrative, që në vitin 2023 ishte 6,2 për qind – pothuaj në të njëjtin nivel me vitin 2022, por që shënonte një rritje me 1,7 pikë përqindjeje krahasuar me vitin 2021.<sup>280</sup> Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se këtu nuk janë përfshirë gratë që punojnë në sektorin informal. Këto shifra janë mjaft më të ulëta se mesatarja evropiane prej 13 për qind.<sup>281</sup>

HGJP-ja ndryshon nga sektori në sektor dhe HGJP-ja është në marrëdhënie përpjesëtimore të drejtë me përqindjen e burrave dhe grave të punësuar. HGJP-ja është më e lartë në sektorët ku ka përqendrim më të madh të grave, që pasqyron ndikimin e segregimit horizontal në pagat e grave. Për shembull HGJP-ja është rreth 10,4 për


277. Kjo pagë llogaritet në bazë të listëpagesave të ndërmarrjeve që deklarohen në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për kontribute të sigurimeve shoqërore, shëndetësore, si edhe për tatimin e të ardhurave nga punësimi.

278. [https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START\\_\\_SES\\_\\_SES06/SES0608/table/tableViewLayout1/](https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START__SES__SES06/SES0608/table/tableViewLayout1/)

279. [https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/sdg\\_05\\_20/default/table?lang=en&category=eq.eq\\_labour\\_earn.eq\\_gpgr](https://ec.europa.eu/eurostat/databrowser/view/sdg_05_20/default/table?lang=en&category=eq.eq_labour_earn.eq_gpgr)

280. Po aty.

281. [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/statement\\_23\\_5692](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/statement_23_5692)

**Figura 11****HPGJ sipas aktivitetit ekonomik kryesor**

Burimi: INSTAT, "Tregu i punës në Shqipëri, 2023"

qind—ose 67 për qind më e lartë se mesatarja (6,2 për qind)— në aktivitete si tregtia me shumicë dhe pakicë, transporti dhe magazinimi, dhe shërbimet e hotelerisë dhe ushqimit, ku janë të punësuar 32 për qind e grave; dhe është 8,4 për qind në bujqësi, ku janë të punësuar 37,3 për qind e grave. Nga ana tjetër, HPGJ-ja është nën mesataren në sektorët ku mbizotërojnë meshkujt, si ndërtimi (-6.8 për qind); furnizimi me energji elektrike, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (-3.9 për qind); shërbimet e furnizimit me ujë, të kanaleve të ujërave të zeza, menaxhimit të mbetjeve dhe përmirësimit të mjedisit (-3.7 për qind); dhe në transportim dhe magazinim (-1.8 për qind). Në vitin 2023, HPGJ-ja ishte më e lartë ndër punonjësit e sektorëve të shërbimeve dhe shitjeve (22,7 për qind) ku numri i grave dhe burrave të punësuar ishte i barabartë (19,7 për qind).

Është e rëndësishme të vihet në dukje se HPGJ-ja e Shqipërisë është mjaft e diskutueshme: formula që përdoret për llogaritjet nuk merr parasysh as informalitetin (që është mjaft i lartë në Shqipëri) dhe as faktorë të tjerë si lloji i punësimit, niveli arsimor, statusi martesor, numri i viteve të përvojës në punë, numri i fëmijëve, etj., (faktorë që merren parasysh në përllogaritjen e HPGJ-së së ponderuar), dhe ka mungesa të informacionit për sa i

përket të ardhurave faktike të grave dhe burrave (d.m.th. në bazë të sistemit të listëpagesave plus përfitimeve të tjera) në sektorin publik.<sup>282</sup>

### 3.3.4 Puna e papaguar dhe balanca punë-jetë

Vitet e fundit Shqipëria ka ndërmarrë një varg masash që synojnë trajtimin e problemit të punës së papaguar të përkujdesit dhe të balancimit të punës me jetën familjare, ndër të cilat leja e paguar e barrëindjes (të ardhurat e barrëindjes); e drejta e lejes prindërore për katër muaj, që mund të përdoret njëherazi apo e ndarë deri sa fëmija të mbushë gjashtë vjeç; si dhe leja për mbështetje me shërbim përkujdesi të paguar për personat me aftësi të kufizuara.

Megjithatë, gratë vazhdojnë kenë nivele më të larta inaktiviteti krahasuar me burrat, që në vitin 2023 ishin përkatësisht 30,4 për qind dhe 18 për qind. Gratë ekonomiksht joaktive kanë më tepër gjasa se burrat joaktive që të angazhohen me punë shtëpie dhe përgjegjësi familjare. Në vitin 2023 ende kishte dallime gjinore në ngarkesën me punët e shtëpisë, ku angazhimi i

282. Sigma and OECD (2024). "Administrata publike në Shqipëri". Shih: [https://www.sigmaweb.org/en/publications/public-administration-in-albania-2024\\_5577d117-en.html](https://www.sigmaweb.org/en/publications/public-administration-in-albania-2024_5577d117-en.html)

grave ishte rreth 25 pikë përqindjeje më i lartë.<sup>283</sup> Studimet tregojnë se gratë shpenzojnë 21,74 për qind të kohës gjatë ditës për punë të papaguara si gatimi, pastrimi dhe kujdesi për fëmijët, ndërsa burrat kontribuojnë vetëm 3,47 për qind.<sup>284</sup> Kjo vë në pah angazhimin e vazhdueshëm të grave në punë shtëpie dhe punë të papaguara, pabarazitë gjinore në pjesëmarrje në forcat e punës dhe pengesat e përgjithshme ndaj fuqizimit ekonomik të grave.

Studime të kryera nga organizata ndërkombëtare dhe OSHC kanë mbledhur të dhëna për përfshirjen e grave dhe vajzave në punë përkujdesi të papaguar në familje, duke filluar që në moshë të vogël. Konstatimet e tyre konfirmojnë se gratë dhe vajzat janë shumë më të ngarkuara me punë të papaguar dhe punë të përkujdesit në familje: 67 për qind e vajzave krahasuar me 30 për qind të djemve të moshës 10-14 vjeçare kryejnë punë në shtëpi; në grupmoshën 15-64 vjeç, 95 për qind e vajzave dhe grave krahasuar me 38 për qind të djemve dhe burrave angazhohen në punë shtëpie dhe përkujdesi; ndërsa ndër personat e moshës mbi 65 vjeç, 86 për qind e grave dhe 63 për qind e burrave kryejnë punë shtëpie.<sup>285</sup> Ngarkesa me punë të papaguar përkujdesi dhe papunësia e grave janë të lidhura gjithashtu me disponueshmërinë, përballueshmërinë dhe cilësinë e shërbimeve të kujdesit për fëmijët (kopshte dhe çerdhe). Në Shqipëri janë bërë përpjekje për të rritur numrin e institucioneve parashkollore dhe për të përmirësuar cilësinë e arsimit parashkollor. Megjithatë, kërkesa është më e madhe se kapacitetet ekzistuese, gjë që çon në shpërndarje të pabarabartë të kopshteve dhe çerdheve, ku në disa zona – sidomos zona rurale dhe me shërbime të kufizuara – numri i tyre është i pamjaftueshëm. Krahas kësaj, në kopshte vihet re një ndarje gjeografike dhe sipas grupimeve, ku fëmijët nga komuniteti rom shpesh kanë akses të kufizuar në arsim parashkollor.<sup>286</sup>

Sa i përket balancës punë-jetë, ka një numër studimesh që hedhin dritë mbi vështirësitë e balancimit të punës

dhe jetës dhe përmasat gjinore të këtij problemi. Punonjësit në sektorin privat punojnë me orare shumë më të zgjatura se ata në sektorin publik (65 për qind kundrejt 14 për qind), dhe kanë më shumë gjasa të punojnë edhe të shtunave dhe në ditët e festave publike (37 për qind kundrejt 5 për qind). Edhe më shqetësues është fakti se 29 për qind e punonjësve të sektorit privat nuk kanë të drejtën e lejes vjetore të pushimit. Ndonëse sektori privat ofron pak më shumë fleksibilitet në orarin e punës, të dy sektorët vazhdojnë të jenë përgjithësisht mjaft të ngurtë në këtë drejtim. Në sektorin privat, rreth një ndër tre punonjëse gëzon njëfarë fleksibiliteti në punë, krahasuar me vetëm 7 për qind të grave në sektorin publik. Dallimet midis dy sektorëve janë të dukshme në kushtet e vendit të punës. Punonjëset e sektorit publik shpesh nuk kanë lehtësitë bazë për ngrënie ose shoqërim dhe mund të mos kenë as orar të caktuar për ngrënie e drekës. Në të dy sektorët, shërbimet mbështetëse, si për shembull mjediset e posaçme për ushqyerjen me gji ose për kujdesin për fëmijët janë të rralla. Megjithëse 38 për qind e bizneseve raportojnë se i lejojnë gratë shtatzëna ose ato që kanë fëmijë në gji që të shkëputen nga puna, vetëm 4 për qind ofrojnë mjedise të posaçme për këtë qëllim.

Ndërgjegjësimi dhe zbatimi i politikave që u kushtojnë vëmendje nevojave të familjeve mbeten në nivel të ulët. Vetëm gjysma e bizneseve të anketuara (200 në shkallë kombëtare) kishin dëgjuar për këto politika. Megjithatë ka mbështetje të fuqishme për idenë e angazhimit të qeverisë: 95 për qind e bizneseve besojnë se shteti duhet të ndihmojë të promovojë politika që favorizojnë familjet përmes stimulave tatimorë (79 për qind), ndihmë financiare (65 për qind), fushata ndërgjegjësuere (35 për qind), dhe vendimmarrje përfshirëse (15 për qind).<sup>287</sup>

Pamjaftueshmëria e politikave dhe masave lidhur me balancën punë-jetë-familje ndikon në shëndetin dhe mirëqe-

283. INSTAT (2023), Të dhëna vjetore të tregut të punës ndarë sipas seksit, moshës, nivelit arsimor dhe vitit [https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START\\_TP\\_LFS\\_LFSV/NewLFSY014/](https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START_TP_LFS_LFSV/NewLFSY014/)

284. Studim i OJQ-ve, 2023, bazuar në të dhëna nga "Anketa e përdorimit të kohës", <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2023/06/developing-a-case-for-investing-in-free-universal-childcare-in-albania>

285. UNFPA, "Politikat e dhe dispozitat ligjore në mbështetje të familjes në Shqipëri", shkurt 2021; "Fletë informative: Situata aktuale e barazisë gjinore në Shqipëri", mars 2021; «Analizë e politikave me ndjeshmëri gjinore që mbështetin familjet në Shqipëri», qershor 2021; «Zbatimi i politikave në mbështetje të familjeve dhe barazisë gjinore në sektorin publik dhe privat – perspektiva e biznesit», qershor 2022; «Zbatimi i politikave në mbështetje të familjeve dhe barazisë gjinore në sektorin publik dhe privat – perspektiva e punonjësve», gusht 2022; etj., shih: <https://albania.unfpa.org/sq/publications/zbatimi-i-politikave-miqësore-për-familjen-dhe-barazinë-gjinore-në-sektorin-publik-dh-1>

286. UNICEF, Shqipëri (2023), "Barrierat në ofrimin e arsimit parashkollor në Shqipëri", <https://www.unicef.org/albania/media/6066/file/Supply-side%20barriers%20to%20Early%20Childhood%20Education%20in%20Shqipëria.pdf>

287. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2024), "Vlerësim gjithëpërfshirës kombëtar i zbatimit të Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim, Pekin +30", <https://unece.org/sites/default/files/2024-08/Shqipëria-Report.pdf>

nien e individëve, sidomos të grave. Për shembull, rreth 30 për qind e grave kanë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve të tyre familjare për shkak të orareve të punës, krahasuar me 19 për qind të burrave. Krahas kësaj, 16 për qind e grave përjetojnë irritim, lodhje mendore ose sëmundje të shkaktuara nga puna, krahasuar me 12 për qind të burrave.<sup>288</sup> Reduktimi dhe rishpërndarja e punës së papaguar të përkujdesit dhe punëve të shtëpisë dhe promovimi i balancës punë-jetë-familje trajtohen në strategjitë kombëtare për barazinë gjinore.

Në SKBGJ 2016-2020, reduktimi i punës së papaguar të grave në familje u synua të arrihej përmes rritjes së aksesit në shërbime sociale dhe cilësisë së tyre. Megjithatë, ky objektivi u zbatua vetëm pjesërisht: 57,5 për qind. Ndër veprimet e pazbatuara ishin ofrimi i shërbimeve sociale në qendra komunitare për fëmijët, gratë dhe nënat me aftësi të kufizuara, ato midis moshës së pensionit dhe moshës së thyer, dhe për grupe të tjera, nga organet e vetëqeverisjes vendore.

SKBGJ 2021-2030 përmban një objektivi specifik me masa që fokusohen në ndarjen e barabartë të punës dhe punës së papaguar të përkujdesit në familje, ofrimin e informacionit mbi format e lejes së paguar që ka të drejtë të marrë secili prind, përmirësimin e kornizës ligjore dhe të politikave që lidhen me fleksibilitetin e punës nga shtëpia, dhe lejen prindërore për të dy prindërit.

Një monitorim i vitit 2022 i zbatimit të SKBGJ 2021-2030 tregoi se progresi ka qenë i kufizuar: vetëm 18 për qind e aktiviteteve të planifikuara ishin zbatuar plotësisht, 10 për qind ishin zbatuar pjesërisht, 18 për qind nuk ishin zbatuar, ndërsa për 54 për qind të aktiviteteve, institucionet përgjegjëse nuk kishin dhënë asnjë informacion. Në përgjithësi, është e rëndësishme që objektivat që lidhen me ekonominë e përkujdesit në kuadër të SKBGJ 2021-2030 të integrohen plotësisht në politikat e punësimit dhe të mbrojtjes sociale, me koordinim ndërsektorial dhe alokim buxheti, sidomos në nivel vendor.

### 3.3.5 Diskriminimi në punë

Diskriminimi me bazë gjinore i grave në vendin e punës mbetet një problem kompleks dhe me rrënjë të thella, që shpesh e ka burimin tek stereotipet gjinore që vazhdojnë të ekzistojnë dhe në rolet tradicionale që konceptohen se duhet t'i kryejnë gratë si nëna dhe kujdestare kryesore. Ky diskriminim shfaqet si në mënyrë të drejtpërdrejtë ashtu edhe të tërthortë në të gjitha nivelet e punësimit, që nga aplikimi për punë dhe rekrutimi, deri tek ngritja në përgjegjësi dhe avancimi në karrierë. Një shqetësim kyç është hendeku gjinor në paga që vazhdon të jetë i pranishëm – gratë shpesh fitojnë më pak se burrat për punë me vlerë të barabartë. Krahas kësaj, ngacmimi në punë – sidomos ngacmimi seksual – vazhdon të jetë një nga format më të rënda të diskriminimit me bazë gjinore në vendin e punës. Kuadri ligjor përkatës i Shqipërisë është përmirësuar konsiderueshëm.

Në të përfshihet Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” (2008), Kodi i Punës (1995) dhe ndryshimet e rëndësishme që iu bënë atij në vitin 2015, dhe Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” (2010) dhe me ndryshimet kyçe të tij në vitin 2020. Shqipëria është palë në traktatet kryesore të ONP-së që trajtojnë diskriminimin në vendin e punës, ndër të cilat Konventa nr. 190 e ONP-së mbi Eliminimin e Dhunës dhe Ngacmimit në Botën e Punës (2022).<sup>289</sup> Megjithatë, është e nevojshme që të bëhet një rishikim i legjislacionit kombëtar për të siguruar që ai të jetë i harmonizuar me standardet ndërkombëtare, sidomos me legjislacionin e BE-së kundër diskriminimit.

Me gjithë përmirësimet në aspektin e legjislacionit, gratë ende përballen me diskriminim në të gjithë sektorët dhe hasin pengesa të shumta në sigurimin e barazisë së mundësive dhe të trajtimit në punësim. Masat ligjore dhe politike që janë ndërmarë nuk duket se kanë arritur ndikimin e dëshiruar. Për shembull, lista e punëve të ndaluara për gratë (Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 207 i vitit 2002) nuk reflekton zhvillimet në shkencë ose parimin e barazisë gjinore.<sup>290</sup> Gjithashtu, nuk janë të disponueshme të dhënat zyrtare se sa të përhapur janë diskriminimi dhe ngacmimi gjinor në vendin e punës, dhe

288. Projekt-dokument politikash për krijimin e një kuadri rregullator të punës: rekomandime për përmirësimet për krijimin e një mjedisi pune që mbështet familjet në tregun e punës, UNFPA, Shqipëri, 2023 (draft).

289. Traktate të tjera relevante të ONP-së në të cilat Shqipëria është palë janë Konventa mbi Diskriminimin në Fushën e Punësimit dhe Profesionit (nr. 111); Konventa për Punëtoret me Përgjegjësi Familjare (nr. 156); dhe Konventa për Mbrojtjen e Amësisë (nr. 183).

290. Ekipi i OKB-së në Shqipëri (2024), Kontributi në kuadër të Rishikimit Periodik Universal për Shqipërinë, <https://www.ohchr.org/en/hrbodies/upr/al-un-contributions-s47>

**Tabela 4**

**Çështjet e shqyrtuara nga Komisioneri për Mbrojtje nga Diskriminimi**

Viti	Numri total çështjeve të shqyrtuara	Numri total i çështjeve që lidhen me diskriminimin me bazë gjinore të shqyrtuara nga KMD (të gjitha fushat)	Numri total i rasteve të diskriminimit në punë për arsye të ndryshme të shqyrtuara nga KMD	Numri total i rasteve të diskriminimit me bazë gjinore në punë	Numri total i çështjeve ex officio të iniciuara nga KMD (të gjitha fushat)
2020	226	7	127 (56%)	7	13
2021	324	15	168 (52%)	15	22
2022	297	7	140 (47%)	7	16
2023	359	11	144 (40%)	No ka informacion	15
2024	380	16	149 (38/9%)	No ka informacion	13

Burimi: Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), Raporte vjetore, 2020, 2021, 2022, 2023<sup>293</sup>

në vend të tyre burimi kryesor i të dhënave janë OSHC-të. Sipas një anketimi të OSHC-ve të vitit 2022, rreth 20 për qind e burrave dhe grave të anketuara raportuan se kishin përjetuar diskriminim gjinor në punë. Numri i grave që raportuan se kishin pasur përvoja me pyetje intervistash që mund të nënkuptonin diskriminim, si pyetje për plane për martesë, ishte më i madh se i burrave (45 për qind kundrejt 35 për qind). 13 për qind e grave shtatzëna nuk kishin përfituar lejen e barrë lindjes dhe 40 për qind thanë se u ishte bërë presion që të ktheheshin në punë më herët se ishte planifikuar.

Për sa i përket ngacmimit seksual, 23 për qind e të anketuarve kishin qenë dëshmitarë të të paktën një forme ngacmimi seksual, pa ndonjë dallim të madh midis gjinive. Numri i të anketuarve që identifikuan burrat si autorë të ngacmimit seksual ishte mjaft i lartë (ndër gratë që kishin përjetuar ngacmim seksual, 72 për qind thanë se autori ishte burrë, ndërsa në 24 për qind të rasteve autorët e raportuar të ngacmimit ishin edhe burra, edhe gra).<sup>291</sup>

Megjithatë, niveli i raportimit të rasteve të diskriminimit me bazë gjinore tek autoritetet, si për shembull tek Komisioneri për Mbrojtje nga Diskriminimi (KMD) dhe Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve

(ISHPSHSH) mbetet i ulët. Gjithashtu, të dy këto institucione tregojnë nivel të kufizuar të angazhimit proaktiv, me një numër të vogël hetimesh *ex officio* të iniciuara nga KMD dhe me numër minimal inspektimesh të ISHPSHSH-së me fokus specifik rastet e diskriminimit me bazë gjinore.

Sipas raporteve vjetore të KMD-së, numri i rasteve të raportuara të diskriminimit me bazë gjinore që i janë raportuar ka vazhduar të jetë shumë i ulët ndër vite, në raport me numrin e përgjithshëm të ankesave. Kjo mbështetet edhe nga rezultatet e vrojtimeve të përmendura më lart, sipas të cilave pothuaj 70 për qind e personave që kishin përjetuar diskriminim me bazë gjinore nuk e kishin raportuar atë në asnjë institucion.<sup>292</sup> Ndër vite, pothuaj të gjitha ankesat në KMD dhe vendimet e KMD-së mbi diskriminimin me bazë gjinore kanë qenë të lidhura me punën dhe punësimin, si pushimi i padrejtë nga puna, trajtimi i padrejtë, ngacmimi seksual dhe pengim të progresit në karrierë. Vetëm në vitin 2023 KMD-ja mori në shqyrtim edhe një numër të vogël rastesh që lidheshin me diskriminimin me bazë gjinore në fusha të tjera, që lidheshin me përfitimin e strehimit social, trajtimin nga forcat e policisë, dhe gjuhën e urrejtjes. Megjithatë, të dhënat e ndara sipas seksit për raste specifike nuk janë të disponueshme.

291. Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Shqipëri (2022), "Diskriminimi me bazë gjinore dhe puna në Shqipëri", botim i dytë, [https://www.gadc.org.al/media/files/upload/GBD%20in%20Labour%20Shqipëria\\_EN\\_15.03.2022.pdf](https://www.gadc.org.al/media/files/upload/GBD%20in%20Labour%20Shqipëria_EN_15.03.2022.pdf)

292. Po aty.

Ndonëse ende ekziston nevoja që të kryhen analiza të detajuara, numri i kufizuar i rasteve që raportohen tek autoritetet mund të jetë për shkak të ndërgjegjësimit të kufizuar të grave, profesionistëve në fushën e ligjit dhe të shoqërisë civile lidhur me mekanizmat e ankimit dhe rekursit, por edhe për shkak të paqartësive për procedurat që duhen ndjekur në rastet e diskriminimit me bazë gjinore. Gjithashtu, ashtu si në fusha të tjera, gratë përballen me barriera në akses në drejtësi, si vështirësitë në sigurimin e ndihmës juridike, me gjithë faktin që viktimat e diskriminimit kanë të drejtën e ndihmës juridike falas, në bazë të Ligjit "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti". Në veçanti, gratë nga grupet e pafavorizuara përballen me forma të shumëfishta të diskriminimit në vendin e punës dhe, për këtë arsye, nevojiten masa specifike që trajtojnë me përparësi informimin dhe aksesin në drejtësi të këtyre grupeve.

Po kështu, janë të kufizuara të dhënat e ndara sipas seksit për sa i përket ankesave, hetimeve ose dënimeve të dhëna nga ISHPSHSH, i vetmi organ administrativ i ngarkuar me ligj për kontrollimin dhe garantimin e zbatimit të masave të barazisë gjinore në lidhje me marrëdhëniet e punës, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, dhe sigurinë në punë. Organet mbikëqyrëse të ONP-së kanë ngritur shqetësime në lidhje me mandatin e përgjithshëm dhe burimet në dispozicion të ISHPSHSH-së për sigurimin e respektimit faktik të legjislacionit të punës.<sup>293</sup>

Pas ratifikimit të Konventës 190 të ONP-së mbi Eliminimin e Dhunës dhe Ngacmimit në Botën e Punës, po bëhen përpjekje për zbatimin e standardeve të saj në vendin e punës. Në vitin 2023, ISHPSHSH dhe KMD shtuan bashkëpunimin mes tyre për identifikimin e rasteve të dhunës dhe ngacmimit në botën e punës. Numri i ankesave që paraqiten në ISHPSHSH lidhur me diskriminimin me bazë gjinore në vendin e punës është i vogël dhe dispozitat ligjore që trajtojnë ngacmimin seksual janë të paqarta për sa i përket elementëve të barrës së provës dhe dashjes.<sup>294</sup>

### 3.3.6 Gratë në ekonominë rurale

Gratë në zonat rurale janë mjaft të angazhuara në punë të rënda fizike në bujqësi dhe tradicionalisht kanë qenë ndër grupet më të pafavorizuara në Shqipëri. Në vitin 2023, 37,3 për qind e grave në forcat e punës punonin në bujqësi, krahasuar me 27,9 për qind të burrave.<sup>295</sup> Në vitin 2022 u miratua Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit (SBZHRD) 2021-2027, e cila synonte të trajtonte disa nga dallimet kryesore gjinore. Një nga objektivat e SBZHRD-së është që të promovojë zhvillimin në nivel vendor përmes mundësive të punësimit dhe biznesit, në ferma dhe jashtë tyre, si dhe përmes nismave zhvillimore në komunitet. Në këtë kontekst, SBZHRD-ja përfshin mbështetjen e grave dhe burrave fermerë, sidomos të rinjve dhe të rejave në zonat rurale, në krijimin dhe zhvillimin e bizneseve bujqësore. Krahas kësaj, fuqizimi dhe i përmirësimi i shërbimeve për gratë e zonave rurale është aspekt qendror i SKBGJ-së 2021-2030 dhe Planit të saj të Veprimit.

Nuk ka informacion për ecurinë e zbatimit të SBZHRD-së, por monitorimi i zbatimit të SKBGJ-së 2021-2030 në vitin 2022, tregoi se janë kryer një numër aktivitesh ndërgjegjësuere dhe trajnuese me gra dhe vajza në zonat rurale.

Me gjithë këto përpjekje, gratë në zonat rurale përballen me vështirësi më të mëdha për të pasur akses dhe për të përfituar nga tregu i punës. Paga mesatare mujore e tyre prej 44.304 lekë (e barabartë me 516 USD ose 452 euro) në vitin 2023 është më e ulët se e grave të punësuar në sektorë të tjerë (dhe afër pagës minimale), dhe HGJP-ja është 8,4 për qind, nga 7,6 për qind që ishte në vitin 2022.<sup>296</sup> Në vitin 2023, numri i fermerëve të regjistruar ishte 96.440, që përbënte një rritje prej 14,3 për qind krahasuar me fundin e vitit 2022. Megjithatë, vetëm 11,2 për qind e pronarëve/administratorëve të fermave ishin gra, një rritje e lehtë nga 10,8% në vitin 2022.<sup>297</sup>

Sikurse është vënë në dukje më parë, bujqësia është një prej sektorëve me nivelet më të larta të punësimit informal, ku gratë janë tejet të përfaqësuara forcat e punës në sektor dhe dominojnë në kategorinë e punëtoreve të papaguara në familje. Në bujqësi punësohen rreth

293. ONP CEACR, 2023. Vrojtim dhe kërkesë direkte në lidhje me Konventën e Inspektimit të Punës 1947, nr. 81.

294. Ekipi i OKB-së në Shqipëri (2024), Kontributi në kuadër të Rishikimit Periodik Universal për Shqipërinë. Shih: <https://www.ohchr.org/en/hr-bodies/upr/al-un-contributions-s47>

295. INSTAT (2024), "Tregu i punës në Shqipëri, 2023". Shih: <https://www.instat.gov.al/media/13552/tregu-i-punes-2023.pdf>

296. INSTAT (2024), "Tregu i punës në Shqipëri, 2023". Shih: <https://www.instat.gov.al/media/13552/tregu-i-punes-2023.pdf>

297. INSTAT (2024), "Regjistri i biznesit në Shqipëri, 2023", <https://www.instat.gov.al/media/13413/regjistrat-e-biznesit-2023.pdf>

37,3 për qind e të gjitha grave ekonomisht aktive dhe, sipas Organizatës së Bujqësisë dhe Ushqimit, 87 për qind e tyre janë të angazhuara si punëtore informale ose në familje.<sup>298</sup> Në vitin 2023, 27,2 për qind e grave të punësuar merrnin pjesë në tregun e punës si punëtore të papaguara në biznesin e familjes.<sup>299</sup>

Gratë në zonat rurale shpesh përballen me disavantazhe të shumëfishta për shkak të mungesës së kohës dhe kufizimeve në mundësitë e lëvizjes, që çon në kapital më të ulët njerëzor dhe akses të kufizuar në teknologji krahasuar si me gratë në zonat urbane, ashtu edhe me burrat në zonat rurale.<sup>300</sup> Një auditim në lidhje me barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në zonat rurale i kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit në 13 bashki, konstatoi se programet për promovimin e punësimit të zbatuara nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) në periudhën 2020-2023, ishin me natyrë të përgjithshme dhe nuk fokusoheshin specifikisht tek gratë, sidomos tek gratë rurale.<sup>301</sup> Ndonëse këto programe u hartuan për t'u zbatuar në nivel kombëtar dhe me synimin e përfitimit të grupeve të pafavorizuara, nuk ka tregues për shtrirjen apo ndikimin e tyre në zonat rurale. Po kështu, përqendrimi i qendrave për formim profesional dhe i shkollave të mesme me orientim bujqësor në qendra urbane kufizon më tej aksesin e grave dhe vajzave nga zonat rurale në mundësi ekonomike dhe nisma sipërmarrjesh rurale. Vihet në dukje se raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit konstatoi se gjatë periudhës së raportit, në kurset e formimit profesional nuk kishte marrë pjesë asnjë grua ose vajzë.<sup>302</sup>

Për sa u përket shërbimeve këshillimore rurale, ndonëse qeveria njihet zyrarisht rolin e grave në zhvillimin e qëndrueshëm të zonave rurale, në praktikë, gratë kanë

mundësi të kufizuara për akses në informacion teknik dhe për të përmirësuar aftësitë, njohuritë dhe përvojat e tyre. Politikat për konkurrueshmërinë dhe modernizimin në bujqësi nuk i kushtojnë vëmendje potencialit sipërmarrës të grave, ndonjëherë duke njohur rolin e tyre vetëm në disa produkte specifike, përpunim bujqësor, ose aktivitete të tjera që nuk lidhen me veprimtarinë bujqësore. Këshilltarët bujqësorë në terren, të cilët janë kryesisht burra, shpesh përdorin kanale komunikimi dhe informimi të dominuar nga meshkujt për të kontaktuar fermerët dhe për të marrë mendimet e tyre. Ky hendek gjinor në informacion pasqyrohet edhe në të dhënat nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, që tregojnë se vetëm rreth 11 për qind e grave në zonat rurale marrin informacion bujqësor. Në vend të këtyre shërbimeve, gratë në zonat rurale shpesh mbështeten në ofruesit privatë të shërbimeve ose OSHC-të, të cilët u përshtaten më mirë nevojave të tyre për njohuri dhe kohës së kufizuar të tyre.<sup>303</sup> Angazhimi i grave në shërbimet këshillimore bujqësore është gjithashtu i kufizuar për shkak të detyrimeve familjare dhe normave patriarkale. Sipas një studimi në disa zona të Shqipërisë, rreth 63 për qind e të anketuarve mendonin se ishte më e përshtatshme që në shërbimet këshillimore dhe trajnuese të merrte pjesë kryefamiljari – zakonisht burrë, ndërsa vetëm 29 për qind mendonin se ishte e përshtatshme që në to të merrnin pjesë gratë (zakonisht bashkëshortet).<sup>304</sup>

Gjithashtu, numri i grave sipërmarrëse në zonat rurale është shumë i kufizuar. Të dhënat e kohëve të fundit tregojnë se në vitin 2022, bizneset me pronare ose administratore gra në bujqësi, pylltari dhe peshkim përbënin vetëm 18,5 për qind të numrit të bizneseve, krahasuar me 81,5 për qind të atyre me pronarë ose

298. FAO dhe UN Women. 2024. Për forcimin e statusit të bashkëshorteve dhe partnereve në bizneset bujqësore në Shqipëri. Dokument politikash. Budapest. Shih: <https://doi.org/10.4060/cd3392en>

299. INSTAT (2023), "Anketa e forcave të punës". Shih: <https://www.instat.gov.al/media/14273/tregu-i-punes-2023.pdf>

300. Instituti i Statistikave, Instituti i Shëndetit Publik dhe ICF. 2018. "Studimi demografik dhe shëndetësor në Shqipëri 2017-2018". Tiranë, Shqipëri: Instituti i Statistikave, Instituti i Shëndetit Publik dhe ICF.

301. Berati, Dibra, Kruja, Elbasani, Lushnja, Gjirokastra, Pogradeci, Lezha, Shkodra, Kavaja, Vlora, Kukësi dhe Divjaka, me gjithsej 116 njësi administrative vendore.


302. Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe UN Women (2024), "Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes në tregun e punës – raport final i auditimit të performancës". Shih: <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2024/06/gender-equality-and-the-empowerment-of-rural-women-through-labor-market-involvement-final-performance-audit-report>; [https://eca.unwomen.org/sites/default/files/2024-12/en\\_joint-report\\_cooperative-performance-audit\\_web.pdf](https://eca.unwomen.org/sites/default/files/2024-12/en_joint-report_cooperative-performance-audit_web.pdf)

303. FAO and UN Women. 2024. "Drejt shërbimeve reaguese gjinore të ekstensionit bujqësor në Shqipëri – Raport vlerësimi." Budapest. Shih: <https://doi.org/10.4060/cc7701en>

304. World Vision Shqipëri (2023), "Edukimi financiar dhe zhvillimi i kapaciteteve të fermerëve". Shih: [https://worldvision.al/wp-content/uploads/2023/08/2022.05\\_Edukimi-financiar-i-fermevere-dhe-zhvillimi-i-kapaciteteve.pdf](https://worldvision.al/wp-content/uploads/2023/08/2022.05_Edukimi-financiar-i-fermevere-dhe-zhvillimi-i-kapaciteteve.pdf)

**Figura 12**

**Ndërmarrjet aktive sipas madhësisë dhe seksit të administratorit**



Burimi: INSTAT, "Regjistri i biznesit në Shqipëri, 2023"

drejtues burra.<sup>305</sup> Rol në këtë drejtim luajnë pabarazitë në akses në kredi, si dhe fakti që titujt e pronësisë mbi tokën vazhdojnë të jenë në pjesën më të madhe në emrin e "kryefamiljarit" (zakonisht bashkëshorti, vjehri, vëllai, babai ose gjyshi). Kjo kufizon të drejtat e grave mbi burimet prodhuese, si e drejta për regjistrimin e biznesit dhe e drejta për të përfituar nga kreditë dhe shërbimet këshillimore bujqësore, dhe gjithashtu kufizon mundësitë e tyre për t'u larguar nga një marrëdhënie e dhunshme.<sup>306</sup> (Për më tepër lidhur me pronësinë mbi tokën, shih seksionin më poshtë.)

Në përgjithësi, statusi ekonomik dhe shoqëror i grave në zonat rurale nuk është i tillë që të mbështesë përfshirjen sociale dhe fuqizimin e tyre. Shkalla e varfërisë është më e lartë në zonat rurale, ku mundësitë e punësimit janë të kufizuara. Migracioni i formave të ndryshme ka pasur ndikim negativ të ndjeshëm në zonat rurale, të cilat janë shpopulluar dhe kanë humbur një varg

shërbimesh sociale, si çerdhe, kopshte, shërbimet e transportit dhe ato shëndetësore, duke i lënë gratë në zonat rurale pa këto shërbime. Sipas Komisionit të Lartë të Shtetit, numri i çerdheve dhe kopshteve nuk është në përpjesëtim të drejtë me njësitë administrative rurale dhe ato urbane, sipas secilës bashki.<sup>307</sup> Në rekomandimet e vitit 2023 drejtuar Shqipërisë, Komiteti i KEGJFDG-së ngriti shqetësimin për aksesin e kufizuar të grave rurale në përfitime ekonomike dhe sociale në Shqipëri, si dhe barrierat e tyre në arritjen e pjesëmarrjes së plotë në jetën ekonomike.<sup>308</sup>

### 3.3.7 Sipërmarrja e grave dhe aksesin në mundësi financimi

Kohët e fundit, Shqipëria ka bërë përpjekje për mbështetjen e sipërmarrjeve të grave. Pritet të miratohet një strategji e posaçme për këtë qëllim, e cila synon të

305. INSTAT (2023). "Gratë dhe burrat në Shqipëri, 2023". Shih: <https://www.instat.gov.al/media/12598/burra-dhe-gra-2023.pdf>

306. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2024). "Vlerësim gjithëpërfshirës kombëtar i zbatimit të Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim, Pekin +30". Shih: <https://unece.org/sites/default/files/2024-08/Shqipëria-Report.pdf>

307. Komisioni i Lartë i Shtetit dhe UN Women (2024), "Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nga zonat rurale përmes përfshirjes në tregun e punës – raport final i auditimit të performancës". Shih: <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2024/06/gender-equality-and-the-empowerment-of-rural-women-through-labor-market-involvement-final-performance-audit-report>; Po aty.

308. KEDG 2023.

**Tabela 5**

**Ndërmarrjet aktive sipas seksit të pronarit/administratorit dhe aktivitetit ekonomik, në përqindje**

Aktiviteti ekonomik	2020		2021		2022		2023	
	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra
Gjithsej	66.8	31.4	68.9	31.1	68.8	31.2	68.8	31.2
Prodhuesit e të mirave	83.1	16.9	83.0	17.0	82.8	17.2	82.9	17.1
Bujqësia, pyjet dhe peshkimi	82.3	17.7	82.9	17.1	81.5	18.5	81.8	18.2
Industria	79.4	20.6	79.0	21.0	78.9	21.1	78.8	21.2
Ndërtimi	90.2	9.8	89.5	10.5	88.8	11.2	88.8	11.2
Prodhuesit e shërbimeve	66.3	33.7	66.7	33.3	66.6	33.4	66.6	33.4
Tregtia	65.0	35.0	65.7	34.3	65.8	34.2	66.1	33.9
Transporti dhe magazinimi	93.4	6.6	93.1	6.9	91.9	8.1	91.9	8.1
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	71.0	29.0	71.4	28.6	71.6	28.4	71.3	28.7
Informacioni dhe komunikimi	75.1	24.9	75.5	24.5	74.6	25.4	75.0	25.0
Shërbime të tjera	59.4	40.6	59.9	40.1	59.8	40.2	59.5	40.5

Burimi: INSTAT, "Burra dhe gra në Shqipëri, 2023"

mbështesë sipërmarrjet e grave dhe të vajzave. Nisma të tjera përfshijnë krijimin e bizneseve të reja dhe fuqizimin e grave sipërmarrëse, që rrisin pavarësinë e tyre ekonomike dhe pakësojnë varësinë nga burime të tjera të ardhurash, duke mundësuar kështu që gratë të kenë më shumë kontroll mbi jetën dhe familjet e tyre. Në të ardhmen, Shqipëria planifikon të promovojë krijimin e programeve dhe politikave që shtojnë aksesin e grave në fonde, grante dhe kredi.<sup>309</sup>

Në vitin 2023 në Shqipëri kishte 130.338 sipërmarrje aktive, që përbënte një rritje prej 4,1 për qind nga viti 2022. Pjesa më e madhe e tyre – 85,9 për qind – ishin ndërmarrje të vogla me 1 deri 4 punëtorë. Gratë ishin pronare ose administratore të 31,2 për qind të të gjitha

ndërmarrjeve aktive, një shifër që ishte e njëjtë me atë të vitit 2022. Megjithatë, gratë kryesisht drejtojnë ndërmarrje të vogla dhe më pak se një të katërtën e ndërmarrjeve të mesme të mëdha (shih figurën 12). Numri më i madh i grave në role vendimmarrëse është i përqendruar në aktivitetet e shitjeve (33,9 për qind) dhe shërbime të tjera (40,5 për qind). Gratë përbëjnë 47 për qind të punësimit total në bizneset e regjistruara. Numri i bizneseve me pronare ose administratore gra është më i madh në sektorin e shërbimit, sesa në sektorin prodhues, përkatësisht 33,4 për qind dhe 17,2 për qind.<sup>310</sup> Sipas një analize të kohëve të fundit të 50 kompanive që gjenerojnë më shumë të ardhura në Shqipëri, gratë mbajnë vetëm 17% të vendeve në bordet drejtuese (25 nga 147)

309. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (2024), "Vlerësim gjithëpërfshirës kombëtar i zbatimit të Deklaratës së Pekinit dhe Platformës për Veprim, Pekin +30". Shih: <https://unece.org/sites/default/files/2024-08/Shqipëria-Report.pdf>

310. INSTAT, "Burra dhe gra, 2023", f. 106. Shih: <https://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2023/burra-dhe-gra-2023/>

dhe 22% të roleve drejtuese ekzekutive ose si administratore të larta (16 nga 73). Nga shtatë kompani që kanë kryetar bordi të emëruar, tre janë gra, dhe përfaqësimi i tyre në rolin e drejtorit jo-ekzekutiv mbetet i ulët, me prani minimale në korporatat e mëdha.<sup>311</sup> Po kështu, përfaqësimi i grave në bordet e korporatave në Shqipëri vazhdon të jetë shumë më i ulët se sa kuota gjinore prej 40% e përcaktuar në politikat e BE-së. Është nevojë urgjente që të përshpejtohet progresi drejt barazisë gjinore në sferën e drejtimit të korporatave.

### Avancimi i barazisë gjinore në role drejtuese në sektorin privat

Qeveria shqiptare ka filluar të ndërmarrë hapa për përmirësimin e barazisë gjinore në drejtimin e sektorit privat, si pjesë e angazhimit të përgjithshëm të saj në kuadër të integritimit evropian. Ndonëse legjislacioni dhe institucionet ekzistuese janë ende mbrapa në këtë drejtim, janë krijuar mekanizma të reja për nxitjen e sektorit privat që t'u përmbahet udhëzimeve gjinore ndërkom-bëtare. Në këtë kontekst, Parimet e Fuqizimit të Grave (PFP) ofrojnë një tjetër kornizë, me pjesëmarrje vullnetare, që nxit kompanitë të zbatojnë qasje përgjigjëse gjinore në vendin e punës, treg, dhe shoqëri.

Ndonëse PFP-të<sup>312</sup> mbështeten nga donatorët dhe nuk janë të detyrueshme me ligj, ato po shihen gjithnjë e më shumë si një mjet i rëndësishëm për përgatitjen e sektorit privat për përmbushjen e kërkesave ligjore të BE-së, sidomos ato të kodifikuara në Direktivën (BE) 2022/2464 për Raportimin e Korporatave lidhur me Qëndrueshmërinë. Direktiva kërkon nga bizneset që të bëjnë të ditur publikisht të dhëna lidhur me barazinë gjinore, shpërblimin e drejtë, diversitetin në poste drejtuese, dhe matje të tjera të qëndrueshmërisë sociale. Zbatimi i PFP-ve lehtëson krijimin e strukturave të brendshme dhe kërkesave për raportim, që të jenë të harmonizuara me këto kërkesa rregullatore të së ardhmes. Numri i kompanive që kanë nënshkruar angazhimin e tyre për zbatimin e këtyre parimeve është rritur ndjeshëm në Shqipëri: nga vetëm 11 kompani në vitin 2021 në 75

kompani deri në 2024, çka demonstroi ndërgjegjësimin në rritje të korporatave për përgjegjësitë e tyre në lidhje me barazinë gjinore. Krahas rritjes numerike, në Tiranë janë organizuar edhe nisma si EXPO 2023 dhe EXPO 2024 për sipërmarrjet e grave, me pjesëmarrjen e kompanive nënshkruese të PFP-ve, grave sipërmarrëse, institucioneve publike dhe partnerëve ndërkombëtarë për diskutimin e mekanizmave financues dhe zhvillimin e bizneseve përfshirëse. Këto platforma kanë ndihmuar mbi 80 gra sipërmarrëse që të përmirësojnë aksesin e tyre në rrjete investitorësh dhe biznesesh, çka kontribuon më tej në rritje ekonomike me përfshirje gjinore. Ndryshimet sistemike kërkojnë më shumë ndërhyrje nga shteti. Kjo kërkon vendosjen e detyrimit që bizneset të raportojnë për aspektet gjinore, të përfshijnë gjininë në dialogun publik-privat, dhe të sigurojnë që reformat në sektorin privat, që kërkojnë sipas *acquis*-it të BE-së, të trajtojnë shprehimisht barazinë gjinore në përputhje me kapitujt 23 dhe 24 dhe kornizën për Raportimin e Korporatave lidhur me Qëndrueshmërinë.

Në vitin 2022, 56,5 për qind e huamarrësve nga bankat private ishin burra, ndërsa 43,5 për qind ishin gra. Ndonëse nuk ka të dhëna të disponueshme të ndara sipas seksit për huatë dhe kreditë, apo për kreditë e buta të marra nga bizneset, studimi nga një OSHC i botuar në vitin 2023 tregon se më shumë se gjysma e grave sipërmarrëse (53,9 për qind) përdorën kursimet e familjes si burim kryesor financues për themelimin, regjistrimin ose fillimin e biznesit. Vetëm një ndër dhjetë gra sipërmarrëse kishin marrë financim nga bankat tregtare dhe shtatë nga dhjetë gra sipërmarrëse thanë se nuk kishin bërë asnjëherë kërkesë për të marrë hua ose kredi nga bankat për bizneset e tyre.<sup>313</sup> Studime të tjera tregojnë se shumë gra nuk kishin kapitalin e nevojshëm për të investuar në biznesin e tyre, duke bërë që të mbështeteshin në kursimet personale, hua nga familja dhe, në disa raste, kryerjen e disa punëve njëherazi për të kursyer fondet e nevojshme. Krahas këtyre, refuzimi i kredive për biznesin dhe mungesa e një sistemi të përshtatshëm tatimor pengoi rritjen e bizneseve të tyre.<sup>314</sup>

311. Gratë në Borde, Shqipëri (2024). Shih: <https://wobal.org/advancing-women-in-corporate-leadership-wob-al-index-next-steps/>

312. UN Women, Shqipëri po mbështet punën me bizneset dhe korporatat për nënshkrimin e Parimeve të Fuqizimit të Grave dhe aktivitete të tjera për zbatimin e këtyre parimeve.

313. Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, GADC (2023), "Vlerësimi i mjedisit për sipërmarrjen e grave në Shqipëri: Një vëzhgim mbi sipërmarrjen e grave në Shqipëri", <https://www.gadc.org.al/media/files/upload/Study%20women%20in%20business.pdf>

314. UNDP 2023, "Një përshkrim i shkurtër lidhur me gratë në ekonomitë në Ballkanin Perëndimor". Shih: <https://www.undp.org/montenegro/publications/women-western-balkan-economies-nutshell#:~:text=Around%20the%20Western%20Balkans%20region,in%20the%20labour%20market%20remain>

Si element pozitiv, gratë përbënin shumicën e përfituesve nga skemat mbështetëse të kohëve të fundit në kuadër të Fondit të Ekonomive Kreative dhe Fondit Shqiptar në Mbështetje të Sipërmarrjeve të Reja, me përkatësisht 80 për qind dhe 78,9 për qind të përfituesve. Në vitin 2019, gra përbënin 56 për qind të përfituesve të skemave të tjera mbështetëse të Agjencisë Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve. Megjithatë, gjatë periudhës 2020-2022, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve nuk aplikoi skema ose investime mbështetëse.<sup>315</sup>

Agjencitë e OKB-së të angazhuara në fushat e zhvillimit të infrastrukturës dhe projekte të ndërtimit kanë vërejtur se pjesëmarrja e grave në këta sektorë në Shqipëri mbetet e kufizuar, kryesisht për shkak të normave gjinore ekzistuese dhe mungesës së ndërhyrjeve të posaçme reaguese gjinore. Megjithatë, në projektet ku këto strategji janë integruar – si për shembull në nismat e rekrutimit, trajnimet e specializuara dhe mentorimet për gratë në ndërtim dhe planifikim urban – ka pasur përmirësime të konsiderueshme në përfshirjen dhe rolin drejtues të grave.<sup>316</sup>

Në përgjithësi, ka shumë nevojë për nisma për ngritjen e kapaciteteve që integrojnë aftësitë tradicionale, si ato artizanale, me praktikatat moderne të biznesit – sidomos në fusha si marketimi digjital, krijimi dhe prezantimi i produkteve dhe menaxhimi financiar. Këto ndërhyrje jo vetëm që do të shtojnë qëndrueshmërinë e bizneseve por edhe do t'i ndihmojnë gratë sipërmarrëse t'i zgjerojnë bizneset e tyre në mënyrë të efektshme. Për të siguruar që ndikimi të jetë afatgjatë, është po aq e rëndësishme të krijohen mekanizma të qëndrueshëm për transferimin e njohurive që fuqizojnë brezat e ardhshëm të grave sipërmarrëse.

### 3.3.8 Aksesi në arsim

Shqipëria ka bërë përparim në vite për sa i përket arsimit të vajzave dhe grave. Të dhënat e Censit të fundit të popullsisë tregojnë se ndër personat me arsim të lartë 55,7 për

qind janë femra dhe 44,3 për qind janë meshkuj. Përqindja e femrave që përfundojnë arsimin universitar është rritur vazhdimisht – nga 41,1 për qind në Censin e vitit 2001 në 51,0 për qind në vitin 2011, dhe 55,7 për qind në vitin 2023. Me gjithë progresin e bërë, modelet e gjinorizuara vazhdojnë të ekzistojnë, me ndarje të qartë horizontale në arsimin e lartë. Në vitin shkollor 2023-2024, vajzat përbënin 58,4 për qind të numrit të studentëve.<sup>317</sup> Fushat e studimit më të ndjekura nga vajzat janë pedagogjia (82,6 për qind), shëndetësia dhe mirëqenia (78,1 për qind) dhe shkencat shoqërore (78,4 për qind).<sup>318</sup> Megjithëse numri i vajzave që mbarojnë studimet universitare është më i lartë se i djemve, jo të gjitha hyjnë në forcat e punës dhe shpesh punët që bëjnë nuk përputhen me kualifikimet profesionale të tyre.<sup>319</sup> Mbi-kualifikimi është bërë më i përhapur vitet e fundit dhe punësimi në një vend pune me kërkesa më të ulëta arsimore se ai i punëmarrësit shoqërohet me 'ndëshkim në pagë', nga i cili ndikohen më shumë gratë se burrat.<sup>320</sup>

Për sa i përket arsimit fillor dhe të mesëm, po bëhen përpjekje për të luftuar lënien e shkollës, përfshirë edhe përmes sistemit të bursave. Strategjia e Rinisë dhe Plani Kombëtar i Garancisë Rinore synojnë të mbështesin të rinjtë dhe të rejat e cenueshme, sidomos ato që nuk janë në punësim, trajnim ose arsim. Sidoqoftë, është e nevojshme rritja e bursave, sidomos për grupet më të cenueshme. Dallimet gjinore në akses në arsim dhe ndjekjen e shkollës vazhdojnë të ekzistojnë, sidomos ndër nxënësit me aftësi të kufizuara dhe romë, ku vajzat janë ato që më së shumti e lënë shkollën.<sup>321</sup> Janë ngritur shqetësime edhe për cilësinë e arsimit, pas marrjes së rezultateve mesatare të testit PISA 2022 të nxënësve të moshës 15 vjeçare, që ishin shumë më të ulëta krahasuar me 2018.<sup>322</sup>

Pjesa më e madhe e nxënësve në shkollat profesionale janë djem, që përbëjnë rreth 84 për qind të numrit të përgjithshëm të nxënësve. Ndër arsyt kryesore janë mjedisi social në shkollat profesionale (të dominuara nga

315. INSTAT (2023), "Gratë dhe burrat në Shqipëri, 2023". Shih: <https://www.instat.gov.al/media/12598/burra-dhe-gra-2023.pdf>

316. Kontributi i Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Shërbimet e Projekteve (UNOPS) për profilin e barazisë gjinore të Shqipërisë (2025).

317. INSTAT (2023), Nxënësit e regjistruar në arsimin e mesëm. Shih: [https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START\\_\\_ED\\_REG/ArSm01/](https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START__ED_REG/ArSm01/)

318. INSTAT (2024). "Statistika të diplomimeve 2022-2023". Shih: <https://www.instat.gov.al/media/13332/statistika-te-diplomimeve-2022-23-update-2024.pdf>

319. INSTAT (2020). "Tregu i punës 2019". Shih: <http://www.instat.gov.al/en/publications/books/2020/labour-market-2019/>

320. ONP (2019). "Mospërputhjet midis aftësive dhe punësimit në vendet me të ardhura të ulëta dhe të mesme të ulëta". Shih: [https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/--ed\\_emp/documents/publication/wcms\\_726816.pdf](https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/--ed_emp/documents/publication/wcms_726816.pdf)

321. Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (2024). Kontributi në kuadër të Rishikimit Periodik Universal për Shqipërinë

322. PISA është programi i OECD-së për vlerësimin ndërkombëtar të arritjeve të nxënësve. PISA mat aftësinë e nxënësve 15 vjeçarë për të përdorur njohuritë e tyre në lexim, matematikë dhe shkencë për zgjidhjen e problemeve në jetën e përditshme.

djemtë), mentaliteti i përgjithshëm që lidhet me shkollat profesionale, lloji i kurrikulave që ofrohen, dhe perspektivat e punësimit për vajzat pas mbarimit të shkollës – që lidhen që të gjitha me të ashtuquajturat “profesionet mashkullore”.

### Aksesi në aftësi dhe ekonominë digjitale

Dallimet gjinore në aksesin digjital vazhdojnë të përbëjnë pengesë të konsiderueshme për arritjen e përfshirjes digjitale dhe barazisë gjinore në Shqipëri, sidomos tani që vendi po harmonizon prioritetet zhvillimore me agjendën e digjitalizimit të BE-së. Gratë dhe vajzat në Shqipëri kanë nivel më të ulët aksesin në mjete digjitale, lidhje me internetin, njohuri digjitale dhe në fushat SHTIM, krahasuar me burrat, që kufizon pjesëmarrjen e tyre në ekonominë digjitale dhe jetën publike. Këto dallime janë sidomos të theksuara ndër gratë e zonave rurale, ato nga komunitetet rome dhe egjiptiane, dhe gratë me aftësi të kufizuara. Me përparimet e bëra nga BE-ja në përmbushjen e objektivave të Dekadës Digjitale – si për shembull, sigurimi që 80% e popullsisë të zotërojë aftësitë digjitale bazë deri më 2030 – mbyllja e hendekut gjinor digjital në Shqipëri bëhet prioritet kombëtar dhe domosdoshmëri rajonale. Trajtimi i këtyre dallimeve kërkon investime të fokusuara për trajnime për aftësimin e grave dhe të vajzave në fushën digjitale, për akses të barabartë në infrastrukturën digjitale, dhe integrimin e perspektivës gjinore në të gjitha politikatat dhe programet kombëtare për transformimin digjital.

#### 3.3.9 Të drejtat pronësore

Në veçanti për gratë, zotërimi i pronës është burim i fuqizimit ekonomik dhe ofron mbrojtje në rast të zgjidhjes së martesës ose braktisjes. Provat janë të shumta që zotërimi i pronës nga gratë ka rrjedhoja pozitive për fuqizimin, ushqyerjen dhe shëndetin e tyre, dhe për arsimimin e fëmijëve të tyre.<sup>323</sup>

Legjislacioni shqiptar për garantimin e të drejtave të barabarta të pronësisë dhe trashëgimisë për gratë është

përmirësuar ndjeshëm pas miratimit të Ligjit “Për kadastrën” dhe Ligjit “Për noterinë” në vitin 2018. Këto dy ligje dhe nënligjet përkatëse sqarojnë procedurat dhe e bëjnë të detyrueshëm regjistrimin e përbashkët të pronave martesore. Ata mundësojnë gjithashtu edhe korrigjime në titujt e pronësisë për regjistrimin e pronave të përfuara bashkërisht gjatë martesës në emrin e të dy bashkëshortëve, në qoftë se nuk ishte bërë para miratimit të ligjeve vitin 2018.<sup>324</sup> Përpara vitit 2018, ndonëse pronat e përfuara gjatë martesës konsideroheshin pronë e përbashkët e çiftit, ligji nuk parashikonte detyrimin për regjistrimin e tyre në emrin e të dy bashkëshortëve.

Megjithëse kanë kaluar disa vjet nga këto përmirësime në legjislacion, ende nuk ka të dhëna të disponueshme të përditësuara mbi pronësinë dhe pronat e grave, që e bën të vështirë vlerësimin e zbatimit dhe të ndikimit faktik të këtyre dispozitave. Të dhënat më të fundit janë nga Studimi Demografik dhe Shëndetësor i vitit 2018, sipas të cilit 52,2 për qind e burrave dhe 23,2 për qind e grave kishin në pronësi banesë - ose në emër të tyre, ose së bashku me të tjerë, në vitin 2018.<sup>325</sup>

Në legjislacion janë bërë përmirësime edhe lidhur me pronësinë mbi tokën dhe banesën në zonat rurale, por ato kryesisht u ofrojnë mbrojtje grave për pronat në pronësi të përbashkët të të dy bashkëshortëve (pronë e blerë nga bashkëshortët gjatë martesës). Nga ana tjetër, ka edhe dispozita të tjera lidhur me “njësitë familjare bujqësore”, që, sipas Kodit Civil, përfaqësohen nga kryefamiljari, zakonisht mashkulli më i moshuar në familje. Por këto dispozita këto nuk u ofrojnë mbrojtje grave që hyjnë në njësinë familjare bujqësore dhe bëhen punëtore bujqësie përmes martesës. Ato bëjnë punë të papaguar në biznesin bujqësor të familjes pa pasur ndonjë pushtet vendimmarrës të njohur ligjërish.<sup>326</sup>

Studimet tregojnë se në zonat rurale mbizotërojnë praktikatat tradicionale që favorizojnë burrat për sa i përket pronësisë mbi tokën dhe trashëgimisë. Si rezultat, vazhdon të ekzistojnë një hendek i konsiderueshëm midis të drejtave ligjore (*de jure*) dhe praktikave faktike

323. Banka Botërore (2023), “Peizazhi gjinor në Shqipëri”, <https://documents1.worldbank.org/curated/en/099009306242233233/pdf/IDU13dd6d2e1105a0146141a426192b3de433582.pdf>

324. Me miratimin e Ligjit “Për kadastrën” dhe Ligjit “Për noterët” në vitin 2018.

325. <https://dhsprogram.com/data/available-datasets.cfm>

326. UN Women dhe Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (2023), “Avancimi i angazhimeve të barazisë gjinore në Shqipëri: Një vështrim mbi ligje të caktuara”, [https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-01/01\\_legislation\\_women\\_2.pdf](https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-01/01_legislation_women_2.pdf); FAO dhe UN Women. 2024. “Forcimi i statusit të bashkëshortes dhe partneres në bizneset bujqësore në Shqipëri – dokument politikash”. Budapest. <https://doi.org/10.4060/cd3392en>

(*de facto*) në lidhje me pronësinë mbi tokën dhe trashëgiminë. Ky dallim është sidomos i theksuar në zonat malore dhe të thella, dhe i ka rrënjët në normat patriarkale dhe institucionet informale në komunitet.<sup>327</sup> Mungesa e pronësisë mbi tokën ka ndikim negativ të ndjeshëm në pushtetin ekonomik të grave rurale në familjet e tyre dhe kufizon aftësinë e tyre për të pasur bizneset e tyre bujqësore ose jobujqësore. Ajo gjithashtu kufizon aksesin e tyre në mbështetjet financiare të shtetit për zhvillimin rural.

### 3.3.10 Turizmi

Vitet e fundit, turizmi është bërë një sektor i rëndësishëm në ekonominë shqiptare. Si i tillë, ai ofron mundësi të rëndësishme për fuqizimin ekonomik të grave, sidomos në sektorin e akomodimit/hotelerisë, artizanatit dhe guidave turistike. Megjithatë, shpesh gratë janë më të përqendruara në vende pune me paga të ulëta dhe me pushtet të kufizuar vendimmarrës. Nxitja e fuqizimit gjinor përmes mbështetjes së bizneseve të drejtuara nga gratë dhe përmirësimit të kushteve të tyre të punës forcon barazinë gjinore dhe zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit.

Aktualisht Shqipëria është në proces të hartimit të Strategjisë Kombëtare të Turizmit 2025-2030, që kaloi në proces konsultimi publik në tetor 2024.<sup>328</sup> Dokumenti përveç vizionin e Shqipërisë për një sektor turizmi të qëndrueshëm dhe përfshirës dhe njeh përfshirjen sociale si një parim kyç. Në pjesën narrative, strategjia përfshin shprehimisht integrimin gjinor dhe thekson arsimimin, fuqizimin dhe rolin drejtues të grave në turizëm. Ajo thekson gjithashtu rëndësinë e programeve të fokusuar për ndërtimin e kapaciteteve, për të siguruar që gratë të fitojnë aftësitë e nevojshme, të trajnohen për role drejtuese dhe udhëheqëse, me qëllim që të marrin role kyçe në sektor. Krahas këtyre, strategjia promovon grante, programe mentorimi, dhe formuese për zhvillimin e biznesit për mbështetjen e grave sipërmarrëse në turizëm dhe akomodim.

Strategjia njeh gjithashtu rolin qendror të grave në turizmin me bazë në komunitet (TBK), sidomos në zonat rurale

dhe më pak të pazhvilluara. Shumë aktivitete turistike me bazë në komunitet tashmë drejtohen nga gra dhe zgjerimi i këtyre nismave mund të çojë në pjesëmarrje më të madhe të grave në ekonomi si dhe në mundësi më të mëdha të tyre për të qenë në role drejtuese. Zhvillimet e ardhshme të TBK-së duhet t'u japin përparësi projekteve të drejtuara nga gratë, duke siguruar rolin e tyre aktiv në formimin dhe menaxhimin e përvojave turistike në komunitetet e tyre. Megjithatë, është me rëndësi kyçe që synimet e shprehura në pjesën narrative të strategjisë të kthehen në ndryshime, veprime konkrete dhe burime konkrete. Për impakt sa më të madh, Shqipëria duhet të integrojë mbledhjen e të dhënave të ndara sipas seksit, të përdorë buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, dhe të sigurojë mbështetje institucionale për përfshirjen e grave në drejtimin e turizmit. Forcimi i këtyre masave do ta harmonizonte sektorin e turizmit me angazhimet globale për barazinë gjinore, duke nxitur një sektor më përfshirës dhe konkurrues.

### 3.3.11 Politika dhe akte ligjore kyçe të BE-së

Një numër i madh aktesh ligjore dhe politikash të BE-së trajtojnë barazinë gjinore dhe të drejtat e grave fusha si tregu i punës, lufta kundër diskriminimit në vendin e punës, zhvillimin e sektorit privat dhe zhvillimin e aftësive. Disa prej dokumenteve kryesore të politikave janë: Gjatë viteve, Shqipëria ka bërë përpjekje të harmonizojë legjislacionin e saj për punësimin dhe fuqizimin ekonomik të grave me politikën e BE-së, kryesisht përmes ndryshimeve në Kodin e Punës në vitet 2015 dhe 2024, përfshirë aktet nënligjore të tyre, si dhe në ligjin "Për mbrojtjen nga diskriminimi" në vitin 2020. Sipas raportit të fundit të Komisionit Evropian për Shqipërinë (2024), qeveria është mesatarisht e përgatitur në sektorin e punësimit dhe ka bërë njëfarë përparimi, sidomos me miratimin e Strategjisë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023-2030 dhe pilotimin e Planit të Garancisë Rinore për të përmirësuar aksesin në vende pune. Megjithatë, raporti thekson faktin se pabarazitë gjinore vazhdojnë të ekzistojnë në punësim dhe politika sociale dhe thekson nevojën që Shqipëria të harmonizojë më tej kuadrin e saj ligjor me direktivat e BE-së, sidomos me direktivën

327. FAO dhe UN Women Shqipëri (2024) "Drejt shërbimeve të përgjigjshme gjinore të këshillimit bujqësor në Shqipëri - Raport vlerësimi" <https://www.fao.org/europe/resources/country-gender-assessment-series/towards-gender-responsive-agricultural-extension-services-in-albania/en>

328. Shih: [https://www.konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK\\_785\\_Strategjia-Kombe%CC%88tare-e-Turizmit-2024-2030\\_Update\\_6\\_Tetor.pdf](https://www.konsultimipublik.gov.al/documents/RENJK_785_Strategjia-Kombe%CC%88tare-e-Turizmit-2024-2030_Update_6_Tetor.pdf)

mbi balancën punë-jetë private/familjare.<sup>329</sup> Aktualisht, Shqipëria është në proces të rishikimit të Ligjit "Për barazinë gjinore në shoqëri". Një aspekt kryesor i këtij procesi është harmonizimi i tij me direktivat përkatëse të BE-së, ndër të cilat edhe ato lidhur me barazinë midis burrave dhe grave në çështje të punësimit dhe profesionit, paga të barabarta, sigurime shoqërore, vetëpunësim dhe akses dhe sigurimin e mallrave dhe shërbimeve, si dhe direktivat që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtoreve shtatzëna dhe standardet për institucionet e barazisë në fushën e trajtimit të barabartë dhe mundësive të barabarta midis grave dhe burrave në çështje të punësimit dhe profesionit.<sup>330</sup>

Megjithatë, vetëm dispozitat e Ligjit "Për barazinë gjinore në shoqëri" nuk mund të garantojnë harmonizim të plotë me të gjitha instrumentet ligjore në këtë fushë. Nevojiten përpjekje të përgjithshme për të siguruar harmonizimin dhe transpozimin e *acquis*-it të BE-së në të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore relevante që lidhen me punësimin, sigurinë në punë, antidiskriminimin, mbrojtjen sociale dhe shërbimet sociale, qeverisjen e korporatave, shoqëritë tregtare, bujqësinë, sipërmarrjet dhe të tjera.

Aktualisht Shqipëria po përgatitet të avancojë negociatat në grup-kapitullin 3, i cili fokusohet në forcimin e konkurrueshmërisë dhe nxitjen e rritjes ekonomike përfshirëse. Ky grup-kapitull përfshin, ndër të tjera, kapitullin 19 mbi punësimin dhe politikat sociale.<sup>331</sup> Ky është momenti i përshtatshëm që vendi të harmonizojë më tej legjislacionin për barazinë gjinore dhe punësimin dhe, në veçanti, të marrë masa institucionale për të trajtuar problemin e mangësive në fushën e barazisë gjinore të identifikuar nga mekanizmat e BE-së dhe të drejtave të njeriut.

### 3.3.12 Rekomandime

Rekomandimet kryesore për fuqizimin ekonomik të grave në Shqipëri bazohen në rekomandimet e kohëve të fundit të mekanizmave të drejtave të njeriut në kontekstin e rishikimit të pestë periodik nga Komiteti i KEGJFDG-së në vitin 2023<sup>332</sup> dhe cikli i katërt i RPU-së (2024-2025).<sup>333</sup> Rekomandimet e mëposhtme pasqyrojnë gjithashtu edhe informacionin e kontribuar nga ekipi i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri në kuadër të raporteve të këtyre mekanizmave gjatë procesit të rishikimit.<sup>334</sup>

- 1. Nxitja e punësimit të plotë dhe produktiv dhe i punës së denjë** për të gjitha gratë dhe të gjithë burrat dhe hartimi i politikave të fokusuar të tregut të punës për të trajtuar problemin e papunësisë tek të rinjtë dhe gratë e pafavorizuara. Në to duhet të përfshihen shërbime të përgatitjes profesionale dhe të punësimit që i përshtaten sektorëve me potencial për punë të denjë. (Në përputhje me rekomandimet e KEDG-së 2023 dhe RPU-së 2025).<sup>335</sup>
- 2. Rritja e aksesit të grave në punësim formal**, sidomos të atyre nga grupet e pafavorizuara dhe zgjerimi i skemave të mbrojtjes sociale për gratë e punësuar në ekonominë informale. Në këtë kontekst, është e rëndësishme të miratohet një strategji reaguese gjinore për formalizimin, që i jep përparësi zgjerimit të mbrojtjes sociale, njohjes ligjore dhe kushteve të denja të punës për gratë në punësim informal, sidomos në bujqësi, turizëm dhe punë të papaguar në familje. (Harmonizuar me Konventat e ratifikuara të ONP-së: K100, K111, dhe K190.)
- 3. Të zbatohet me efektivitet parimi i pagave të barabarta për punë me vlerë të barabartë**, me qëllim që të ngushtohet dhe përfundimisht të

329. Komisioni Evropian (2024). "Raporti për Shqipërinë 2024". Gjetet në: [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024\\_en](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en)

330. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Projektligji "Për barazinë gjinore në shoqëri" (drafti i shkurtit 2025, i pabotuar).

331. Negociatat e anëtarësimit, që u hapën në korrik 2022, bazohen në një kuadër negociues dhe kryhen në bazë të vlerësimit analitik "ose procesit të shqyrtimit", që është i organizuar në bazë të gjashtë grupkapitujve. Këta grupkapituj organizohen sipas *acquis*-it të BE-së dhe përbëhen kapituj, të cilët secili mbulojnë një fushë të caktuar politikash dhe parime dhe standarde më të përgjithshmes.

332. Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit të Grave, (2023) (CEDAW/C/ALB/5). Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave, Kombet e Bashkuara. <https://www.ohchr.org/documents/treaties/KEGJFDG>

333. Këshilli i të Drejtave të Njeriut. (20 dhjetor 2024). *Raport i Grupit të Punës mbi Raportin Periodik Universal: Shqipëria* (Seanca e 58-të, Pika e rendit të ditës 6); A/HRC/58/

334. Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (2024), Kontributi në kuadër të Rishikimit Periodik Universal për Shqipërinë, <https://www.ohchr.org/en/hr-bodies/upr/al-un-contributions-s47>; Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (2022) Raport konfidencial dorëzuar Komitetit të KEGJFDG-së në kuadër të rishikimit të pestë periodik të Shqipërisë (i pabotuar).

335. CEDAW/C/ALB/CO/4, para. 31; CEDAW/C/ALB/CO/5, Rekomandimi 38 (a).

mbyllet hendeku gjinor në paga, përmes: (i) kryerjes së inspektimeve të rregullta të punës; (ii) zbatimit të metodave asnjane gjinore të klasifikimit dhe vlerësimit analitik të vendeve të punës; (iii) kryerjes së vrojtimeve të rregullta për pagat; dhe (iv) inkurajimit të punëdhënësve që të bëjnë publike të dhënat e hendekut gjinor në paga, me synimin për të kuptuar më mirë arsyet e ekzistencës së tij dhe për të marrë masat e duhura korrigjuese. (Në përputhje me rekomandimet e KEDG-së.)<sup>336</sup>

- 4. Të njihet, reduktohet dhe rishpërndahet ngarkesa e grave me punë të papaguar,** përmes: (i) ofrimit të shërbimeve të përbalueshme financiarisht për kujdesin për fëmijët dhe për të moshuarit; (ii) nxitjes së ndarjes së barabartë të punëve dhe përgjegjësive në shtëpi mes grave dhe burrave; dhe (iii) sigurimit që gratë e punësuar në biznesin familjar të shpërblehen siç duhet dhe të kenë akses në skema të mbrojtjes sociale. Krahas kësaj, është e rëndësishme që Shqipëria të krijojë një kuadër ligjor dhe të politikave për garantimin e marrëveshjeve për punë fleksibël midis punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe për vendosjen e balancës së duhur midis punës dhe jetës private/familjare. (Në përputhje me rekomandimet e Komitetit të KEGJFDG-së, rekomandimet e RPU-së të viteve 2023 dhe 2024, dhe kontributin e EKBSH-së dorëzuar KEDG-së, 2022.)<sup>337</sup>
- 5. Të forcohen kapacitetet njerëzore dhe logjistike të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimit Social** dhe të rritet akses i grave në mekanizmat konfidencialë dhe të pavarur të ankimit, për trajtimin e problemit të diskriminimit të grave në fushën e punësimit. (Në përputhje me rekomandimet e KEDG-së 2023 dhe kontributin e EKBSH-së për RPU-në 2024.)<sup>338</sup> Gjithashtu, forcimi i mekanizmave të negociimit kolektiv dhe dialogut social është me rëndësi thelbësore për të luftuar diskriminimin në vendin e punës dhe për të nxitur përfshirjen e dispozitave kundër diskriminimit në marrëveshjet kolektive. (Në përputhje me Konventën nr. 111 mbi diskriminimin në vendin e punës dhe Konventën nr. 190 për eliminimin e dhunës dhe ngacmimit, të ONP-së)

- 6. Të sigurohet zbatimi efektiv i Konventës 190 kundër dhunës dhe ngacmimit në botën e punës,** si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat, përfshirë përmes miratimit të një Plani Kombëtar të Zbatimit, me role të qarta për organet zbatuese (KMD, ISHPSHSH), politika të detyrueshme në vendin e punës, si dhe programe parandaluese specifike për çdo sektor. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet punëtorëve të cënueshme dhe informale. Krahas kësaj, janë të nevojshme sisteme të dhënash dhe vrojtime të ndara sipas seksit për monitorimin e përhapjes së ngacmimit dhe diskriminimit në vendin e punës, duke siguruar të dhëna si nga sektorët formalë, ashtu edhe ata informalë. (Në përputhje me rekomandimet e Komitetit të KEGJFDG-së dhe kontributin e EKBSH-së për RPU 2024.)<sup>339</sup>
- 7. Të ndërmerren reforma për sigurimin e të drejtave të barabarta të grave në burime ekonomike,** si edhe akses në pronësi dhe kontroll mbi tokën dhe forma të tjera të pronës, shërbime financiare, trashëgimi dhe burime natyrore, në përputhje me legjislacionin e vendit. Gjithashtu, duhet të përmirësohen statistikat kombëtare për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas seksit për të shërbyer si bazë për hartimin e politikave të ndjeshme gjinore dhe të bazuara në fakte për gratë rurale. (Në përputhje me rekomandimet e KEDG-së dhe kontributin e EKBSH-së për KEDG-në 2022.)<sup>340</sup>
- 8. Të sigurohet akses i barabartë i grave në tregje dhe kredi financiare,** përfshirë në kredi me interes të ulët dhe pa kolateral, prokurime publike dhe TIK, në mënyrë që grave t'u mundësohet angazhimi në tregti përmes internetit dhe në tregti ndërkufitare për mallrat dhe produktet e tyre. Përveç kësaj, Shqipëria duhet të nxisë sipërmarrjet e grave dhe bizneset e drejtuara nga gratë, përfshirë sipërmarrjet shoqërore, përmes ofrimit të skemave novatore të investimit. (Në përputhje me rekomandimet e KEDG-së 2023 dhe kontributin e EKBSH-së për Komitetin e KEGJFDG-së 2022.)<sup>341</sup>

336. CEDAW/C/ALB/CO/5, Rekomandimi 34 (a).

337. CEDAW/C/ALB/CO/5, Rekomandimi 34 (c); RPU 124.109, A/HRC/58/5.

338. CEDAW/C/ALB/CO/5, Rekomandimi 34 (b).

339. CEDAW/C/ALB/CO/5, Rekomandimi 34 (d).

340. CEDAW/C/ALB/CO/5, Rekomandimi 40 (a).

341. CEDAW/C/ALB/CO/5, Rekomandimi 38 (b).

9. **Të sigurohet që gratë dhe vajzat rurale, gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara dhe ato nga pakicat etnike të kenë akses të mjaftueshëm në TIK**, në mënyrë që të mund të përfitojnë nga të mësuarit në distancë dhe të regjistrohen në programe arsimore që ofrohen në internet. Gjithashtu, Shqipëria duhet të përmirësojë programet lidhur me njohuritë digjitale dhe SHTIM.<sup>342</sup> (në përputhje me Rekomandimet e KEDG-së 2023.)<sup>343</sup>
10. **Të sigurohet që të rinjtë dhe të rejtat** të mos jenë të përjashtuar nga mundësitë për arsimim dhe punësim, përmes mbështetjes financiare dhe koordinimit për zbatimin efektiv të Strategjisë së Rinisë dhe Planit të Garancisë Rinore.<sup>344</sup>
11. **Të rritet ndërgjegjësimi dhe t'u jepet grave ndihmë juridike** për të garantuar që ato të përfitojnë plotësisht nga dispozita ligjore të përmirësuara që mundësojnë regjistrimin e pasurisë së përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve. (Në përputhje me Kontributin e EKBSH-së për KEDG 2022 dhe me RPU, 2023.)<sup>345</sup>

### 3.4 BARAZI NË PJESËMARRJE, UDHËHEQJE DHE VENDIMMARRJE

Pjesëmarrja e grave në udhëheqje dhe vendimmarrje është shtyllë qendrore e qeverisjes demokratike dhe barazisë sociale. Shqipëria ka bërë përparim të dukshëm në promovimin e barazisë gjinore në sferat politike, ekonomike dhe publike, të cilat mbështeten në dispozita ligjore në lidhje me kuotat e detyrueshme gjinore në proceset zgjedhore dhe administratë publike.

Megjithatë, gratë vazhdojnë të përballen me pengesa strukturore, kulturore dhe institucionale që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në role drejtuese dhe vendimmarrëse.

#### 3.4.1 Gratë në parlament dhe qeverisjen vendore

##### Gratë në parlament

Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për forcimin e përfaqësimit të grave në strukturat qeverisëse kombëtare. Kodi Zgjedhor (2020) përcakton një kuotë gjinore minimale prej 30 për qind për zgjedhjet parlamentare dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka kompetencë të detyrojë përmbushjen e kësaj kuote përmes vendosjes së sanksioneve kundër partive politike që nuk e arrijnë këtë prag. Kuota gjinore minimale prej 30 për qind dhe sanksione parashikohen me ligj edhe për të gjitha nivelet e administratës zgjedhore, që kanë zëvendësuar sistemin e mëparshëm të gjobave me masa për mospranimin e listave në qoftë se partitë politike nuk iu përmbaheshin kuotave gjinore. Ky kuadër ligjor ka kontribuar në rritjen e përfaqësimit të grave në Kuvendin e Shqipërisë nga 29,5 për qind (36 gra) në vitin 2020 në 35 për qind (49 gra) në 2024.<sup>346</sup> Ndonëse Shqipëria ka rezultate më të mira se mesatarja botërore (27,2 për qind) dhe mesatarja evropiane (31.8 për qind), ajo ende është mbrapa vendeve me paritet gjinor më të lartë, si Islanda (47,6 për qind), Suedia (46,7 për qind), Finlanda (46 për qind), Danimarka (45,3 për qind), dhe Norvegjia (44,4 për qind), si dhe Maqedonia e Veriut (39,2 për qind) dhe Serbia (37,2 për qind) në Ballkanin Perëndimor.<sup>347</sup>

Pesë nga tetë komisionet parlamentare drejtohen nga gra. Megjithatë, pjesëmarrja e grave në këto komisione duhet të përmirësohet, sidomos në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin (ku vetëm 10 për qind e anëtarëve janë gra) dhe në Komisionin për Sigurinë Kombëtare (me 15 për qind anëtare gra), të cilët të dy drejtohen nga burra, si edhe në Komisionin për Punët e Jashtme, që drejtohet nga një grua dhe me përfaqësim të grave në masën 26,3 për qind.<sup>348</sup> Në zgjedhjet parlamentare të 11 majit 2025, Shqipëria kishte 2046 kandidatë

342. Shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë

343. CEDAW/C/ALB/CO/5, Rekomandimi 32 (c).

344. CEDAW/C/ALB/5, Rekomandimi 32 (c)

345. Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (2024), Kontributi në kuadër të Rishikimit të Katërt Universal Periodik për Shqipërinë, <https://www.ohchr.org/en/hr-bodies/upr/al-un-contributions-s> f.47


346. "Vlerësim gjithëpërfshirës kombëtar mbi zbatimin e platformës për veprim të Pekinit - Shqipëria", f. 59. Shih: [https://www.unwomen.org/sites/default/files/2024-09/b30\\_report\\_albania\\_en.pdf](https://www.unwomen.org/sites/default/files/2024-09/b30_report_albania_en.pdf)

347. Unioni Ndërparlamentar (IPU), Të dhëna globale mbi parlamentet kombëtare. Shih: [https://data.ipu.org/women-ranking/?date\\_month=01&date\\_year=2025](https://data.ipu.org/women-ranking/?date_month=01&date_year=2025). Ky informacion është i vlefshëm edhe pas zgjedhjeve parlamentare të vitit 2025 në Shqipëri, ku gratë përfaqësojnë 35% të numrit të përgjithshëm të deputetëve dhe deputeteve.

348. INSTAT, "Burra dhe gra, 2023", f. 110. Shih: <https://www.instat.gov.al/media/12598/burra-dhe-gra-2023.pdf> dhe <https://www.parlament.al/>

**Figura 13**


**Përbërja e Kuvendit të Shqipërisë 2020-2025**




Burimi: INSTAT, "Burra dhe gra, 2023"

**Figura 14**

**Përqindja e grave në parlamentet kombëtare**



Burimi: KQZ, 2025

**Figura 15****Përbërja e komisioneve parlamentare, sipas seksit, 2022**

Burimi: INSTAT, "Burra dhe gra, 2023".

për deputetë dhe deputete, nga të cilët 787 ose 38% ishin gra.<sup>349</sup> Këta kandidatë dhe kandidatet konkurruan në 12 prefektura, për 140 vende në Kuvend. Në këto zgjedhje kishte 3,7 milion votues të regjistruar, ku rreth 246.000 ishin nga diaspora.<sup>350</sup> Me reformën zgjedhore u futën për herë të parë kuotat 'zinxhir', sipas të cilave një e treta e vendeve në Kuvend duhet të ziheshin nga gra, qoftë nga listat e mbyllura, ashtu edhe nga ato preferenciale. Të dhënat zyrtare për rezultatet përfundimtare janë ende në proces përgatitjeje. Është e rëndësishme të theksohet se edhe këtë herë grave iu desh të përballeshin me sfida të konsiderueshme gjatë fushatës zgjedhore, si ngacmimet në internet, fushatat që vinin në shënjestër gratë, aksesit i kufizuar në fonde për fushatë zgjedhore, dhe tendenciozitetin gjinor brenda partive – probleme që u identifikuan si pengesa ndaj pjesëmarrjes së plotë në zgjedhje nga Zyra për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE/ODIHR). Gjithashtu, sistemi i listave të hapura dobësoi efektin e kuotave,

sepse shumë grave nga mbetën jashtë vëmendjes për shkak të grave më të votuara.<sup>351</sup> Këto sfida theksojnë rëndësinë për reforma strukturore me veprim të gjerë për të shtuar mundësitë e grave për t'u zgjedhur në role udhëheqëse dhe drejtuese.

### Gratë në qeverisjen vendore

Pavarësisht nga kuota gjinore prej 50% që u përfshi në Kodin Zgjedhor të Shqipërisë të vitit 2015 në lidhje me zgjedhjet vendore, gratë vazhdojnë të jenë shumë të nënpërfaqësuar në poste drejtuese në bashki. Të dhënat nga zgjedhjet e viteve 2019, 2022, dhe 2023 tregojnë se gratë përbënin vetëm një numër shumë të vogël të kandidatëve dhe fituesve të zgjedhjeve për kryetar bashkie. Në zgjedhjet vendore të vitit 2019 u regjistruan gjithsej 97 kandidatë për kryetar bashkie (11 gra dhe 86 burra), nga të cilët fituan 61 (tetë gra dhe 53 burra). Për këshillat bashkiakë u regjistruan 9882 (4842 gra dhe 5040 burra) nga të cilët fituan 1621 (707 gra

349. Të dhëna zyrtare paraprake të KQZ-së, të analizuar nga UN Women (qershor 2025) në kuadër të këtij raporti.

350. Shih: <https://www.ifes.org/tools-resources/election-snapshots/elections-albania>

351. Për më shumë informacion për sistemin e kuotave gjinore që u përdorën mbi bazën e ndryshimeve të vitit 2025 në Kodin Zgjedhor, shih UN Women dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve "Informacion praktik mbi proceset zgjedhore në Shqipëri 2025" (f. 13-14) <https://kqz.gov.al/media/documents/Informacion-praktik-mbi-proceset-zgjedhore-ne-Shqiperi9.pdf>

**Tabela 6****Kandidatët, kandidatet, dhe zyrtarët e zgjedhur në zgjedhjet vendore (2019-2023)**

Viti zgjedhor	Posti	Gjithsej kandidatë	Gra kandidate	Burra kandidatë	Gra të zgjedhura	Burra të zgjedhur
2019	Kryetar(e) bashkie	97	11	86	8	53
	Këshill bashkiak	9,882	4,842	5,040	707	914
2022 (të pjesshme)	Kryetar(e) bashkie (6 bashki)	19	3	16	2	4
2023	Kryetar(e) bashkie	144	15	129	8	53
	Këshill bashkiak	23,763	11,828	11,935	706	967

Burimi: INSTAT, "Burra dhe gra, 2023".

dhe 914 burra). Në zgjedhjet e pjesshme vendore të vitit 2022, u regjistruan gjithsej 19 kandidatë për kryetarë bashkie (tri gra dhe 16 burra) në gjashtë bashkitë ku u mbajtën këto zgjedhje, nga të cilët fituan gjashtë (dy gra dhe katër burra).<sup>352</sup> Në zgjedhjet vendore të vitit 2023 konkurruan për kryetar bashkie 144 kandidatë (15 gra dhe 129 burra),<sup>353</sup> nga të cilët fituan tetë gra dhe 53 burra. Për anëtarë të këshillave bashkiakë u regjistruan gjithsej 23.763 kandidatë<sup>354</sup> (11.828 gra dhe 11.935 burra), nga të cilët fituan 1673 (57,8 për qind burra dhe 42,2 për qind gra).

Për t'u regjistruar në këto zgjedhje, listat e kandidatëve për këshillat bashkiakë duhet të kishin përfaqësim të barabartë të burrave dhe grave, me alternim të kandidatëve nga dy gjinitë, por në shumicën e bashkive ky kusht nuk u plotësua.<sup>355</sup> Pas zgjedhjeve vendore të vitit 2023 në Shqipëri, 102 anëtarë të këshillave bashkiakë dhe 80 kandidatë për anëtarë të këshillave bashkiakë i tërhoqën kandidaturat e tyre para se të merrnin postet. Sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, 132 nga kandidatët që u tërhoqën ishin gra, krahasuar me vetëm 50 burra.

Ky hendek i konsiderueshëm gjinor në tërheqjen e kandidaturave është parë me shqetësim nga vëzhguesit, sepse këto dorëheqje mund të përdoren si mënyrë për t'iu shmangur kriterit të kuotave gjinore, duke ushtruar presion mbi gratë që të tërhiqen, për të mundësuar marrjen e atyre vendeve nga burrat e renditur më poshtë në listat partiake. Kjo është një sfidë të vazhdueshme në kulturën politike të vendit, ku kandidaturat e grave shpesh shërbejnë për të përmbushur kriteret ligjore nga ana formale, në vend që të bëhen ndryshime reale në sistem. Sigurimi i përfaqësimit të njëmendtë të grave në nivelin vendor kërkon përpjekje të vazhdueshme për forcimin e pjesëmarrjes politike të tyre, krijimin e mjediseve mbështetëse, dhe promovimin e përfshirjes së tyre të vërtetë në proceset vendimmarrëse. Sipas një studimi të shoqërisë civile të vitit 2023, që u botua në vitin 2024,<sup>356</sup> rritja e numrit të grave këshilltare jo domosdoshmërisht përkthehet në ndikim më të madh të tyre në këshill bashkiak. Analiza të procesverbaleve të 49 mbledhjeve të këshillave bashkiakë, kanë treguar se nga 8.300 raste të marrjes së fjalës nga këshilltarët, burrat folën 6.169 herë (74,33 për qind) ndërsa gratë e morën

352. "Vlerësim gjithëpërfshirës kombëtar mbi zbatimin e platformës për veprim të Pekinit - Shqipëria", f. 60. Shih: [https://www.unwomen.org/sites/default/files/2024-09/b30\\_report\\_albania\\_en.pdf](https://www.unwomen.org/sites/default/files/2024-09/b30_report_albania_en.pdf)

353. Raporti Përfundimtar i Misionit të ODHIR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve, shtator 2023, f. 13. Shih: <https://www.osce.org/files/f/documents/d/d/553972.pdf>

354. Po aty.

355. Raporti Përfundimtar i Misionit të ODHIR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve shtator 2023, f. 14. Shih: <https://www.osce.org/files/f/documents/d/d/553972.pdf>

356. AWEN, prill 2024. "Përfaqësimi politik në këshillat bashkiakë pas zbatimit të kuotës gjinore 50/50: Çfarë po ndodh me hendekun gjinor?". Shih: <https://www.awenetwork.org/media/665858df0c2bc.pdf>

fjalën 2.131 herë (25,67 për qind). Gjithashtu, grave iu ndërpre fjala rreth 2,5 herë më shpesh se burrave. Studimi tregoi gjithashtu se shumë gra u tërhoqën për shkak të diskreditimit, ndërprerjeve të shpeshta kur merrnin fjalën në publik<sup>357</sup> dhe për shkak të presionit nga drejtuesit e partisë – një aspekt të cilit i është kushtuar pak vëmendje publike. Megjithëse partitë politike mund t'i respektojnë kuotat gjinore kur dorëzojnë listat në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, ato shpesh ushtrojnë presion ndaj grave – përfshirë duke i kërcënuar me pushim nga puna – që të tërhiqen në masë pas zgjedhjeve, për t'u lëshuar vendin burrave.<sup>358</sup> Në një këshill bashkiak u tërhoqën më shumë se dhjetë gra për t'ua lënë vendin burrave. Kjo strategji legjitimon idenë se politika është sferë e burrave dhe se gratë janë në shërbim të tyre.<sup>359</sup>

Për të lehtësuar pjesëmarrjen aktive të grave në jetën publike dhe politike, përfshirë në zgjedhjet për kryetar bashkie, është e nevojshme që organet e qeverisjes në të gjitha nivelet të bëjnë përpjekje të gjithanshme ligjore, institucionale dhe edukative për të kapërcyer stereotipet gjinore ekzistuese. Gjithashtu, organizatat ndërkombëtare i kanë nxitur partitë politike të identifikojnë dhe eliminojnë barrierat me bazë gjinore për gratë kandidatë, përfshirë përmes rishikimit të praktikave aktuale brenda partisë që pengojnë përfaqësimin më efektiv të grave brenda strukturave të partisë dhe si kandidatë.<sup>360</sup>

Përveç kësaj, nevojitet të bëhet më shumë progres për përmirësimin e përfaqësimit të grave si administratore në njësitë administrative, ose si kryetare fshati. Për shembull, në bashkinë e Tiranës, me 27 njësi administrative dhe tri lagje, ka vetëm pesë gra administratore (16 për qind)<sup>361</sup> dhe në bashkinë e Elbasanit, nga 116 fshatra, vetëm dy (1,7 për qind) kanë kryetare gra.<sup>362</sup> Edhe në bashki të tjera të dhënat do të tregojnë pjesëmarrje minimale ose mungesë totale të grave në këto poste

drejtuese. Fokus i veçantë duhet t'i kushtohet grave dhe vajzave të reja dhe pjesëmarrjes së tyre në politikë. Krahas rritjes së pjesëmarrjes së tyre, është me rëndësi thelbësore të sigurohet që kjo pjesëmarrje të jetë e njëmendtë, sepse ato vazhdojnë të përballen me stereotipe gjinore, mundësi të kufizuara mentorimi dhe përfaqësim të ulët në struktura politike kyçe, sidomos në njësi administrative dhe fshatra. Trajtimi i problemit të këtyre barrierave është tejte i rëndësishëm për krijimin e një mjedisi politik më përfshirës, me angazhim aktiv të grave dhe vajzave të reja në hartimin e politikave në nivel vendor dhe kombëtar.

Këshillat Vendorë Rinorë (KVR), të cilët po institucionalizohen gjithnjë e më shumë në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029<sup>363</sup> me mbështetjen e Ministrisë së Rinisë dhe Fëmijëve, synojnë të fuqizojnë rininë – sidomos të rejtat – në kuadër të organeve të qeverisjes vendore dhe hartimit të politikave. Aktualisht, rreth 70 për qind e Këshillave Vendorë Rinorë mbajnë mbledhje të përmuajshme me autoritetet bashkiake, që forcojnë angazhimin aktiv të të rinjve dhe të rejave.<sup>364</sup> Në të paktën 10 bashki, Këshillat Vendorë Rinorë kanë forcuar kapacitetet e tyre për t'u vënë në krye të nismave lidhur me ndryshimet klimatike dhe aktivizmin, përmes trajnimeve të posaçme.<sup>365</sup> Në rang kombëtar, në periudhën shkurt-mars 2024 u mbajt konferenca "Rinia 2030", me pjesëmarrjen e 350 të rinjve e të rejave, ndër të cilët edhe anëtarë të Këshillave Vendorë Rinorë, që u angazhuan në monitorimin e zbatimit të Strategjisë.<sup>366</sup> Megjithatë, pjesëmarrja e të rejave vazhdon të pengohet për shkak të mangësive institucionale, normave sociale dhe mekanizmave të pamjaftueshme për mbështetjen e tyre. Për korrigjimin e këtyre mangësive nevojiten ndërhyrje të fokusuar – përfshirë përmes programeve të mentorimit, trajnimeve për role udhëheqëse dhe politika reaguese gjinore – për të krijuar mundësi përfshirjeje për hyrjen e grave dhe vajzave të reja në qeverisje. Zgjerimi i mundësive në këshillat rinorë,

357. Po aty.

358. Po aty.

359. AWEN, prill 2024. "Përfaqësimi politik në këshillat bashkiakë pas zbatimit të kuotës gjinore 50/50: Çfarë po ndodh me hendekun gjinor?". Shih: <https://www.awenetwork.org/media/665858df0c2bc.pdf>

360. Raporti Përfundimtar i Misionit të ODHIR-it për Vëzhgimin e Zgjedhjeve shtator 2023, f. 13. Shih: <https://www.osce.org/files/f/documents/d/d/553972.pdf>

361. Shih: <https://tirana.al/faqe/administrata-e-bashkise>

362. Shih: <https://elbasani.gov.al/wp-content/uploads/2023/12/listaadministratore.pdf>

363. Masa 1.1.6 nën objektivin specifik 1.1 "Rritja e ndërgjegjësimin politik të të rinjve dhe në veçanti i vajzave dhe grave të reja, nëpërmjet promovimit të programeve të edukimit të votuesve dhe nismave të tjera ndërgjegjësuere". Shih: [https://riniafemijet.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/SKR29\\_Anglisht.pdf](https://riniafemijet.gov.al/wp-content/uploads/2023/04/SKR29_Anglisht.pdf)

364. Shih: <https://www.un.org/peacebuilding/content/western-balkans-success-story-local-youth-councils>

365. UNICEF, 2023. Shih: <https://www.unicef.org/media/151936/file/Shqipëria-2023-COAR.pdf>

366. Kjo konferencë u organizua me mbështetjen e Bashkimit Evropian dhe asistencën teknike "Mbështetja e BE-së për përfshirjen sociale në Shqipëri" (EU4SI). Shih: <https://rinia.gov.al/en/rinia-2030-strategjia-kombetare-e-rinise-2022-2023/>

organet e qeverisjes vendore dhe organizatat politike është me rëndësi qendrore për krijimin e një grupi të fuqishëm grash e vajzash të reja udhëheqëse të së ardhmes dhe për të siguruar që ato të luajnë rol aktiv në formimin e kornizave demokratike dhe të politikave në Shqipëri.

Duke iu përgjigjur angazhimit në rritje të Shqipërisë për barazi gjinore në udhëheqjen politike, një numër organizatash – ndër të cilat UN Women, Instituti Demokratik Kombëtar (IND, në SHBA), OSBE/ODIHR, dhe OSHC-të kombëtare – kanë ndërmarrë projekte plotësuese për të mbështetur një pjesëmarrje më të madhe të grave në politikë (PGP). Në 2024-2025, UN Women Shqipëri hartoi dhe zgjeron manualin e organizatës në lidhje me pjesëmarrjen e grave në politikë, me fokus në rreth 150 gra me prejardhje shoqërore të ndryshme, të cilat ishin të gatshme të vinin kandidaturën për deputete në zgjedhjet parlamentare të vitit 2025 dhe në ciklet politike të ardhshme. Në këtë projekt u përfshinë programe për zhvillimin e kapaciteteve dhe mundësi mentorimi që synonin rritjen e numrit të grave kandidate të kualifikuara. Paralelisht me këtë, UN Women po i pajis gratë e zgjedhura si anëtare të këshillave bashkiakë me aftësitë e nevojshme legjislative, të përfaqësimit, dhe mbikëqyrjes për realizimin me efektivitet të mandateve të tyre (2023-2026), bazuar në vlerësimin të nevojave për ndërtim kapacitetesh në nivel kombëtar në vitin 2023.

Rol të rëndësishëm kanë luajtur edhe palë të tjera të interesit: NDI ka mundësuar trajnime për gratë udhëheqëse të së ardhmes në lidhje me dialogun shumëpartiak dhe aftësitë për kryerjen e fushatave; Prania e OSBE-së në Shqipëri ka bërë lobim për strategji në lidhje me eliminimin e diskriminimit si dhe ka kryer monitorime me ndjeshmëri gjinore të mediave gjatë proceseve zgjedhore; dhe organizatat vendore kanë punuar për parandalimin e dhunës politike me bazë gjinore dhe për monitorimin e zbatimit të kuotave gjinore. Këto përpjekje kolektive përbëjnë një qasje të shumanshme për forcimin e gjithëpërfshirjes, qëndrueshmërisë dhe përfaqësimit të politikës shqiptare dhe garantojnë që kontributet dhe udhëheqja e grave të ndihmojnë në mënyrë të njëmendtë në formimin e demokracisë së ardhshme të vendit.

### 3.4.2 Dhuna ndaj grave në zgjedhje

Një studim i kryer në vitin 2021, "Dhuna ndaj grave gjatë zgjedhjeve dhe tendencioziteti gjinor në mbulimin nga media të zgjedhjeve të përgjithshme të prillit 2021 në Shqipëri"<sup>367</sup> tregoi se ndonëse në Shqipëri ka një numër të madh mediash, pronarët e tyre zakonisht ushtrojnë kontroll mbi përmbajtjen e tyre, çka kufizon pavarësinë editoriale dhe nxit vetëcensurën tek gazetarët, shumë prej të cilëve nuk e kanë vendin e punës të sigurt. Në të kaluarën, mediat kanë raportuar raste të dhunës ndaj grave gjatë zgjedhjeve dhe në politikë, përfshirë edhe raste kur ndaj grave kandidate u ushtrua presion që të jepnin dorëheqjen dhe të mos zinin vendet e tyre si deputete në parlament, si dhe raste të sulmeve fizike ndaj grave kandidate në tubimet gjatë fushatave zgjedhore. Megjithatë, mediat shpesh kontribuojnë në delegjitimizimin e grave si aktore të mundshme politike, duke i portretizuar gratë në jetën publike në mënyrë të seksualizuar, duke raportuar pretendime për jetën e tyre private, ose duke u fokusuar në veshjen dhe pamjen e tyre dhe jo në punën dhe kontributet e tyre të rëndësishme në shoqëri. Megjithëse gratë përbënin 40 për qind të kandidatëve për deputetë në Kuvend, gjatë periudhës parazgjedhore atyre iu dedikua vetëm 22 për qind e kohës mediatike, me 78 për qind të kohës kushtuar kandidatëve meshkuj. Monitorimi sasior tregoi një angazhim shumë të ulët të mediave për çështjet e të drejtave të grave dhe barazisë gjinore. Çështje si: të drejtat seksuale dhe riprodhuese, dhuna ndaj grave, të drejtat ekonomike, kulturore dhe sociale të grave, ose pjesëmarrja e grave në politikë u diskutuan vetëm në dy për qind të artikujve të shtypit ose emisioneve për zgjedhjet gjatë periudhës parazgjedhore; vetëm në një për qind të tyre gjatë periudhës zgjedhore dhe paszgjedhore; dhe në dy për qind të tyre gjatë periudhës së formimit të kabinetit të ri të ministrave.<sup>368</sup> Një monitorim i ngjashëm po kryhet për zgjedhjet e përgjithshme të vitit 2025 (për periudhën gjatë fushatës dhe pas zgjedhjeve, deri në formimin e Këshillit të Ministrave) për të vlerësuar ndikimin e dinamikave zgjedhore dhe mediatike tek gratë kandidate dhe për të identifikuar tendencat e barrierave me bazë gjinore në angazhimin politik. Të dhënat paraprake tregojnë se, ndonëse kuotat zgjedhore kanë përmirësuar

367. Përgatitur nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori) dhe mbështetur nga UN Women Shqipëri në kuadër të programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara «Të japi fund dhunës ndaj grave dhe vajzave» financuar nga Qeveria e Suedisë përmes fondit të përshejtit të OZHQ-ve në Shqipëri. Shih: [https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2022-06/media\\_brief\\_web.pdf](https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2022-06/media_brief_web.pdf)

368. "Vlerësim gjithëpërfshirës kombëtar mbi zbatimin e platformës për veprim të Pekinit - Shqipëria", f. 64. Shih: [https://www.unwomen.org/sites/default/files/2024-09/b30\\_report\\_albania\\_en.pdf](https://www.unwomen.org/sites/default/files/2024-09/b30_report_albania_en.pdf)

përfaqësimin formal të grave në listat e partive, mbulimi nga mediat mbetet barrierë e rëndësishme ndaj pjesëmarrjes së tyre të njëmendtë. Analiza e gjashtë emisioneve më kryesore të debateve dhe diskutimeve politike tregoi se burrat përbënin 75 për qind të të ftuarve, duke dominuar në role kyçe si kandidatë, analistë dhe gazetarë. Kjo mungesë e vazhdueshme balance gjinore kufizon aksesin e grave në agjendën publike dhe pengon aftësinë e tyre për të ndikuar në diskursin politik.<sup>369</sup>

Pavarësisht nga prania e grave kandidate në fushatë zgjedhore, çështjet e barazisë gjinore përgjithësisht nuk u përfshinë në debatet televizive dhe diskursin e fushatës. Nga 55 emisione televizive me debate politike, vetëm pesë trajtuan realisht tema që lidheshin me gjininë. Një shqetësim kryesor ishte shkalla e abuzimit gjinor në internet. Analiza e 100.755 komenteve për postimet e grave kandidate në Facebook, tregoi se 5,5 për qind e tyre (5.561 komente) përmbanin gjuhë armiqësore, ofenduese ose diskriminuese. Në shënjestër ishin si kandidatet me profil të njohur, ashtu edhe ato më pak të njohura, dhe komentet abuzive shpesh fillonin menjëherë pas shpalljes së kandidaturës prej tyre.<sup>370</sup> Këto komente, që ndërthurnin identitetin politik dhe të gjinorizuar, tregojnë se platformat në internet nuk janë vetë kanale komunikimi, por edhe hapësira aktive të armiqësisë gjinore. Mungesa e moderimit dhe toleranca e lartë ndaj përmbajtjes toksike në media në internet mundësoi përhapjen e mizogjinisë dhe disinformimit, duke minuar legjitimitetin dhe pjesëmarrjen e grave në politikë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në bashkëpunim me Komisionerin për Mbrojtje nga Diskriminimi, kreu studimin “Dhuna ndaj grave në politikë”<sup>371</sup> gjatë vitit zgjedhor 2021, me fokus mbi aspekte si gjuha seksiste dhe diskriminuese gjatë fushatës zgjedhore. Analiza tematike identifikoi forma të ndryshme dhune që përjetojnë gratë në vendimmarrje politike, si gjuha përbuzëse dhe fyese; ndërprerja e fjalës, tallja, ofendimet, shakatë; akuza të rreme në media; kërcënime; vënia në dyshim e aftësive të tyre; heqja nga lista e kandidatëve të partisë; mohimi i aksesit në fondet e partisë gjatë fushatave të zgjedhjeve; heqja ose kërcënimi për heqje nga poste qeveritare (për to ose anëtarët e familjeve të tyre); akuzat e rreme dhe

thashethemet e natyrës seksuale; ngacmimi seksual; mospërfillja gjatë mbledhjeve; konsiderimi i kontributit të tyre si me rëndësi të vogël ose pa rëndësi; kufizimi i rolit në votimin e vendimeve të paracaktuara; manipulimi i votave të grave gjatë procedurës së votimit; dhe përjashtimi nga informacioni, etj. Në rastet kur gratë kanë kërkuar pozita udhëheqëse në parti, partia e tyre ka qenë burimi kryesor i dhunës. Bazuar në këto konstatime, Avokati i Popullit bëri rekomandime për partitë politike, organizatat politike të grave, Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, OSHC-të, institucionet e të drejtave të njeriut dhe mediat.

Pengesa ndaj arritjes së balancës gjinore në politikë shihen edhe në shtetet e BE-së. Sipas dokumentit të Parlamentit Evropian “Gratë në politikë në BE – situata në vitin 2024” faktorë kryesorë që ndikojnë në vendimet e grave për t’u marrë ose jo me politikë janë perceptimi i politikës nga gratë si një fushë e dominuar nga burrat ose jomiqësore, aksesin e pabarabartë në burime kyçe, përgjegjësitë familjare të pabarabarta, kultura politike në parti dhe parlamente e dominuar nga meshkujt, rolet gjinore dhe stereotipet në shoqëri, dhe mungesa e shembujve të grave për t’u ndjekur si model. Niveli i abuzimit dhe dhunës ndaj grave në jetën politike dhe publike është shqetësim në rritje, sidomos sepse i shkurajon gratë që të merren me politikë, sepse mjedisi është tepër toksik. Për të rritur numrin e grave që kandidojnë dhe zgjidhen, është shumë i rëndësishëm zbatimi i formave të ndryshme të kuotave gjinore, mbështetja e posaçme e tyre, trajnimi i grave se si të kandidojnë për poste, aksesin e barabartë në fonde për fushatë, dhe luftimi i stereotipeve gjinore dhe dhunës ndaj grave në politikë.<sup>372</sup> Përveç kësaj, sipas dokumentit të Parlamentit Evropian të vitit 2024 “Dhuna ndaj grave aktive në politikë në BE: pengesë serioze për pjesëmarrjen në politikë” dhuna ndaj personave aktivë në politikë – qoftë burra apo gra – përbën një pengesë madhore ndaj ushtrimit të të drejtave dhe lirive politike dhe është shkelje e rëndë e të drejtave njerëzore bazë. Polarizimi në rritje i shoqërive liberale është shoqëruar me dhunë në rritje ndaj aktorëve politikë në përgjithësi. Duke pasur parasysh pasojat e rënda të dhunës ndaj grave në politikë në veçanti, ky problem duhet të kuptohet dhe trajtohet në mënyrë të veçantë. Kur dhuna politike vë në shënjestër gratë për shkak të seksit së

369. Rrjeti “Barazi në vendimmarrje” dhe BIRN, Shqipëri, me mbështetjen e UN Women Shqipëri 2025. “Raport paraprak për tendencat: Dhuna me bazë gjinore ndaj grave në politikë”, draft i pabotuar.

370. Po aty.

371. Mbështetur me ekspertizën teknike të UNDP në kuadër të programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara “T’i japim fund dhunës ndaj grave në Shqipëri”, financuar nga qeveria e Suedisë.

372. Dokumenti i Parlamentit Evropian “Gratë në politikë në BE – Gjendja në vitin 2024”. Shih: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2024/760348/EPRS\\_BRI\(2024\)760348\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2024/760348/EPRS_BRI(2024)760348_EN.pdf)

**Tabela 7****Përqindja e grave në pozicione të larta drejtuese në shërbimin civil**

	2020	2021	2022	2023
Administratore të larta	45.2	49.7	53.8	53.8
Administratore të nivelit të parë	36.2	42.5	46.8	46.8
Administratore të nivelit të dytë	48.8	51.9	56.6	56.6

Burimi: Instituti Evropian për Barazi Gjinore, IEBGJ

tyre, duke marrë forma seksiste dhe të seksualizuara, me synimin që të dekurajojë pjesëmarrjen e grave në politikë - kjo ka ndikim tejet negativ edhe për praninë e grave në jetën politike në përgjithësi. Dhuna ndaj grave në politikë merr forma të ndryshme, që nga sulmet fizike deri në abuzimet psikologjike dhe simbolike, si komentet seksuale dhe seksiste, gjuha e urrejtjes në internet dhe ngacmimi seksual. Kjo lloj dhune u shkakton grave shqetësim të madh psikologjik, duke i dekurajuar dhe duke bërë që ato të tërhiqen nga mbrojtja e pozitave të tyre.<sup>373</sup>

### 3.4.3 Gratë në qeveri

Përfaqësimi i grave në nivel ministror është i lartë në Shqipëri, me **nëntë ministre nga 17 ministra gjithsej në qeveri (53 për qind) në vitin 2024, që e vendos** Shqipërinë shumë më lart se **mesatarja globale prej 22,8 për qind gra ministre**.<sup>374</sup> Kabinetin qeveritar drejtohet nga Kryeministri dhe një zëvendëskryeministre. Në vitin 2024, nga pesë ministratë me buxhetin më të madh, tri drejtohen nga gra.<sup>375</sup> Kryenegociatorja për integrimin evropian është grua. Në vitin 2020, një deputete shqiptare u emërua për herë të parë në postin e zëvendëspresidentes së Asamblesë Parlamentare të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut.<sup>376</sup>

### 3.4.4 Gratë në funksione publike

Të dhënat e vitit 2021 për pjesëmarrjen e grave në misionet diplomatike tregojnë se në shërbimin diplomatik janë 30,8 ambasadore, 66,7 ministre fuqiptotë, 46,2 për qind ministre këshilltare, 63,6 për qind sekretare të para, 59 për qind sekretare të dyta dhe 50 për qind sekretare të treta.<sup>377</sup> Përfaqësimi i grave në pozita me rang të lartë në administratë është përmirësuar gjatë periudhës 2020-2023, siç shihet në tabelën 7.

### 3.4.5 Gratë në sistemin gjyqësor

**Gjykata Kushtetuese** në Shqipëri drejtohet nga një grua që nga viti 2019 dhe përbëhet nga nëntë anëtarë - gjashtë prej tyre (67 për qind) janë gra.<sup>378</sup> Gjatë historisë së Gjykatës Kushtetuese, në aspektin e përfaqësimit gjinor, deri në vitin 2019 numri i gjyqtareve ishte më i vogël se ai i gjyqtarëve.<sup>379</sup>

**Këshilli i Lartë Gjyqësor** drejtohet nga një burrë, ndërsa zëvendëse është një grua. Këshilli përbëhet nga 11 anëtarë, pesë prej të cilëve janë gra.<sup>380</sup>

**Këshilli i Lartë i Prokurorisë** drejtohet nga një grua dhe zëvendësi është një burrë. Dy nga nëntë anëtarët janë gra.<sup>381</sup>

373. Shih: [https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2024/759600/EPRS\\_BRI\(2024\)759600\\_EN.pdf](https://www.europarl.europa.eu/RegData/etudes/BRIE/2024/759600/EPRS_BRI(2024)759600_EN.pdf)

374. "Gratë në politikë: 2023." Shih: <https://www.unwomen.org/en/digital-library/publications/2023/03/women-in-politics-map-2023>

375. Pesë ministratë me buxhet më të lartë në vitin 2024 ishin Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Infrastrukturës dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, dhe Ministria e Mbrojtjes. Tri të parat drejtohen nga gra ministre. Shih: <https://arkiva.financa.gov.al/akti-normativ-nr-1-date-21-02-2024/>

376. Plani i Veprimit për Zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara "Për gruan, paqen dhe sigurinë" 2023-2027, f. 14.

377. INSTAT, "Burra dhe gra, 2023", f. 112. Shih: <https://www.instat.gov.al/media/12598/burra-dhe-gra-2023.pdf> and <https://www.parlament.al/>

378. Shih: [https://www.gjk.gov.al/web/Perberja\\_90\\_1.php](https://www.gjk.gov.al/web/Perberja_90_1.php)

379. Raporti vjetor i Gjykatës Kushtetuese, 2023, f. 11. Shih: [https://www.gjk.gov.al/web/raporti\\_vjetor\\_2023\\_gjk\\_2680.pdf](https://www.gjk.gov.al/web/raporti_vjetor_2023_gjk_2680.pdf)

380. Shih: <https://klgj.al/perberja-e-keshillit/>

381. Shih: <https://klp.al/stafi-yne/>

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë** drejtohet nga një burrë dhe përbëhet nga nëntë këshilltarë, gjashtë prej të cilëve janë gra (67 për qind); po kështu janë gra sekretarja e përgjithshme, asistent këshilltarja dhe sekretarja. Nga katër inspektorë magjistratë, tre (75 për qind) janë gra; nga pesë inspektorë jo-magjistratë, dy (40 për qind) janë gra, dhe nga gjithsej 21 ndihmës inspektorë, 11 (52,3 për qind) janë gra.<sup>382</sup>

**Gjykata e Lartë** drejtohet nga një burrë, dhe zëvendësi është gjithashtu burrë. Gjykata ka 15 anëtarë, nga të cilët vetëm katër (26,6 për qind) janë gra.<sup>383</sup>

**Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm** (e cila që prej 1 shkurtit 2023 funksionon si e vetmja gjykatë e apelit në Shqipëri) aktualisht përbëhet nga 78 gjyqtarë, por funksionin e ushtrojnë vetëm 28 gjyqtarë. Prej tyre, 20 (71,4 për qind) janë gra.<sup>384</sup>

**Gjykata e Shkollës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm**, ka 64 gjyqtarë në detyrë, nga të cilët 30 (46,8 për qind) janë gra.<sup>385</sup>

Në **Shkollën e Magjistraturës**, në krye të këshillit drejtues është një burrë; po kështu edhe zëvendëskryetari i këshillit është burrë. Nga 15 anëtarë, vetëm katër janë gra (26,7 për qind). Këshilli pedagogjik ka 17 anëtarë,

ndër të cilët drejtori i Shkollës së Magjistraturës, që është burrë, dhe katër anëtare gra (23,5 për qind).<sup>386</sup> Me kalimin e viteve, numri i studenteve konkurruese është rritur ndjeshëm krahasuar me studentët meshkuj (shih Tabelën 7), që do të çojë në një numër më të madh grash anëtare të gjyqësorit në të ardhmen. Me gjithë rritjen e dukshme të pranisë së grave në trupat prokuroriale dhe gjyqësore, dallimet gjinore vazhdojnë të ekzistojnë në shpërndarjen e kompetencave dhe të roleve drejtuese. Gratë janë përgjithësisht të mbipërfaqësuar në pozitat e nivelit të mesëm dhe ato teknike, ndërsa rolet drejtuese kyçe – sidomos në institucionet e niveleve më të larta, si Gjykata e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Shkolla e Magjistraturës – mbeten të dominuara nga burrat. Kjo sugjeron praninë e efektit të ‘tavanit të qelqtë’ që kufizon aksesin e grave në pushtetin vendimmarrës, me gjithë shtimin e numrit të tyre në profesion.

Problemi kryesor lidhur me gjininë i kapërcen kufijtë e thjesht përfaqësimit; ai përfshin edhe mungesën e mundësive strukturore të programuara që mbështesin ngjitjen e grave në postet me rang më të lartë në gjyqësor. Pa përpjekje të fokusuara për zhvillim profesional me ndjeshmëri gjinore – si, për shembull, përmes mundësive të mentorimit, zbatimit të kriterëve të drejta për avancim në karrierë, dhe përgjegjësisë organizative – Shqipëria

**Tabela 8**

**Postet drejtuese, tendencat e regjistrimit dhe të pranimit të studentëve në Shkollën e Magjistraturës**

Kategoria	2020		2021		2022	
	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra
Këshilli drejtues	8	6	8	6	11	4
Drejtor	1	0	1	0	1	0
Studentë konkurrues	97	180	82	176	93	224
Studentë fitues	26	50	25	42	26	51

Burimi: INSTAT, “Burra dhe gra në Shqipëri, 2023”.

382. Shih: <https://ild.al/en/office-of-the-high-inspector-of-justice/our-staff/>

383. Shih: <https://www.gjykataelarte.gov.al/sq/anetaret-e-gjykates-se-larte>

384. Shih: <https://gjykata.gov.al/apel-tiran%C3%AB/gjykata-e-apelit-tiran%C3%AB/gjykata/gjykat%C3%ABsit/>

385. Shih: <https://gjykata.gov.al/rrethi-tiran%C3%AB/gjykata-e-shkall%C3%ABs-s%C3%AB-par%C3%AB-e-juridiksionit-t%C3%AB-pergjithsh%C3%ABm-tiran%C3%AB/gjykata/gjyqtar%C3%ABt-e-gjykat%C3%ABs/>

386. Shih: <https://www.magjistratura.edu.al/en/keshilli-pedagogjik>

rrezikon që hierarkitë gjinore në gjyqësor të mbeten të pandryshuara. Për arritjen e barazisë së plotë duhet të shkohet përtej përfaqësimit numerik, me qëllim trajtimin e pabarazive në pushtet dhe në strukturat institucionale që pengojnë pjesëmarrjen e plotë dhe të drejtë të grave në pozitat e niveleve më të larta.

### 3.4.6 Gratë në sektorin e mbrojtjes dhe të sigurisë

#### Pjesëmarrja e grave në forcat e armatosura.

Në vitin 2022, gratë oficere përbënin 40,9 për qind të numrit total të grave të punësuar me gradë.<sup>387</sup> Në vitin 2023, numri i burrave në uniformë ishte 4.955 ndërsa i grave në uniformë ishte 899 (ose 15,3 për qind) (të dhëna shtesë jepen në tabelën 10).<sup>388</sup> Që nga viti 2019, Shqipëria ka kontribuar me gra ushtarake në misionin e Kombeve të Bashkuara në Sudanin e Jugut (UNMISS) – një nga operacionet e pakta paqeruajtëse në të cilat merr pjesë vendi. En shprehur në numër, në mision kanë marrë pjesë dy gra ushtarake në vitin 2020, një në vitin 2021, asnjë në vitin 2022, një në vitin 2023, dhe dy në vitin 2024. Ky mision është kanali kryesor përmes të cilit Shqipëria promovon pjesëmarrjen e grave në misione paqeruajtëse, në përputhje me angazhimet në kuadër të agjendës “Gratë, paqja dhe siguria”.

Pjesëmarrja e grave në forcat e armatosura pasqyron progresin gradual në avancimin profesional të tyre, por ende ka kufizime për shkak të barrierave strukturore. Ndonëse numri i grave oficere është shtuar, prania e tyre në forcat e ndryshme dhe në operacione mbetet e kufizuar. Pjesëmarrja e tyre sporadike në misione paqeruajtëse ndërkombëtare tregon se ende ekzistojnë probleme që lidhen me praktikatat e dislokimit, kulturën organizative dhe strukturat mbështetëse. Për të siguruar integritet të njëmendtë dhe të vazhdueshëm të grave, nevojiten përpjekje më të mëdha për zbatimin e politikave me ndjeshmëri gjinore në rekrutim, promovim dhe caktime në detyra operative, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Shqipërisë dhe aspiratat e saj për integritet në BE.

#### Pjesëmarrja e grave në strukturat e policisë

Numri i grave të punësuar në strukturat e policisë mbetet shumë i ulët, pa ndonjë progres të ndjeshëm gjatë pesë viteve të fundit. Në vitin 2022, nga 10.868 punonjës policie, 14,8 për qind ishin gra. Gratë janë të rralla në nivelin e drejtuesit madhor – deri më sot nuk ka pasur asnjë grua drejtuese madhore dhe në vitin 2022, vetëm një grua ishte në pozitën e drejtuesit. Numri i punonjëseve të policisë rritet në nivelet e gradave më të ulëta, me shifrat më të larta në gradat inspektor dhe

Tabela 9

### Të dhëna mbi personelin e forcave të armatosura sipas seksit, 2023

Kategoria	Gjithsej	Numri		Përqindja	
		Burra	Gra	% burra	% gra
Oficerë/e	1,762	1,386	376	78.7	21.3
Nënoficerë/e	2,652	2,293	359	86.5	13.5
Ushtarakë/e	1,438	1,276	162	88.7	11.3
Personel civil	1,748	1,094	654	62.6	37.4

Burimi: Ministria e Mbrojtjes, 2024.

387. INSTAT, “Burra dhe gra, 2023”, f. 106. Shih: <https://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2023/burra-dhe-gra-2023/>

388. “Vlerësim gjithëpërfshirës kombëtar mbi zbatimin e platformës për veprim të Pekinit - Shqipëria”, f. 111. Shih: [https://www.unwomen.org/sites/default/files/2024-09/b30\\_report\\_albania\\_en.pdf](https://www.unwomen.org/sites/default/files/2024-09/b30_report_albania_en.pdf)

**Tabela 10****Numri dhe përqindja e punonjëseve femra në strukturat e policisë sipas gradës, 2022**

Grada	Gjithsej punonjës	Gra punonjëse	Gra (%)
Drejtues madhor	1	0	0
Drejtues i lartë	7	0	0
Drejtues të tjerë	160	16	10
Kryekomisar	275	25	10
Komisar	495	49	10
Nënkomisar	1500	242	16
Inspektorë	7528	661	9.1
Civilë	1172	615	52.5

Burimi: INSTAT, "Burra dhe gra, 2023"

punonjës civil. Në vitin 2022, në numrin e gjithsejtë të grave të punësuar, inspektorët përbënin 9,1 për qind dhe punonjëset civile 52.5 për qind. Numri i burrave në strukturat e policisë është shumë më i lartë krahasuar me numrin e grave, me përjashtim të nivelit civil, ku numri i grave tejkalon atë të burrave.<sup>389</sup>

Në Akademinë e Sigurisë, të gjitha procedurat e konkurimit – si ato të rekrutimit, ngritjes në detyrë dhe specializimit – kryhen në përputhje me Rregulloren e Policisë së Shtetit,<sup>390</sup> sipas së cilës "Në kuotat e pranimit për çdo konkurim përcaktohen edhe kuotat për gjininë më pak të përfaqësuar, fëmijët e punonjësve të policisë që kanë rënë në krye të detyrës, dhe minoritetet."<sup>391</sup> Në të gjitha drejtoritë e rretheve u mbajtën takime me vajza dhe gra të reja nga drejtoritë vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për të promovuar sistemin e edukimit të Akademisë së Sigurisë dhe për të theksuar nevojën për gra dhe vajza në strukturat e Policisë së Shtetit.<sup>392</sup>

Në këto takime u vu re një rritje e pjesëmarrjes dhe interesit të vajzave dhe grave të reja për të hyrë në radhët e Policisë së Shtetit. Krahas kësaj, në vitin 2023 filloi aktivitetin Shoqata e Grave në Policinë e Shtetit,<sup>393</sup> e cila ka mbajtur takime konsultative në Drejtorinë e Antiterrorit, disa drejtori vendore të policisë, dhe në Akademinë e Sigurisë në lidhje me çështje të punonjësve të reja në Policinë e Shtetit.<sup>394</sup>

Me gjithë zbatimin e masave proaktive – përfshirë kuotat gjinore për regjistrimet në Akademi, programet e rekrutimit me fokus vajzat dhe gratë e reja dhe krijimi i Shoqatës së Grave në Policinë e Shtetit në vitin 2023 – provat që tregojnë për përmirësime të ndjeshme në rezultate janë të kufizuara. Ndonëse interesi dhe pjesëmarrja në rritje janë inkurajuese, nuk ka të dhëna të disponueshme publike që të pasqyrojnë ndonjë rritje të dukshme në regjistrimet e vajzave në Akademi dhe as tregues se numri i vajzave dhe grave që përfundojnë studimet ose që promovohen brenda radhëve të Policisë së Shtetit është rritur. Deri sa të

389. INSTAT, "Burra dhe gra, 2023", f. 105. Shih: <https://www.instat.gov.al/al/publikime/librat/2023/burra-dhe-gra-2023/>

390. Miratuar me VKM nr. 750, datë 16.09.2015, miratuar me VKM nr. 1143, datë 09.12.2020, ku "kuotat për konkurim" përcaktohen në nenin 128, paragrafi 2.

391. Ndryshuar (fjalë të shtuara në pikën 2) me VKM nr. 1143, datë 9.12.2020.

392. Në bazë të Urdhrit nr. 1426 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

393. Me vendim të gjykatës nr. 1124/1, datë 21.07.2023.

394. "Vlerësim gjithëpërfshirës kombëtar mbi zbatimin e platformës për veprim të Pekinit", f. 61-62. Shih: [https://www.unwomen.org/sites/default/files/2024-09/b30\\_report\\_albania\\_en.pdf](https://www.unwomen.org/sites/default/files/2024-09/b30_report_albania_en.pdf)

bëhet e mundur verifikimi i këtyre tendencave në terren – përmes shifrave për nivelet e regjistrimeve, diplomimeve dhe matjeve të avancimit në karrierë – do të jetë e vështirë të përcaktohet nëse këto programe vërtet po sjellin arritje të matshme në përfaqësimin e grave në të gjitha nivelet e forcave të policisë.

### 3.4.7 Trajtimi i hendekut gjinor në sektorët e infrastrukturës dhe TIK-ut

Pjesëmarrja dhe roli drejtues i grave në sektorët e infrastrukturës si ndërtimi, transporti, zhvillimi urban dhe TIK duhet të kërkojnë vëmendje të menjëhershme. Këto fusha dominohen në pjesën më të madhe nga burrat dhe rritja e rolit të grave është një mënyrë e rëndësishme për të ndrequr imbalancat gjinore dhe për të shtuar reagueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen në planifikimin dhe ofrimin e shërbimeve të infrastrukturës.

Krijimi i mundësive për gratë që të punojnë në profesione teknike, ose që të jenë në poste drejtuese dhe organe vendimmarrëse në këto fusha, shton cilësinë dhe barazinë në përdorimin e investimeve publike në fusha si mobiliteti, siguria dhe mundësitë ekonomike. Kjo vlen edhe për infrastrukturën digjitale, ku pjesëmarrja e grave në TIK dhe programim tashmë ka treguar që ka pasur ndikim të rëndësishëm. Për shembull, programime të drejtuara nga gratë kanë krijuar me sukses platforma digjitale cilësore, duke theksuar vlerën e udhëheqjes përfshirëse krahas vlerës së aftësive teknike. Për avancimin e kësaj agjende nevojiten integrimi i politikave reaguese gjinore në sistemet e prokurimit dhe planifikimit publik, investime për trajnime të grave në lidhje me aftësitë drejtuese dhe teknike, si dhe nxitja e përfaqësimit përfshirës në planifikim urban dhe në strukturat drejtuese që kanë të bëjnë me infrastrukturën..

### 3.4.8 Akte ligjore kyçe të BE-së

BE-ja ka krijuar një kuadër solid ligjor dhe të politikave për promovimin e **pjesëmarrjes, rolit udhëheqës dhe vendimmarrjes së barabartë** për gratë në sektorin politik, ekonomik dhe të biznesit. Megjithatë nuk ka një direktivë të posaçme që përcakton me ligj balancën gjinore në përfaqësimin politik, një numër direktivash dhe politikash të rëndësishme e mbështesin këtë synim në mënyrë të t

hortë. Një listë e detajuar e tyre gjendet në Shtojcën 3.

Krahas direktivave, *acquis*-i i BE-së përfshin komunikata, rezoluta dhe udhërrëfyes, ndër të cilët edhe Udhërrëfyesi Evropian për të Drejtat e Grave COM/2025/97, që promovon të drejtat universale të çdo gruaje për pjesëmarrje të lirë dhe të sigurt në jetën publike. Gjithashtu, BE-ja e konsideron Rezolutën 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së “Për gratë, paqen dhe sigurinë” si pjesë integrale të kornizave të tij të politikave të jashtme dhe të sigurisë, me rrjedhoja të drejtpërdrejta për integrimin gjinor në forcat e armatosura dhe në misionet paqeruajtëse. **Strategjia e BE-së për Barazinë Gjinore 2020-2025**,<sup>395</sup> si dhe komunikata të ndryshme të Komisionit Evropian dhe rezoluta të Parlamentit Evropian, nxisin aktivisht **kuotat gjinore, përfaqësimin e barabartë politik dhe fonde për gratë kandidatë**. Vendosja e kuotave gjinore në zgjedhjet parlamentare dhe vendore në Shqipëri ka rezultuar vetëm në përfshirje formale, në vend të pjesëmarrjes aktive të tyre. Normat sociale me rrënjë të thella, strukturat patriarkale në partitë politike, dhe dhuna me bazë gjinore, vazhdojnë të pengojnë angazhimin e plotë të grave në sferën politike.

Për të siguruar angazhim ndaj parimeve të BE-së në të gjithë Evropën, harmonizimi ligjor duhet të përfshijë ndërtimin e institucioneve, mekanizmat zbatues, dhe skema mbështetëse të fokusuar. Këto nisma duhet të përfshijnë masa për sigurimin e llogaridhënies në rastet e akteve të diskriminimit, të forcojnë mbrojtjen e grave në sferën politike, dhe të ndikojnë në krijimin e një mjedisi që ushqen pjesëmarrjen aktive dhe të barabartë të grave në të gjitha nivelet e proceseve të vendimmarrjes publike.

### 3.4.9 Rekomandime

- 1. Të forcohen dhe tejkalohen kuotat gjinore në politike dhe qeverisje.** Shqipëria duhet të rishikojë dhe forcojë ligjin për kuotat gjinore për të përmirësuar përmbushjen e standardeve të BE-së për barazinë gjinore, që kërkojnë paritet me përfaqësim prej të paktën 40 për qind për gjininë e nënpërfaqësuar. Kuotat e tanishme, të caktuara në nivelin 30 për qind, nuk janë të mjaftueshme për përmbushjen e këtij kriteri dhe mundësojnë vazhdimin e pabarazive strukturore, ku burrat vazhdojnë të dominojnë në sferat politike dhe të vendimmarrjes. Është e domosdoshme të bëhen ndryshime në kuadrin ligjor, me qëllim që

395. Shih: <https://ec.europa.eu/newsroom/just/items/682425/en>

të sigurohet një minimum përfaqësimi i grave në nivelin 40 për qind, mbështetur me mekanizma të fuqishëm dhe efektivë që sigurojnë zbatimin dhe shkurajojnë moszbatimin e tyre. Megjithatë, krahas përmbushjes së këtij kriteri minimal, Shqipëria duhet të synojë edhe t'i tejkalojë këto kuota, me qëllim që të promovojë një qeverisje me të vërtetë përfshirëse dhe demokratike. Këto përpjekje duhet të përfshijnë të gjitha gratë – pavarësisht nga partitë politike, rajoni gjeografik, grupmosha ose prejardhja sociale e tyre – dhe të përforcohen me përpjekje për pakësimin e barrierave, si dhuna politike, mungesa e fondeve për fushatë, dhe rezistenca brenda partisë.

**2. Të sigurohet përfaqësim i grupeve të nënpërfaqësuar.** Partitë politike duhet të sigurojnë përfshirjen e grupeve të nënpërfaqësuar – si për shembull, gratë me aftësi të kufizuara, gratë rome dhe egjiptiane, vajzat e reja, dhe gratë nga zonat rurale – në pajtim me angazhimet e Shqipërisë në kuadër të KEGJFDG-së, Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Ligjit "Për barazinë gjinore në shoqëri".

**3. Të luftohet dhuna kibernetike dhe diskriminimi gjinor në politikë** duke bërë përmirësimet e nevojshme në legjislacionin për penalizimin e këtyre formave të dhunës, si edhe përmes përdorimit të mjeteve dhe metodave specifike që kanë rezultuar të suksesshme në Evropë. Ndër masat dhe mjetet me potencial për të përmirësuar ndjeshëm situatën janë hartimi ose zgjerimi i rregulloreve procedurale dhe kodeve të sjelljes që trajtojnë problemin e dhunës; vendosja e procedurave ankimore konfidenciale; denoncimi publik i të gjitha formave të dhunës ndaj grave në politikë; rritja e ndërgjegjësimit përmes deklaratave publike, aktivizmit dhe fushatave; marrja e masave për të siguruar që organet zgjedhore të monitorojnë dhunën ndaj grave në politikë; sigurimi që sistemet e paralajmërimit të hershëm për dhunën zgjedhore të jenë të ndjeshme në lidhje me dhunën ndaj grave në politikë; organizimi i fushatave të shoqërisë civile për edukimin e njerëzve në lidhje me rreziqet e dhunës ndaj grave në politikë; përmirësimi i aksesit të grave në fonde të partive politike për të siguruar kushte të barabarta konkurrimi; dhe

sigurimi i trajnimeve të specializuara të nevojshme për organet ligjzbatuese dhe ato gjyqësore për identifikimin, hetimin dhe ndjekjen penale të efektshme të dhunës me bazë gjinore në internet.

**4. Të trajtohet problemi i dallimeve në financim në fushatë e zgjedhjeve.** Trajtimi i barabartë në financim është me rëndësi kritike për gratë kandidatë. Kodi Zgjedhor i Shqipërisë nuk rregullon shpërndarjen e fondeve publike, ose të fondeve të tjera private, ndër kandidatët brenda partive, duke i lënë gratë në pozitë të pafavorizuar. Shumë gra kandidatë nuk kanë akses të barabartë në fonde për fushatë për shkak të barrierave strukturore dhe stereotipeve gjinore në ngritjen e fondeve. Për të parandaluar diskriminimin financiar, partitë politike duhet (i) të miratojnë rregullore të brendshme që sigurojnë akses të barabartë të grave kandidatë në fondet për fushatë<sup>396</sup> dhe (ii) të sigurojnë transparencë të plotë në shpërndarjen e fondeve brenda partive.

**5. Të prezantohen kuotat ligjore për gratë në drejtimin e bizneseve/korporatave** në përputhje me Direktivën (BE) 2022/2381 "Për gratë në borde". Masat duhet të përfshijnë raportimin e detyrueshëm mbi diversitetin gjinor, stimujt për kompanitë që promovojnë balancën gjinore, dhe gjoba për mospërmbushjen e tyre. Rritja e pjesëmarrjes së grave në pozita ekzekutive dhe në nivelin e bordeve është me rëndësi kyçe për avancimin e barazisë gjinore në vendimmarrjen ekonomike.

**6. Të forcohen politikat për balancën punë-jetë, për të nxitur** përparimin e grave në karrierë, duke inkurajuar burrat që të marrin leje prindërore, që rrjedhimisht redukton ngarkesën e grave me punë të përkuqjesit. Zgjerimi i skemave të punës fleksibël dhe përmirësimi i aksesit në shërbime publike të kujdesit për fëmijët do t'u mundësojë më shumë grave që të kandidojnë për role drejtuese pa u ndikuar në mënyrë shproporcionale nga përgjegjësitë familjare të tyre. Krahas këtyre, zbatimi i të gjitha masave dhe veprimeve të renditura në SKBGJ 2021-2030 në lidhje me këtë temë do ta përmirësojë situatën aktuale.

**7. Të promovohet përfaqësimi i grave në organet**

396. Po aty.

**e sigurisë dhe të rendit** përmes rekrutimeve të posaçme, programeve të mentorimit dhe trajnimit për role drejtuese, për rritjen e pjesëmarrjes së tyre në këta sektorë që tradicionalisht janë dominuar nga burrat. Për të ndrequr mungesën e balancës në këtë drejtim është e rëndësishme që të sigurohen mundësi të barabarta promovimi dhe mbështetje institucionale.

#### **8. Të shtohet mbështetja për gratë sipërmarrëse dhe akses i tyre në financim,**

për të siguruar akses të barabartë në burime financiare, mundësi investimi dhe trajnime për biznesin. Nismat e sektorit publik dhe privat duhet të krijojnë mundësi për vendosje të lidhjeve në rrjete, mundësi investimi dhe programe për ndërtimin e kapaciteteve, për të fuqizuar më shumë gra që të hyjnë dhe të kenë sukses në sektorin e biznesit, sidomos në sektorët jotradicionalë.

#### **9. Të përmirësohen mekanizmat e monitorimit dhe llogaridhënies**

për të parë ecurinë e përpjekjeve për arritjen e barazisë gjinore në të gjithë sektorët. Institucione si Komisioneri për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të marrin më shumë kompetenca në lidhje me zbatimin e rregulloreve për balancën gjinore dhe ndëshkimin e efektshëm të shkeljeve

#### **10. Të kundërshtohen stereotipet gjinore përmes edukimit dhe rritjes së ndërgjegjësimit**

në shkolla, universitete dhe vendet e punës, për të promovuar barazinë gjinore, aftësitë drejtuese, dhe fuqizimin e vajzave që në moshë të hershme. Po kështu, organizatat e mediave duhet të inkurajohen që t'i japin përparësi përfaqësimit të drejtë të grave në role drejtuese. Parandalimi, frenimi dhe ndalimi i stereotipeve të dëmshme gjinore në media, arsim dhe diskutime publike janë me rëndësi themelore për promovimin e pjesëmarrjes së plotë të grave në jetën politike dhe publike.

#### **11. Të forcohen bashkëpunimi rajonal dhe shkëmbimi i praktikave më të mira**

përmes bashkëpunimit aktiv

me shtetet e BE-së dhe të Ballkanit Perëndimor për shkëmbimin e praktikave të mira dhe mësimet të nxjerra nga puna për promovimin e barazisë gjinore në vendimmarrje. Angazhimi me institucionet e BE-së, organizatat e shoqërisë civile dhe partnerët ndërkombëtarë do të ofrojë mundësi për përmbushjen e standardeve evropiane të barazisë gjinore dhe zbatimin e reformave efektive të politikave.

Rekomandimet mësipërme janë në përputhje me, dhe mbështesin, zbatimin e rekomandimeve të **KEGDG-së dhe të RPU-së** për Shqipërinë në lidhje me pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, sikurse përmendet më poshtë.

**Komiteti i KEGJFDG-së**, në rishikimin e pestë periodik të Shqipërisë,<sup>397</sup> thekson nevojën për përmirësimin e masave për forcimin e pjesëmarrjes së grave në role udhëheqëse dhe vendimmarrje politike. Në pajtim me rekomandimin e përgjithshëm nr. 23 mbi jetën politike dhe publike dhe objektivin 5.5 të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), Komiteti thekson veprimet kyçe që duhet të ndërmerren për arritjen e paritetit gjinor në qeverisje:

- Së pari, Komiteti rekomandon programe për ndërtimin e kapaciteteve për t'i pajisur gratë kandidate me aftësi në drejtim dhe zhvillimin e fushatave, si dhe për t'u siguruar akses në fonde për zhvillimin e fushatave<sup>398</sup> për reduktimin e barrierave ekonomike ndaj pjesëmarrjes.
- Gjithashtu, ai bën thirrje për masa të veçanta të përkohshme, si kuotat e detyrueshme dhe një sistem pariteti gjinor, për të siguruar përfaqësim të barabartë të grave në parlament, këshilla bashkiakë, qeveri, shërbimin civil dhe shërbimin e jashtëm. Këto masa duhet të kenë në fokus gratë nga grupet e marginalizuara, gratë e zonave rurale, gratë me aftësi të kufizuara, pakicat etnike dhe individët LGBTIQ+.<sup>399</sup>
- Komiteti thekson më tej rëndësinë e luftimit të diskriminimit me bazë gjinore në ligjërimit politik, sidomos gjuhën e urrejtjes dhe ngacmimet ndaj

397. Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit të Grave, (2023) "Vërejtjet përmblylëse mbi raportin e pestë periodik të Shqipërisë" (CEDAW/C/ALB/5). Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave, Kombet e Bashkuara <https://www.ohchr.org/documents/treaties/KEGJFDG>.

398. CEDAW/C/ALB/5, f. 8 neni 28 (a).

399. CEDAW/C/ALB/5, f. 8 neni 28 (b).

grave politikane. Ai nxit Shqipërinë të forcojë mekanizmat e raportimit dhe monitorimit, kërkon nga partitë politike të miratojnë kode sjelljeje që promovojnë barazinë gjinore dhe i vënë mediat para përgjegjësisë për përmbajtje diskriminuuese.<sup>400</sup>

- Komiteti i KEGJFDG-së shpreh gjithashtu shqetësimin se Shqipëria nuk ka zbatuar plotësisht masa të veçanta të përkohshme për promovimin e barazisë gjinore në jetën politike dhe publike. Ai thekson se, ndonëse kuotat gjinore ekzistojnë, nevojiten masa më të gjera për të trajtuar problemin e nënpërfaqësimit të grave, sidomos të atyre që përballen me forma të shumëfishta diskriminimi, si gratë e zonave rurale, gratë me aftësi të kufizuara dhe ato nga pakicat etnike (rekomandimi nr. 19).<sup>401</sup>
- Komiteti nxit Shqipërinë të miratojë masa të veçanta të përkohshme shtesë, përtej kuotave, për të përshpejtuar barazinë reale mes grave dhe burrave dhe pjesëmarrjen e njëmendtë të të gjitha grave në vendimmarrjen politike (rekomandimi nr. 20).<sup>402</sup>

Konstatimet e Komitetit të KEGJFDG-së plotësohen nga **Rishikimi Periodik Universal (RPU)** i cili gjithashtu nxit Shqipërinë që të:

- Promovojë përfaqësimin e grave në të gjitha nivelet e administratës publike dhe të shtojë praninë e tyre në sektorin privat.<sup>403,404</sup>
- Të ndër marrë reforma ligjore për të parandaluar dhunën me bazë gjinore në politikë,<sup>405</sup> përmes trajtimit të stereotipeve gjinore në ligjërimin politik dhe në media<sup>406</sup> dhe alokimit të fondeve publike për politika të fokusuar gjinore që synojnë reduktimin e pabarazive gjinore.<sup>407</sup>

400. CEDAW/C/ALB/5, f. 8 neni 28 (c).

401. CEDAW/C/ALB/5, f. 5 neni 19.

402. CEDAW/C/ALB/5, f. 6 neni 20.

403. Këshilli i të Drejtave të Njeriut (20 dhjetor 2024). "Raporti i grupit të punës mbi Raportin Periodik Universal: Shqipëria" (Seanca e 58-të, Pika 6 e rendit të ditës); A/HRC/58/5, Rekomandimi 124.137, f.18.

404. A/HRC/58/5, Rekomandimi 124.138, f.18.

405. A/HRC/58/5, Rekomandimi 124.176 p.20.

406. A/HRC/58/5, Rekomandimi 124.144 p.18.

407. A/HRC/58/5, Rekomandimi 124.141, f.18.

408. Grupi i Bankës Botërore (2024), "Raport për klimën dhe zhvillimin: Shqipëria", shih:<https://openknowledge.worldbank.org/server/api/core/bitstreams/5a7fd970-4855-4ec0-8423-152cf0656ea8/content>

409. Në veçanti (i) në lidhje me ekonominë qarkore, me ngritjen e Agjencisë Kombëtare të Ekonomisë së Mbetjeve; (ii) në lidhje me cilësinë e ujit, me miratimin e ligjeve mbi burimet ujore dhe mbrojtjes së mjedisit detar dhe tre plane për menaxhimin e baseneve ujore; dhe (iii) në lidhje me mbrojtjen civile, me miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030. Megjithatë, miratimi në vitin 2024 i ndryshimeve në Ligjin "Për zonat e mbrojtura" konsiderohet zhvillim negativ dhe nuk pati ndonjë zhvillim të veçantë në drejtim të trajtimit të ndryshimeve klimatike.

410. Komisioni i BE-së (2024), "Raport i BE-së 2024", [https://enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024\\_en](https://enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en)

411. UN Women (2022). "Reduktimi i riskut nga fatkeqësitë". Shih: <https://www.unwomen.org/en/what-we-do/humanitarian-action/disaster-risk-reduction>.

## 3.5 GJINIA, MJEDISI, DHE NDRYSHIMET KLIMATIKE

### 3.5.1 Përmasat gjinore të ndryshimeve klimatike dhe degradimit të mjedisit

Shqipëria ka treguar përkushtim për kryerjen e përshtatjeve në përgjigje të ndryshimeve klimatike dhe zbutjen e efekteve të tyre përmes masave ligjore dhe politike, si dhe përmes formulimit të objektivave dhe planeve të veprimit specifike sektoriale, me fokus në fusha si energjetika, transporti, bujqësia dhe ekosistemet bregdetare. Me gjithë këto përpjekje, zbatimi i masave për përshtatjen ndaj klimës nuk ka ecur mjaftueshëm pas dhe integrimi i konsideratave të ndryshimeve klimatike në sektorë të ndryshëm përballlet me vështirësi për shkak të mungesës së burimeve financiare dhe kapaciteteve institucionale.<sup>408</sup> Në raportin e fundit të progresit, BE-ja pranon se Shqipëria është disi e përgatitur për të përballuar ndryshimet klimatike, duke vënë në dukje disa zhvillime në masat relevante ligjore dhe të politikave.<sup>409</sup> Megjithatë, harmonizimi me *acquis*-in e BE-së dhe kapacitetet e vendit për të përfshirë ndryshimet klimatike në strategjitë dhe planet sektoriale vazhdojnë të jenë në nivel të ulët.<sup>410</sup>

Gratë dhe vajzat ndikohen në mënyrë disproporcionale nga degradimi i mjedisit dhe kërcënimet e shaktuara prej ndryshimeve klimatike. Në të gjitha aspektet – që nga pritshmëria e jetëgjatësisë, tek arsimit, strehimi, shëndetësia, siguria, siguria e punësimit dhe ushqyerja – gratë dhe vajzat ndikohen shumë më tepër se burrat. Dhe megjithatë, gratë janë përgjithësisht të përjashtuara nga politikat, strategjitë dhe programet që trajtojnë problemet e ndryshimeve klimatike dhe të qëndrueshmërisë mjedisore.<sup>411</sup> Kjo është e vërtetë edhe për gratë në

Shqipëri, të cilat vitet e fundit kanë pasur mjaft pasoja nga një numër fatkeqësish natyrore, përfshirë edhe ato të shkaktuara nga ndryshimet klimatike.

Në Shqipëri analizat mbi ndikimin e ndryshëm të ndryshimeve klimatike tek gratë dhe burrat janë të kufizuara. Sipas një studimi të kryer në kuadër të Komunikimit të Katërt Kombëtar (KK4), 39 për qind e të anketuarve besojnë se ka dallime midis aftësive të grave dhe të burrave për t'iu përgjigjur ndryshimeve klimatike. Deri më tani, analizat në këtë fushë janë fokusuar kryesisht tek bujqësia – një sektor ku mbizotëron puna fizike dhe ku gratë janë mjaft të angazhuara. Prodhimi bujqësor dhe tokat e punueshme bujqësore në Shqipëri janë mjaft të varura nga kushtet klimatike dhe janë të parat që dëmtohen nga proceset e trajtimit të mbetjeve, si për shembull djegia e tyre. Për shembull, djegësi i mbetjeve në fshatin Vërrit të Fierit ka shkaktuar rënie të prodhimit në tokat bujqësore përreth tij. Ky shqetësim u përmend sidomos nga gratë e asaj zone, të cilat i ndjenë drejtpërdrejt pasojat e djegësit në të ardhurat e tyre.<sup>412</sup>

Gjithashtu, anketimi në kuadër të KK4 identifikoi rritjen e dhunës ndaj grave dhe shtimin e orëve të shpenzuara nga gratë për punët e shtëpisë si ndikime kryesore të ndryshimeve klimatike në jetën e grave. Gratë raportuan edhe rritje më të madhe të problemeve shëndetësore, fizike dhe emocionale krahasuar me burrat, pas fatkeqësive të lidhura me klimën. Në veçanti, gratë shtatzëna ndikohen në mënyrë disproporcionale nga problemet në akses në shërbimin shëndetësor pas fatkeqësive natyrore.<sup>413</sup> Pas përmbytjeve, ato janë më të prira të preken nga bronkitet ose infeksionet, për shkak të punës për pastrimin e shtëpive me lagështirë. Po kështu, ekspozimi ndaj temperaturave të larta ka pasoja negative për gratë shtatzëna (efekte teratogjenike). Këto ndikime specifike gjinore ndërthuren me faktorë si përkatësia etnike, vendbanimi (sidomos në zonat ku banojnë popullatat më të cënueshme), varfëria dhe statusi i imigracionit.<sup>414</sup>

Cikli i menaxhimit të mbetjeve është një fushë tjetër ku dallimet gjinore janë mjaft të përhapura. Këto dallime

vijnë për shkak të përgjegjësive kryesore të grave në familje dhe varen nga perceptimet e ndryshme se çfarë përbën mbetje dhe çfarë jo, si dhe nga sjelljet e ndryshme konsumatore të grave dhe të burrave. Proceset e trajtimit të mbetjeve dhe ujërave të zeza ndikojnë në prodhim, ndotje industriale dhe sjelljet e familjeve, me pasoja të ndryshme për gratë dhe burrat. Për shembull, gratë ndikohen më shumë nga mungesa e trajtimit të ujërave të zeza dhe nga mosfunksionimi i sistemit të kanalizimeve, sepse gratë përgjithësisht janë më të rrezikuara nga kontaminimi krahasuar me burrat.<sup>415</sup>

### 3.5.2 Aftësia për përballimin e fatkeqësive natyrore

Shqipëria aktualisht është në proces konsolidimi të kuadrit të politikave të saj për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë në përputhje me Kornizën Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015-2030 (SFF ZRF). Baza ligjore kryesore në këtë fushë janë: Ligji nr. 49/2019 'Për mbrojtjen civile' me të cilin u krijua Agjencia Kombëtare për Mbrojtje Civile (AKMC); Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (2023-2030); Plani Kombëtar për Emergjencat Civile (2023); dhe Vlerësimi i Riskut nga Fatkeqësitë në Nivel Qendror dhe Vendor (2023). Me gjithë përmirësimet, Shqipërisë ende i duhet të forcojë sistemin e mbrojtjes civile nëpërmjet rishikimit të planeve të emergjencës dhe përmirësimit të konsiderueshëm të kapaciteteve operacionale dhe infrastrukturës për paralajmërimin e hershëm dhe reagimin e shpejtë.<sup>416</sup> Kjo bëhet sidomos urgjente në kontekstin kur, ndër vendet Evropiane, Shqipëria ka një nga nivelet më të larta të riskut nga fatkeqësitë dhe mundësisë së goditjes nga tërmetet, përmbytjet, rrëshqitjet e tokës dhe zjarret masive, që kanë prekur 95 për qind të bashkive shqiptare në dy dekadat e fundit.<sup>417</sup>

Si rezultat i barrierave dhe pabarazive gjinore specifike, humbjet e jetës dhe të mjeteve të jetesës gjatë dhe

412. Rjeti i Monitorimit të Dhunës me Bazë Gjinore (2019), "Raporti i organizatave të shoqërisë civile për zbatimin e Platformës për Veprim të Pekinit në Shqipëri, Pekin +25". Shih: <https://rjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/wp-content/uploads/2020/01/shqiptar-OSHCs-report-on-the-implementation-of-PpVP.pdf>

413. Plani i rishikuar i Veprimit për Kontributin Kombëtar të Përcaktuar (2021) të Shqipërisë. Gjetendet në: <https://unfccc.int/sites/default/files/2022-08/Shqipëria%20Revised%20NDC.pdf>

414. UN Women Shqipëri (2023), "Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe ndryshimet klimatike", [https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-03/web\\_drr\\_14122023.pdf](https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-03/web_drr_14122023.pdf)

415. Ekipi i Kombeve të Bashkuara Shqipëri (2020). "Analizë e përbashkët e vendit". Shih: <https://albania.un.org/en/111493-albania-common-country-analysis-2020>; UN Women Shqipëri (2023), Zvogëlimi i Riskut nga Fatkeqësitë dhe Ndryshimet Klimatike, [https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-03/web\\_drr\\_14122023.pdf](https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-03/web_drr_14122023.pdf)

416. Komisioni i BE-së (2024), "Raporti i BE-së, 2024", [https://enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024\\_en](https://enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en)

417. Grupi i Bankës Botërore (2024), "Raporti për klimën dhe zhvillimin, Shqipëria". Shih: <https://openknowledge.worldbank.org/server/api/core/bitstreams/5a7fd970-4855-4ec0-8423-152cf0656ea8/content>

prej fatkeqësive janë më të shumta tek gratë, dhe atyre u duhet më shumë kohë të rimëkëmben. Në Shqipëri mungojnë studimet mbi ndikimin e këtyre ngjarjeve mbi gratë dhe burrat. Megjithatë, një numër raportesh tregojnë se gratë – sidomos ato që edhe më parë kanë qenë në situatë të cenueshme – preken më rëndë nga pasojat e rreziqeve natyrore dhe krizave shëndetësore të shkaktuara prej tyre.<sup>418</sup>

Vlerësimi i nevojave pas fatkeqësive (VNPF) që u krye pas tërmetit të vitit 2019, me qëllim vlerësimin e performancës së shërbimeve të ZRF-së, konstatoi se "... përgjigjja [ndaj tërmetit] u ndikua nga një varg cenueshmëri ekzistuese". Në veçanti, VNPF-ja vuri **në pah ndikimin** shproporcional të tërmetit tek gratë dhe vajzat në zonat e prekura dhe gjasat e rritjes së ngarkesës së punës së tyre, sidomos ndër gratë që jetojnë me familjet e tyre. Kjo për shkak të gjasave që gratë të shtyhen më tej drejt roleve dhe veprimtarive të tyre tradicionale, si kujdesi për fëmijët dhe anëtarët e moshuar apo të sëmurë të familjes, pastrimi, dhe kujdesi për atë çka ka mbetur prej banesave të tyre.<sup>419</sup>

Një vlerësim i shpejtë gjinor që u krye pas pandemisë së COVID-19 **në Shqipëri** tregoi se gratë u përballën me shumë më tepër kufizime se burrat për të pasur akses në ushqime (46 për qind kundrejt 43 për qind) **për shkak të mbylljes së tregjeve dhe reduktimit të orëve të punës të dyqaneve**. Më shumë gra se sa burra (51 për qind kundrejt 27 për qind) punuan nga shtëpia dhe jo nga vendi i zakonshëm i punës. Si pasojë e tronditjes së sigurisë ekonomike të grave, ngarkesa e tyre me punë të papaguar dhe punë shtëpie u rrit, me 76 për qind të grave që raportuan se shpenzonin më shumë kohë duke kryer punë shtëpie, krahasuar me 66 për qind të burrave. Përveç kësaj, ndikimi ishte më i madh edhe në shëndetin psikologjik dhe mendor të grave (69 për qind e grave kundrejt 57,5 për qind të burrave), dhe gratë u përballën me më shumë vështirësi në kërkimin e ndihmës mjekësore se sa burrat (55 për qind e grave kundrejt 45 për

qind të burrave).<sup>420</sup> Një studim i kohëve të fundit që u krye në zonat rurale të Lezhës konstatoi se gratë vazhdojnë të jenë tejet të cenueshme për sa i përket nivelit të gatishmërisë për përballimin e fatkeqësive për shkak të barrierave sistemike. Vetëm 2 për qind e grave dhe burrave e vlerësuan informacionin për paralajmërimin e hershëm si "shumë të aksesueshëm", ndërsa 9 për qind e grave dhe 18 për qind e burrave e vlerësuan atë si "jo shumë të aksesueshëm." Një për qind e grave dhe 2 për qind e burrave thanë se kishin marrë masa për të qenë të përgatitur, ndërsa 43 për qind e grave dhe 54 për qind e burrave nuk kishin ndërmarrë asnjë veprim. Këto dallime ekzistojnë për shkak të roleve tradicionale gjinore në zonat rurale të Shqipërisë, sepse gratë, që shpesh janë personat kryesorë që ofrojnë përkujdes, mund t'i kushtojnë më shumë vëmendje sigurisë, por nuk kanë burimet financiare për të ndërmarrë veprime. Krahas kësaj, vetëm 4 për qind e grave dhe 11 për qind e burrave konfirmuan se ndihma humanitare u ishte dhënë në kohë, që vë në pah përsëri dallimet gjinore në shpërndarjen e ndihmave. Për ta ngushtuar këtë hendek kërkohet bashkëpunim më i ngushtë mes institucioneve kërkimore, sektorit publik dhe atij privat, dhe organizatave humanitare. Ndër zgjidhjet kryesore janë hartimi i strategjive përfshirëse për paralajmërim të hershëm, komunikimi më i qartë, fushatat ndërgjegjësuese dhe praktikimi i ushtrimeve për përmirësimin e gatishmërisë dhe reagimit të barabartë gjinor.<sup>421</sup>

### 3.5.3 Konsiderata gjinore në kushtet e ndryshimeve klimatike, zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe kornizat zhvillimore

Në Shqipëri, legjislacioni dhe politikat kombëtare ende nuk trajtojnë mjaftueshëm hapat konkretë për integrimin e konsideratave të barazisë gjinore në politikat lidhur me ndryshimet klimatike. Ndonëse "Raporti i parë dyvjeçar i **përditësuar për Shqipërinë**" **përmban udhëzime**

418. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, GEF and UNDP (2021). "Raporti i parë dyvjeçar i përditësuar për Shqipërinë për Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Ndryshimet Klimatike (KKKBNK)". Shih: [https://unfccc.int/sites/default/files/resource/First%20Biennial%20Update%20Report%20for%20Shqipëria\\_EN.pdf](https://unfccc.int/sites/default/files/resource/First%20Biennial%20Update%20Report%20for%20Shqipëria_EN.pdf)

419. Kombet e Bashkuara, Shqipëri (2020). "Vlerësimi i nevojave pas fatkeqësive në Shqipëri". <https://albania.un.org/en/46378-albania-post-disaster-needs-assessment-pdna-volume-report-february-2020>

420. UN Women (2020). "Impakti i Covid-19 në jetën e grave dhe të burrave dhe në fitimin e jetesës në Evropë dhe në Azinë Qendrore: Rezultate paraprake nga një analizë e shpejtë gjinore". Shih: <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/07/the-impact-of-covid19-on-womens-and-mens-lives-and-livelihoods-0>

421. Bonner, I. (2024). "Ngushtimi i hendekut – analizimi i barrierave dhe forcimi i aftësive përballuese të komuniteteve të zonave më të thella përmes strategjive për paralajmërim të hershëm dhe gjithëpërfshirës në zonat rurale të Lezhës". Studim i financuar nga Qendra Globale e Gatishmërisë për Përballimin e Fatkeqësive e Kryqit të Kuq Amerikan). Shih: <https://preparecentre.org/wp-content/uploads/2025/01/Full-Paper-Inclusive-EWS-in-Albania.pdf>

**për përfshirjen e objektivave të barazisë gjinore në programet dhe planet për zbutjen dhe përshtatjen me ndryshimet klimatike, ato ende nuk janë reflektuar në të gjitha ligjet dhe politikat e kohëve të fundit që lidhen me klimën. Këtu përfshihen** Ligji nr. 155/2020 “Për ndryshimet klimatike”, Strategjia Kombëtare e Ndryshimeve Klimatike, Plani Kombëtar për Zbutjen e Pasojave (PKZP), Plani Kombëtar i Përshtatjes (PKP), të miratuar në vitin 2019.<sup>422</sup> Gjuha e përdorur në këto dokumente nuk është me ndjeshmëri gjinore, sidomos në pjesën e përshkrimit narrativ, dhe në to nuk përcaktohen objektiva ose veprime të posaçme me ndjeshmëri gjinore. Po kështu, konsideratat gjinore mungojnë edhe në politikat dhe planet e tjera të përshtatjes ndaj klimës si Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Turizmit (2019-2023), Dokumenti i Politikave për Pyjet në Shqipëri (2019-2030) dhe Plani i Integruar Ndërsektorial për zonën Tiranë-Durrës.<sup>423</sup> Plani i Veprimit për Tiranën e Gjelbër ka një seksion të posaçëm mbi përshtatjen dhe përfshin një sistem pikëzimi për vlerësimin *ex-ante* të impaktit të veprimeve të propozuara sipas pesë treguesve social-ekonomikë, ndër të cilët edhe barazia gjinore.<sup>424</sup> Megjithatë, nuk ka informacion të disponueshëm publikisht për mënyrën se si u bë vlerësimi fillestar i impaktit gjinor dhe as për monitorimin e impaktit gjinor të veprimeve në kuadër të këtij plani veprimi me kalimin e viteve.

Nga ana tjetër, kuadri ligjor për ZRF-në dhe reagimet në rast të emergjencave ka ndihmuar më shumë për trajtimin e pabarazive gjinore. Ligji nr. 45/2019 «Për mbrojtjen civile» përfshin disa konsiderata gjinore, si për shembull të drejtën e grave për të kërkuar mbrojtje dhe për t’u trajtuar me përparësi në përgjigjet ndaj emergjencave civile, për sigurimin e kushteve të përshtatshme të jetesës, së bashku me fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. Megjithatë, është e nevojshme të kryhet një analizë e kujdesshme e ligjit për të vlerësuar nëse dispozitat ekzistuese ofrojnë garanci të mjaftueshme për të trajtuar siç duhet përparësitë dhe nevojat e grave

gjatë situatave emergjente.<sup>425</sup> Një zhvillim pozitiv në këtë kontekst është miratimi i Strategjisë së parë të Shqipërisë për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023-2030 (‘Strategjia ZRF’) dhe Plani i saj i Veprimit, miratuar në vitin 2023.<sup>426</sup> Kjo strategji – në përputhje me Kornizën Sendai për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2015-2030 – synon të shërbejë si bazë për të gjitha veprimtaritë dhe investimet e ardhshme në fushën e menaxhimit të risqeve nga fatkeqësitë në Shqipëri. Strategjia përfshin një objektiv të dedikuar për sigurimin e ndërgjegjësimit dhe aftësisë ripërtëritëse në komunitete, me fokus të veçantë në parimet e barazisë gjinore (Objektivi 2). Gjithashtu, në strategji përmenden shprehimisht risqet më të mëdha me të cilat përballen gratë dhe grupe të tjera gjatë fatkeqësive natyrore, dhe trajton format e ndërthurura të cenueshmërisë për shkak të seksit dhe faktorëve të tjerë, si moshja, orientimi seksual, aftësia e kufizuar, përkatësia etnike, statusi ekonomik dhe social, dhe të tjerë. Në dokument merren angazhime të rëndësishme në lidhje me barazinë gjinore, ndër të cilat:

- Sigurimi që të gjitha fazat e menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë dhe të gjitha projektet strategjike të marrin në konsideratë nevojat prioritare të grave dhe grupeve të cenueshme dhe impaktin që do të kenë fatkeqësitë në mirëqenien e këtyre grupeve;
- Miratimi i dispozitave të përgjithshme strategjike mbi barazinë gjinore dhe cenueshmëritë në nivel vendor gjatë përgatitjes dhe zbatimit të planeve vendore të veprimit për ZRF;
- Promovimi i pjesëmarrjes së grave dhe i rolit të tyre udhëheqës në të gjitha fazat e menaxhimit të riskut të fatkeqësive; dhe
- Sigurimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në të gjitha projektet, skemat dhe nismat me fokus ZRF-në, plotësuar me një listë të kriterëve të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

Megjithatë, këto angazhime për barazinë gjinore nuk janë reflektuar në Planin e Veprimit të Strategjisë me aktivitete specifike që do t’u përgjigjeshin drejtpërdrejt nevojave

422. Miratuar me VKM nr. 466, datë 3.7.2019 “Për miratimin e dokumentit strategjik dhe të planeve kombëtare për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike”. Shih: <https://faolex.fao.org/docs/pdf/alb211874.pdf>

423. Gjendet në: <https://www.yumpu.com/en/document/read/59900990/integrated-cross-sectorial-plan-of-tirana-durres-area>

424. Bashkia Tiranë (2018). Plani i Veprimit për Tiranën e Gjelbër. Gjendet në: <https://ebrdgreencities.com/assets/Uploads/PdF/tirana-GcAP.pdf> (versioni në gjuhë angleze); dhe në: <https://ebrdgreencities.com/assets/Uploads/PdF/tirana-GcAP-Alba.pdf> (versioni në gjuhë shqipe).

425. UN Women Shqipëri (2023), “Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe ndryshimet klimatike”, [https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-03/web\\_dr\\_14122023.pdf](https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-03/web_dr_14122023.pdf)

426. VKM nr. 94, datë 22/02/2023, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 31, datë 24/02/2023. Shih: <https://qzb.gov.al/eli/fz/2023/31/099f9b27-e232-4aa5-ae19-20d532632f74>

dhe prioriteteve të grave dhe vajzave dhe grupeve të tjera të cenueshme. Po kështu mungojnë edhe treguesit me ndjeshmëri gjinore, që janë thelbësorë për monitorimin e impaktit të strategjisë mbi gratë dhe vajzat dhe grupet e cenueshme.

Dispozitat shprehimisht me ndjeshmëri gjinore – sidomos angazhimi për të siguruar që gjatë procesit të përgatitjes dhe zbatimit të planeve vendore të veprimit për ZRF-në, “të miratohen në nivel vendor” dispozita të përgjithshme lidhur me barazinë gjinore dhe cenueshmërinë – si bazë e shëndoshë për ta bërë menaxhimin e ZRF-së në Shqipëri me të vërtetë reagues gjinor. Në këtë kontekst, është e rëndësishme që termi “të miratohen” të kuptohet si një proces gjithëpërfshirës në të cilin konsideratat e barazisë gjinore integrohen gjatë gjithë fazave të përgatitjes dhe zbatimit të planeve vendore, pas rekomandimeve të hartuara specifikuara për këtë fushë.<sup>427</sup>

Në mënyrë të ngjashme, ZRF mund të jetë një prej fushave të ndërhyrjes që duhet të mbahet parasysh kur organet e pushtetit vendor – sidomos bashkitë – të përgatisin dhe zbatojnë planet vendore të veprimit me fokus barazinë gjinore. Përfshirja e këndvështrimit gjinor në fusha të tjera përtej thjesht “çështjeve sociale” është shumë e rëndësishme dhe duhet të jetë në qendër të vëmendjes në nivel vendor (dhe qendror). Kjo qasje është në përputhje me fushën kyçe tematike të politikave 3.6: “Trajtimi i sfidave dhe shfrytëzimi i mundësive të ofruara nga tranzicioni i gjelbër dhe transformimi digjital” i PVGJ III të BE-së.

Ndër masat kryesore që përmenden si veprime të BE-së në kuadër të këtij plani përfshihen nxitja e pjesëmarrjes dhe rolit udhëheqës të grave dhe vajzave për të siguruar strategji reaguese gjinore për zbutjen e pasojave të klimës dhe përshtatjen me të; ZRF dhe menaxhimi me përfshirje të gjerë dhe të qëndrueshme të burimeve natyrore; dhe ndërtimi i kapaciteteve, fondeve dhe mbështetjes për investime në strategji dhe plane veprimi reagues gjinorë në shkallë kombëtare në fushat e klimës, mjedisit dhe ZRF-së.

### KUTIA 3: PLANI VENDOR I VEPRIMIT PËR BARAZINË GJINORE 2023-2025 I BASHKISË DURRËS

Durrësi është bashkia e parë në Shqipëri që ka planifikuar një objektiv specifik për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë në Planin Vendor të Veprimit për Barazinë Gjinore (PVVBGJ) 2023-2025, të miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 151 datë 22.12.2022. Ky plan, i hartuar me asistencën teknike të UN Women gjatë zbatimit të projektit “BE për barazinë gjinore në Shqipëri” (BEpBGJ I) i financuar nga BE-ja, është një instrument konkret për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 dhe të Kartës Evropiane për Barazinë e Burrave dhe Grave në Jetën Vendore. Ai gjithashtu merr në konsideratë fushën tematike të politikave 3.6, përmes objektivit specifik: “Promovimi i planifikimit të përgjigjshëm gjinor për të përballuar dhe zvogëluar rrezikun nga fatkeqësitë natyrore.” Plani përfshin disa veprimtari specifike, ndër të cilat:

- Përgatitja e një harte me informacion të detajuar të zonave më të cenueshme, me të dhëna të përditësuara për numrin e familjeve dhe individëve, të ndara sipas seksit, moshës, aftësisë së kufizuar, nevojave të veçanta, etj.;
- Përgatitja e materialeve informative, të formuluar me gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, në lidhje me institucionet dhe numrat e kontaktit, si dhe vendet ku gratë dhe vajzat mund të shkojnë gjatë fatkeqësive natyrore;
- Organizimi i aktiviteteve informative brenda njësive administrative dhe zonave më të rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore, me fokus mbi gratë dhe vajzat në gjithë diversitetin e tyre; dhe
- Përgatitja e një plani vendor veprimi të përgjigjshëm gjinor që fokusohet në përballimin dhe zvogëlimin e rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore.

427. UN Women Shqipëri (2023), “Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe ndryshimet klimatike”, [https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-03/web\\_drr\\_14122023.pdf](https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-03/web_drr_14122023.pdf)

Kostoja e zbatimit të veprimtarive nën këtë objektiv specifik llogaritet të jetë 2.778.962 lekë (32.375 USD ose 31.125 euro) (me një hendek financiar prej 1.931.400 lekë (22.501 USD ose 21.632 euro).<sup>428</sup> Impakti i këtij objektiv do të matet gjatë muajve të fundit të vitit 2025, kur Bashkia Durrës do të kryejë monitorimin për implementimin e PVVBGJ-së 2023-2025 si hap paraprak përpara hartimit të PVVBGJ-së të ri për vitet e ardhshme.<sup>429</sup>

Po kështu, qeveria e Shqipërisë ka përfshirë konsiderata gjinore në Planin Kombëtar të Veprimit për Emergjencat Civile.<sup>430</sup> Ky dokument përfshin një analizë të shkurtër të ndikimit të emergjencave tek gratë dhe përfshin barazinë gjinore si një prej parimeve të tij kryesore gjatë procesit të zbatimit. Megjithatë, angazhimet për barazinë gjinore në plan mbeten kryesisht deklarative dhe duhet të shndërrohen në veprime specifike për zbatim në nivel kombëtar dhe vendor. Në mars të vitit 2023, u miratua dokumenti kombëtar 'Për miratimin e vlerësimit të riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror' që përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt forcimit të sistemit kombëtar të mbrojtjes civile.<sup>431</sup> Dokumenti përmban gjashtë vlerësime tematike,<sup>432</sup> por as dokumenti kryesor dhe as vlerësimet tematike nuk përfshijnë konsiderata gjinore, nuk trajtojnë çështje të barazisë gjinore dhe nuk përmendin grupet e cenueshme.<sup>433</sup>

### 3.5.4 Pjesëmarrja e grave në vendimmarrje për klimën dhe zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë

Një nga arsyet për mungesën e perspektivës gjinore në kuadrin ligjor dhe të politikave të Shqipërisë për ndry-

shimet klimatike është mungesa e grupeve të interesit për përfaqësimin e grave dhe të grupeve të pafavorizuara në vlerësime *ex ante* dhe gjatë proceseve të hartimit të politikave dhe programeve që lidhen me mjedisin dhe ndryshimet klimatike.

Organizatave të shoqërisë civile raportojnë se edhe në ato raste kur janë organizuar mbledhje konsultative – për shembull, **për menaxhimin e integruar të mbetjeve të ricikluara** – në to nuk përfshihen sa duhet gratë e zonës dhe OJQ-të që veprojnë në komunitet.<sup>434</sup> Përfaqësimi dhe pjesëmarrja aktive e grave dhe grupeve të pafavorizuara në këto procese është detyrim në bazë të Konventës mbi Aksesin në Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Aksesin në Drejtësi për Çështje Mjedisore (Konventa e Aarhusit).<sup>435</sup>

### 3.5.5 Të dhëna të ndara sipas seksit në lidhje me ndryshimet klimatike dhe ndikimet e tyre

Sistemi kombëtar i statistikave në Shqipëri nuk bën matje lidhur me ZRF-në në nivel kombëtar ose vendor. Në raste fatkeqësish, matjet që ndërmerren janë *ad hoc*. Mjetet e përdorura për këto matje ende nuk janë pasqyruar në kuadrin kombëtar për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe kornizën monitoruese të tij. Matjet e para të riskut nga fatkeqësitë me përfshirje të perspektivës gjinore u kryen nga UN Women pas përmbytjeve në jug të vendit në vitin 2015, me përdorim të instrumenteve matëse sasiore dhe cilësore.<sup>436</sup> Më vonë, pas tërmetit të nëntorit 2019, një numër institucionesh shtetërore dhe aktorësh privatë (burime joadministrative) mblodhën të dhëna të

428. Shih: <https://durrës.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/PVVBGJ-2023-2025-Bashkia-Durrës.docx>

429. Të gjithë këta hapa (monitorimi i PVVGJ-së dhe përgatitja e PVVGJ-së të ri) parashikohen të mbështeten nga UN Women në kuadrin të zbatimit të BE Për barazinë gjinore në shoqërinë Shqipëri, faza e dytë (BEpBGJ II) me financim nga BE-ja.

430. VKM nr. 94, datë 22/02/2023, botuar në Fletoren Zyrtare nr.31, datë 24/02/2023. Shih: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2023/31/099f9b27-e232-4aa5-ae19-20d532632f74>

431. Miratuar me VKM nr. 168, datë 24/03/2023 dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr.51, datë 28/03/2023. Shih: <https://qbz.gov.al/eli/fz/2023/51/182631e0-3d7c-46d8-bee2-6b37acb60a55>

432. Nga një për secilin prej risqeve më kryesore të identifikuar: përmbytjet, tërmetet, rrëshqitjet e tokës, risqet teknologjike, zjarret dhe sëmundjet ngjitëse.

433. UN Women Shqipëri (2023), "Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe ndryshimet klimatike", [https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-03/web\\_drr\\_14122023.pdf](https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-03/web_drr_14122023.pdf)

434. Rrjeti i Monitorimit të Dhunës me Bazë Gjinore (2019). "Raport i organizatave të shoqërisë civile mbi zbatimin e Platformës për Veprim të Pekinit në Shqipëri, Pekin +25". Gjetet në: <https://rrjetikunderdhunesgjinore-monitorime.al/en/wp-content/uploads/2020/01/shqiptar-OSHCs-report-on-the-implementation-of-PpVP.pdf>

435. UNECE (1998) Konventa mbi Aksesin në Informacion, Pjesëmarrjen e Publikut në Vendimmarrje dhe Aksesin në Drejtësi për Çështje Mjedisore. Shih: <https://unece.org/dAM/env/pp/documents/cep43e.pdf>

436. UN Women - Qendra e Njohurive për Përbalimin e Fatkeqësive nga Gratë (2021). "Pabarazitë gjinore dhe ndikimi i tërmeteve dhe përmbytjeve në Shqipëri". Shih: <https://wrđ.unwomen.org/explore/insights/%20gender-inequality-earthquake-and-flood-impacts-albania>

disponueshme dytësore dhe informacion parësor. Po kështu, edhe INSTAT-i kreu anketime të strukturuar për vlerësimin e ndërtesave, një anketim të bizneseve dhe një të mjeteve të jetesës, me fokus mbi gratë dhe burrat e mbetur pa shtëpi dhe të strehuar në hotele dhe çadra. Metodologjia e përdorur nga INSTAT-i u bazua në atë që zbatohet në Statistikat e të Ardthurave dhe Nivelit të Jetesës së BE-së (EU-SILC/AANJ) dhe në Anketën e Buxhetit të Familjes (ABF), si anketat më të konsoliduara për familjet në nivel kombëtar. Në rastin e tërmetit të nëntorit 2019, metoda që u përdor për mbledhjen e të dhënave lejon përlogaritjen e tre treguesve specifikë gjinorë të propozuar nga UN ESCAP (Komisioni Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara për shtetet e Azisë dhe të Paqësorit) dhe grupi i punës i UN Women:<sup>437</sup>

- (i) Numri i vdekjeve, i personave të humbur dhe i personave të prekur drejtpërdrejt nga fatkeqësitë, të ndarë sipas seksit;
- (ii) Numri i personave banesat e të cilëve janë dëmtuar si pasojë e fatkeqësive, të ndarë sipas seksit;
- (iii) Numri i personave të cilëve iu vështirësua jetesa ose iu shkatërruan mjetet e jetesës, të ndarë sipas seksit.

Së fundi, gjatë pandemisë së COVID-19, Shqipëria u përfshi në nismën globale të UN Women për matjen e ndikimit social-ekonomik të izolimit për shkak të pandemisë. U hartua një metodologji e konsoliduar e cila u zbatua njëtrajtësisht në të gjitha vendet dhe rajonet e botës, duke siguruar kështu krahasueshmërinë e të dhënave.<sup>438</sup>

### 3.5.6 Harmonizimi me politikat dhe legjislacionin e BE-së

Trajtimi i risqeve që lidhen me ndryshimet klimatike dhe

degradimin e mjedisit është një prioritet kryesor i BE-së, që po punon aktivisht për të zvogëluar ndikimin e tyre në mjedis, si në shtetet anëtare, ashtu edhe në nivel global. Në vitin In 2021, BE-ja miratoi një varg propozimesh të njohura si "Marrëveshja e gjelbër evropiane" që, së bashku me Rregulloren (BE) 2021/1119 (ose ligji evropian për klimën), synojnë të zvogëlojnë emetimet e gazeve të serrës dhe ta bëjnë Evropën kontinentin e parë neutral klimatik në botë deri në vitin 2050.<sup>439</sup>

Përveç kësaj, BE-ja synon të sigurojë që shqetësimet në lidhje me klimën të trajtohen edhe në fusha të tjera të politikave, si transporti dhe energjetika, dhe promovon teknologjitë me emetim të ulët të karbonit dhe masat e përshtatjes.

Me përgatitjen e Shqipërisë për avancimin e negociatave të grup-kapitullit të katërt, që fokusohet në agjendën e gjelbër dhe konektivitetin e qëndrueshëm, duhet të ndërmerren hapa seriozë për sigurimin e përfshirjes së perspektivës gjinore në të gjitha masat përkatëse legjislative dhe të politikave.

### 3.5.7 Rekomandime

Rekomandimet e mëposhtme bazohen në raporte të mëparshme në këtë fushë,<sup>440</sup> rekomandime të kohëve të fundit të mekanizmave të të drejtave të njeriut në kontekstin e raportit të pestë periodik për Shqipërinë të Komitetit të KEGJFDG-së (2023)<sup>441</sup> dhe ciklin e katërt të RPU-së (2024-2025),<sup>442</sup> si dhe në informacionin e kontribuar nga ekipi i OKB-së në Shqipëri për këto mekanizma në kuadër të proceseve të shqyrtimit.<sup>443</sup>

437. Departamenti i Statistikave i UN ESCAP, IUCN, UNEP dhe UN Women (2019). "Integrimi gjinor në statistikat mjedisore për OZHQ-të dhe më tej: Identifikimi i përparësive në shtetet e Azisë dhe Paqësorit". Seria e dokumenteve të punës SD/WP/10 tetor. Shih: <https://repository.unescap.org/handle/20.500.12870/1138?locale-attribute=es>

438. UN Women (2020). "Ndikimi i Covid-19 në jetën dhe mjetet e jetesës të grave dhe burrave në Evropë dhe Azinë Qendrore: Rezultatet paraprake të një vlerësimi të shpejtë gjinor". Shih: <https://albania.unwomen.org/en/digital-library/publications/2020/07/the-impact-of-covid19-on-womens-and-mens-lives-and-livelihoods>

439. Komisioni Evropian (2022). Agjencia Evropiane e Operacioneve të Mbrojtjes Civile dhe Ndhmës Humanitare. "Fletë informative për ndryshimet klimatike dhe mjedisin". Shih: [https://civil-protection-humanitarian-aid.ec.europa.eu/what/%20humanitarian-aid/climate-change-and-environment\\_en](https://civil-protection-humanitarian-aid.ec.europa.eu/what/%20humanitarian-aid/climate-change-and-environment_en)

440. Shih për shembull, UN Women Shqipëri (2023), "Zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë dhe ndryshimet klimatike", [https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-03/web\\_drr\\_14122023.pdf](https://albania.unwomen.org/sites/default/files/2024-03/web_drr_14122023.pdf)

441. Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit të Grave, (2023) "Vërejtjet përmbyllëse mbi raportin e pestë periodik të Shqipërisë" (CEDAW/C/ALB/5). Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave, Kombet e Bashkuara. <https://www.ohchr.org/documents/treaties/KEGJFDG>

442. Këshilli i të Drejtave të Njeriut. (20 dhjetor 2024). "Raporti i grupit të punës mbi Raportin Periodik Universal: Shqipëria" (Seanca e 58-të, Pika 6 e rendit të ditës); A/HRC/58/

443. Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (2024), Kontributi në kuadër të Raportit të Katërt Periodik Universal, <https://www.ohchr.org/en/hr-bodies/upr/al-un-contributions-s47>; Ekipi i Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (2022) Raport konfidencial për Komitetin e KEGJFDG-së në kuadër të raportit të pestë periodik për Shqipërinë, i pabotuar.

- 1. Të sigurohet që kornizat ligjore dhe ato të politikave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, ndryshimet klimatike dhe zhvillimin e turizmit të trajtojnë problemin e pabarazive gjinore dhe të ndikimeve të diferencuara gjinore në mënyrë konsistente dhe gjithëpërfshirëse.** Legjislacioni shqiptar dhe politikat kombëtare dhe vendore në këto fusha duhet të përfshijnë perspektivën gjinore në mënyrë konsistente dhe të pajisen me kapacitete dhe burime të mjaftueshme për këtë qëllim. (Në përputhje me rekomandimet e RPU-së të vitit 2024,<sup>444</sup> dhe kontributin e EKBSH-së Shqipëri për RPU-në, 2024.)
- 2. Të trajtohen nevojat dhe prioritetet specifike të grave dhe vajzave gjatë fatkeqësive.** Kjo mund të arrihet përmes planifikimit paraprak dhe zbatimit të masave specifike gjatë emergjencave, si ekzistenca e infrastrukturës dhe shërbimeve kritike të përshtatshme për të gjitha gratë dhe vajzat, reduktimi i rreziqeve të tjera, përfshirë masat për parandalimin e dhunës me bazë gjinore në strehëza/kampe dhe respektimi i privatësisë së grave dhe vajzave. Vëmendje duhet t'u kushtohet edhe masave të rimëkëmbjes pas fatkeqësive, për të siguruar që gratë të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga të gjitha programet e infrastrukturës dhe të rimëkëmbjes.
- 3. Të analizohen dhe trajtohen cenueshmëritë specifike të grave, sidomos të grave në zonat rurale, për shkak të ndryshimeve klimatike dhe degradimit mjedisor.** Prioritet kyç mbetet pjesëmarrja e grave rurale në hartimin dhe zbatimin e politikave, programeve dhe nismave kombëtare në lidhje me ndryshimet klimatike, si edhe për ruajtjen e biodiversitetit dhe të trashëgimisë kulturore (në përputhje me vërejtjet përmblyëse të Komitetit të KEGJFDG-së).<sup>445</sup>

444. RPU 124.131, A/HRC/58/5.

445. CEDAW/C/ALB/CO/5, Rekomandimi 40 (c).

# 4

**PIKA HYRËSE  
DHE MUNDËSI NË  
KONTEKSTIN E  
ZBATIMIT TË PVGJ  
III TË BE-SË**

## Angazhimi i BE-së për barazinë gjinore në Shqipëri pasqyrohet në mbështetjen e tij strategjike për reformat politike, ekonomike dhe sociale që përputhen me Planin e Veprimit Gjinor III të BE-së (PVGJ III) dhe prioritetet financuese të IPA III.

Pikat kyçe hyrëse për angazhimin politik dhe operacional të BE-së përfshijnë forcimin e integritimit gjinor në politikat kombëtare, për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe sigurimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

Tabela në vijim harmonizon veprimet kyçe të rekoman-

duara për Shqipërinë me fushat tematike të PVGJ III të BE-së dhe Udhëzuesin e BE-së për të Drejtat e Grave (2025). Kjo siguron që mbështetja e BE-së të kontribuojë në mënyrë efektive në reformat e barazisë gjinore dhe prioritetet e anëtarësimit në BE.

**Tabela 11**

### Veprime kyçe të rekomanduara për Shqipërinë në kuadër të fushave tematike të PVGJ III të BE-së dhe Udhërrëfyesit të BE-së për të Drejtat e Grave

Fushat kyçe të veprimit	Veprime aktuale dhe të propozuara (Nivel kombëtar)	Fushat tematike të PVGJ III të BE-së	Objektivat e udhërrëfyesit të i BE-së për të drejtat e grave (2025)
1. Forcimi politik dhe institucional	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Mbështetja e zbatimit të SKBGJ 2021-2030, duke siguruar përputhshmërinë me PVGJ III të BE-së.</li> <li>- Forcimi i rolit të nëpunësve gjinorë (NGJ) në hartimin e politikave dhe planifikimin e buxhetit.</li> <li>- Forcimi i rolit të Këshillit Kombëtar për Barazinë Gjinore me më shumë burime dhe koordinim.</li> <li>- Zbatimi i Planeve Vendore të Veprimit për Barazinë Gjinore të harmonizuar me standardet evropiane.</li> </ul>	<p>Fusha 1: Sigurimi i eliminimit të të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore (DHBGJ).</p> <p>Fusha 2: Promovimi i të drejtave ekonomike dhe sociale të grave dhe fuqizimi i grave.</p>	Objektivi: Pjesëmarrja në politikë dhe përfaqësimi i barabartë – Forcimi i balancës gjinore në vendimmarrje në të gjitha nivelet.
2. Fuqizimi ekonomik dhe përfshirja sociale	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Zgjerimi i përpjekjeve programatike për të mbështetur sipërmarrjen dhe përfshirjen ekonomike të grave.</li> <li>- Promovimi i përfshirjes financiare dhe integrimi në tregun e punës i grave nga grupet e cenueshme.</li> <li>- Sigurimi i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në programet e IPA III.</li> </ul>	<p>Fusha 2: Të drejtat ekonomike dhe sociale, ngushtimi i hendekut gjinor në paga dhe promovimi i sipërmarrjeve të grave.</p> <p>Fusha 5: Trajtimi i sfidave të tranzicionit të gjelbër dhe transformimit digjital.</p>	Objektivi: Pagë e barabartë dhe fuqizim ekonomik—Mbështetja e aksesit të barabartë në burime financiare, tregun e punës dhe transparencës në paga.

(vazhdon në faqen tjetër)

Fushat kyçe të veprimit	Veprime aktuale dhe të propozuara (Nivel kombëtar)	Fushat tematike të PVGJ III të BE-së	Objektivat e udhërrëfyesit të i BE-së për të drejtat e grave (2025)
3. Drejtësia dhe të drejtat e njeriut	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Forcimi i kuadrit ligjor mbi DHBGJ-në në përputhje me standardet e BE-së.</li> <li>- Zgjerimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas, duke përmirësuar aksesin në drejtësi për gratë.</li> <li>- Trajtimi i problemit të hendeqeve gjinore në legjislacionin zgjedhor, duke siguruar mundësi të barabarta për gratë.</li> </ul>	<p>Fusha 1: Eliminimi i DHBGJ-së përmes mbrojtjes më të fortë ligjore.</p> <p>Fusha 3: Forcimi i zërit të dhe pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje.</p>	Objektivi: E drejta për të jetuar pa dhunë me bazë gjinore—Forcimi i ligjeve dhe i mekanizmave zbatues kundër DHBGJ-së, përfshirë kundër dhunës në internet.
4. Integrimi gjinor sipas sektorëve specifikë	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Arsimi dhe aftësitë: promovimi i lëndëve SHTIM për vajzat dhe integrimi i kurrikulave me ndjeshmëri gjinore.</li> <li>- Shëndetësia dhe mbrojtja sociale: zgjerimi i shërbimeve të shëndetit riprodhues dhe seksual.</li> <li>- Klima dhe zvogëlimi i riskut nga fatkeqësitë: Hartimi i politikave reaguese gjinore për të qenë të përgatitur në rast fatkeqësish.</li> </ul>	<p>Fusha 4: Avancimi i pjesëmarrjes së barabartë dhe rolit drejtues në sferat publike dhe private.</p> <p>Fusha 5: Politika me ndjeshmëri gjinore në veprimet klimatike dhe për transformimin digjital.</p>	<p>Objektivi: Arsim cilësor dhe përfshirës – rritja e aksesit në lëndët SHTIM për vajzat dhe trajtimi i problemit të pabarazive gjinore.</p> <p>Objektivi: Standardet më të larta të shëndetit – përmirësimi i aksesit në shërbime të kujdesit shëndetësor dhe në të drejtat riprodhuese.</p>
5. Vënia në zbatim e PVGJ III të BE-së në Shqipëri	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Sigurimi i integritetit gjinor në të gjitha programet e IPA III, me përfshirje të treguesve me ndjeshmëri gjinore.</li> <li>- Rritja e fondeve të BE-së për nisma të barazisë gjinore, veçanërisht për fuqizimin ekonomik, pjesëmarrjen politike dhe parandalimin e DHBGJ-së.</li> <li>- Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për sigurimin e një kornize kohezive të barazisë gjinore në Shqipëri.</li> </ul>	Parimi ndërsektorial: Marrja e masave që barazia gjinore të jetë fokus qendror në të gjitha instrumentet financiare dhe politike të BE-së.	Objektivi: Mekanizma institucionale që realizojnë të drejtat e grave – sigurimi i fondeve të qëndrueshme, i mekanizmave të monitorimit dhe të ndërtimit të kapaciteteve.

**SHTOJCA**

## Shtojca 1. Kornizat kombëtare dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore në Shqipëri

### Kuadri ligjor ndërkombëtar

Vitet e fundit Shqipëria është përfshirë në tregues të shumtë globalë dhe rajonalë. Pozita e Shqipërisë në Forumin Ekonomik Botëror 2024<sup>446</sup> (në vend të 23-të në nivel global me vlerësim 0,780) tregon përmirësim krahasuar me pozitën e saj në vitin 2020,<sup>447</sup> (në vendin e 20-të në nivel global, me vlerësim 0,769). Megjithatë, në vitin 2024, pati një rënie të lehtë krahasuar me vitin 2023<sup>448</sup> (në vendin e 17-të, me vlerësim 0,791) dhe me vitin 2022<sup>449</sup> (në vendin e 18-të me vlerësim 0,787) – sidomos në nënrubrikat "Pjesëmarrja dhe mundësitë ekonomike « dhe «Fuqizimi politik ». Shqipëria vazhdon të jetë në vendin e parë në botë, me vlerësimin më të lartë në tregues kyç si «Gratë në poste ministrore», «Regjistrimet në arsimin e lartë» «Punonjës teknikë dhe profesionistë» dhe të tjerë, duke u renditur më lart se shumë vende të zhvilluara evropiane.

Për sa u përket **OZHQ**-ve, sipas Indeksit të OZHQ-ve të vitit 2024<sup>450</sup> Shqipëria është në vendin e 42-të (nga 167 vende) me 75 pikë (që është më shumë se mesatarja e rajonit prej 70,6). Në renditjen e vitit 2022 në **Bazën e të Dhënave Globale të OZHQ-ve**,<sup>451</sup> Shqipëria mori 100 pikë (nga 100) për masën në të cilën kornizat e saj ligjore promovojnë, zbatojnë dhe monitorojnë barazinë gjinore në jetën publike; 88,9 pikë për masën në të cilën kornizat e saj ligjore promovojnë, zbatojnë dhe monitorojnë barazinë gjinore në lidhje me dhunën ndaj grave; 80 pikë për masën në të cilën kornizat e saj ligjore promovojnë, zbatojnë dhe monitorojnë barazinë gjinore në lidhje me

punësimin dhe përfitimet ekonomike; dhe 90,9 pikë për masën në të cilën kornizat e saj ligjore promovojnë, zbatojnë dhe monitorojnë barazinë gjinore në lidhje me martesën dhe përfitimet familjare. Përqindja e vendeve të mbajtura nga gratë në parlamentet me një dhomë ose në dhomat e ulëta të parlamenteve u rrit nga 5,2 për qind në vitin 2000 në 35,7 për qind në vitin 2024.<sup>452</sup>

Në **Indeksin 'Gratë, paqja dhe siguria'** 2023/2024,<sup>453</sup> Shqipëria u rendit në vendin e 45-të nga 177 shtete, që është përmirësim krahasuar me 2021/2022<sup>454</sup>, kur renditej në vendin e 58-të nga 170 shtete dhe me 2019/2020,<sup>455</sup> kur renditej në vendin e 57-të nga 167 shtete.

Në **Raportin e Zhvillimit Njerëzor** 2023/2024 të UNDP-së,<sup>456</sup> Shqipëria renditet në vendin e 74-t nga 193 shtete, me një ndryshim prej **-8** në renditjen e Indeksit të Zhvillimit Njerëzor për periudhën 2015-2022. Megjithatë, në të njëjtin raport, Indeksi i Zhvillimit Gjinor i Shqipërisë për vitin 2022 ishte 0.977 dhe ajo u klasifikua në Grupin e Parë, që përfshin vendet me shkallë të lartë barazie midis grave dhe burrave në arritjet e zhvillimit njerëzor.<sup>457</sup>

Sipas bazës së të dhënave **Gender Data Compass 2023** (Busulla e të Dhënave Gjinore) në internet,<sup>458</sup> që ofron një vlerësim të përgjithshëm të sistemit të të dhënave gjinore të një vendi në pesë fusha kyçe – disponueshmëria, aksesueshmëria, bazat, kapaciteti dhe financimi – në të cilat rezultati i përgjithshëm i Shqipërisë ishte 30 nga 100. Ky rezultat e rendit Shqipërinë në vendin e 95-të në botë dhe në vendin e 8-të në rajonin e Evropës Jugore. Për të trajtuar problemin e mangësive në mbulimin e të dhënave gjinore, është me rëndësi thelbësore që të botohen më shumë të dhëna dhe të sigurohet ndarja e duhur e tyre

446. <https://www.weforum.org/publications/global-gender-gap-report-2024/>

447. <https://www.weforum.org/publications/gender-gap-2020-report-100-years-pay-equality/>

448. <https://www.weforum.org/publications/global-gender-gap-report-2023/>

449. <https://www.weforum.org/publications/global-gender-gap-report-2022/>

450. <https://dashboards.sdgindex.org/Kapitullis/part-2-the-sdg-index-and-dashboards>

451. <https://unstats.un.org/sdgs/dataportal/countryprofiles/alb#goal-5>

452. Po aty.

453. <https://giwps.georgetown.edu/wp-content/uploads/2023/10/WPS-Index-full-report.pdf>

454. <https://giwps.georgetown.edu/wp-content/uploads/2021/11/WPS-Index-2021.pdf>

455. <https://giwps.georgetown.edu/wp-content/uploads/2019/12/WPS-Index-2019-20-Report.pdf>

456. <https://hdr.undp.org/system/files/documents/global-report-document/hdr2023-24reporten.pdf>

457. Vendet e grupit të parë kanë shkallë të lartë barazie midis grave dhe burrave në arritjet e Indeksit të Zhvillimit Njerëzor: devijimi absolut më i ulët se 2,5 për qind. Shih: <https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/tr/UNDP-TR-EN-RZHNJ-2019-FAQS-GDI.pdf>

458. Shih: <https://gdc.opendatawatch.com/>

sipas seksit. Sipas **Gender Data Compass**, Shqipëria nuk publikonte 11 nga 53 treguesit e vlerësuar në asnjë faqe interneti qeveritare, dhe shtatë nga treguesit e publikuar nuk ishin të ndarë sipas seksit. Statistikat gjinore dhe të dhënat e ndara sipas seksit janë tejet të rëndësishme për trajtimin e pabarazive gjinore dhe mbështetjen e hartimit të politikave efektive. Duke pasur parasysh këtë, ekziston një nevojë e qartë për të prodhuar tregues të rinj që lidhen me gjininë, bazuar si në burime administrative, ashtu edhe në bazë të anketimeve dhe vrojttimeve.<sup>459</sup>

Shqipëria ka ratifikuar dhe është anëtare e një numri konventash dhe marrëveshjesh ndërkombëtare që ofrojnë bazat për barazinë gjinore. Ndër këto janë:

- **Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (DUD-NJ)** e vitit 1948, e cila ndonëse nuk i kushtohet ekskluzivisht aspekteve të seksit, hodhi bazat për veprim në shkallë ndërkombëtare për të drejtat e grave dhe barazinë gjinore, duke u dhënë formë traktateve dhe politikave themelore që mbështesin mundësitë e barabarta dhe mbrojtje për të gjitha gjinitë. DUDNJ rikonfirmon parimet e barazisë, dinjitetit dhe të mosdiskriminimit, dhe ndalon specifikisht diskriminimin me bazë gjinore. Ajo siguron të drejta të barabarta martesore, paga të barabarta, arsim dhe mbrojtje për nënat dhe fëmijët.
- **Konventa për të Drejtat Politike të Grave (KDPG)**, e ratifikuar në vitin 1995, e cila garanton të drejta të barabarta të grave për të votuar, për të kandiduar për poste publike, dhe për të marrë pjesë në qeveri.
- **Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDKP)**, e ratifikuar në vitin 1991, e cila ndalon diskriminimin me bazë gjinore dhe garanton mbrojtje të barabartë në ligj, të drejtën e votimit dhe të drejtat politike të grave.
- **Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale e Kulturore (KNDESK)**, ratifikuar në vitin 1991, që garanton paga të barabarta, kushte të drejta pune, mbrojtje të amësisë dhe akses të grave dhe vajzave në arsim.
- **Konventa për të Drejtat e Fëmijës (CRC)**, ratifikuar në vitin 1992, që forcoi mbrojtjen e të drejtave të

grave dhe vajzave për arsimim dhe kujdes shëndetësor, si dhe mbrojtjen nga martesat në moshë të mitur, shfrytëzimi ekonomik dhe diskriminimi me bazë gjinore.

- **Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit të Grave (KEGJFDG)**, ratifikuar në vitin 1993, dhe **Protokolli Opsional** i saj, ratifikuar në vitin 2003, e cila krijoi kuadrin ligjor për eliminimin e diskriminimit në arsim, punësim, kujdes shëndetësor dhe martesë, duke vendosur edhe mekanizmat që u mundësojnë individëve të kërkojnë drejtësi për shkeljet e të drejtave të grave.
- **Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor (KNEGJ-DR)**, ratifikuar në vitin 1994, që ndalon diskriminimin racor dhe etnik dhe njeh diskriminimin për shkak të përkatësisë së shumëfishtë – racor dhe me bazë gjinore.
- **Konventa Kundër Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Posh-tëruese (KKT)**, ratifikuar në vitin 1994, që detyron parandalimin, hetimin dhe dënimin e torturës, si për shembull në rastin e dhunës me bazë gjinore.
- **Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim (DPPV)**, miratuar në vitin 1995, që është agenda globale më gjithëpërfshirëse dhe transformative për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave dhe të vajzave.
- **Konventa Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (KEDNJ)**, ratifikuar në vitin 1996, që ofron mbrojtje me ligj kundër dhunës dhe diskriminimit me bazë gjinore për sigurimin e mbrojtjes së të drejtave themelore të grave nën juridiksionin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
- **Rezoluta 1325 e Këshillit të Sigurimit të OKB-së 'Gratë, paqja dhe siguria'**, ratifikuar në vitin 2000, që njeh rolin e grave në proceset e paqes dhe të zgjidhjes së konflikteve dhe insiston në mbrojtjen e tyre në situata lufte.

459. Shih: <https://gdc.opendatawatch.com/country-profiles/ALB>

- **Konventa nr. 183 për Mbrojtjen e Amësisë e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP)**, ratifikuar në vitin 2004, që garanton mbrojtjen e punësimit gjatë lejes së barrë lindjes, si dhe siguri dhe mbrojtje të punësimit për nënat në marrëdhënie pune.
- **Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të të Gjithë Punëtorëve Migrantë dhe Familjeve të Tyre (KNDPM)**, ratifikuar në vitin 2007, që siguron të drejta dhe mbrojtje të barabartë për punëtorët migrantë pavarësisht nga gjinia e tyre. Ajo trajton cenueshmëri specifike gjinore, ndër të cilat shfrytëzimi, diskriminimi, si edhe aksesin në kujdes shëndetësor dhe të drejtat e punëtorëve.
- **Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë (KMPZH)**, ratifikuar në vitin 2007, që mbron individët nga zhdukjet me forcë – një problem që ndikon shumë më tepër tek gratë si viktimat dhe si persona që kërkojnë drejtësi për të afërmit e zhdukur. Ajo njeh ndikimin specifik gjinor të zhdukjeve, përfshirë dhunën seksuale dhe vështirësitë ekonomike, dhe garanton drejtësinë të vërtetën dhe zhdëmtime.
- **Konventa nr. 156 për Punëtorët me Përgjegjësi Familjare (1981)**, ratifikuar në vitin 2007, që promovon barazinë gjinore në punësim duke siguruar që punëtorët dhe punëtorët me përgjegjësi për kujdesin në familje – sidomos gratë – të mos diskriminohen. Ajo bën thirrje për politika të vendit të punës që mbështesin balancën punë-jetë familjare/personale, mundësi të barabarta dhe ndarjen e përgjegjësisë familjare.
- **Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPK)**, ratifikuar në vitin 2012, që garanton të drejta dhe mbrojtje të barabartë për personat, me fokus të fuqishëm mbi barazinë gjinore. Ajo njeh që gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara përballen me forma të shumëfishta të diskriminimit dhe bën thirrje për akses të barabartë në arsim, punësim, kujdes shëndetësor dhe mbrojtje nga dhuna.
- **Këshilli i Evropës: Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave**

dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), ratifikuar në vitin 2013, që shënon një arritje madhore për sa i përket kriminalizimit të dhunës në familje. Ajo forcon mbrojtjen e viktimave dhe përdor qasje parandaluese.

- **Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe 17 Objektivat e saj e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)**, pjesë e së cilës Shqipëria u bë në vitin 2015, që rikonfirmojnë barazinë gjinore si pjesë e prioritetëve kombëtarë, sidomos përmes OZHQ 5 për eliminimin e diskriminimit, dhunës dhe barrierave ndaj fuqizimit të grave.
- **Konventa nr. 190 për Dhunën dhe Ngacmimin në Botën e Punës**, ratifikuar në vitin 2021, që është instrumenti i parë ligjor ndërkombëtar që trajton specifikisht dhunën dhe ngacmimin me bazë gjinore në mjediset e punës, duke njohur ndikimin e rëndë që kanë ato në sigurinë dhe pjesëmarrjen ekonomike të grave. Ajo përcakton detyrime për shtetet dhe punëdhënësit për parandalimin e dhunës, mbrojtjen e viktimave dhe sigurimin e aksesit në drejtësi, duke siguruar që në vendet e punës të mos ketë abuzim, frikësim dhe diskriminim. Konventa përfshin punëtorët formalë dhe informalë, sidomos grupet e cenueshme të punëtorëve shtëpiake dhe atyre në punësim të pasigurt.

## Kuadri ligjor kombëtar për barazinë gjinore dhe të drejtat e grave në Shqipëri

### Dispozitat kushtetuese

Kushtetuta garanton barazi gjinore (neni 18/2) dhe mbron të drejtat e nënave, fëmijëve dhe familjeve (neni 54).

- **Ligje kryesore në lidhje me barazinë gjinore dhe të drejtat e grave**
- **Ligji nr. 9970/2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”** – përcakton parimet dhe kuotat e barazisë gjinore por ka probleme në zbatim. Po hartohet një version i rishikuar.
- **Ligji nr. 9669/2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”** – parashikon urdhra mbrojtës dhe ndihmë për viktimat, por duhet të

zgjerohet për të mbuluar të gjitha format e dhunës me bazë gjinore.

- **Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”** – Ndalon diskriminimin me bazë gjinore dhe prezantoi ndryshimet e vitit 2020 që zgjerojnë mbrojtjen në lidhje me identitetin gjinor, orientimin seksual dhe diskriminimin për shkak të përkatësisë së shumëfishtë.

## Ndryshimet legislative dhe ligje të miratuara kohët e fundit

- **Ndryshimet e vitit 2022 në Kodin Penal** – forcuar mbrojtjen ligjore ndaj dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, përmes kriminalizimit të dhunës psikologjike dhe harmonizimit me Konventën e Stambollit.
- **Ligji nr. 81/2020** – garanton trajtim jodiskriminues të grave të burgosura si dhe mbrojtje nga DHBGJ.
- **Ndryshimet në Kodin Zgjedhor (2020 dhe 2024)** – përfshinë për herë të parë kuotën gjinore prej 50 për qind gender për këshillat bashkiakë dhe forcuar mekanizmat e zbatimit.
- **Ligji nr. 87/2022** – zgjeroi mbulimin me sigurime shëndetësore shtetërore duke përfshirë edhe gratë e papuna me tre ose më shumë fëmijë.
- **Ligji nr. 62/2022** – krijoi Regjistrin Kombëtar të Autorëve të Krimeve Seksuale, për të mbrojtur gratë dhe fëmijët.
- **Ligji nr. 30/2023** – përfshiu dispozita kundër seksizmit në legjislacionin për mediat, për të parandaluar përmbajtjet diskriminuese dhe gjuhën e urrejtjes.

## Strategji kombëtare

Përveç SKBGJ 2021-2030, gjatë pesë viteve të fundit janë miratuar edhe një numër strategjish dhe planesh të tjera veprimi kombëtare me fokus mbi barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, si:

- **Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022-2030 (SKZHIE)** – Barazia gjinore është një prej objektivave të SKZHIE dhe ndërhyrjet specifike të parashikuara në të kontribuojnë në arritjen e OZHQ-ve si edhe në përmbushjen e Agjendës 2030 të OKB-së. Vizioni i barazisë gjinore në SKZHIE është: “Një shoqëri e cila vlerëson barazinë dhe drejtësinë gjinore si kushte të domosdoshme drejt zhvillimit të qëndrueshëm social, ekonomik e politik të vendit, fuqizon të gjithë individët për të gëzuar të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës, nuk lejon që askush të mbetet pas, si dhe që mbështetet në parimin e tolerancës zero kundër praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke ndëshkuar dhunuesit dhe duke mbrojtur, rehabilituar e riintegruar personat e dhunuar.” SKZHIE artikulon angazhimin e Shqipërisë për barazinë gjinore si një nga qëllimet kryesore në fusha të ndryshme. Megjithatë, në pjesën më të madhe Strategjia përvijon objektiva të përgjithshëm, pa përcaktuar tregues të matshëm apo modele specifike financimi që kërkohen për arritjen e barazisë gjinore. Për shembull, SKZHIE aludon për barazinë gjinore në kontekstin e konformitetit me standardet evropiane, por nuk rekomandon masa konkrete në formën e programeve ose nismave të specializuara për trajtimin e problemit të pabarazive gjinore që ende ekzistojnë. Kjo mungesë e planifikimit dhe alokimit të burimeve mund të pengojë përmbushjen e efektshme të synimit të barazisë gjinore të strategjisë.
- **Plani Kombëtar i Veprimit për HIV/AIDS 2020-2025** kontribuon në arritjen e OZHQ 5, në veçanti të qëllimit 5.6: “Sigurimi i aksesit universal në shërbimet e shëndetit seksual dhe në të drejtat riprodhuese sikurse është rënë dakord në përputhje me programin e Veprimit të Konferencës Ndërkombëtare mbi Popullsinë dhe Zhvillimin dhe me Platformën për Veprim të Pekinit.” Plani përmban masa konkrete për parandalimin e HIV-it në një kontekst më të gjerë të të drejtave gjinore dhe të shëndetit seksual dhe riprodhues. Ai fokusohet në grupet më të cënueshme dhe më të rrezikuara, si vajzat adoleshente, vajzat e reja të përfshira në punë seksuale, komunitetet rome dhe egjiptiane, përdoruesit e drogave me injeksione dhe komuniteti LGBTIQ+. Përveç këtyre, parandalimi i transmetimit

nga nëna tek foshnja është një komponent kyç i reagimit në nivel kombëtar ndaj HIV -it dhe një prej objektivave specifike të Planit Kombëtar të Veprimit për HIV/AIDS 2020-2025. Ndër ndërhyrjet mbështetëse janë promovimi dhe ofrimi i analizave për HIV/STI për gratë shtatzëna përmes këshillimit me bazë institucionet dhe shërbimet e kujdesit shëndetësor parësor.

- **Strategjia kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Plani i saj i Veprimit 2020-2025** (miratuar me VKM nr. 1084, datë 24.12.2020), ka në fokus: garantimin e sigurisë kibernetike në nivel kombëtar përmes mbrojtjes së infrastrukturës së informacionit dhe fuqizimit të mjeteve teknologjike dhe ligjore; ndërtimin e një programi edukimi për një mjedis të sigurt kibernetik në fushën e sigurisë së informacionit; krijimin e mekanizmave të nevojshëm për sigurinë e fëmijëve në hapësirën kibernetike, duke përgatitur njëkohësisht një brez të ri të aftë për të përfituar nga të mirat e teknologjisë dhe për të përballuar sfidat e zhvillimit; dhe përmirësimin e bashkëpunimit kombëtar dhe ndërkombëtar me partnerët strategjikë në fushën e sigurisë kibernetike. Megjithatë, kësaj strategjie i mungon qasja me ndjeshmëri gjinore dhe masat e posaçme që u drejtohen grave. Ndonëse u jep prioritet edukimit për sigurinë dhe ndërgjegjësimin kibernetik si dhe mbrojtjes së fëmijëve në hapësirën kibernetike, ajo nuk trajton kërcënimet kibernetike me bazë gjinore, ose përfaqësimin e ulët të grave në sigurinë kibernetike. Me gjithë mundësinë që gratë të përfitojnë në mënyrë të tërthortë nga masat për promovimin e aftësive digjitale dhe sigurisë kibernetike, strategjia nuk përfshin nisma të posaçme për të ngushtuar ose mbyllur hendekun gjinor në këtë fushë.
- **Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2020-2023** kishte si synim dhe realizoi arritje të rëndësishme për reformimin e politikave të mbrojtjes sociale përmes: shndërrimit të skemës së ndihmës ekonomike (NE) në një skemë aktive që mundëson ri-integrimin social; rishikimit të sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar; ndërhyrjeve dhe garantimit të ri-integrimit të fëmijëve në familje dhe komunitet, duke i kushtuar vëmendje të veçantë jetimëve socialë dhe biologjikë; dhe garantimit të

ofrimit të shërbimeve të integruara sociale dhe të asistencës në komunitet. Krahas kësaj, strategjia ka përmirësuar lidhjet dhe integrimin mes politikave aktive të punësimit dhe politikave të përfshirjes dhe mbrojtjes sociale. Në vitin 2021, u bënë disa rivlerësime të shumave të NE-së për disa kategori të caktuara, si për shembull: dyfishimi i shumës së NE-së për familjet me tre ose më shumë fëmijë, dhe një shtesë prej 10 për qind për familjet e tjera, trefishimi i pagesave për jetimët, viktimat e trafikimit dhe viktimat e dhunës në familje. Në vitin 2022, ndihma ekonomike u rrit përsëri për kategori të tjera, ndër të cilat, dyfishimi i pagesës për gratë kryefamiljare me deri në dy fëmijë dhe për personat mbi 65 vjeç që nuk përfitojnë pension pleqërie ose pension social. Familjet e tjera në këtë skemë përfituan një rritje prej 10 për qind që nga fillimi i vitit 2022. Në vitin 2023 u ofrua për herë të parë mbështetje e veçantë për gratë e papuna me tre ose më shumë fëmijë deri në moshën 18 vjeç, me të ardhura familjare deri në 100.000 lekë në muaj (e barabartë me 1,165 USD ose 1,020 euro), si dhe mbështetje me pagesat e sigurimeve shëndetësore dhe shoqërore për periudhën e përkujdesit për fëmijë deri në moshën 5 vjeç.

- **Strategjia Kombëtare për Mbrojtjen Sociale 2024-2030** (miratuar me VKM nr. 152/2024) u përgatit duke mbajtur parasysh dokumentet strategjike të Komisionit Evropian mbi përkujdesin social, si dhe në përputhje me OZHQ-të, në veçanti OZHQ 5. Një nga objektivat specifike të strategjisë është zbutja e varfërisë për çdo individ në nevojë dhe përmirësimi i kushteve të jetesës për personat me aftësi të kufizuara përmes mbështetjes me skema financiare të përshtatshme, reaguese gjinore dhe transparente, që mundësojnë përbalimin e rreziqeve nga krizat. Në të parashikohen masa për ofrimin e shërbimeve për personat midis moshës së pensionit dhe moshës së thyer, ku do të merren parasysh dallimet gjinore midis grave dhe burrave të moshuar, duke u ofruar atyre shërbime të përshtatura me nevojat e tyre specifike.
- **Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030** (miratuar me VKM nr. 210, datë 6.4.2022) e vë Shqipërinë në rrugën drejt mbulimit shëndetësor universal përmes përmirësimit të cilësisë së shërbimit shëndetësor, aksesit, infrastrukturës, dhe besimit të publikut në këto shërbime. Ajo është një

dokument politikash të qeverisë shqiptare që synon të përkufizojë dhe arrijë objektivat e programit për mbrojtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullsisë së Shqipërisë. Objektivat kryesore të Strategjisë janë: përmirësimi i cilësisë së shërbimeve të kujdesit shëndetësor, përmes garantimit të aksesit të plotë të të gjithë personat që jetojnë në Shqipëri, bazuar në një sistem financiar të qëndrueshëm; rritja e numrit të viteve të shëndetshme të jetës të popullsisë; modernizimi i infrastrukturës dhe përmirësimi i sigurisë dhe cilësisë së kujdesit spitalor; përmirësimi i cilësisë dhe sigurisë së barnave në përputhje me standardet evropiane; zhvillimi i një qasjeje të integruar dhe më të mirëkoordinuar ndaj kujdesit shëndetësor; dhe rritja e transparencës dhe përgjegjshmërisë dhe rikthimi i besimit të publikut të gjerë në sistemin e kujdesit shëndetësor. Ajo pranon rëndësinë e barazisë gjinore për arritjen e rezultateve shëndetësore të qëndrueshme, në përputhje me OZHQ 5. Strategjia përfshin masa specifike për gratë, si shërbimet e shëndetit amëzor dhe riprodhues, programe të depistimit për sëmundjet e kancerit (për shembull, kanceri i gjirit dhe kanceri i qafës së mitrës), dhe nisma për trajtimin e problemit të dhunës me bazë gjinore. Krahas këtyre, ajo thekson rëndësinë e reduktimit të pabarazisë në akses në shërbime shëndetësore dhe njih nevojat shëndetësore të grupeve të cenueshme, ndër to edhe gratë dhe vajzat. Megjithatë, ndonëse strategjia vë në dukje aspektet gjinore në fushën e shëndetit, asaj i mungon një kuadër gjithëpërfshirës për integrimin e barazisë gjinore në të gjithë sektorët. Konsideratat gjinore kufizohen kryesisht në shëndetin amëzor dhe riprodhues, me integrim të kufizuar të perspektivës gjinore në fusha si sëmundjet jorgjithëse, shëndeti mendor, kujdesi për të moshuarit dhe shëndeti digjital. Po kështu, asaj i mungojnë udhëzimet e qarta dhe mekanizmat institucionalë për përfshirjen sistematike të perspektivave gjinore në politikat dhe programet e kujdesit shëndetësor. Po kështu, nuk i jepet prioritet mbledhjes së të dhënave të ndara sipas seksit dhe dallimet më të mëdha gjinore – si rreziqet ndaj shëndetit për shkak të profesionit dhe ndikimet e sëmundjeve kronike – vazhdojnë të mos trajtohen sa duhet. Strategjia gjithashtu nuk përmend buxhetimin e përgjigjshëm gjinor dhe trajnimin e detyrueshëm për ofruesit e shërbimeve shëndetësore, që kufizon përpjekjet për mbylljen e hendeqeve gjinore në këto fusha.

- **Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026** (miratuar me VKM nr. 621, datë 22.12.2021) synon të ndërtojë një sistem arsimor me cilësi të lartë, gjithëpërfshirës dhe të barabartë që mbështet të mësuarit gjatë gjithë jetën dhe është e harmonizuar me standardet evropiane. Fokusi i saj është zgjerimi i aksesit në arsim, përmes përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, promovimit të digjitalizimit dhe forcimit të lidhjeve me tregun e punës. Strategjia vë në pah dallimet gjinore dhe promovon politika arsimore gjithëpërfshirëse, sidomos në sigurimin e pjesëmarrjes së barabartë në arsimin parauniversitar dhe të lartë. Ajo thekson rëndësinë e metodave të ndjeshme gjinore të mësimdhënies, aksesin e vazhduar në programet SHTIM dhe trajtimi i problemit të DHBGJ-së në shkolla. Megjithatë, ndonëse strategjia përfshin objektiva të lidhura me gjininë, asaj i mungon një kuadër i përgjithshëm për integrimin e seksit në të gjitha nivelet arsimore. Nuk ka masa të qarta për eliminimin e barrierave strukturore ndaj grave në role drejtuese në arsim, apo nisma konkrete për parandalimin e diskriminimit dhe dhunës me bazë gjinore në sistemin arsimor.
- **Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027 (SBZHRD)** – miratuar me VKM nr. 460, datë 29.6.2022 – është një politikë kombëtare me qasje ndërsektoriale. Kjo politikë përvijon veprimet që duhet të ndërmerren për zhvillimin e qëndrueshëm dhe efektiv të sektorëve të bujqësisë, ushqimit, blegtorisë dhe peshkimit, bazuar në inovacion dhe digjitalizim. Qëllimi është që të mundësohet qëndrueshmëria e këtyre sektorëve ndaj presioneve të tregut kombëtar dhe ndërkombëtar, si edhe ndaj sfidave që lidhen me ndryshimet klimatike, humbjen e biodiversitetit, dhe tranzicionit në ekonominë e gjelbër. Duke siguruar menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, politika synon gjithashtu të përmirësojë cilësinë e jetës së banorëve dhe të mbështesë një zhvillim rural gjithëpërfshirës. Ajo e përfshin barazinë gjinore si një temë horizontale të harmonizuar me politikat e BE-së dhe me Planin e Veprimit Gjinor 2021-2025. Ajo pranon të drejtat ekonomike dhe sociale të grave, duke promovuar akses të barabartë në mundësi financimi, si për shembull duke u dhënë grave aplikante më shumë pikë për përfitimin e granteve të IPARD III. Megjithatë, ndonëse strategjia siguron

pjesëmarrje të barabartë në programe të zhvillimit rural, asaj i mungon një kuadër i përgjithshëm dhe specifik për përfshirjen e perspektivës gjinore, masat specifike që trajtojnë sfidat e grave në bujqësi, peshkim dhe tregun rural të punës. Nuk ka një fokus të dedikuar për kapërcimin e barrierave strukturore për gratë në role drejtuese, sipërmarrje ose pronësi të burimeve rurale.

- **Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026 (AKDF)** - miratuar me VKM nr. 659, datë 3.11.2021 – u hartua në emër të qeverisë shqiptare nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në koordinim me Agjencinë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve, dhe në konsultim me palë të ndryshme të interesit, partnerë, OSHC, organizata ndërkombëtare, etj. AKDF-ja konsolidon dhe vazhdon punën e bërë në kuadrin e Agjendës Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020, duke trajtuar mangësitë vijuese dhe sfidat e reja dhe duke reflektuar perspektivat novatore, sidomos ato që lidhen me Strategjinë e Bashkimit Evropian për të Drejtat e Fëmijës. Ky dokument përdor një qasje ndërsektoriale dhe krijon bazat për bashkërendimin e përpjekjeve mes ministrive dhe sektorëve të ndryshëm, si dhe e drejton kuadrin rregullator kombëtar drejt një strategjie të harmonizuar dhe efektive për fëmijët. AKDF përmban katër objektiva strategjikë: i) qeverisje e mirë në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve; ii) eliminimi i të gjitha formave të dhunës dhe mbrojtja e fëmijëve; iii) sisteme dhe shërbime miqësore për fëmijë dhe adoleshentë; dhe iv) promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale. Ky dokument ofron një varg masash mbështetëse për reduktimin e diskriminimit dhe të pabarazive për vajzat dhe adoleshentët.
- **Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet (SNSK) 2021-2026 dhe Plani i Veprimit 2021-2023** (miratuar me VKM nr. 1139, datë 24.12.2020). SNSK përcakton qartë prioritetet përmes politikave dhe objektivave kombëtare të sigurisë dhe përvijon parimet bazë që do të mbështesin përpjekjet ndërsektoriale për garantimin e sigurisë publike. SNSK krijon bazat për ndërtimin dhe forcimin e një mjedisi bashkëpunues ku qeveria dhe qytetarët mund të përmbushin më me efektivitet përgjegjësitë

përkatese të parandalimit dhe mbrojtjes. Politikat dhe objektivat specifike të SNSK-së janë të harmonizuara me disa OZHQ dhe me Agjendën 2030, në veçanti: OZHQ 3, OZHQ 5, OZHQ 11 dhe OZHQ 16. Ajo përmend nevojën për mbrojtjen e grave dhe vajzave nga dhuna, trafikimi dhe shfrytëzimi dhe sigurimin e pjesëmarrjes së tyre në proceset vendimmarrëse që lidhen me sigurinë në komunitet. Megjithatë, strategjisë i mungon një kuadër gjithëpërfshirës për përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha aspektet e sigurisë në komunitet. Ndonëse pranon ekzistencën e sfidave me bazë gjinore, nuk ka masa konkrete, të detajuara, të hartuara specifikisht për forcimin e sigurisë së grave, rritjen e përfaqësimit të grave në organet e rendit dhe të ligjit, ose që trajtojnë dallimet gjinore në akses në drejtësi dhe nismat për sigurinë në komunitet.

- **Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet (SNSK) 2021-2025 dhe Plani i Saj i Veprimit 2021-2023** (VKM nr. 1137, datë 16.12.2020). SNSK 2021-2025 përfaqëson dokumentin themelor strategjik kombëtar në luftën kundër terrorizmit. Ajo kombinon agjendën e BE-së për integrim dhe detyrimet e Kapitullit 24 në luftën kundër terrorizmit me zhvillimin ekonomik dhe social të vendit, përfshirë në lidhje me OZHQ-të. Ajo artikulon vizionin kombëtar për krijimin e një shoqërie pa kërcënime terroriste, që njihet si vend i sigurt sipas standardeve evropiane të përmbushjes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Megjithatë, kësaj strategjie i mungon njohja e rreziqeve të sigurisë që lidhen me gjininë, si roli i grave në parandalimin e radikalizimit, DHBGJ që lidhet me ekstremizmin, ose impakti i masave kundër terrorizmit mbi gratë dhe vajzat. Ajo nuk rendit veprime konkrete për sigurimin përfshirjen gjinore në përpjekjet kundër terrorizmit dhe as nuk trajton cënueshmëritë specifike gjinore në zonat në konflikt. Në përgjithësi, ndonëse ofron një kuadër solid për sigurinë kombëtare dhe mbështet aspiratat për integrim në Bashkimin Evropian, ajo nuk integron konsiderata gjinore apo ndërhyrje të fokusuara për forcimin e mbrojtjes dhe pjesëmarrjes së grave në politikat kundër terrorizmit.
- **Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2021-2023** (miratuar me VKM nr. 670, datë 10.11.2021)

pasqyronte praktikat më të mira ndërkombëtare për sa i përket faktorëve nxitës të trafikimit dhe formave të shfaqjes së tij. Ajo pranon ndikimin shproporcional të trafikimit të qenieve njerëzore tek gratë dhe vajzat dhe një shprehimisht gratë dhe fëmijët, sidomos nga komunitetet e cenueshme, si grupe me risk të lartë trafikimi dhe përfshin masa të fokusuara për mbrojtjen, ndihmën dhe riintegrimin e tyre. Në plan renditen programe për shërbime mbështetëse të specializuara, ndihmën juridike falas, ndihmën psikologjike dhe programe të posaçme riintegrimi për gratë dhe vajzat viktimat të trafikimit. Ajo përfshin gjithashtu një qasje me ndjeshmëri gjinore, me në qendër viktimat, në përpjekjet për parandalimin, mbrojtjen, dhe ndjekjen penale të trafikimit.

- **Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2024-2025** ruan elementët që u vlerësuan si aspektet më të forta të PKV-së për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve njerëzore, por po përditësohet me një qasje të re në përgjigje të nevojave dhe kushteve të reja. Ky plan veprimi mban elementët më të rëndësishëm që lidhen me përfshirjen e institucioneve shtetërore dhe joshitetërore, dhe thekson forcimin e kapaciteteve dhe strukturave në nivelet qendrore dhe vendore dhe masat për mbrojtjen e grave, vajzave dhe fëmijëve.
- **Plani Kombëtar i Veprimit për Personat LGBTI+ (2021-2027)**—miratuar me VKM nr. 700, datë 18.11.2021 – përfshin angazhime për luftimin e diskriminimit, përmirësimin e mbrojtjeve ligjore, sigurimin e aksesit në shërbime cilësore dhe rritjen e ndërgjegjësimit për diversitetin gjinor dhe seksual. Ai i referohet kornizave ligjore kombëtare dhe ndërkombëtare që promovojnë barazinë gjinore dhe mosdiskriminimin. Po kështu, ai vë në pah sfidat me të cilat përballen individët LGBTIQ+, si forma të shumëfishta të diskriminimit, dhe propozon masa specifike për trajtimin e tyre. Krahas kësaj, ajo është e harmonizuar me Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore (2021-2030) dhe me dokumentin e Komisionit Evropian “Bashkimi i barazisë: Strategjia e barazisë për LGBTIQ 2020-2025”.
- **Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve në Shqipëri 2021-2025** (miratuar me VKM nr. 701,

datë 17.11.2021) është një angazhim i ri i qeverisë që përfshin perspektivën gjinore si edhe programe dhe veprime të fokusuara për popullatën rome dhe egjiptiane që jeton në Shqipëri. Ai synon të ngushtojë hendekun në akses në shërbime publike cilësore në krahasim me popullatën shumicë. Plani përmend rrezikun më të madh për përjashtim social dhe diskriminim që përjetojnë gratë rome dhe egjiptiane dhe përfshin hapa për përmirësimin e kujdesit shëndetësor, punësimin dhe asistencës ligjore. Objektivat kryesore të tij janë reduktimi i barrierave dhe inkurajimi i pjesëmarrjes aktive të grave dhe vajzave në shoqëri përmes fokusimit në regjistrimin dhe ndjekjen e shkollës, trajnimin profesional, kujdesin shëndetësor amësor, mbrojtjen nga DHBGJ dhe ndihmën me regjistrimin në gjendjen civile.

- **Plani Kombëtar i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2021-2025** (miratuar me VKM nr. 276, datë 12.05.2021) njihet sfidat e ndryshme me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara, përfshirë gratë me aftësi të kufizuara. Ai promovon politika që synojnë garantimin e aksesit të tyre të barabartë në arsim, punësim, kujdes shëndetësor dhe shërbime sociale, duke i harmonizuar përpjekjet në nivel kombëtar me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK). Megjithatë pranon cenueshmërinë e grave me aftësi të kufizuara, ai nuk trajton plotësisht diskriminimin e tyre të shumëfishtë, varësinë ekonomike dhe praninë e DHBGJ-së në jetën e tyre. Dokumenti “Parashtrimi i qëndrimit të OKB-së në lidhje me dhunën ndaj grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara” vë në pah disa mangësi kyçe, si mbrojtja e pamjaftueshme ligjore, aksesin e kufizuar në drejtësi dhe shërbime mbështetëse jo të specializuara mjaftueshëm. Për të forcuar ndikimin e tij, Plani i Veprimit duhet të përfshijë shprehimisht politika me ndjeshmëri gjinore, të garantojë mbrojtje ligjore dhe sociale të aksesueshme, dhe të alokojë fonde të dedikuara për organizata të personave me aftësi të kufizuara të drejtuara nga gratë. Gjithashtu, për të pasur politika përfshirëse të bazuara në informacion dhe të harmonizuara me standardet ndërkombëtare, me rëndësi është edhe përmirësimi i mbledhjes së të dhënave dhe i koordinimit midis institucioneve.
- **Plani Kombëtar i Veprimit për Moshimin 2020-2024** (miratuar me VKM nr. 864, datë 24.12.2019)

vë në dukje moshimin e popullsisë shqiptare dhe është harmonizuar me korniza ndërkombëtare që promovojnë moshimin aktiv. Megjithëse në të barazia gjinore përmendet si parim drejtues, planit i mungojnë të dhënat e ndara sipas seksit, analiza me ndjeshmëri gjinore dhe masat e fokusuara për trajtimin e cenueshmërive të veçanta të grave të moshuara. Gratë e moshuara përballen me nivele më të larta varfërie, përfitojnë pensione më të ulëta dhe kanë probleme shëndetësore më të mëdha për shkak të hendekut në paga dhe përgjegjësi të përkujdesit për familjen gjatë gjithë jetës së tyre. Megjithëse plani synon të reduktojë varfërinë në personat e moshuar dhe të zgjerojë mbulimin me pension, ai nuk trajton hendekun gjinor në pensione dhe nuk propozon kompensim për punën e papaguar. Në mënyrë të ngjashme, megjithëse shpreh angazhimin ndaj shërbimit shëndetësor universal, në plan nuk trajtohet prevalenca më e madhe të sëmundjeve kronike, nevojat e shëndetit mendor dhe ngarkesa me punë përkujdesi tek gratë e moshuara. Gjithashtu, plani parashikon qendra ditore dhe rezidenciale për përmirësimin e përfshirjes sociale, por nuk specifikon se si do t'i mbështesin këto qendra gratë e moshuara, sidomos ato që jetojnë vetëm ose përballen me përjashtim social. Pa politika të ndjeshme gjinore, pabarazitë ekzistuese mund të vazhdojnë, duke kufizuar sigurinë ekonomike, aksesin në kujdes shëndetësor dhe pjesëmarrjen sociale të grave të moshuara. Forcimi i reformave të pensionit, të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe i masave të mbrojtjes sociale janë me rëndësi thelbësore për sigurimin e dinjitetit dhe mundësive të barabarta për gratë e moshuara në Shqipëri.

- **Strategjia Ndërsektoriale “Agjenda digjitale e Shqipërisë 2022-2026”** (miratuar me VKM nr. 370, datë 1.6.2022) thekson se inteligjenca artificiale do të vendoset në krye të agjendës së qeverisë për të siguruar që askush të mos mbetet pas në transformimin digjital – qytetarëve duhet t'u krijohen të gjitha mundësitë që të fitojnë aftësitë e nevojshme dhe të zhvillojnë talentet dhe aftësitë, duke promovuar në të njëjtën kohë barazinë gjinore dhe diversitetin. Procesi i transformimit gjinor ka kohë që ka filluar në Shqipëri dhe të gjithë aktorët publikë dhe privatë po punojnë me intensitet për të ndryshuar mendësinë e qytetarëve në lidhje me këtë

formë të re dhe të pashmangshme të komunikimit. Që nga viti 2020, qytetarët dhe bizneset aplikojnë përmes platformës digjitale e-Albania për një varg shërbimesh publike dhe punonjësit e administratës publike i mbledhin të gjitha dokumentet shtetërore për shërbimet e përdorura, duke i çliruar qytetarët nga detyrimi për të shkuar dhe për t'i marrë ato fizikisht në letër nga zyrat shtetërore. Megjithatë, ndonëse strategjia vë theksin mbi transformimin digjital, inovacionin dhe aksesin në teknologji, ajo nuk trajton dallimet gjinore në njohuri digjitale, në akses në TIK ose në përfshirjen e vajzave dhe grave në fushat SHTIM. Në të nuk përmenden shprehimisht politika digjitale specifike gjinore, si garantimi i mundësive për gratë në sipërmarrjet digjitale dhe në fushën e sigurisë kibernetike. Po kështu, strategjisë i mungojnë veprimet e fokusuara për trajtimin e rreziqeve me bazë gjinore në internet ose nismat për ngushtimin e dallimeve gjinore në akses digjital. Si koment i përgjithshëm, megjithëse dokumenti përpiqet të promovojë akses digjital universal, ai nuk përfshin konsideratat gjinore në objektivat dhe kornizën zbatuese të tij.

- **Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur (SNDM) 2022-2026** dhe Plani i saj i Veprimit (miratuar me VKM nr. 892, datë 27.12.2022) është dokumenti i dytë i politikave për drejtësinë për të mitur i hartuar nga Ministria e Drejtësisë, që synon zbatimin me efektivitet të të drejtave të tyre. Ai inkorporon parime të ndjeshme gjinore, sidomos për sa i përket mbrojtjes së vajzave dhe grave në sistemin e drejtësisë, dhe është i harmonizuar me korniza kombëtare dhe ndërkombëtare mbi të drejtat e fëmijëve dhe barazinë gjinore, duke theksuar një drejtësi që mban parasysh specifikat e të miturve dhe mbrojtjen e tyre nga dhuna, diskriminimi dhe shfrytëzimi. Megjithatë, ndonëse strategjia pranon cenueshmëritë me të cilat përballen vajzat, ajo nuk ka masa specifike, posaçërisht të fokusuara në trajtimin e dallimeve gjinore në sistemin e drejtësisë për të mitur. Nuk ka nisma të dedikuara për të forcuar ndihmën juridike që i përgjigjet nevojave gjinore, programe rehabilitimi ose riintegrimi për vajzat në moshë të mitur në konflikt me ligjin. Forcimi i mbledhjes së të dhënave sipas seksit dhe përfshirja e konsideratave gjinore në të gjitha reformat e drejtësisë do ta shtonin efektivitetin e saj.

- **Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023-2030** (miratuar me VKM nr. 542, datë 20.09.2023) është një dokument tjetër i rëndësishëm politikash që promovon përparimin në fushat TIK dhe SHTIM. Ajo synon: të shtojë efikasitetin dhe qëndrueshmërinë e sistemit për mbështetjen e kërkimit shkencor – të integruar në nivel ndërkombëtar – në të gjithë spektrin e fushave të shkencave natyrore, inxhinierike dhe teknologjike, mjekësore, bujqësore, sociale dhe humane; krijimin e një mjedisi që lehtëson mekanizmat e ndërveprimit dhe transferimit të teknologjive për bashkëpunim midis komunitetit të kërkimit, ekonomisë, inovacionit dhe institucioneve publike; dhe promovimin e kulturës së shkencës dhe inovacionit në edukim, për të siguruar një qasje didaktike me theks në praktikat kërkimore dhe projektet. Ajo njeh rëndësinë e rritjes së pjesëmarrjes së grave në shkencë dhe teknologji dhe synon të zvogëlojë barrierat që pengojnë hyrjen e grave dhe vajzave në fushat SHTIM. Megjithatë, ndonëse pranon ekzistencën e dallimeve gjinore, strategjisë i mungon një kornizë me përfshirje të plotë të këndvështrimit gjinor për sigurimin e përfshirjes së grave në kërkime shkencore, inovacion dhe role drejtuese në sektor. Për të shtuar ndjeshmërinë gjinore, strategjia duhet të përfshijë mekanizma për financime specifike, nisma për ndërtimin e kapaciteteve, dhe politikave që trajtojnë dallimet gjinore në kërkime shkencore dhe zhvillim teknologjik.
- **Strategjia Kombëtare e Rinisë 2022-2029**, ndër të tjera, përmban objektiva dhe masa për fuqizimin e vajzave dhe djemve adoleshente për të marrë pjesë në vendimmarrje përmes këshillave rinore. Strategjia thekson përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha politikat për rininë dhe siguron mundësi dhe pjesëmarrje të barabartë në vendimmarrje. Ajo trajton edhe DHBGJ-në, diskriminimin dhe përfshirjen sociale përmes mbështetjes së grupeve të cënueshme, ndër të cilët edhe vajzat e reja nga komunitetet e marginalizuara. Një varg programesh, si ato që mbështesin krijimin e këshillave rinorë, U-Report, Qytetet Miqësore për Fëmijët, UPSHIFT, PONDER, etj., kanë mbështetur edukimin mediatik dhe politik, aftësitë e arsyetimit dhe debatimit, si dhe dialogun me vajzat dhe djemtë për të pasur ndikim në marrjen e vendimeve për çështje që kanë lidhje

me ta. Grupi i deputetëve “Miqte e fëmijëve” (GDMF) është një grup parlamentar jopartiak i përbërë nga 48 deputetë dhe deputete, i kryesuar nga Kryetarja e Kuvendit, që i kushtohet mbrojtjes dhe avancimit të të drejtave të fëmijëve. Përmes takimeve me djem dhe vajza adoleshente, grupi trajton çështje si pabarazitë gjinore, diskriminimi dhe përjashtimi social. Ai promovon fuqizimin e grave të reja dhe vajzave në arsim, punësim, sipërmarrje dhe udhëheqje. GDMF luan një rol kyç në mbikëqyrjen e legjislacionit dhe të buxhetit, duke punuar nga afër me shoqërinë civile dhe fëmijët për të garantuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre

- **Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësi**

**(SKPA) 2023-2030** (VKM nr. 173, datë 24.03.2023) synon të krijojë vende pune dhe mundësi cilësore punësimi dhe aftësish në të gjithë vendin, mundësi cilësore arsimimi dhe formimi profesional për gratë dhe burrat, përfshirë të rejtat dhe të rinjtë, duke promovuar gjithëpërfshirjen dhe kohezionin social dhe duke forcuar sistemet e punës dhe të kualifikimit në treg. “Rritja e përfshirjes së grave në tregun e punës” është një masë prioritare e SKPA 2023-2030, me fokus mbi integrimin e grave joaktive përmes politikave me perspektivë gjinore të aftësimi, punësimit fleksibël dhe vetëpunësimit, dhe ofrimit të mbështetjes specifike për aktivizimin e tyre. Për këtë qëllim, do të ndërtohen mekanizma për identifikimin e nevojave dhe profileve të grave joaktive nëpërmjet administratorëve socialë dhe nëpunësve/nëpunësive gjinore në nivel vendor si dhe mekanizma për të ofruar mundësi aftësimi dhe punësimi në sektorë të ndryshëm ekonomikë, përfshirë dhe sektorët e përkujdesjes. Krahas kësaj, do të hartohen dhe zbatohen programe për rritjen e pjesëmarrjes së grave në tregun e punës rural dhe bujqësor duke ofruar informacion dhe mbështetje për të aksesuar dhe mundësuar marrjen e fondeve për zhvillim, si ato për zhvillimin rural, agroturizmin apo turizmin. Institucionet do të mbështesin gratë joaktive me sipërmarrjen dhe ekonominë sociale, prodhimin e produkteve vendore apo ekonominë e gjelbër, aktivitetet e biznesit online, si dhe vlerësimin e mundësisë së stimujve fiskalë në këta sektorë. Kjo strategji njeh përgjegjësitë e përkujdesit si barrierë, por nuk trajton shprehimisht nevojat e

konsiderueshme të paplotësuara për shërbime të kujdesit për fëmijët në Shqipëri – një nga faktorët kryesorë që shkaktojnë papunësinë, inaktivitetin dhe punën informale të grave.

- **Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore (PZGR)**

**2023-2027** (VKM nr. 173, datë 24.03.2023) ka në fokus nxitjen e punësimit të të rejave dhe të rinjve si një prej prioriteteve të qeverisë shqiptare. Ajo përmban masa që ofrojnë mundësi të denja punësimi, aftësimi, ose arsimimi për çdo të re ose të ri (të moshës 15-29 vjeç) brenda katër muajsh nga identifikimi i tyre, në përputhje me rekomandimet e BE-së. Ky angazhim është në përputhje me OZHQ 8 (Puna e denjë dhe rritja ekonomike) dhe OZHQ 4 (Arsimimi cilësor). Grupi i synuar janë të rejtat dhe të rinjtë, që nuk janë të arsim, punësim, ose aftësim profesional, duke qenë se niveli i papunësisë në radhët e këtij grupi është shumë i lartë. Pilotimi i PZGR-së filloi në vitin 2023 me mbështetjen e të rinjve dhe të rejave që nuk ishin në arsim, punësim apo aftësim profesional të regjistruar në zyrat e punës, të cilët përfituan nga një ofertë punësimi/aftësimi profesional/arsimimi brenda katër muajsh nga humbja e punës apo përfundimi i kursit të aftësimit profesional. Programi përbëhet nga dy faza, faza pilot (2023-2024), përfshin masa si organizimi dhe vënia në funksionim e strategjisë vendore për ndërgjegjësimin dhe regjistrimin e të rinjve dhe të rejave të këtij grupi; krijimi dhe testimi i sistemit IT të SKPA-së për të regjistruar të dhënat në kuadër të garancisë rinore; reformimi i kriterëve për implementimin e programeve për nxitjen e punësimit; dhe kryerja e ndryshimeve të nevojshme ligjore për grante për organizatat e rinisë. Rezultati i pilotimit do të shërbejë si bazë për zgjerimin e programit – në fazën e dytë – në vitet në vijim.

- **Plani Kombëtar i Veprimit për zbatimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Për gruan, paqen dhe sigurinë” 2023-2027**, që synon të përmirësojë institucionalizimin dhe të ndërtojë kapacitete për të siguruar që përpjekjet në kuadër të Agjendës GPS që jenë të qëndrueshme dhe me efekt afatgjatë. Zbatimi i qasjes gjinore në trajtimin e çështjeve humanitare, konflikteve dhe situatave pas konflikteve, krizave

apo fatkeqësive natyrore është një qasje progresive që pasqyron parimin se çdo njeri ka rolin e vet dhe mund të kontribuojë në zhvillimin e përgjithshëm dhe të qëndrueshëm të shoqërisë. Plani i Veprimit është i harmonizuar dhe në përputhje me OZHQ 5 dhe 16.

- **Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë (SKZRF) 2023-2030 (VKM nr. 94, datë 22.03.2023)** është e harmonizuar me Kornizën Sendai 2015-2030, e cila thekson një qasje gjithëpërfshirëse dhe me ndjeshmëri gjinore në menaxhimin e risqeve nga fatkeqësitë. Ajo njeh cenueshmëritë më të mëdha të grave, fëmijëve, të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara, dhe individëve LGBTIQ+, dhe integron parimet e barazisë gjinore përmes një objekti specifik, si dhe risqet si rezultat i përkatësive të shumfishta që lidhen me moshën, orientimin seksual, aftësinë e kufizuar dhe statusin social-ekonomik. Ndër angazhimet kryesore janë trajtimi me përparësi i nevojave të grave në planifikimin e reagimeve ndaj fatkeqësive, nxitja e rolit të tyre udhëheqës në ZRF, integrimi i barazisë gjinore në planet e veprimit vendor, dhe sigurimi i buxhetimit me ndjeshmëri gjinore. Zbatimi i kësaj strategjie lidhet me shumë OZHQ, ndër të cilat OZHQ 5 (Barazia gjinore) dhe OZHQ 13 (Veprimi për klimën), duke përforcuar rolin e grave në zhvillimin e qëndrueshëm. Megjithatë, Planit të saj të Veprimit i mungojnë aktivitetet konkrete që trajtojnë nevojat specifike të grave si dhe treguesit e ndjeshëm gjinorë për matjen e impaktit të saj. Për t'i realizuar me efektivitet këto angazhime, duhet të forcohet ekspertiza gjinore dhe ndërtimi i kapaciteteve në këtë fushë gjatë zbatimit dhe monitorimit të saj.
- **Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë 2023-2028** (miratuar me Ligjin nr. 14/2024, datë 08.02.2024) synon të pasqyrojë sfidat dhe kërcënimet kryesore ndaj sigurisë kombëtare të Shqipërisë dhe të përfshijë përgjigjet institucionale ndaj tyre. Strategjia trajton luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, menaxhimin e dhur të fatkeqësive natyrore, intensifikimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, forcimin e sundimit demokratik të ligjit, krijimin e një klime të favorshme për tërheqjen e investimeve të huaja të sigurta, si dhe zhvillimi arsimor dhe kulturor i vendit. Në strategji mungon njohja e risqeve të

sigurisë të lidhura me gjininë, si dhuna me bazë gjinore, roli i grave në fushat e paqes dhe sigurisë, dhe ndikimi i politikave të sigurisë tek gratë dhe grupet e cenueshme. Ajo nuk përfshin të dhëna të ndara sipas seksit, nisma të posaçme për nxitjen e pjesëmarrjes së grave në institucionet e sigurisë, apo masa për trajtimin e cenueshmërive specifike gjinore. Për të shtuar ndjeshmërinë ndaj aspekteve gjinore, strategjia duhet të përfshijë perspektivat gjinore në politikat e sigurisë, të promovojë rolet drejtuese të grave në fushat e mbrojtjes dhe të rendit, dhe të krijojë mekanizma për mbrojtjen e grave nga kërcënimet që lidhen me konfliktet dhe sigurinë.

- **Plani Kombëtar për Emergjencat Civile (PKEC) – miratuar me VKM nr. 807, datë 28.12.2023**

-identifikon rreziqet kritike që kanë potencialin më të madh për të ndikuar negativisht në zhvillimin e vendit: përmbytjet, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, çarjet e digave, zjarret masive dhe ortekët. Plani njihet barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale si tema ndërsektoriale, por i mungon një qasje plotësisht e zhvilluar me ndjeshmëri gjinore. Ndonëse thekson mbrojtjen për grupet e cenueshme, përfshirë gratë, plani nuk trajton risqet specifike për gratë dhe vajzat në përgjigje ndaj fatkeqësive dhe rimëkëmbjen pas tyre. Plani nuk përfshin të dhëna të ndara sipas seksit, nuk nxit rolin drejtues të grave në menaxhimin e emergjencave dhe nuk përmban masa të posaçme për t'iu përgjigjur cenueshmërive me bazë gjinore. Për të shtuar perspektivën gjinore, ai duhet të përfshijë politika reaguese gjinore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, trajnime gjinore për personelin, programe për ngritjen e kapaciteteve të grave dhe mekanizma për të siguruar pjesëmarrjen aktive të grave në planifikimin dhe vendimmarrjen në rast emergjencash.

- **Strategjia Ndërsektoriale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit dhe Planet e Veprimit 2023-2025**

(VKM nr. 81, datë 14.02.2023) përfaqësojnë vëmendjen e shtuar që po i kushtohet parandalimit të akteve terroriste, radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ato synojnë të krijojnë komunitete dhe institucione më të qëndrueshme, të rehabilitojnë dhe riintegrojnë personat e radikalizuar dhe të kthyerit nga zonat e konfliktit dhe familjet e tyre, të zhvillojnë komunikimin strategjik dhe të parandalojnë

radikalizimin përmes internetit. Për arritjen e vizionit të strategjisë, theksi do t'i vihet parandalimit të akteve terroriste përmes përdorimit të një përgjigjeje të bashkënduar nga institucionet shtetërore në bashkëpunim të ngushtë me komunitetin. Megjithatë, strategjia nuk njihet përmasat gjinore të ekstremizmit të dhunshëm, si roli i grave në parandalimin e radikalizimit, impakti i ideologjive ekstremiste tek gratë, dhe nevoja për programe rehabilitimi dhe riintegrimi me ndjeshmëri gjinore. Ai nuk përfshin të dhëna të ndara sipas seksit, mbështetje të posaçme për gratë e kthyer nga zonat e konfliktit, ose nisma për nxitjen e rolit drejtues të grave në përpjekjet për luftën kundër ekstremizmit. Forcimi i konsideratave gjinore përmes politikave të fokusuar, mekanizmave të specializuar të mbështetjes dhe angazhimeve institucionale ndaj integritimit gjinor do ta përmirësonin natyrën gjithë përfshirëse dhe efektivitetin e strategjisë.

- **Strategjia Ndërsektoriale për Mbrojtjen e Viktimave të Krimit 2024-2030 (SNMVK) – miratuar me VKM nr.729, datë 13.12.2023**

– synon fuqizimin e viktimave të veprave penale, duke garantuar mbështetje, mbrojtje dhe një mjedis të sigurt, me qëllim që të mbijetuarit dhe mbijetuarat të raportojnë krimet. Kjo strategji ndërsektoriale synon të përmirësojë aksesin në drejtësi, të vendosë një skemë kombëtare kompensimi dhe të lehtësojë aksesin e të mbijetuarve në kompensim, duke garantuar kompensimin e drejtë dhe të duhur të tyre. Ajo trajton çështje si informimi i viktimës, trajtimi i tij/saj me dinjitet për të parandaluar viktimizimin dytësor dhe të përsëritur, dhe mbështetja dhe mbrojtja e viktimave në çdo fazë të procesit dhe, kur është e nevojshme, edhe pas përfundimit të procesit penal. Perspektiva gjinore është përfshirë në përgatitjen, hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e SNMVK 2024-2030 dhe programet e shpenzimeve për promovimin e barazisë midis grave dhe burrave, luftimin e diskriminimit, dhe trajtimin e aspektit të përfaqësimit të grave dhe burrave në masat që lidhen me mbrojtjen e viktimave të krimit.

- **Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024-2030**

synon të nxisë sipërmarrjet në vend përmes një modeli të ri ekonomik që bazohet në inovacion dhe zhvillim gjithëpërfshirës, sidomos

përmes përfshirjes së grave në sipërmarrje. Strategjia përfshin dispozita për lehtësimin dhe mbështetjen e grave sipërmarrëse dhe u jep atyre përparësi në marrjen e granteve përmes pikëve të kualifikimit – në rastet kur burrat dhe gratë aplikante kanë pikë të barabarta, prioritet u jepet grave, çka tregon për një përkushtim ndaj barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave në ekosistemin e sipërmarrjes në Shqipëri.

- **Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2024-2030** (miratuar me VKM nr. 859, datë 26.12.2024) synon forcimin e integritetit, transparencës dhe llogaridhënien në sektorin publik dhe privat, me fokus mbi parandalimin, luftimin dhe ndërgjegjësimin në lidhje me korrupsionin. Objektivi specifik 3.4 thekson nevojën e rritjes së pjesëmarrjes së grave në identifikimin dhe luftimin e korrupsionit dhe trajtimin e formave të tij specifike gjinore, përfshirë mitdhënien dhe dhunën gjinore që lidhet me korrupsionin. Strategjia njeq dimensionin social-kulturor të korrupsionit dhe rolin qendror të grave në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të qëndrueshme. Ajo synon të forcojë transparencën institucionale, të forcojë politikat publike dhe të bashkëpunojë me shoqatat e barazisë gjinore për një analizë më të thelluar të impaktit të korrupsionit mbi gratë dhe vajzat.
- **Strategjia Kombëtare për Migracionin 2024-2030 dhe Plani i saj i Veprimit 2024-2026** (miratuar me VKM nr. 271, datë 02.05.2024) pranon rekomandimet ndërkombëtare, përfshirë ato të KEDG-së dhe GREVIO-s, që theksojnë mbrojtjen e të drejtave të grave. Ajo përfshin masa konkrete për gratë migrante, si rritja e aksesit të tyre në shërbime financiare, përmes informimit të tyre për të drejtat pronësore, zvogëlimin të barrierave ndaj pjesëmarrjes në tregun e punës (sidomos në fushat SHTIM), dhe përmirësimit të shërbimeve mbështetëse për të mbijetuarat e dhunës me bazë gjinore dhe trafikimit. Krahas kësaj, ajo i jep përparësi mbledhjes së të dhënave të ndara sipas seksit për të siguruar politikëbërje më të bazuar në informacion dhe më

të barabartë. Të gjitha së bashku, këto përpjekje synojnë të nxisin barazinë gjinore, të fuqizojnë gratë migrante dhe të eliminojnë dallimet në kornizën qeverisëse të migracionit në Shqipëri.

## Shtojca 2. Listë e detajuar e direktivave të BE-së sipas fushave tematike

### Fuqizimi ekonomik

- Strategjia e BE-së për Barazinë Gjinore 2020-2025, që thekson nevojën për trajtimin e shkaqeve që qëndrojnë në themel të pabarazisë gjinore përmes trajtimit të problemit të hendekut gjinor në paga dhe ndarjen gjinore në tregun e punës, si edhe përmes promovimit të balancës punë – jetë.<sup>460</sup>
- Shtylla Evropiane e të Drejtave Sociale, që promovon mundësi të drejta dhe të barabarta në tregun e punës përmes masave si shërbime më të aksesueshme dhe më të përbalueshme të kujdesit për fëmijët.<sup>461</sup>
- Udhërrëfytyesi i BE-së për të Drejtat e Grave (mars 2025), që është dokumenti më i fundit që përforcon angazhimin e Komisionit Evropian për barazinë gjinore, i cili paraqet një vizion afatgjatë për progresin në këtë fushë. Udhërrëfytyesi ndërton mbi përparimin e konsiderueshëm të bërë në kuadër të Strategjisë për Barazinë Gjinore 2020-2025 dhe synon të hapë rrugën për tetë objektivat kyçe, ndër të cilat: paga të barabarta dhe fuqizim ekonomik; balanca punë-jetë dhe përkujdes; dhe mundësi të barabarta punësimi dhe kushte pune të përshtatshme.
- Strategjia Evropiane për Përkujdesin (2022), që synon të garantojë shërbime përkujdesi cilësore, të përbalueshme dhe të aksesueshme në të gjithë shtetet e BE-së dhe të përmirësojë situatën si të përfituesve të përkujdesit ashtu edhe të personave që kujdesen për ta, profesionalisht apo në mënyrë informale.<sup>462</sup>
- Krahas këtyre, në nivelin e BE-së janë miratuar një numër

460. Komisioni Evropian (2020), Komunikatë e Komisionit –Një bashkim i barazisë: Strategjia e Barazisë Gjinore 2020-2025 (COM(2020)

461. Komisioni Evropian (2019), Shtylla Evropiane e të Drejtave Sociale, [https://employment-social-affairs.ec.europa.eu/policies-and-activities/european-pillar-social-rights-building-fairer-and-more-inclusive-european-union\\_en](https://employment-social-affairs.ec.europa.eu/policies-and-activities/european-pillar-social-rights-building-fairer-and-more-inclusive-european-union_en)

462. Komisioni Evropian (2022), Strategjia Evropiane për Përkujdesin, [https://employment-social-affairs.ec.europa.eu/news/european-care-strategy-caregivers-and-care-receivers-2022-09-07\\_en](https://employment-social-affairs.ec.europa.eu/news/european-care-strategy-caregivers-and-care-receivers-2022-09-07_en)

direktivash, të cilat kanë synimin e drejtpërdrejtë të mbrojnë të drejtat e grave në tregun e punës. Ndër to janë:

- 'Direktiva 2006/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 korrik 2006 mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe **trajtimin të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit** (e re).'
- 'Direktiva (BE) 2023/970 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 10 maj 2023 për forcimin e zbatimit të parimit të pagës së barabartë për punë të barabartë ose punë me vlerë të barabartë midis burrave dhe grave **nëpërmjet transparencës së pagave dhe mekanizmave të zbatimit.**'
- 'Direktiva (BE) 2019/1158 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 qershor 2019 për **balancën punë-jetë për prindërit dhe kujdestarët** dhe që shfuqizon Direktivën e Këshillit 2010/18/EU.'
- 'Direktiva e Këshillit 92/85/EEC e datës 19 tetor 1992 për futjen e masave për nxitjen e përmirësimeve në **sigurinë dhe shëndetin në punë të punëtoreve shtatzëna dhe punëtoreve që kanë pak kohë që kanë lindur, apo që kanë fëmijë në gji.**'
- 'Direktiva e Këshillit 79/7/EEC e datës 19 dhjetor 1978 për zbatimin progresiv të parimit **të trajtimit të barabartë për gratë dhe burrat në çështjet e sigurimeve shoqërore.**'
- 'Direktiva 2010/41/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 7 korrik 2010 për zbatimin e **parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave të vetëpunësuar.**'
- 'Direktiva e Këshillit Nr. 2004/113/EC e datës 13 dhjetor 2004 mbi zbatimin e parimit **të trajtimit të barabartë për burrat dhe gratë në lidhje me aksesin dhe ofrimin e mallrave dhe shërbimeve.**'
- 'Direktiva (BE) 2022/2381 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 nëntor 2022 për **përmirësimin e balancës gjinore ndër drejtuesit e shoqërive tregtare të listuara në bursë dhe masat e lidhura me to.**'

- 'Direktiva (BE) 2024/1500 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 maj 2024 për standardet për organet e barazisë në fushat e **trajtimin të barabartë dhe mundësive të barabarta të grave dhe burrave për çështje të punësimit dhe profesionit**, që ndryshon Direktivat 2006/54/EC dhe 2010/41/EU'
- 'Direktiva (BE) 2022/2464 për Raportimin e Korporatave lidhur me Qëndrueshmërinë.'

## Roli udhëheqës dhe pjesëmarrja e grave në politikë

- 'Direktiva 2006/54/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 5 korrik 2006 mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimin të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe profesionit (e re)'<sup>463</sup> siguron trajtim të barabartë në punësim, përmes ndalimit të diskriminimit me bazë gjinore dhe nxitjes së progresit në karrierë dhe në role drejtuese. Ajo trajton gjithashtu edhe diskriminimin e tërthortë që mund të kufizojë përparimin e grave në karrierë drejt roleve drejtuese. Ligji "Për barazinë gjinore në Shoqëri" (2008) është i harmonizuar me këtë direktivë përmes garantimit të aksesit të barabartë në punësim, avancimit të grave në karrierë dhe role drejtuese. Kodi i Punës i Shqipërisë ndalon diskriminimin gjinor në marrje në punë dhe në kushtet e punës. Komisioneri për Mbrojtje nga Diskriminimi (KMD) garanton zbatimin e politikave kundër diskriminimit në vendin e punës. Megjithatë, zbatimi i legjislacionit vazhdon të jetë sfidë, duke pasur parasysh se ende ekziston hendek gjinor në paga dhe nënperfaqësim i grave në role drejtuese ekzekutive në sektorin privat.
- 'Direktiva (BE) 2019/1158 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 qershor 2019 mbi balancën punë-jetë për prindërit dhe kujdestarët, që shfuqizon Direktivën e Këshillit 2010/18/EU'<sup>464</sup> trajton barrierat strukturore përmes promovimit të përgjegjësive të përbashkëta prindërore duke ua bërë të mundur më shumë grave që të aplikojnë dhe të kenë role drejtuese. Ajo mbështet barazinë gjinore përmes përmirësimit të lejes prindërore për baballarët dhe balancës punë-jetë, gjë që i ndihmon

463. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2006/54/oj/eng>

464. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2019/1158/oj/eng>

gratë të avancojnë në karrierë dhe të marrin role drejtuese. Shqipëria ka të parashikuar me ligj lejen e barrëlindjes me pagesë (365 ditë, me 80 për qind të pagës për gjashtë muajt e parë) si dhe lejen prindërore për baballarët. Kodi i Punës mundëson punën fleksibel për prindërit dhe kujdestarët. Megjithatë, leja prindërore mbetet e nënshfrytëzuar nga baballarët, sepse normat gjinore tradicionale shkurajojnë marrjen e lejes nga burrat. Politikat e vendit të punës nuk inkurajojnë fuqimisht ndarjen e përgjegjësive prindërore, gjë që ndikon përparimin e grave në karrierë.

- **‘Direktiva 2010/41/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 7 korrik 2010 për zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë të burrave dhe grave të vetëpunësuar, që shfuqizon Direktivën e Këshillit 86/613/EEC’<sup>465</sup>** garanton barazinë gjinore për personat e vetëpunësuar, ku përfshihet akses në ndihma për amësinë që mund të ndikojë në aftësinë e grave për t’u përfshirë në role vendimmarrëse. Në Shqipëri, Ligji “Për sigurimet shoqërore” u ofron grave të vetëpunësuar akses në **pagesa për barrëlindje**. Megjithatë, gratë sipërmarrëse përballen me barriera për të pasur akses në financime dhe mundësi investimi për bizneset e tyre.
- **‘Direktiva (BE) 2022/2381 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 23 nëntor 2022 për përmirësimin e balancës gjinore ndër drejtuesit e shoqërive tregtare të listuara në bursë dhe masat e lidhura me to (tekst me relevancë për Zonën Ekonomike Evropiane)’<sup>466</sup>** është një hap i rëndësishëm drejt vendimmarrjes me pjesëmarrje të balancuar gjinore. Ajo përcakton se kompanitë e listuara në bursë duhet të garantojnë që gratë të kenë të paktën 40 për qind të vendeve në bordet joekzekutive, ose 33 për qind të të gjitha vendeve në borde deri në **korrik 2026**. Kjo direktive nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me politikën, por pasqyron angazhimin e BE-së për balancë gjinore në vendimmarrje. Në Shqipëri, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore nxit rolin drejtues të grave në biznes, por nuk

ka kuota të detyrueshme ligjore për gratë në bordet e korporatave. Përfaqësimi i grave në pozitat e larta ekzekutive është e kufizuar në shoqëritë tregtare private dhe nuk ka sanksione të forta apo mekanizma detyrues të zbatimit për shoqëritë tregtare që nuk përmirësojnë balancën gjinore.

- **‘Direktiva (BE) 2024/1385 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 14 maj 2024 për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe dhunës gjinore’<sup>467</sup>** thekson ndikimin negativ të dhunës kibernetike tek gratë politikane dhe kërkon vendosjen e rregullave minimale në BE në lidhje me veprën penale të ngacmimit kibernetik. Në Shqipëri, Ligji “Për barazinë gjinore”, i ndryshuar, ofron mbrojtje ligjore kundër dhunës me bazë gjinore, por është ende e nevojshme që të bëhet harmonizimi në lidhje me dhunën dhe dhunën kibernetike ndaj grave politikane. Krahas kësaj, duhet të planifikohen trajnime të specializuara për punonjësit e agjencive ligjzbatuese në lidhje me dhunën me bazë gjinore në mjedisin digjital.

## Ndryshimet klimatike

Institucionet e BE-së pranojnë ndikimet e diferencuara gjinore që shpesh bëjnë që gratë të jenë më të rrezikuara dhe më të cenueshme. Në vijim paraqiten disa prej dokumenteve kryesore të politikave të BE-së mbi ndryshimet klimatike, ZRF dhe barazinë gjinore:

- Përfundimet e Këshillit Evropian mbi ndryshimet klimatike dhe zhvillimin (2009), theksojnë ‘përmasën njerëzore të ndryshimeve klimatike, përfshirë edhe perspektivën gjinore, dhe se të varfrit janë më të rrezikuarit dhe se duhet të forcohet aftësia e tyre ripërtëritëse përballë ndryshimeve klimatike’. Dokumenti gjithashtu thekson nevojën për të siguruar që në hartimin e strategjive të përshtatjes “vëmendje e veçantë i duhet kushtuar barazisë gjinore dhe fuqizimit të grave.”<sup>468</sup>
- Përfundimet e Këshillit mbi barazinë gjinore dhe

465. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2010/41/oj/eng>

466. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2022/2381/oj/eng>

467. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2024/1385/oj/eng>

468. Këshilli i Bashkimit Evropian (2009). *Përfundime në lidhje me ndryshimet klimatike dhe zhvillimin*. Shih: [https://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms\\_data/docs/pressdata/en/ec/108622.pdf](https://www.consilium.europa.eu/uedocs/cms_data/docs/pressdata/en/ec/108622.pdf)

mjedisin (2012), ku thuhet që përparimi në vendim-marrje, kualifikime dhe konkurrueshmëri në fushën e politikave për zbutjen e ndryshimeve klimatike në BE, luan rol të rëndësishëm në fokusin që u kushtohet çështjeve gjinore në të gjitha politikat mjedisore të BE-së.<sup>469</sup>

- Rezoluta e Parlamentit Evropian e 20 prillit 2012 mbi gratë dhe ndryshimet klimatike (2012) trajton shprehimisht zbulimin e lidhjes midis ndryshimeve klimatike dhe seksit, dhe u bën thirrje “Komisionit dhe Këshillit që, për të siguruar që veprimet klimatike të mos i shtojnë pabarazitë gjinore por të rezultojnë në bashkëpërfitim në situatën e grave, të përfshijnë dhe integrojnë gjininë në çdo hap të politikave klimatike, që nga konceptimi deri tek financimi, zbatimi, dhe vlerësimi i tyre ...”<sup>470</sup>
- Rezoluta e Parlamentit Evropian për rolin e grave në ekonominë e gjelbër (2012) përfshin një numër rekomandimesh në lidhje me aspektet gjinore të mjedisit dhe ekonomisë së gjelbër në përgjithësi, si edhe rekomandime praktike në lidhje me konsumin e qëndrueshëm, transportin e qëndrueshëm, sektorin e asistencës shoqërore, vendet e punës ‘të gjelbra’, dhe politikat e qëndrueshme në politikat ndërkombëtare.<sup>471</sup>

Programi i Tetë i Veprimit Mjedisor (PTVM) (2022), që është programi më i fundit i BE-së në këtë fushë, njeh ndikimet specifike gjinore të ndryshimeve mjedisore. Ai pranon faktin se rolet e diferencuara gjinore shkaktojnë cenueshmëri të diferencuara të grave dhe burrave edhe për sa i përket ndikimit të ndryshimeve klimatike, dhe se ndryshimet klimatike i përkeqësojnë pabarazitë gjinore ekzistuese.

PTVM kërkon posaçërisht përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha politikat për klimën dhe mjedisin, ndër të tjera edhe përmes përfshirjes së perspektivës gjinore në të gjitha fazat e procesit të vendim-marrjes<sup>472</sup>

### Shtojca 3. Analizë e legjislacionit dhe politikave që trajtojnë dhunën me bazë gjinore

Shqipëria ka një ligj të posaçëm mbi dhunën me bazë gjinore dhe disa nga format kryesore të dhunës ndaj grave kanë vite që penalizohen. Megjithatë, ende ekziston nevoja për përmirësime të mëtejshme për harmonizimin e plotë me kërkesat dhe standardet ndërkombëtare dhe legjislacionin e BE-së.

Në vitin 2020, Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa kundër dhunës në marrëdhëniet familjare” (me Ligjin 125/2020), iu bënë ndryshime të rëndësishme për forcimin e mbrojtjes nga DHF. Ndër këto ndryshime ishin përdorimi i një qasjeje me ndjeshmëri gjinore, që thekson garanci të posaçme për gratë, vajzat, fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara (neni 1), dhe kërkesa për largimin e menjëhershëm të dhunuesit nga banesa në rastin kur ai jetonte në të njëjtën shtëpi si viktima (neni 10). Vendimi për largimin e dhunuesit nga shtëpia merret nga gjykata dhe nga policia, përmes urdhrit për masë paraprake të mbrojtjes së menjëhershme (UMPMM) deri në lëshimin nga gjykata të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrit të mbrojtjes, përveç rastit kur dhunuesi është i mitur ose i moshuar, ose person me aftësi të kufizuara (neni 13/2). Në këto ndryshime theksohet edhe rehabilitimi i dhunuesit (neni 10/1). Disa nga ndryshimet e vitit 2020 u bënë edhe me qëllim që të trajtohej problemi i DHF në situata emergjencash civile, duke filluar që nga kriza e pandemisë COVID-19 (neni 13/1, pika 3/1). Në ligj theksohet edhe detyrimi për të respektuar parimet e mishëruara në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, KEGJFDG, Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje dhe në instrumentet e tjera ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë (neni 3/1).

Edhe **Kodi Penal** u ndryshua në vitin 2020 (Ligji nr. 35, datë 16.04.2020), me përfshirjen e dispozitave për kriminalizimin e dhunës psikologjike dhe përfshirjen e partnerëve intimë ekzistues ose të mëparshëm

469. Këshilli i Bashkimit Evropian (2012). *Përfundime në lidhje me barazinë gjinore dhe mjedisin*. Shih: <https://www.cedefop.europa.eu/en/news/council-conclusions-gender-equality-and-environment-enhanced-decision-making>

470. Shih: [https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-7-2012-0145\\_EN.html](https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-7-2012-0145_EN.html)

471. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A52012IP0321>

472. Vendim (BE) 2022/591 i Parlamentit Evropian dhe i Këshillit i datës 6 prill 2022 për një program të përgjithshëm veprimi për mjedisin deri në vitin 2030. Shih: <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32022D0591&from=EN>

–pavarësisht nëse janë ose jo bashkëjetues – në kategorinë e viktimave të DHF. Këto ndryshime harmonizojnë përmbajtjen e nenit 130/a të Kodit Penal me nenin 3 të Konventës së Stambollit. Gjithashtu, ndryshimet parashikojnë dënime më të rënda për autorët e DHF. Megjithatë, përkufizimi i përdhunimit në Kodin Penal vazhdon të jetë i bazuar në përdorimin e forcës ose të kërcënimeve nga dhunuesi, dhe jo në mungesën e pëlqimit, që nuk është i harmonizuar me kërkesat e Konventës së Stambollit.

Në ndryshimet e Ligjit **nr. 10221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”** në vitin 2020 (ndryshuar me Ligjin nr. 124/2020, datë 15.10.2020), u fut koncepti i “shqetësimit seksual” si formë e padëshiruar e sjelljes verbale, joverbale, ose krijim i një mjedisi frikësues, armiqësor, degradues, poshtëruës ose fyes. Kjo është në përputhje me dispozitat e Konventës së Stambollit, ndërsa ndryshimet në përgjithësi janë të mirëharmonizuara me direktivat e BE-së kundër diskriminimit, sidomos Direktiva 2000/43/EC (Direktiva për barazi racore), Direktiva 2000/78/EC (Direktiva për barazi në punësim), Direktiva 2006/54/EC (Direktiva për barazi gjinore në punësim) dhe Direktiva 2004/113/EC (Direktiva për barazi gjinore në lidhje me aksesin në mallra dhe shërbime).

Në vitin 2021, u miratua një **Vendim i Këshillit të Ministrave (No.327/2021)** – VKM nr. 327, datë 02.06.2021 – për përmirësimin e funksionimit të mekanizmit të koordinuar të referimit (MKR) për rastet e dhunës në familje. Ai kishte për qëllim zbatimin e një qasjeje të koordinuar shumësektoriale për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, bazuar edhe në rekomandimet e GREVIO-s dhe të KEDG-së. Krahas qartësimin të mëtejshëm të roleve dhe përgjegjësi të institucioneve dhe profesionistëve për menaxhimin efektiv të rasteve të dhunës në familje, ky vendim krijon hapësirë për zbatimin e aspekteve të menaxhimit të rasteve të DHF-së nga MKR-ja, edhe në rastet e formave të tjera të dhunës me bazë gjinore ndaj grave. Ky VKM është gjithashtu pjesërisht i harmonizuar me Direktivën (BE) 2024/1385 mbi luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje; megjithatë, trajtimi i problemit të dhunës ndaj grave në internet vazhdon të jetë mangësi në funksionimin e MKR-së.

**Ligji nr. 13/2022, datë 3.2.2022, “Për ratifikimin e Konventës së Organizatës Ndërkombëtare të Punës**

**nr. 190 mbi dhunën dhe ngacmimin”** që hyri në fuqi në Shqipëri më 6 maj 2023, parashikon masa për mbrojtjen e punonjësve nga çdo formë dhune, ngacmimi ose sjelljeje që dëmton, kërcënon, ose fyen dinjitetin e tyre, përfshirë dhunën fizike, seksuale dhe psikologjike në mjedisin e punës. Ky përkufizim mbulon të gjithë personat që punojnë, përfshirë stazhierët dhe praktikantët, punëdhënësit, sektorin publik dhe privat, ekonominë formale dhe informale, si dhe zonat rurale dhe urbane. Shqipëria do të duhet të ndërmarrë masa efektive me qëllim që të gjitha viktimat të kenë akses të sigurt, të drejtë dhe efektiv në mekanizmat dhe procedurat për raportimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në rastet e dhunës dhe ngacmimin në botën e punës, përfshirë dhunën me bazë gjinore.

**Ligji nr. 62/2022 “Për regjistrin kombëtar të të dënuarve për krime seksuale”** synon të rrisë sigurinë për fëmijët, vajzat dhe gratë dhe mbrojtjen e tyre nga sulmet seksuale, përmes publikimit të regjistrit të personave të dënuar për krime seksuale. Ky ligj është pjesërisht i harmonizuar me direktivat e BE-së për parandalimin e dhunës seksuale (Direktiva 2011/93/EU), për të drejtat e viktimave (Direktiva 2012/29/EU), dhe Rregulloren e Përgjithshme për Mbrojtjen e të Dhënave – Rregullorja (BE) 2016/679.

Një ndër ndryshimet e vitit 2023 në Ligjin **nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”** (ndryshuar me Ligjin nr. 30/2023) ishte përkufizimi i seksizmit në media dhe ndryshimet janë të harmonizuara me Direktivën 2010/13/EU “Direktiva për mediat audiovizive” ndryshuar me Direktivën 2018/1808 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit Evropian, që garanton specifikisht mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore, si dhe respektin për dinjitetin njerëzor në transmetimet audiovizuale.

Qëllimi i tretë strategjik i **Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030** fokusohet në “Reduktimin e të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.” Strategjia ofron një qasje gjithëpërfshirëse për trajtimin e dhunës në familje dhe të gjitha formave të dhunës ndaj grave; thekson aspektin diskriminimit për shkak të përkatësisë së shumëfishtë (përkatësia e shumëfishtë; njeh sfidat me të cilat përballen vajzat dhe gratë nga grupe të caktuara jo vetëm për shkak të seksit, por edhe për shkak të fak-

torëve të tjerë; dhe u kushton rëndësi të veçantë grave dhe vajzave, në të gjithë diversitetin e tyre, sidomos atyre nga zonat rurale dhe të pafavorizuara, pakicat etnike, personat me aftësi të kufizuara, LGBTIQ+, nënat e vetme, personat e trafikuar, personat e moshuar, migrantët dhe azilkërkuesit.

Masat e parashikuara nën objektivat specifike të këtij qëllimi përfshijnë përmirësimin e legjislacionit dhe zbatimin efektiv të tij; sigurimi i shërbimeve të specializuara mbështetëse për viktimat/të mbijetuarat; rritja e ndërjegjësimit; mbështetja financiare për OJQ-të e specializuara që fokusohen në këtë çështje; forcimi dhe përmirësimi i punës dhe efektivitetit të MKR-ve; përmirësimi i mbledhjes së të dhënave; ndëshkimi i autorëve të dhunës dhe ngritja e programeve të rehabilitimit; përmirësimi i aksesit të viktimave/të mbijetuarave në drejtësi dhe integrimi i tyre; sigurimi i shërbimeve cilësore të shëndetit seksual dhe riprodhues, etj. SKBGJ 2021-2030 është e lidhur me Strategjinë e BE-së për Barazinë Gjinore 2020-2025 dhe bazohet veçanërisht në objektivat dhe masat e parashikuara në Planin e Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore (PVGJ III) 2021-2025, si dhe në Direktivën (BE) 2024/1385 "Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje".

**Plani Kombëtar i Veprimit (PKV) për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2021-2023** (miratuar me VKM nr. 670, datë 10.11.2021) dhe ai për vitet **2024-2025** përvijojnë shërbime të specializuara mbështetëse, ndihmë juridike, asistencë psikologjike dhe programe të posaçme riintegrimi për gratë dhe vajzat viktime të trafikimit. Gjithashtu, këto plane integrojnë një qasje me ndjeshmëri gjinore dhe me në qendër viktimën në të gjitha përpjekjet për parandalim, mbrojtje dhe ndjekje penale. **PKV 2024-2025** ruan elementë të rëndësishëm që lidhen me përfshirjen e agjencive shtetërore dhe joshtetërore dhe zbatimin e veprimeve të parashikuara në të gjithë Shqipërinë, duke theksuar forcimin e kapaciteteve dhe strukturave në nivele qendrore dhe vendore dhe masat për mbrojtjen e grave, vajzave dhe fëmijëve.

Këto plane janë të harmonizuara me direktivat e BE-së, sidomos me Direktivën 2011/36/EU (Direktiva kundër trafikimit e BE-së), Direktiva 2012/29/EU (Direktiva për të drejtat e viktimave), dhe Direktiva 2009/52/EC (Direktiva

për masat kundër punëdhënësve për punë të detyruar). Planet janë gjithashtu të harmonizuara me Konventën e Stambollit dhe rekomandimet e Grupit të Ekspertëve për Veprim kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, që forcon progresin e Shqipërisë drejt anëtarësisë në BE. Megjithatë, ende ka mangësi në riintegrimin e viktimave, zbatimin e mbrojtjeve në vendin e punës dhe bashkëpunimin ndërkuftar. Forcimi i këtyre fushave do të jetë me rëndësi kyçe për harmonizimin e plotë me standardet e luftës kundër trafikimit.

**Tre dokumente mbi procedurat standarde të veprimit, të miratuara** në vitin 2020, shërbejnë për forcimin dhe rritjen e efektivitetit të MKR-ve në vend:

1. Procedurat standarde të veprimit (PSV) për punonjësit e shëndetësisë (miratuar me Urdhrin nr. 101, datë 21.02.2020, të MSHMS-së) trajtojnë çështjet që duhet të kenë parasysh punonjësit e shëndetësisë dhe hapat që duhet të ndjekin, pavarësisht nëse janë shërbime parësore, dytësore apo tretësore (ndonëse këto të fundit kanë më pak gjasa të hasin ose të përfshihen në trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave). Shërbimet e kujdesit shëndetësor në këtë rast janë anëtarët e MKR-së për rastet e dhunës në familje në nivel vendor.
2. PSV-të për punonjësit socialë (miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 21.02.2020, të MSHMS-së), trajtojnë çështjet që duhet të kenë parasysh dhe hapat që duhet të ndjekin punonjësit socialë, që në këtë rast konsiderohen anëtarë të MKR-ve për rastet e dhunës në familje në nivel vendor.
3. PSV-të për punonjësit e shërbimit shëndetësor për reduktimin e riskut të përjetimit të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në situata të emergjencave civile (miratuar me Urdhrin nr. 102, datë 21.02.2020, të MSHMS-së) trajtojnë hapat që duhet të ndjekë sektori i shëndetësisë për planifikimin, monitorimin, koordinimin, zbatimin dhe vlerësimin e veprimeve bazë për parandalimin dhe reduktimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore në situata të emergjencave civile. Parimet e theksuar në PSV janë të harmonizuara me ato të Konventës së Stambollit, si dhe pjesërisht me Direktivën (BE) 2024/1385 "Për luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje".

**“Protokolli i funksionimit të qendrave rezidenciale publike dhe jopublike që ofrojnë shërbimin e strehimit (strehëzat) për viktimat e dhunës në familje dhe trafikimit në situatën e pandemisë së COVID-19”** miratuar në vitin 2020 me Urdhrin nr. 254, datë 10.04.2020 të MSHMS-së, i cili synon që t’u vijë në ndihmë ofruesve të shërbimeve për të funksionuar sa më efektivisht në përputhje me kufizimet për shkak të masave parandaluese. Zbatimi i protokollit të emergjencës së COVID-19 për strehëzat ka ndihmuar personelin e strehëzave në ofrimin e shërbimeve të nevojshme për viktimat e dhunës në familje dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore pa rrezikuar shëndetin ose jetën e tyre ose të viktimave të tjera që përfitojnë nga shërbimet, të familjeve të tyre dhe të komunitetit në përgjithësi. Pjesë e këtij protokollit ishin standardet minimale të veprimit sipas Konventës së Stambollit dhe përshtatja e tyre me situatën e emergjencës për shkak të COVID-19.

